RAPORTI PËRFUNDIMTAR

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
PËR PLANIN E INTEGRUAR PËR BASHKINË
POGRADEC



KONSORCIUM BOLLES + WILSON
GMBH&CO IDRA sh.p.k

Përfaqësues
Enkelejda Pashaj

_____

Vlerësues
Sazan Guri

_____

PËRMBAJTJA

SEKSIONI 1 PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE 13

1.1 HYRJE 13

1.2 KUADRI I VLERËSIMIT 14

1.3 OBJEKTIVAT E VSM 14

1.4 HAPAT E RRADHËS 17

PARATHËNIE 18

SEKSIONI – 2 HYRJE 20

2.1 ÇFARË ËSHTË VSM 20

2.2 KUADRI LIGJOR i VSM 20

2.3 FAZAT KYÇ TË PROCESIT TË VSM-SË 21

SEKSIONI - 3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT 24

3.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE 24

3.2 OBJEKTIVAT E VSM PËR BASHKINË POGRADEC 33

3.3KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR 35

3.4 LEGJISLACIONI MJEDISOR 36

3.5 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË 47

3.6 ANALIZA, NISMA DHE PROGRAME ZBATIMI 59

SEKSIONI 4 PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT 86

4.1 MJEDISI ATMOSFERIK 86

4.2 KLIMA 92

4.3 NDËRTIMI GJEOLOGJIK 99

4.4 MJEDISI UJOR 101

4.5 MORFOLOGJIA, TOPOGRAFIA DHE RELIEVI 111

4.6 BIODIVERSITETI - FLORA DHE FAUNA 113

4.7 TIPET E GJEOMONUMENTEVE TË BASHKISË SË POGRADECIT 133

4.8 INFRASTRUKTURA MJEDISORE 149

4.9 ENERGJIA 161

4.10 PRESIONET NATYRORE 168

4.11 KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE NË BASHKINË POGRADEC 182

4.12 ASPEKTE GJEOMJEDISORE TË BASHKISË POGRADEC 184

4.13 PASURITË MINERALE TË BASHKISË PPOGRADEC 191

4.14 POPULLSIA 196

4.15 PROJEKTET PILOTË 199

SEKSIONI 5 TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0") 203

5.1 Toka 203

5.2 Ajri 203

5.3 FAKTORËT KLIMATIKË 204

5.4 UJI 205

5.5 BIODIVERSITETI 205

5.6 MBETJET 205

5.7 ZHURMA 206

5.8 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE 206

5.9 TRASHËGIMIA KULTURORE 207

5.10 PEIZAZHI 207

5.11 SEGMENTI I KORRIDORIT EKOLOGJIK URBAN (KEU), LIN - POGRADEC - TUSHEMISHT 207

SEKSIONI 6 BAZA PËR PERGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR 211

6.1 PERCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE 211

6.2 METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS 223

SEKSIONI 7 VLERËSIMI i PËRPUTHSHMERISË SË OBJEKTIVAVE 238

7.1 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMERISË 238

7.2 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE DHE POLITIKAVE TË PLANIT ME OBJEKTIVAT .. 238

SEKSIONI 8 VLERËSIMI i PROJEKTEVE 244

8.1 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTEVE 244

8.2 KRAHASIMI I PROJEKTEVE PRIORITARE PËR BASHKINË E POGRADECIT 244

SEKSIONI 9 VLERËSIMI i NDIKIMEVE MJEDISORE 262

9.1 VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMET E PASOJAVE TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT 262

9.2 IMPAKTET KUMULATIVE 280

9.3 IMPAKTET NDËRKUFITARE 281

SEKSIONI 10 UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE 282

10.1 TOKA 282

10.2 AJRI 284

10.3 Faktorët klimatikë 285

10.4 PËRSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE 286

10.5 UJI 287

10.6 MJEDISI NATYROR 289

10.7 MBETJET 291

10.8 ZHURMAT 293

10.9 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE 294
10.11 PEISAZHI 295
SEKSIONI 11 MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS 299
SEKSIONI 12 PËRFUNDIME DHE MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH 304
12.1 PËRFUNDIME..... 304
12.2 MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH 312
SHTOJCAT SHTOJCA 01: PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA DHE TAKIMI PUBLIK 324

FIGURAT

Figure 1 Grafiku i vlerave vjetore te SO2
Figure 2 Grafiku i vlerave vjetore te NO2
Figure 3 Grafiku i vlerave vjetore te PM10
Figure 4 Perqendrimi i NO ne Tirane-
Figure 5 Grafiku i numrit të ditëve që tejkalon standartin ditor të BE-së për PM10
Figure 6 Vlerat mesatare vjetore te PM 2.5
Figure 7 Grafiku i vlerave vjetore te O3 ne qytetet kryesore
Figure 8 Vlerat vjetore te CO
Figure 9 LAeq/dite ne qytetet kryesore krahasuar me normat e BE
Figure 10 Ndryshimet vjetore te temperatures
Figure 11 Permbajtja e fosforit total
Figure 12 Harta Fizike e Shqiperise
Figure 13 Harta gjeologjike e Shqiperise dhe Harta tektonike
Figure 14 Harta e zonave te mbrojtura
Figure 15 Harta e Impjanteve te trajtimit te ujerave te zeza
Figure 16 Tendenca e Gjenerimit te mbetjeve urbane, inerte dhe ne total
Figure 17 Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori
Figure 18 Konsumi final i energjisë elektrike sipas çdo sektori
Figure 19 Konsumi final i produkteve të naftës sipas sektorëve
Figure 20 Grafiku i bilancit te pergjitshem te energjise
Figure 21 Energjia e instaluar e HEC-eve per cdo basen ujor
Figure 22 Harta e Hidrocentraleve te Shqiperise
Figure 23 Harta e rrezikut nga zjarri
Figure 24 Harta e permbytjeve ne Shqiperi
Figure 25 Harta e erozionit dhe Harta e rrezikut gjeologjik ne Shqiperi

Figure 26 Harta e rrezikut sizmik dhe Harqet kryesore sizmike

Figure 27 Piramida e popullsise, 01.01.2015

Figure 28 Popullsia urbane/rurale e Shqiperise 2001 - 2015

Figure 29 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore e popullsise, 2001 - 2014

Figure 30 Trendi i emigracionit 1990 - 2010

Figure 31 Migracioni M/F sipas rajoneve (te ardhur)

Figure 32 Migracioni M/F sipas rajoneve (te larguar)

Figure 33 PBB dhe rritja ekonomike 2010 - 2013

Figure 34 Ndryshimi i PBB per fryme 2005 - 2014

Figure 35 Grafiket paraprak te PBB

Figure 36 Papunesia ne % te forces se pergjithshme puntore

Figure 37 Punesimi sipas aktiviteteve ekonomike 2014

TABELAT

Tabela 1 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Tabela 2 Atraksionet më të preferuara

Tabela 3 Rezultatet e Monitorimit per tre periudhat e monitoruara

Tabela 4 Lendet ozonholluese ne vite

Tabela 5 Krakteristikat kryesore të klimës në rajonin e Pogradecit

Tabela 6 Reshjet vjetore (në mm) Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar,Libri Klimatologjia

Tabela 7 Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raporti ndërmjet tyre

Tabela 8 Lartësia e reshjeve vjetore me periudhë të ndryshme përsëritje

Tabela 9 Akuiferet e Pogradecit

Tabela 10 Monitorimi i Klorofiles ne Liqenin e Prespes

Tabela 11 Paraqitje grafike e të dhënave për treguesin klorofila a

Tabela 12 Mesatarja vjetore e klorofilës a në tre stacionet e Liqenit të Prespës gjatë vitit 2015

Tabela 13 Të dhënat mbi vlerat e TSIC të kampioneve të ujrave në Liqenin e Prespës

Tabela 14 Paraqitje grafike e të dhënave për treguesin TSIC

Tabela 15 Gjëndja trofike e mesatarizuar për tre stacionet e Liqenit të Prespës

Tabela 16 Amfibët e pranishëm në zonë

Tabela 17 Reptilet e pranishëm në zonën e projektit

Tabela 18 Shpendët e pranishëm në zonë

Tabela 19 Llojet e gjitarëve

Tabela 20 Siperfaqia e rrethit te Pogradecit e ndare sipas k.perdorimit te territorit

Tabela 21 Ndarja e siperfaqes pyjore dhe kullosore

Tabela 22 Llojet e habitateve që gjenden në pjesën shqiptare të Parkut Kombëtar të Prespës

Tabela 23 Karakteristika të zonës qendrore të Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit

Tabela 24 Shkarkimet e mbetjeve

Tabela 25 Masat e propozuara për rehabilitimin dhe mbylljen e fushës së mbetjeve

Tabela 26 Masat e propozuara për rehabilitimin dhe mbylljen e fushave të mbetjeve

Tabela27 Përbërja e mbeturinave në rajonin në studim

Tabela 28 Konsumi familjar i energjisë në Bashkinë Pogradec

Tabela 29 Konsumi jofamiljar i energjisë në Bashkinë Pogradec

Tabela 30 Humbjet e energjisë në Bashkinë Pogradec

Tabela 31 Energjia per ngrohje në Bashkinë Pogradec

Tabela 32 Zjarret ne pyje per periudhen 1990-2014

Tabela 33 Gërryerja e tokës

Tabela 34 Analiza SWOT

Tabela 35 Konventat e ratifikuara dhe Direkitivat respektive të BE-së dhe të shtetit Shqiptar

Tabela 36 Ndikimet mjedisore qe mund te shkaktohen nga aktivitetet e parashkuara ne Plan

Tabela 37 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM1

Tabela 38 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM2

Tabela 39 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM3

Tabela 40 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM4

Tabela 41 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM5

Tabela 42 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM6

Tabela 43 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM7

Tabela 44 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM8

Tabela 45 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM9

Tabela 46 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM10

Tabela 47 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM11

Tabela 48 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM12

Tabela 49 Grafiku i vleresimit te nivelit te perputhshmerise mes objektivave

Tabela 50 Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore

Tabela 51 FISHA 1

Tabela 52 FISHA 2

Tabela 53 FISHA 3

Tabela 54 FISHA 4

Tabela 55 FISHA 5

Tabela 56 FISHA 6

Tabela 57 FISHA 7

Tabela 58 FISHA 8

Tabela 59 FISHA 9

Tabela 60 FISHA 10

Tabela 61 FISHA 11

Tabela 62 FISHA 12

Tabela 63 FISHA 13

Tabela 64 Përpuethshmëria me Objektivat Mjediore dhe Impakti në Mjedis

Tabela 65 Indikatorët kryesore kumulative dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Pogradec

Tabela 66 Indikatori PM10 dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Shqipëri

Tabela 67 Masat për mbrojtjen e Biodiversitetit

Tabela 68 Monitorimi i ndikimeve ne mjedis prej zbatimit të planit

Tabela 69 Lista e dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar

SHKURTIME

ADA	Agjencia Austriake per Zhvillim
AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit
AKU	Agjencia Kombetare e Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Informatizimit te Zonave te Ndertimeve Informale
AP	Autoriteti Propozues
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
BB	Banka Boterore
BE	Bashkimi Evropian
DEU	Delegacioni i Bashkimit Evropian ne Shqiperi
EBRD	Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
EEC	Keshilli Ekonomik Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
KfW	Banka Gjermane per Zhvillim
KKT	Keshilli Kombëtar i Territorit
LPT	Ligji i Planifikimit të Territorit
MÇV	Ministria e Çeshtjeve Vendore
MM	Ministria e Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJQV	Njesi e Qeverisjes Vendore
PhD	Doktor i Shkencave
PINS L	Plani i Integruar Ndërsektorial për Liqenin
PINS	Plani i Integruar Ndërsektorial
PKS	Plani Kombëtar Sektorial
PLANI	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
SECO	Organizata Zvicerane per Bashkepunim Ekonomik
TAP	Tubacioni Trans-Adriatik

ToR	Termat e References
UNDP	Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
USAID	Agjencia e Shteteve te Bashkuara per Zhvillim Nderkombetar
VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
VNM	Vleresim i Ndikimit ne Mjedis
VSM	Vleresimi Strategjik Mjedisor

PËRKUFIZIME

Mjedisi – është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jo biotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë.

Mbrojtja e mjedisit – është veprimtaria që synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes dhe degradimit të mjedisit, dhe përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

Mbrojtja e tokës siguron mbrojtjen e funksioneve të saj natyrore në mënyrë të qëndrueshme.

Mbrojtja e ujit përfshin ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, burimet e tyre, sasinë dhe cilësinë, shtretërit dhe brigjet e ujërave sipërfaqësor dhe formimet akuifere.

Mbrojtja e biodiversitetit përfshin të gjithë organizmat e gjallë, biocenozat dhe habitatet e tyre.

Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe së ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm.

Ndikimi në mjedis është çdo ndryshim i mjedisit fizik, përfshirë pasojat shëndetësore, ekonomike, shoqërore, estetike, natyrore, fizike.

Ndotja e mjedisit është futja e drejtpërdrejt ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës e faktorëve biologjikë në ajër, në ujë e në tokë, të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës.

Shkarkimi në mjedis është çlirimi dhe dalja në mjedis

Mbetjet janë lëndët, objektet ose pjesë të tyre që përcaktohen nga autoriteti përgjegjës të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t'i largojë.

Ndotja e ujit – është veprimi dhe ndikimi i futjes së materialeve të ngurta, të gazta, të lëngëta, qënieve të gjalla dhe formave të energjisë në ujë, që drejtpërdrejt e tërthorazi ndryshojnë cilësinë e ujit.

Rezervat ujore – janë të gjitha ujërat e brendshme liqenore, sipërfaqësore nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike nën juridiksionin dhe kontrollin e R. SH

Basen ujëmbledhës – është sipërfaqja e tokës brenda së cilës uji pasi konvertohet në një rrjedhë të vetme, nëpërmjet një rrjeti rrjedhash sipërfaqësore e nëntokësore derdhet në det.

Informacion mjedisor – nënkupton çdo informacion me shkrim, vizual, gojor, elektronik ose të çdo lloj forme tjetër materiali mbi gjendjen e elementëve të mjedisit, si ajri e atmosfera, uji, toka, peizazhi e shumëllojshmëria biologjike e komponentët e tij;

Publiku – nënkupton një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre;

Publiku i interesuar – nënkupton publikun ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore; për qëllimet e këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që promovojnë më tej mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat e vëna në ligjet kombëtare, do të konsiderohen të interesuara.

Parimi "Ndotësi paguan" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme.

Planifikim urban nënkupton një sintezë dhe rrjedhojë e analizave në disa disiplina të ndryshme si të asaj sociale, ekonomike, historike dhe ekologjike.

Qeverisja është arti që bën të punojë lokomotivën qytet, përtej diferencave politike e kufizimeve burokratike e arbitrare, e cila kërkon udhëheqje, imagjinatë, fleksibilitet, pjesëmarrje dhe aftësi negocimi.

Zhvillim i qëndrueshëm urban është ai zhvillim, i cili kënaq nevojat e brezit që jeton pa dëmtuar mundësitë që do të kenë brezat e ardhshëm për të kënaqur nevojat e tyre e për të zgjedhur stilin e tyre të jetës.

Qëndrueshmëria e plot nënkupton ruajtjen dhe zhvillimin me efiçencë të tri përbërësve kryesorë potencialë si të atij social, ekologjik dhe ekonomik.

Përdorim toke nënkupton reduktimin e rritjes së sipërfaqeve të ndërtuara, ripërdorimin e territoreve djerrë urbane dhe ndërtesave të pazëna, shfrytëzimin maksimal i dendësisë së ndërtimit, ruajtjen dhe lidhjen me sipërfaqet e lira klimaterike, si dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të asfaltuara.

Ruajtje e vlerave ekologjike të peisazhit nënkupton kursimin e energjisë dhe përdorimin më të gjerë të burimeve rigjeneruese të energjisë, pakësimin e lëndëve të dëmshme për atmosferën dhe lëndëve djegëse, ruajtjen dhe përkujdesjen për burimet tokësore ujore dhe ato vendore, si dhe forcimin e riciklimit të lëndëve dhe pakësimin e mbetjeve urbane.

Përgjegjësi sociale për banim nënkupton burime për ndërtim me kosto të reduktuar të banesave, strehim të të pastrehëve me nevoja specifike banimi, mbështetje të nismave të Bashkisë apo Qarkut.

SEKSIONI 1
PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

1.1 HYRJE

Në thelb të vizionimit të territorit të bashkisë Pogradec qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit. Ajo ç'ka synohet është që të arrihet zhvillimi i turizmit sezonal. Zhvillimi i turzimit do të bazohet në potencialet natyrore, historike dhe kulturore të bashkisë. Synohet zhvillimi i turizmit liqenor, turizmit kulturor, duke marrë parasysh këtu praninë e shesheve arkeologjike, nxitjen e itenerareve historike, natyrore dhe peisazhistike. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Pogradec do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj zone, si dhe do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm. Qëllimet që synon të përmbushë PPVBP janë:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private;
- të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin;
- të krijojë kushte të përshtatshme, të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, lidhshmëri ekonomike e sociale, si dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Sipas një vizioni perspektiv urban, në vitin 2031 …, Pogradeci do të karakterizohet si:

Bashkia e NATYRËS

Sepse, Liqeni i Ohrit do të jetë fuqia jonë. Malet do të shtojnë bukurinë, do të ngjallin historinë dhe mbështesin ekonominë tonë. Në partneritet me qytetarët, bizneset edhe institucionet do të arrijnë standarde më të larta të mbrojtjes së natyrës dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.

Bashkia e NJERËZVE

Sepse, njerëzit janë pasuria më e madhe e Pogradecit, mbasi krenohemi me mikpritjen, urtësine dhe shpirtin demokratik të njerëzve tanë. Nëpërmjet urbanizimit të kontrolluar, infrastrukturës dhe

shërbimeve cilësore jetesa e banorëve tanë do të përmirësohet ndjeshëm, turizmi do të jetë i zhvilluar, bujqësia dhe industria do të përparojnë.

Bashkia e KULTURËS

Sepse, Pogradeci është i poetëve, shkrimtarëve, piktorëve dhe gjithë artistëve të tjerë. Sepse, trashëgimia historike do të rivitalizohen, dhe vlerat tona kulturore do të ruhen dhe promovohen.

1.2 KUADRI I VLERËSIMIT

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesemarrje që perdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet "si një proces sistematik, i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendimmarrjes". Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë, edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore janë dhënë si më poshtë:

- Ligji nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"
- Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian
- Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)

1.3 OBJEKTIVAT E VSM

1.3.1 Detyrimet prej Konventave dhe Situatës Ekzistuese

Bazuar në analizën e:

- detyrimeve të specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë;
- situatës ekzistuese të mjedisit;
- ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan.

Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisorë dhe objektivat mjedisore, si më poshtë:

Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi I menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricikluesshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë, ujërat e njelmët, ujërat liqenorë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmes/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.
Shpjegimi i përcaktimit të objektivave mjedisore jepet në seksionet në vijim.

1.3.2 Vlerësimi Mjedisor

Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

1. Politikat që lidhen me Infrastukturën urbane dhe mjedisin urban dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilesisë së Mjedisit Natyror kanë klasifikimin më të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore.
2. Politikat që lidhen me Sigurimin e zhvillimit ekonomik, me Zhvillimin e Turizmit dhe Përmirësimin e Infrastrukturës së Transportit kanë klasifikimin më të ulët në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre politikave është në përputhshmëri të plotë me të paktën një, dhe në shumicën e rasteve me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.
3. Dy politika të Planit, specifikisht: Vendosja e standardeve të projektimit urban, dhe Krijimi i Parqeve Rajonale, janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore, duke marrë rezultatin maksimal të mundshëm.
4. Secila prej politikave të planit (përveç dy politikave që klasifikohen me përputhshmëri të plotë) nuk kanë lidhje me të paktën një objektiv mjedisore dhe në shumicen e rasteve me 2 objektiva.
5. Dy objektiva të Planit që lidhen me Infrastukturën Urbane dhe Rajonalizimin janë pothuajse në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore.
6. Tre objektiva të Planit që lidhen me sektorin për sigurimin e qëndrueshmërisë financiarë të institucionit të bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumentave finacnciare për daljen nga borxhi nuk përputhet me asnjë nga objektivat mjedisore.
7. Një nga ovjektivat e planit që lidhet me sektorin mbi "Sigurimin e zhvillimit ekonomik" nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë, saktësisht Hartimi i programeve për zhvillimin e industrisë minerare në zonat me potencial më të madh, përputhet pjesërisht vetëm me një nga objektivat mjedisore.
8. Një nga ovjektivat e planit që lidhet me sektorin për Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industriesë, saktësisht Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të Bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës, përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore, duke kërkuar kështu zbatimin e masave mbrojtëse.

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Konkretisht:

- Objektiva mjedisore 1 që lidhen me menaxhimin e tokës, dhe objektiva 10 që lidhen me popullsinë, janë në përputhshmëri të plotë me pjesën më të madhe të politikave të planit;

- Duhet theksuar se të dyja këto objektiva janë ose në përputhshmëri të plotë, ose nuk lidhen me politikat e planit;
- Objektiva 11 që lidhet me ruajtjen e trashëgimisë kulturore është objektiva që nuk lidhet me pjesën më të madhe të politikave të Planit;
- Të gjitha objektivat e tjera mjedisore paraqesin një diversitet të madh lidhur me nivelin e përputhshmërisë së tyre me politikat përkatëse të Planit.

Si konkluzion mund të thuhet se në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat dhe politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.

1.4 HAPAT E RRADHËS

Siç parashikohet në Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", do të mbahet dëgjesa publike lidhur me Raportin Paraprak të Vlerësimit Stategjik Mjedisor të Planit. Të gjitha komentet , vërejtjet, sugjerimet e mara, do të paraqiten dhe adresohen në Raportin Final të VSM-së.

PARATHËNIE

Raporti Paraprak i Vlerësimit Strategjik Mjedisor – RPVSM në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Pogradecit (PPVBP) është një nga dokumentet kryesore për t'iu paraprirë analizave të mëtejshme mjedisore. RPVSM synon të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimeve dhe mbrojtjeve përkatëse mjedisore të territorit brenda afatit të tij të vlefshmërisë, i cili zgjat 15 vite që nga dita e miratimit të tij. Ky dokument i ofron lexuesit/përdoruesit të krijojë një panoramë të përgjithshme analitike të gjendjes ekzistuese mjedisore në Bashki, si dhe të kuptojë drejtimet e ardhshme të zhvillimeve mjedisore përmes vizionit të planifikim e zhvillim të territorit.

Gjendja ekzistuese është bazuar në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese të çështjeve mjedisore, si dhe te raporti mbi Stategjinë për Bashkinë Pogradec, dokumente të hartuara gjatë fazës së parë dhe të dytë të këtij projekti, i cili ka patur synimin grumbullimin dhe shqyrtimin e të gjithë informacionit ekzistues nga institucionet shtetërore sipas ligjeve në fuqi për të siguruar të dhënat e nevojshme për në fazën e tretë të këtij projekti.

Për të kuptuar më mirë vlerësimin e gjendjes mjedisore ekzistuese në territorin e ri të bashkisë, janë prodhuar disa harta, profile e tabela për secilën prej njësive të reja administrative që i janë shtuar territorit të bashkisë se re. Këto profile janë prodhuar nga bashkëpunimi i drejtpërdrejt i stafit të Bashkisë Pogradec me ekspertët e studiove konsulente. Metodologjia e gjenerimit të gjetjeve është bazuar te vizita të drejtpërdrejta në zyrat e njësive administrative, konsultime me personelin dhe të dhënat e administratës në kohën e takimeve, vizita e studim i drejtpërdrejt i territorit të njësisë dhe takime të rastësishme me qytetarët.

Drejtimet kryesore të zhvillimit të synuar për 15 vitet e ardhshme të Bashkisë Pogradec shtjellohen në kapitujt e tjerë të këtij dokumenti, duke bërë të mundur që:

1. Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
2. të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të neojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
3. të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
4. të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,

5. të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatin e synuar nga të gjitha veprimet e nëvojshme për t'u ndërmarrë gjatë kësaj periudhe. Thënë ndryshe, Raporti zbërthehet në dimensione të përgjithshme zhvillimi, mbi bazën e të cilave janë hartuar masat përkatëse për secilin dimension. Çdo objektiv strategjik trajtohet me programe specifike dhe konkretizohet me projekte të veçanta sipas një plani veprimi të ndarë në faza dhe të shtrirë në kohë. Zhvillimi i ardhshëm i Bashkisë, nga termat e planifikimit strategjik të këtij dokumenti do të përkthehet në terma vazhdimisht të ndryshueshme territoriale, të cilat specifikohen në Planin Territorial dhe menaxhohen drejtpërdrejt nga strukturat e Bashkisë Pogradec.

SEKSIONI – 2

HYRJE

2.1 ÇFARË ËSHTË VSM

Vlëresimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si "një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendim- marrjes".

Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendimmarrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor. Më konkretisht, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendim-marrësit, që të marrin në konsideratë:

- Tendencat kyç mjedisore, potencialet dhe shqetësimet që mund të prekin apo mund të preken nga plani apo programi;
- Objektivat dhe indikatorët mjedisorë që janë në përputhje me planin apo programin;
- Efektet e mundshme dhe të konsiderueshme mjedisore të opsioneve të propozuara dhe të zbatimit të planit apo programit;
- Masat për të shmangur, zvogëluar apo zbutur efektet negative dhe ato për të rritur e përforcuar efektet pozitive;
- Pikëpamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet përkatese, publiku dhe – sipas rastit –
- vendet fqinje që preken nga zbatimi i planit apo programit.

Në përgjithësi, VSM-ja aplikohet për plane rregulluese territoriale, programe, politika dhe dokumente të tjerë me natyrë strategjike (përfshirë mundësisht edhe dokumentet ligjore).

2.2 KUADRI LIGJOR i VSM

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore jane dhënë më poshtë:

- ***Ligji nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"***, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit

gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritete përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor. Ligji është përafruar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Më shumë informacion gjendet në http://www.legjislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.

- ***Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian*** mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve apo programeve të caktuara (Direktiva e VSM-së). Më shumë informacion gjendet në http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm.
- ***Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)***. Më shumë informacion gjendet në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.

2.3 FAZAT KYÇ TË PROCESIT TË VSM-SË

2.3.1 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Tab. - 1 *Fazat kyç të procesit të VSM-së.*

Faza	Përshkrimi
Shqyrtimi	Gjatë shqyrtimit identifikohet nevoja për VSM që aplikohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efekte të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet, dhe përjashton nga procesi i VSM-së ato të cilat kanë ndikime te vogla, ose nuk kanë fare ndikime. Qëllimi i shqyrtimit është të identifikojë, nëse VSM-ja duhet te aplikohet për një plan, program apo projekt specifik.
Studimi i shtrirjes / qëllimit të VSM	Çështjet e identifikuara gjatë studimit të shtrirjes /qëllimit të VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale, siç janë përshtatjet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim, etj. Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen çështjet kyç që duhen adresuar në raportin e VSM-së.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese do të përbëjë bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme që të përvijohen tendencat e mundshme në të ardhmen – kështu që duhet të bëhet analiza e tendencave në të kaluarën, me qëllim që të parashikohen zhvillimet që do të ndodhin në të. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme nuk mund të bëhet pa kuptuar mirë gjendjen ekzistuese të çështjeve kyç të identifikuar në studimin e shtrirjes/qëllimit të VSM-së. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi më të mirë të çështjeve kyç, dhe një identifikimi më të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.

Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. Një nga përfitimet kryesore prej VSM-së është se ai mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të një numri projektesh të perfshira në dokumentin strategjik, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve të vogla individualisht, por të konsiderueshme të marra së bashku, që do të kryhen për një periudhë të caktuar kohore. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuara, VSM-ja sugjeron masa zbutëse për të adresuar efektet e pritshme negative si dhe për të rritur ndikimet pozitive që do të vijnë nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve përkatëse. Kjo fazë ka për qëllim të vlerësojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive të planeve përkatese, dhe, në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, të marrë në konsideratë alternative dhe opsione, dhe të formulojë masat zbutëse për të parandaluar, reduktuar dhe sa më shume të jetë e mundur, të kompensojë çdo ndikim të konsiderueshëm negativë të planeve programeve apo projekteve përkatëse.

Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM-së dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të shkruar mirë dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit përkatës, si janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit të konsultimeve, si dhe për metodat e monitorimit të efekteve të konsiderueshme mjedisore që vijnë nga zbatimi i planit, programit apo projektit përkatës.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese / zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar.

2.3.2 Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të "parandalimit", sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht, që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret. Po ashtu, edhe politikat, planet dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Paraprak Strategjik Mjedisor (VPSM). Procesi i VPSM-së është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet.

VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.

Vlerësimi i situatës

Për të ngritur një infrastrukturë miqësore urbane me mjedisin, sikundër dhe rajoni e ka në ADN e vet, kërkohet të merren në konsideratë disiplina e fusha si;

- Kuadri administrativ, Plani rregullues egzistues (realizimet dhe mosrealizimet, struktura ekzistuese e fshatit, zonimi dhe identifikimi i nevojave);
- Pozicionin gjeografik të Bashkisë Pogradec dhe kufinjtë administrativ të saj;
- Relievi i azhornuar, të dhëna gjeologjike dhe gjeomorfologjike;
- Të dhëna hidro-gjeologjike, të dhëna klimatike dhe hidrologjike;
- Të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës në studim;
- Raporti i ndikimit në mjedis;
- Kushtet sizmike e tektonike të rajonit;
- Burimet territoriale dhe ekonomike;
- Historia, monumentet e kulturës, arkeologjia;
- Popullsia (gjëndja ekzistuese dhe tendecat e ndryshimeve);
- Pronësia mbi trojet, Strehimi, Arsimi;
- Profili ekonomi (biznesi i vogël, ndërmarrjet, turizmi), Punësimi;
- Infrastruktura (rrjeti rrugor, sheshet e grumbullimit të mbetjeve urbane, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefoni);
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale.

SEKSIONI - 3
PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT

3.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

3.1.1 Objektivat e PPU për Bashkinë Pogradec

Vizioni: Në thelb të vizionimit të territorit të bashkisë Pogradec qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit. Ajo ç'ka synohet është që të arrihet zhvillimi i turizmit gjith vjetor. Zhvillimi i turzimit do të bazohet në potencialet natyrore, historike dhe kulturore të bashkisë. Synohet zhvillimi i turizmit liqenor, turizmit kulturor, duke marrë parasysh këtu praninë e shesheve arkeologjike, promovimin e itinerareve historike, sic është ajo qe lidhte rruga Egnatia, e itinerare natyrore dhe peisazhistike. Vizioni i bashkisë Pogradec është hartuar duke marrë parasysh konsideratat në shkallë rajonalë, propozimet që vijnë nga Plan i Përgjithshëm Kombëtar, propozimet që vijnë nga strategjitë sektoriale, gjetjet kryesore të analizave, të dhënat e nxjera nga studimi i profilit të çdo njësie administrative, takimet publike dhe rezultatet e anketës mbi vlerësimin dhe prioritetet e qytetarëve për territorin e bashkisë Pogradec.

Pogradeci, Qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror - bujqësi.

PPVBP do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj zone, si dhe do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm. Qëllimet që synon të përmbushë ky Plan janë:

1. të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
2. të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
3. të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
4. të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,
5. të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Plani është ndeshur me disa sfida, si në nivel rajonal, ashtu edhe në atë lokal. Këto sfida prekin thuajse të gjithë sektorët e marrë në konsideratë. Masa e kapërcimit të tyre do të sjellë masën e suksesit të planit. Sfidat janë:

- Ekonomia Globale dhe Konkurenca Rajonale;

- Integrimi i hapësirave Informale;
- Rigjenerimi Urban dhe Strehimi;
- Lëvizja dhe Transporti;
- Kapërcimi Teknologjik dhe Infrastruktura dixhitale;
- Situata Mjedisore dhe Menaxhimi i Mbetjeve;
- Ndryshimi i Stilit të Jetesës.

Për të kapërcyer sfidat, plani ka marrë në konsideratë mundësitë specifike që e bëjnë të konkurrueshëm territorin në fjalë:

- Kultura dhe Kreativiteti;
- Diversiteti i Lartë i Sektorëve Ekonomikë;
- Popullsi në moshë të re;
- Pozita Gjeografike e Favorshme.

Mundësia për të zbatuar koncepte dhe priorite të zhvillimit territorial të Komunitetit Europian është parë në disa perspektiva për t'u përputhur si më poshtë:

- Koncepti i Zhvillim i balancuar Policentrik. (Sistemi Policentrik i Qendrave Urbane);
- Vendosja e një forme të re zhvillimi Urban-Rural në nivel të Zonave Funksionale Urbane;
- Barazi në aksesin në infrastrukturë, energji dhe shërbime;
- Mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshem të kapitalit dhe aseteve natyrore.

Strukturat ekologjike dhe resurset kulturore, si potenciale zhvillimi në rajonet që janë më të vonuar në zhvillim dhe janë të klasifikuar si zona ekologjike dhe kulturalisht sensitive. Hartimi i vizionit është realizuar, duke ndërthurur në një koncept të vetëm Sfidat, Mundësitë, Qëllimet dhe Parimet e planit, duke krijuar kështu një qëndrueshmëri të tij dhe përkthimin më tej në objektiva strategjike më efektive.



Fig. - 1 *Vizioni i Bashkisë Pogradec*

3.1.2 Parimet e Planit Stategjik

Në qendër të vizionit të zhvillimit të territorit të Pogradecit qëndron sektori i turizmit së bashku me potencialet e tij. Kështu, referuar edhe skemës së mësipërme të vizionit është evidentuar qartazi zona e peisazhit të mbrojtur të Pogradecit, zonë e cila praktikisht do t'i dedikohet zhvillimit të turizmit rrethliqenor.

Ndërkohë, ***territori i Bashkisë Pogradec*** do të kufizohet / orientohet nga dy akset kryesore rrugore: ajo ekzistuese dhe Qukës – Qafë Pllocë, aksi që është duke u ndërtuar. Gjithashtu, edhe aksi i hekurudhës është një linjë, e cila kufizon ose orienton zhvillimin e territorit të bashkisë Pogradec. Ndërkohë, qyteti i Pogradecit do të jetë qendra kryesore urbane. Gjithashtu është menduar që zona ekonomike të ngelet zona drejt rrugës Pogradec - Korçë dhe zona industriale e Pogradecit.

Njësia administrative Cërravë do të jetë një zonë e orjentuar drejt zhvillimit të industrisë së mineraleve, si edhe zhvillimit të pemëtarisë dhe bujqësisë.

Nj.A Dardhas dhe territoret e saj do të jenë të fokusuara në zhvillimin e vreshtarisë, pemëtarisë dhe bujqësisë. Ndërsa, zona e Proptishtit do të fokusohet në zhvillimin e vreshtarisë, industrisë minerale dhe turizmit.

Nj.A Velçan do të fokusohet në zhvillimin e sektorit të energjitikës (HEC-e), zhvillimine bujqësisë me theks të veçantë blegtorinë dhe turizmin.

Nj.A Trebinjë dhe territoret e saj do të jetë qendra kryesore e shërbimeve dhe administrative për zonën e Mokrës si dhe do fokusohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në shërbim të vizionit të përgjithshëm janë propozuar pika grumbullimi të produkteve bujqësore në Trebinjë dhe Cërravë, si edhe tregje blegtorale në Cërravë dhe Proptisht.

Pra, siç u theksua edhe më lart, në thelb të vizionimit të territorit të bashkisë Pogradec qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit. Ajo ç'ka synohet është që të arrihet zhvillimi i turizmit gjithëvjetor. Këtë kërkon të shpjegojë dhe ilustrojë edhe diagrama e mëposhtme.

Kështu, zhvillimi i turzimit do të bazohet në potencialet natyrore, historike dhe kulturore të Bashkisë.

Synohet zhvillimi i turizmit liqenor, turizmit historiko-kulturor, turizmit natyror, duke marrë parasysh këtu prezencën e shesheve arkeologjike, siç është ai i Selcës, mozaiku i Linit, Kalaja, etj.

Zhvillimi i sektorit të industrisë minerale zë një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik të bashkisë, pavarësisht se siktor i parë ekonomike ngelet zhvillimi i turizmit dhe bujqësisë. Sektori i industrisë minerale sugjerohet të ngelet një sektor mbështetës, duke pasur parasysh zhvillimin e këtij sektori pa cënuar zhvillimin e sektorit të turizmit.



Fig. - 2 *Skema e zhvillimit të turizmit në Pogradec*

Për këtë arsye është shmangur zhvillimi i kësaj industrie në zonën e peisazhit të mbrojtur, pavarësisht burimeve të shumta minerare që gjenden në të. Mendohet se gjithë veprimtaritë e shfrytëzimit të inerteve apo gurëve gëlqerorë që ndodhen në zonën me pamje estetike brenda zones së mbrojtur të kat. – V, sugjerohet që të mbyllen. Veprimtaria e shfrytëzimit të gurëve dekorativë do të zhvillohet konkretisht në zonën e Velçanit, Dardhasit, Cërravës. Në Velçan sugjerohet të zhvillohet edhe shfrytëzimi i qymyrit. Në zonën e Proptishtit për shkak të potencialeve të shumta sugjerohet të zhvillohet industria minerare e kromit.

Pra, siç u theksua edhe më lart në thelb të vizionit të territorit të bashkisë Pogradec qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit.

Drejtimet e propozuara:

Zhvillimi i një ***turizmi multisezonal***, që do të bazohet në potencialet natyrore, historike dhe kulturore të Bashkisë.

1. ***Turizmi liqenor*****,** parashikohet të zhvillohet në një mënyrë më të organizuar. ***Krijimi i moleve liqenore*** *(mole turistike)*, për ankorimin e mjeteve lundruese, si: tragetet që do të përshkojnë itinerare turistike Lin – Pogradec –Tushemisht, dhe që në kuadër të zhvillimit të turizmit ndërkufitar do të bëjnë dhe lidhjen me Strugën, Ohrin e Shën Naum-in, barkave me vela (për sporte ujore), canoe-t, barkat pedaliere, dhe barkat tradicionale të peshkimit, (çka mund të ofrohen si shërbim edhe për turistët vendas e të huaj në të ardhmen). Pjesa e vijës liqenore Lin - Pogradec dhe Pogradec - Buçimas mund të shfrytëzohet për vendosjen e kampingjeve, parqeve me rulota, dhe në përgjithësi të një turizmi jo – pushtues ndaj mjedisit natyror. Ky lloj turizmi do të ndërthurë agroturizmin (për shkak të afërsisë me tokat bujqësore) me turizmin liqenor.
2. ***Turizmi natyror/malor*** mendohet të zhvillohet në zona me potencial të theksuar natyror, si Liqenet e Lukovës në NjA Velçan, Burimi i Drilonit dhe Pylli i Gështenjave në NjA Buçimas dhe zona e Gurit të Nikës dhe Gurit të Kamjes në NjA Dardhas. Sugjerohet promovimi i itinerareve peizazhistike, si itinerari që lidh Qafë Thanën me fshatin Çervenakë në NjA Udënisht, duke na ofruar një pamje shumë të veçantë të liqenit të Ohrit, dhe një itinerar që do të lidhë zonën e Malit të Thatë, me Malësinë e Gorës e më pas me Malësinë e Mokrës të poshtme e të sipërme.
3. ***Turizmi Kulturor***, është një potencial i rëndësishëm i Bashkisë të Pogradecit, duke marrë parasysh trashëgiminë kulturore, sitet arkeologjike, banesat dhe arkitekturën karakteristike. Një itinerar i natyrës historike, është ai që lidh fshatrat e NjA Proptisht, Trebinjë, Velçan e Dardhas me Voskopojën (segment i rrugës Egnatia), gjatë të cilit ndodhen një numër i konsiderueshëm monumentesh kulture, si: Ura e Golikut, varret monumentale të Selcës, kalaja e Zemçës, Ura në fshatin Niçë, Manastiri dhe Kisha e Shën Marenës, etj. Itinerari i dytë kulturor është ai që kalon në vijën bregliqenore nga Lin-i në Tushemisht, dhe përfshin sitet arkeologjike dhe fshatin karakteristik të Lin-it, palafitet e zbuluara kohët e fundit në Pojskë deri në Tushemisht. Të dyja këto itinerare, përveçse itinerare kulturore mund të shihen edhe si itinerare agroushqimore; pjesa bregliqenore e specializuar në gatimet me bazë peshkun, dhe prodhimet bujqësore të zonës, ndërsa pjesa malore e specializuar në prodhimet e mirënjohura blegtorale dhe në traditën vendase të gatimit të tyre.

Dimensionet Strategjike

Për përmbushjen e vizionit të bashkisë Pogradec, zhvillimi i territorit të bashkisë Pogradec do të bazohet në pesë shtylla/dimensione, që do të kenë për synim zhvillimin e territorit në aspektet e mjedisit natyror, infrastrukturës dhe mjedisit urban, cilësisë së jetesës, zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë financiare. Këto dimensione paraqiten në mënyrë të skematizuar në diagramin e mëposhtëm, ndërkohë që shtjellohen objektivat dhe programet strategjike për çdo dimension. Në planin e veprimeve, programet shtjellohen në projekte prioritare përkatëse.

Fig. - 3 *Dimensionet e zhvillimit të territorit, IDRA*

1. Infrastruktura urbane dhe mjedisi urban

O1. Sigurimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizmit, bujqësisë dhe industrisë minerale.

- **OI 1** Zhvillimi i infrastrukturës rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokale brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NjA me qëndrën e qytetit dhe qëndrat e NjA me fshatrat e tjerë;
- **OI 2** Menaxhimi efektiv i sistemeve të transportit brenda bashkisë, atij ndërqytetas, dhe ndërkombëtar ujor;
- **OI 3** Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe sistemit të kanalizimeve të ujit të pijshëm dhe të ujrave të zeza dhe ndriçimit;
- **OI 4** Rigjenerimi i strukturës urbane dhe rurale, duke ruajtur kodin gjenetik të vendbanimeve historike, lagjeve muze, krijimit të hapësirave publike dhe zhvillimit/rizhvillimit të strukturës urbane;
- **OI 5** Rikualifikimit te tesktures urbane ;
- **OI 6** Integrimi i zonave informale;
- **OI 7** Program per dixhitalizmin/modernizimin e planifikimit.

2. Cilësia e jetës

Duke parë përqëndrimin e zonave urbane në Bashkinë e Pogradecit, ky objektiv synon përmirësimin e cilësisë së mjedisit të ndërtuar në hapësirën Bashkisë dhe njësive administrative. Zhvillimi kaotik i dekadave të fundit i lidhur dhe me zhvillime informale ofron një pasqyrë të vështirë urbane. Si rrjedhojë, duke parë dhe dëshirën për tërheqjen e kompanive të huaja, përtej atyre vendase, është e udhës që cilësia urbane të kthehet në një prioritet për këtë plan. Përmirësimi i këtij mjedisi me anë të projekteve të rigjenerimit, konsolidimit, si dhe integrimit do të ofrojë një mundësi të mirë për:

- ofrimin e modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve;
- do të rrisë atraksionin e bashkisë së Pogradecit edhe në nivel ndërkombëtar;
- si dhe, do të nxisë industrinë e ndërtimit të kontrolluar ekologjikisht dhe të turizmit që janë në një nivel jo të kënaqshëm për momentin.

Duke përmirësuar proceset planifikuese dhe manaxhuese, Pogradeci do të ketë një formë urbane që i përshtatet objektivave ambicioze të bashkisë dhe të mbështesë zhvillimin në tërësi.

O2. Përmirësimi i cilësisë së jetesës përmes përmirësimit të infrastrukturave shëndetsore – arsimore, uljes së nivelit të varfërisë dhe promovimi i punësimit të qëndrueshëm.

- **O21** Rritja e cilësisë së jetës përmes ndërhyrjeve në arsim dhe shëndetsi;
- **O22** Ulja e papunësisë nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm;
- **O23** Rivlerësimi i traditës dhe kulturës lokale për rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e turizmit;
- **O24** Krijimi i programeve të strehimit dhe mbrojtjes sociale për shtresat në nevojë;
- **O25** Incentivimi i banesave ekologjike;
- **O26** Përmirësimi i shërbimeve publike dhe administrative të Bashkisë;
- **O27** Zhvillimi dhe mbështetja për Energjitë Alternative;
- **O28** Përmirësimi i efiçiencës energjitike në banesa dhe biznese.

3. Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë.

Bashkia Pogradec është një nga qytetet juglindore ekonomike të Shqipërisë. Rajoni do të kthehet në një hapësirë, duke u bazuar në parimet e metabolizmit, ku prodhimi dhe zhvillimin e metëjshem kryhen nën paradigmën e nje cikli të mbyllur ku mbetjet e një procesi përdoren si lënda e parë e një procesi tjetër. Rajoni synon të mbështesë bizneset dhe indrustritë kreative dhe zhvillimin e turizmit gjithëvjetor, të cilat do të lejojnë në kapërcimin teknologjik të këtij rajoni në të ardhmen. Qendër rajonale me një ekonomi konkuruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi të zhvilluar, turizëm shumë përmasor, e fokusuar te inovacioni dhe duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin.

O4. Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë.

- **OE1** Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës;
- **OE2** Zhvillimi dhe promovimi i turizmit malor, kulturor dhe liqenor;
- **OE3** Hartimi i programeve për zhvillimin e industrisë minerare në zonat me potencial më të madh;
- **OE4** Program specifik për bashkëpunimin ndërkufitar;
- **OE5** Program specifik për nxitjen e punësimit;
- **OE6** Program specifik për administrimin e aseteve vendore.

2. Objektiva Strategjike 4 (OS 4): Zhvillimi i Turizmit

- **OT1** Zhvillimi i Turizmit Kulturor;
- **OT2** Zhvillimi i Turizmit të Natyrës;
- **OT3** Krijimi i Itinerarëve drejt monumenteve të kulturës dhe natyrës;

- **OT4** Përfshirja në rrjetin e itinerarëve turistike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- **OT5** Ndërthurje midis turizmit modern dhe atij tradicional;
- **OT6** Aktivizimi i turizmit në zonat e mbrojtura natyrore.

3. Përmirësimi i Infrastrukturës së Transportit

Zhvillimi i lëvizshmërisë dhe optimizimi i saj midis zonave të kësaj hapësire me qëllim përmirësimin e ndërlidhjes midis bizneseve dhe furnitorëve të tyre, si dhe aksesin e individëve tek shërbimet e ofruara nga kjo hapësire ekonomike. Master plani i transportit duhet të marrë parasysh zhvillimin e rrugëve, transportin publik dhe parkimin, si dhe të sigurojë më shumë lidhje ndërmjet lagjeve; të rrisë aksesueshmërinë nga të gjithë. Për më tepër, duhet të nxisë modelet alternative të transportit dhe të theksojë nocione specifike për transportin publik. Plani ka propozuar zhvillimin e një sistemi rrugësh këmbësorësh dhe biçikletash që duhet të përdorin topografinë e sheshtë të qytetit dhe traditën urbane të përdorimit të biçikletave. Rrjetet e këmbësorëve dhe të biçikletave synojnë të çojnë në ulje të varësisë nga makinat dhe në ulje të nivelit të ndotjes, e nga ana tjetër të sjellin një ndikim shumë pozitiv mbi shëndetin dhe cilësinë e jetës publike. Infrastrukturë publike që rrit mundësinë e zhvillimit të bizneseve dhe komuniteteve, duke u shoqëruar me rritjen e mobilitetit për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mënyrë të "zgjuar" dhe efiçente.

- **OT 1** Përmirësimi i Transportit Publik;
- **OT 2** Transporti Multimodal dhe hekurudhor;
- **OT 3** Transporti Alternativ dhe i Shëndetshëm;
- **OT 4** Menaxhimi efektiv i sistemeve të transportit brenda bashkisë, atij ndërqytetas, dhe ndërkombëtar ujor;
- **OT 5** Zhvillimi i infrastrukturës rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokale brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NjA me qendrën e qytetit.

4. Mjedisi natyror

Ruajtja e Burimeve Natyrore dhe Mbrojtja e Mjedisit, ku konsiderohet Uji si prioritet i zhvillimit, përmiresimi i kualitetit dhe i sigurisë së aksesit me ujërat liqenorë e sipërfaqësorë, përdorimi teknologjive me zero emetim të dëmshëm. Integrimi i sistemeve natyrore me dizajnin e infrastrukturës si dhe krijimi i rrjeteve të parqeve nga niveli lokal tek ai rajonal. Mjedis natyror i mbrojtur, duke zbatuar standardet teknike e ligjore për trajtimin e ekosistemeve dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke siguruar kushtet e nevojshme për zhvillimin urban.

O1. Mbrojtja e mjedisit natyror, duke respektuar kuadrin ligjor të peisazheve të mbrojtura, si dhe duke siguruar qasje të zhvillimit të qëndrueshëm për zhvillimin e territorit.

Ky objektiv ka për detyrë:

1. ***OS1*** Konservimi i peisazhit të mbrojtur të Ohrit nëpërmjet ruajtjes së habitatit dhe biodiversitetit, parqeve natyrore dhe gjeomonumenteve.
2. ***OS2*** Sigurimi i qasjeve të zhvillimit të qëndrueshëm për zhvillim e territorit, lidhur me mënyrat alternative të sigurimit të energjisë, mënyrat e transportit dhe sigurimin e hapësirave të gjelbra

3. ***OS3*** Zbutja e efekteve mjedisore nga veprimtaritë natyrore, aktiviteti ekonomik, industria e ndërtimit dhe minierave.

Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregliqenore dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

5. Qëndrueshmëria financiare

Qendër rajonale me një ekonomi konkuruese, sipërmarrje dinamike, bujqësi të zhvilluar, turizëm shumëdimensional, e fokusuar tek inovacioni dhe duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin.

O5. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të institucionit të bashkisë për zhvillim ekonomik dhe territorial.

- **OF1** Bashkëpunim me nivelin Qendror për evidentimin e këtij problemi dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për situatën financiare të bashkisë;
- **OF2** Ulja e nivelit të borxhit nëpërmjet negociatave me palët e treta dhe duke përdorur asetet dhe pronat e bashkisë si mënyrë për të shlyer detyrimet e papaguara.

Vizioni është formuluar me disa fasha:

1. Të kthehemi në një nga rajonet ekonomike më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, me prosperitet të lartë dhe që redukton pabarazitë me rajonet e tjera, i drejtuar nga zhvillime të qënësishme në punësim dhe infrastrukturë konkuruese.
2. Një ekonomi lider, e cila konkuron në nivel ndërkombëtar, e bazuar në investime inovative, të cilat promovojnë bizneset kreative dhe të bazuara në njohuri si dhe nxisin një nivel të lartë edukimi dhe aftësish profesionale.
3. Të përmirësojë cilësinë e jetesës për të gjithë, me anë të promovimit të stileve të shëndetshme të jetesës, aksesit në shërbime shëndetësore cilësore dhe zhvillimin e komuniteteve të qëndrueshme.
4. Përmirësimi e lëvizshmërisë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, falë zgjidhjeve në transport të cilat ndërlidhin komunitetet me mundësitë për punësim dhe shërbime lokale, kontrollojnë dhe zvogëlojnë trafikun, si dhe përmirësojnë lidhjet strategjike tokësore, hekurudhore, liqenore dhe ajrore me anë të Aeroportit Ndërkombëtar dhe atij lokal.
5. Specializim, densifikim dhe mbështetje e bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilat promovojnë ekonominë lokale.
6. Suksesi duhet të sigurohet me mënyra që promovojnë efiçiencën energjitike, mbrojnë cilësinë e ajrit, minimizojnë dhe menaxhojnë mbetjet, si dhe mbrojnë e përmirësojnë mjedisin natyror dhe atë të ndërtuar.

Në kuadër të plotësimit të vizionit janë përcaktuar gjashtë objektiva strategjike kryesore. Secila prej objektivave strategjike shtjellohet në kapitullin pasardhës me anë të politikave përkatëse, të cilat drejtojnë hartimin e PPV për Bashkinë Pogradec.

3.2 OBJEKTIVAT E VSM PËR BASHKINË POGRADEC

Objektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues (PPRr) së Bashkisë Pogradec për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij.

Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të PPRr, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre.

VSM analizon disa skenarë. Skenari "0", pra "i të mos bërit asgjë" në këtë Bashki do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VSM-ja synon të orientojë planin për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme. Për Planin Rregullues të Bashkisë, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i planit. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari "0" nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore në Bashkinë Korcë është e mirë po t'i referohemi standardeve bashkëkohore, dhe do të përkeqësohet edhe më shumë nëse vazhdon të mos merren masa në përmirësimin e kësaj situate. Veçanërisht për PPRr, ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:

- mjedisit urban në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, zonave të ndotura, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;
- mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhistike të qytetit;
- veprimtarive ekonomike dhe shoqërore – të tilla si tregtia, industria, shëndeti dhe arsimi, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin;
- infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve – sigurimi (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; qarkullimi dhe lëvizshmëria në rrugë dhe transport; lëvizshmëria alternative.

3.2.1 Projekt-Raporti Paraprak

Instrumentet dhe çështjet që influencojnë planifikimin e territorit

Bazuar në përcaktimet e rezultateve të pritshme në Termat e Referencës si dhe në zbatim të Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij, veçanërisht referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", një ndër analizat e para të cilat zhvillohen në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë ose në proces që ndikojnë në zhvillimin e territorit të Bashkisë. Metodoligjia e hartimit të analizës së planeve të

mëparshme është bazuar në një studim të dokumenteve të planifikimit, që për strukturim të informacionit, ato janë ndarë në dy kategori kryesore:

1. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë, që përmban jo vetëm analizat e planeve të mëparshëm territorial të hartuar për Bashkinë Pogradec por edhe një pasqyrë të strategjive ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale që ndikojnë në zhvillimin e Pogradecit;
2. Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave. Prej secilit dokument janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore, të cilat kanë implikime në hartimin e planit të ri të përgjithshëm vendor për Bashkinë Pogradecit.

Ky Projekt-Raport Përfundimtar është rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të Bashkisë Pogradec, si dhe seancave të dëgjesave me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjatë procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen nëse gjykohen të drejta, dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Këshilli i Bashkisë dhe Ministria e Mjedisit. Raporti paraprak i i vlerësimit strategjik mjedisor bën të mundur:

a. përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe të përputhjes se tij me plane ose programe të tjera që lidhen me të, fazën e vendimmarrjes dhe sqarimet nëse disa çështje janë vlerësuar ose do të vlerësohen në nivele dhe procese të tjera planifikimi;
b. përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, dhe burimet e informacionit ekzistues, që përdoren për qëllim të hartimit të raportit;
c. përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero), si dhe arsyetimet përkatëse;
d. objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këta objektiva janë marrë në konsideratë në propozim;
e. përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit ose programit të propozuar;
f. përshkrimin e cilësisë së elementeve të mjedisit në zonën ku propozohet plani apo programi, të cilat mund të ndikohen nga zbatimi i planit ose programit të propozuar;
g. ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit ose programit të propozuar, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si zonat e mbrojtura;
h. pasojat e mundshme negative në mjedis, duke përfshirë ndikimet në biodiversitet, në shëndetin e njerëzve, në tokë, në ujë, në ajër, faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, peizazhin apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
i. pasojat e mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast të zbatimit të nenit 17 të këtij ligji;
j. masat e parashikuara për të shmangur apo zbutur sa më shumë të jetë e mundur pasojat e ndikimeve në mjedis, gjatë zbatimit të planit ose programit;

k. identifikimin e investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme, në kuadër të planit apo programit të propozuar;
l. përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të propozimit;

Raporti paraqet përfundimet me një përmbledhje të shkurtër jo teknike dhe sugjeron disa prej veprimeve kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit të PPRr dhe detajimit të punës gjatë hartimit të Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit.

3.3KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit

Institucionet mjedisore në Shqipëri kanë kaluar nëpërmjet një procesi reformash të thella institucionale gjatë dy dekadave të fundit. Si rezultat i përpjekjeve disa vjeçare të të gjithë aktorëve të interesuar brenda vendit, si dhe kontributit të komunitetit ndërkombëtar, në Shtator 2001 u suprimua Agjencia Kombëtare e Mjedisit (nga 1991 deri 1998; Komitet për Mbrojtien e Mjedisit) dhe në vend të saj u krijua Ministria e Mjedisit, e cila në vazhdim të trendit për rritjen e autoritetit në mbrojtjen e mjedisit, në vitin 2005 transformohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) dhe sot në Ministri Mjedisi.

Ministria e Mjedisit

Ministria e Mjedisit, është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin e mjedisit dhe politikave mjedisore në nivel kombëtar në Shqipëri. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politikën e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nën-ligjore në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjës për çështje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marrëveshjet ndërkombëtare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin "Për Gjendjen e Mjedisit", shqyrton dhe jep lejet mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, nxit informimin, ndërgjegjësimin dhe tërheqjen e publikut në diskutime të rendësishme për mjedisin, etj. Ministria ka dymbëdhjetë Agjensi Rajonale të Mjedisit. Përgjegjësitë e tyre janë zbatimi i legjislacionit; kryerja e inspektimeve; kontrollimi i funksionimit të aktiviteteve dhe përdorimi i burimeve natyrore në rajonet e tyre, duke marrë pjesë në dhënien e lejeve mjedisore për aktivitetet e reja dhe në mbështetjen e monitorimit dhe të vlerësimit mjedisor. Agjencia ka detyrat e mëposhtme:

- Të organizojë dhe menaxhojë programe vjetore të menaxhimit mjedisor;
- Në bazë të të dhënave të monitorimit, AMP përgatit raporte vjetore mbi gjendjen e mjedisit;
- Të mbështesë për analizimin e shkarkimeve në ajër, tokë dhe ujë;
- Të mbështesë autoritetet lokale në aktivitetet e menaxhimit dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të promovojë përdorimin e teknologjive më të pastra;
- Të marrë pjesë në procesin e aprovimit të liçensave dhe deklaratave mjedisore;

- Të bashkëpunojë me autoritetet lokale në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Të informojë publikun dhe të sigurojë pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes;
- Të publikojë të dhënat mjedisore, dhe të përmbushë kërkesat e publikut për informacion.

Aktualisht funksioni kryesor i Agjensisë është të organizojë dhe të menaxhojë zbatimin e programit vjetor të monitorimit mjedisor dhe të raportojë situatën mjedisore nëpërmjet hartimit të raportit vjetor mbi gjendjen e mjedisit.

Autoritete të Tjera në Nivel Qëndror me Përgjegjësi Mjedisore

Komisioni i përhershëm për shëndetin dhe mjedisin punon për Parlamentin dhe rishikon draftet e ligjeve të përgatitura nga MMPAU, aprovon marrëveshje mjedisore ndërkombëtare dhe të tjera në lidhje me çështjet mjedisore.

Në nivel Rajonal dhe Vendor

Në nivel vendor, Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, megjithëse nuk kanë njësi të specializuara mjedisore, përveç Bashkive. Në bazë të ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore Nr.8652, datë 31.7.2000, autoritetet lokale morën përgjegjësinë për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e rezervave ujore, mbetjeve urbane, infrastrukturën e transportit dhe zonat e gjelbra, në fillim të vitit 2001. Bashkitë gjithashtu, janë përgjegjëse për zonat industriale të mbyllura dhe të braktisura që ndodhen në territorin e tyre.

Organizatat Jo-Qeveritare

Organizatat mjedisore shqiptare kanë ndërmarrë aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit, ndër të cilat mund të përmendim në fushat si:

a. Mbrojtja e biodiversitetit, vlerësim i habitateve, depozitimi i mbetjeve të ngurta, studim i problemeve të lidhura me ndotjen urbane, etj.
b. Përfshirje e komunitetit në vendimmarrje, diskutime në tryeza të rrumbullakta, nënshkrimin e vendimeve, etj.
c. Edukim mjedisor i komunitetit nëpërmjet workshopeve dhe trajnimeve, programeve në media, publikimeve, aktivitete të lidhura me shkollat dhe studentët, etj.

3.4 LEGJISLACIONI MJEDISOR

Qeveria i përkushton kujdes të veçantë harmonizimit të ligjeve me ato të Bashkimit Evropian (BE). Deri në vitin 2002, mbrojtja e mjedisit bazohej në ligjin e vitit 1993 të titulluar "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe në një amendim të tij të vitit 1998. Për kohën e vet këto ligje dhanë ndihmesën e nevojshme dhe vunë themelet e shumë proceseve e veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit që sot zhvillohen normalisht. Kërkesat mjedisore të BE-së janë shumë të gjera dhe kanë nevojë për veprim, jo vetëm në bazë të prioriteteve të vendit, por për një sërë sektorësh mjedisorë. Legjislacioni evropian mjedisor përbëhet nga rreth 300 akte ligjore dhe do të trajtohet gjatë gjithë procesit të përafrimit. Procesi i përafrimit kërkon ndërveprim të zgjeruar institucional si në hartimin e legjislacionit mjedisor dhe në zbatimin e tij. Megjithëse ka një proces të qartë në zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët

qëndron në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore.

3.4.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Parimet kryesore, të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Shqipëri, janë të njëjta me ato të Bashkimit Europian. Ato janë të konsakruara në ligjin e ri për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 10 431, datë 9.6.2011, kapitulli II:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm;
2. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
3. Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
4. Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit;
5. Parimi i përafrimit të integruar;
6. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
7. Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit;
8. Ndotësi paguan;
9. Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesmarrja në vendimmarrje.

Lidhur me planet e zhvillimit, të nenit 23 të këtij Ligji, duke ju referuar dhe Ligjit për Planifikimin e Territorit, kërkohet që në hartimin e planeve të zhvillimit të mbahen parasysh ndjeshmëria e mjedisit të një zone të caktuar, kapaciteti bartës i saj, lidhja dhe harmonia e vlerave të peizazhit natyror, lidhja ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgimia kulturore, si dhe tërësia e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese në mjedis dhe atyre të planifikuara. Në nenin 24 ku bëhet fjalë ekskluzivisht për VSM, theksohet ndër të tjera se këtij vlerësimi i nënshtrohen projektet e planifikimit të territorit, si dhe planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor; Legjislacioni për mbrojtien e mjedisit, është pasuruar progresivisht me akte ligjore dhe nënligjore, të cilat janë përgjithësisht përafrim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Ndër to do të veçonim ligjet:

- “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- “Për trajtimin e ujrave të ndotur”;
- “Për substancat dhe preparatet kimike”;
- “Për administrimin e zhurmave në mjedis”;
- “Për zonat e mbrojtura”;
- “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- “Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”.

Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuar, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre:

- Vendimi “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi "Për normat e cilësisë së ajrit";
- Vendimi "Për normat e shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit";
- Vendimi "Për shpalljen e monumenteve të natyrës shqiptare";
- Vendimi "Për administrimin e zonave të mbrojtura";
- Vendimi "Për rregullat e miratimit të zonave të mbrojtura dhe buferike";
- Vendimi "Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit të shtretërve të lumenjve"
- Vendimi "Për çertifikimin e specialistëve për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor";
- Vendimi "Për miratimin e strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit".

LIGJ Nr. 68/2014, PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006, "PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT", TË NDRYSHUAR[1]

Çështje të këtij ligji që lidhen me problematikat e zonës

"Zona me interes për komunitetin" është zona, e cila, në rajonet biogjeografike ose në rajonet të cilave u përket, kontribuon dukshëm në ruajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të një tipi habitati natyror ose lloji, që mund të kontribuojë dukshëm në lidhje me rrjetin "Natura 2000", dhe/ose kontribuon dukshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik brenda rajonit biogjeografik ose rajoneve në fjalë. "Zonë veçanërisht e mbrojtur" është zona ku shpendët e egër klasifikohen si të rrallë e të cenueshëm (vulnerabël) dhe, si rregull, u përkasin llojeve migratore që janë strikte të mbrojtura.".

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR ZONAT E MBROJTURA

Ligji nr. 9806, datë 06.06.2002 "*Për zonat e mbrojtura*" përbën bazën ligjore për menaxhimin e zonave të mbrojtura, sikundër në Shqipëri edhe në rajon. Ky është ligji kuadër për deklarimin, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore e biologjike. Ndërmjet të tjerave, një qëllim i rëndësishëm i këtij ligji është informimi dhe edukimi i komuniteteve lokale lidhur me përfitimet ekonomike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe nxitja e zhvillimit të eko-turizmit. Ligji 8906, në përputhje me kriteret e mbrojtjes së natyrës të përcaktuara nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), identifikon gjashtë kategori të "zonave të mbrojtura", duke u dhënë statuse dhe nivele të ndryshme të mbrojtjes. Neni 4/2 i ligjit nr. 8906, të amenduar, përcakton se territori i çdo zone të mbrojtur, do të ndahet në nënzona, në përputhje me rëndësine e habitateve dhe ekosistemeve të pranishëm në territoret e caktuara. Ligji përcakton ndarjen në nënzona si vijon: zonë qëndrore, zonë e përdorimit të qëndrueshëm, zonë rekreative, zonë e përdorimit tradicional dhe zona të tjera të vogla, të cilat janë në përshtatje me territore të caktuara. Zonimi përcakton nivelin e mbrojtjes së zonës në përputhje me specifikat e saj, duke marrë parasysh natyrën e zonës dhe aktivitetet njerëzore që zhvillohen në të.

Zbatimi i ligjit "***Për zonat e mbrojtura***" të amenduar, shoqërohet edhe me akte të ndryshme nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që përfshijnë:

- VKM nr 676 , date 20.12 . 2002 "*Për shpalljen e monumenteve të natyrës në Shqipëri si zona të mbrojtura*", i cili deklaron si zona të mbrojtur monumentet e natyrës të listuara në aneksin e këtij vendimi;
- VKM Nr.267 , datë 24.04.2003 "*Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike*";
- VKM Nr 266 , datë 24.04.2003 "*Për administratat e zonave të mbrojtura*";
- VKM Nr 86, datë 11.02.2005 "*Për krijimin e komiteteve te menaxhimit per zonat e mbrojtura*";
- VKM Nr 519 , datë 30.06.2010 "*Për propozimin dhe miratimin e procedurave dhe rregullave për administrimin e parqeve natyrore rajonale*";
- VKM nr 897 datë 21.12.2011 "*Për miratimin e rregullave për caktimin e zonave të veçanta të ruajtjes*".

Përcaktimi dhe menaxhimi i habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

Ministria përzgjedh një listë të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojet, sipas shkronjave "a" dhe "b", të nenit 17/4, të këtij ligji, në çdo rajon përkatës biogjeografik, me qëllim propozimin Komisionit Europian të listës së zonave, të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh. Lista kombëtare e zonave me interes për komunitetin, së bashku me një përshkrim të tipareve karakteristike të zonave specifike, përgatitet në përputhje me dokumentacionin dhe kërkesat e përcaktuara për çdo zonë, sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 897, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes".

Projekti «Ruajtja dhe Përdorimi i Qëndrueshem i Biodiversitetit në Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës (Plan Rajonal për Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi)", mbështetur nga GIZ me një shtrirje prej 3 vitesh Objektivi i Përgjithshëm:

- Studimi shkencor i diversitetit biologjik në zonat e tre liqeneve kryesore të Ballkanit Perëndimor;
- Planifikimi i masave për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshem të këtyre liqeneve;
- Informimi i banorëve vendas dhe ngritja e kapaciteteve të nevojshme për menaxhimin kombëtar dhe ndërkufitar.

Projekti do të përfshijë tre komponente:

- Iventarizimin e diversitetit biologjik duke përfshirë studimin për situaten aktuale dhe planin e mbrojtjes për këto liqene dhe brigjet e tyre;
- Zhvillimin e kapaciteteve per nje menaxhim rajonal te biodiversitetit ne keto zona;
- Sqarimin dhe informimin e popullsisë, sidomos nxënësit e shkollave, fshatarët dhe peshkatarët.

Projekti "Mbrojtja dhe përdorimi i biodiversitetit në zonat malore në Shqipëri", me zonen pilot të Alpeve dhe ky projekt mbështetet nga GIZ.

Projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit kombëtar te biosigurisë", mbështetur nga (UNEP-GEF) Maj 2011- Qershor 2015. Projekti pas një periudhe 18 mujore vonese në zbatimin e aktiviteteve të tij për aresye të ndryshme, ka filluar qysh prej Janarit 2013 riaktivizimin e tij pas nje

rishikimi total të aktiviteteve dhe fonde respektive të alokuara në mënyrë që të rikuperohet koha e humbur. Është ngritur Komiteti Drejtues i projektit dhe janë organizuar një numër workshopesh trajnuese me institucionet zbtuese të protkollit të Kartagjenës në të cilin Shqipëria është palë qysh prej vitit 2005. Projekti ka si qëllim të kontribojë në finalizimin e politikave kombëtare për biosigurinë, në hartimin e kuadrit rregullator, kompletimin e testimit pilot të sistemit administrativë dhe vendosjen e sistemit të monitorimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe ndergjegjesimin e publikut për bio-sigurinë dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në vendim marrjen për biosigurinë.

Projekti "Rishikimi dhe Përditesimi i Strategjise dhe Planit të Veprimit për biodiversitetin (2011-2020), mbështetur nga GEF. Ka filluar në Janar 2013, pas miratimit te VKM nr. 674, datë 3.10.2012 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit të Fondit Global për Mjedisin (GEF) midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe IBRD për financimin e projektit "Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin dhe Raportin e 5-të kombëtar të Konventës së Biodiversitetit (CBD)" në linjë me Aichi targets të Konventës së Biodiversitetit dhe planin e saj strategjik për këtë periudhë. Projekti do të realizojë një SPVB të përditësuar në linjë me objektivat globale të CBD dhe me Strategjin e Biodiversitetit të BE-së (Korrik 2011). Është në proces hartimi I draftit të parë të Rapotit Stock Taknig. Gjithashtu është publikuar ftesa për hartimin e Raportit të 5-të Kombëtar të Konventës së Biodiversitetit.

Përgatitjet për Natura 2000 Kemi pergatitur Fiche projektit për IPA 2013 dhe për fillimin e procesit Natura 2000. Propozimi merr parasysh zbatimin e planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë, ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për zonat e mbrojtura, të cilat do të përbëjnë thelbin e Natura 2000 të ardhshëm për Shqipërinë. Projekt-fisha është në proces shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni Evropian. Për vitin 2013 është shqyrtuar Programi Kombetar për Monitorimin dhe janë dhënë mendime krahas treguesve të tjerë dhe për treguesit e tokave. Po ashtu në perputhje me kerkesat e VKM nr. 1189, date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", në bashkëpunim me Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, është kontribuar e janë dhënë mendime e komente për draft programin e monitorimit, sikurse janë dhënë komente e sugjerime për Raportet Vjetor të gjendjes së mjedisit, ku tokat, gjendja dhe mbrojtja e tyre kanë qenë pjesë e këtyre raporteve.

MARRËVESHJET NDËRKOMBTARE, KONVENTA, PROTOKOLLE, MEMORANDUME PËR FUSHEN E NATYRËS

Drejtoria e Biodiversitetit ndjek një numër të konsiderueshëm Marreveshjesh Shumë palëshe Mjedisore (MShM) të fushës së mbrojtjes së natyrës:

- **Konventa për Biodiversitetin**, në të cilën Shqipëria është Palë qysh prej 10.11.1996.
- **Protokolli i Biosigurisë**, ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperisë me Ligjin Nr 9279, datë 23.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kartagjenës për Biosigurinë te Konventës "Për larminë biologjike".
- **Konventa "Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore Evropiane" (konventa e Bernës)** e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998 "Për

- ratifikimin e “Konventës për ruajtjen e florës dhe faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës (konventa e Bernës)”.
- **Konventa “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunes dhe florës së egër”** (CITES), në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9021, datë 6.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të flores dhe faunes së egër”.
- **Konventa “Për Ruajtjen e Llojeve Shtegëtare të Botes së Egër” (Konventa e Bonit)) dhe Marrëveshjet e saj për Cetacete** (ACCOBAMS), lakuriqët e natës (Eurobats) dhe për shpendët migratore euroaziatike (AEWA), në të cilen Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtegtare të kafshëve të egra” dhe mirekuptimet e kësaj Konvente”.
- **“Konventa e Ligatinave të Rëndësisë Ndërkombëtare Veçanerisht si Habitat i Shpendëve të Ujit”** (Konventa e Ramsarit), në të cilën Shqipëria është Palë prej 29.2.1996.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të luftuar shkretëtirëzimin** (UNCCD), në të cilën Shqipëria është palë prej 26.7.2000, pas miratimit të ligjit nr. 8556, datë 22.12.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventen e Kombeve të Bashkuara “Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe /ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë”.

Në zbatim të këtyre Konventave janë hartuar strategji, plane veprime e programe. Gjithashtu hartimi i legjislacionit në fushën e mbrojtjes së natyres mbështetet në parimet dhe detyrimet e konventave, si dhe perfshin dispozita për zbatimin e tyre.

Zona Peisazh i mbrojtur i Liqenit

Zona Peisazh i mbrojtur i Liqenit u krijua për të ruajtur funksionet esenciale të ekosistemeve, të cilat i shërbejnë mbijetesës së popullsisë lokale. Kjo nënkupton që masat për ruajtje dhe mbrojtje janë para së gjithash në interes të njerëzve. Duhet të mirëmbahen funksionet e ekosistemeve si më poshtë:

- Cilësia e habitateve për speciet;
- Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme që lejojnë zhvillimin pa shqetësime të proceseve ekologjike. (p.sh. ciklet jetësore dhe qarkullimi fizik i substancave inorganike);
- Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse dhe i qëndrueshmërisë së ekosistemeve;

Mirëmbajtja e shërbimeve të ekosistemeve:

- Burimet natyrore për popullsinë vendase për sigurimin e nevojave për dru zjarri dhe prodhime të dyta pyjore, ajër i pastër dhe mbrojtje uji.
- Prodhim të ardhurash për popullsinë lokale.

Regjimi i ujit dhe rigjenerimi i tij:

- Mbrojtja e klimës;
- Mbrojtja nga erozioni;
- Zona për çlodhje dhe eksperienca në natyrë.

Zona e mbrojtur duhet të konsiderohet si një peisazh zhvillim. Do të duhen disa dekada deri sa ky peisazh të arrijë statusin që të jetë i krahasueshëm me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, është e rëndësishme që të futen këto standarde, në mënyrë që menaxhimi i saj të çohet në drejtimin e duhur. Koncepti për aplikimin e zonimit, gjithashtu kontribuon në qëllimin për ta integruar pjesën shqiptare të zonës së Ohrit në një sistem më të gjerë të mbrojtjes si një rezervë ndërkufitare të biosferës. Kjo do të përfshijnë të gjithë basenin e Ohrit dhe të Prespës duke ndjekur parimet e programit të UNESCO-s "Njeriu dhe Biosfera ".

ECURIA DHE GJENDJA AKTUALE E ZONAVE TË MBROJTURA

Objektivat kryesore konsistojne në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, nëpërmjet mirë administrimit në tre nivelet përbërëse të tij: lloje, habitate dhe ekosisteme dhe arritjen e statusit të favorshëm për llojet e flores dhe faunes së egër që do të sigurojnë mbijetesën e tyre. Këto objektiva themelore parashikohet të arrihen nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së ZM-ve dhe zbatimit me efikasitet të planeve të tyre të menaxhimit si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Administratave të Zonave të Mbrojtura. Përmirësimi më i rëndësishëm në menaxhimin e zonës së mbrojtur duhet të jetë forcimi i zbatimit të ligjit, ç'ka kërkon një bashkëpunim më të mirë midis institucioneve dhe autoritete të ndryshme në nivel qendror e lokal.

Problem është prania e guroreve pranë dhe në zonën e mbrojtur peisazh. Problem mbeten minierat ekzistuese dhe ato të rinovuara, të cilat ndodhen brenda Peizazhit të Mbrojtur "Pogradec" dhe zonës turistike. Për këto raste dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura" dhe të ligjit "Për liqenet ndërkufitare" nuk shprehen për ndalimin kategorik të tyre, por veprimtaritë duhet të pajisen me leje mjedisore dhe të miratohen në KKT. Gjithashtu, ligji jep mundësine dhe të mosmiratimit të tyre, kur projektet dhe veprimtaritë ekonomike e shoqërore, kanë ndikim të ndjeshem dhe me pasoja në mjedis. Kemi mendimin që fillimisht të largohen guroret të cilat ndodhen brenda basenit ujembledhës të Liqenit të Pogradecit.

Kesisoj jemi shprehur që të shmanget planifikimi i minierave dhe i guroreve në:

- Të gjitha kategorite e Zonave të Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës;
- Sipërfaqet pyjore, ripyllëzimet, shkurret mesdhetare, tokave me bimesi pyjore;
- Pyjet e përcaktuar mbrojtës të tokave, të burimeve ujore, të liqevene, të ujëmbledhësve, të qendrave të banuara dhe rezervatet gjenetike;
- Zonat me rrezikshmëri të lartë për renien e zjarreve;
- Zonat e planifikuara për zhvillimin e turizmit dhe peizazhet me vlera të jashtëzakonshme të vleresuar si një aset thelbësor i zhvillimit të turizmit**;**
- Lugina, ujevara, gjire, kepe, kanione, maja, shpate të thepisur, liqene natyror, ujëmbldhësit, shpella, përgjate lumenjeve e përrenjëve dhe në shtretërit apo brigjet e tyre, në nje distancë jo më afër se 2 km dhe/ose me shtrirje deri në kufirin ujëndarës;
- Vendet rezerva të burimeve ujore nen e mbi tokësore, zonat që shërbejnë si rezerva ujore për ujin e pijshëm dhe territoret e rimbushjes së ujrave nëntokesore, grykëderdhjet e shkarkimit të

burimeve, lumenjeve dhe përrenjve;

- Peizazhin që duket nga qendrat e banuara rurale e të qyteteve, në zonat industriale, sportive, argëtuese, portet, aeroportet, në një distancë jo më afër se 2-5 km si dhe në brezin e gjelbërt urban;
- Territoret e ndjeshme ndaj erozionit, rreshqitjeve, shembjeve, etj.

PERAFRIMI I LEGJISLACIONIT TE RUAJTJES SE NATYRES ME LEGJISLACIONIN EVROPIAN

Aktet ligjore

- Ligj Nr. 8906, date 06.06.2002 "Për zonat e Mbrojtura", përafruar Direktiva e Habitatit - 31992L0043, "Direktiva e Keshillit 92/43 EEC të 21 Majit 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunes dhe flores së egër", Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", përafruar Direktiva e Habitatit -31992L0043, "Direktiva e Këshillit 92/43 EEC të 21 Majit 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunes dhe flores së egër", Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;
- Ligji nr. 9868, datë 04.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", përafruar Direktiva e Habitatit -31992L0043, "Direktiva e Keshillit 92/43 EEC të 21 Majit 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunes dhe flores së egër", Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;
- Ligji nr. 9867, datë 31.01.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për tregëtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të flores dhe faunes së egër", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 19.2.2008, faqe 629-639, përafruar 31997R0338, Rregullorja e Keshillit (EC) Nr 338/97 e 9 Dhjetorit 1996 "Për mbrojtjen e llojeve të faunes dhe flores së egër duke rregulluar tregtinë e tyre", Fletore Zyrtate L 061, 03/03/1997, Faqe 0001-0069 që siguron kuadrin ligjor të përgjithshëm për zbatimin e Konventës "Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunes dhe florës së egër" (CITES) në territorin e BE-së.
- Ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunes së eger", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 168, Viti 2008, Faqe 8273, Data e botimit 31.10.2008, është bërë përafrim i pjesshem i direktivës nr. 79/409 EEC të 2 Prillit "Për ruajtjen e shpendëve të egër", Fletortja Zyrtare Oj L 103, 24/04/1979, Faqe 0001-0018.
- Ligj nr. 10253, datë 11.02.2010 «Për Gjuetinë", përafrim i pjesshëm i direktives nr. 79/409 EEC të 2 Prillit "Për ruajtjen e shpendëve të egër", Fletortja Zyrtare Oj L 103, 24/04/1979, Faqe 0001-0018.
- Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është të kontribuojë në nivel kombëtar për arritjen e objektivave të 2020 në ndalimin e humbjeve të biodiversitetit dhe degradimin e shërbimeve të ekosistemit.

Një objektiv kombëtar, i cili është arritur tashmë, është Protokolli Nagoya, mbi Ratifikimin ABS - Aichi objektivi 16.

- Deri në vitin 2020, të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes natyrore;
- Deri në vitin 2015, të ketë një dokument strategjik për biodiversitetin (SKPVB) të rishikuar dhe të miratuar - në përputhje me objektivin e Aichi 17;
- Deri në vitin 2020, të krijohet një objektiv i ruajtjes prej 17% të zonave ujore tokësore dhe në brendësi dhe 5% e zonave liqenore. Krijimi i Rrjetit Kombëtar ekologjik i Shqipërisë, si një pjesë integrale e Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian (PEEN) - në përputhje me objektivin e Aichi 11;
- Të restaurohen të paktën 15% e zonave të degraduara përmes aktiviteteve konservuese dhe restauruese -në përputhje me objektivat e biodiversitetit Aichi - ky veprim do të arrihet përmes zbatimit të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe përmes zbatimit të planeve të veprimit për llojet në veçanti dhe habitatet;
- Bujqësi dhe pylltari më të qëndrueshme në përputhje me objektivat e biodiversitetit;
- Zbatimi i protokollit Nagoya për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të resurseve gjenetike dhe përfitimet që lindin nga përdorimi i tyre - në përputhje me objektivin e Aichi 16;
- Ndërgjegjësimi mbi biodiversitetin - në përputhje me objektivin Aichi 1

Objektiva të tjera sektoriale strategjike për mbrojtjen e natyrës janë:

- Adresimi i shkaqeve të humbjes së biodiversitetit
- Ulja e presioneve të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm
- Rritja e zbatimit përmes planifikimit me pjesëmarrje, menaxhimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve
- Rritja e përfitimeve për të gjithë, nga biodiversitet dhe shërbimet e ekosistemit

3.4.2 Strategjitë dhe Programet Ndërkombëtare

Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)

Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, për përgatitjen e një dokumenti në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes. Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor:

1. Rritje e Integruar – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe - investimeve të huaja, etj.
2. Rritje e Zgjuar – me fokus rritjen e konkurrueshmërise Rajonale, udhëheqjen nga njohuria dhe novacioni dhe bazuar në kapitalin njerëzor, teknologjitë moderne të komunikimit dhe industritë kreative
3. Rritje e Qëndrueshme – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe ndjeshmëri të burimeve, sidomos atyre natyrore
4. Rritje Gjithëpërfshirëse – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situate ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë

5. Qeverisje në funksion të rritjes - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efikase

Programi Interreg II IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri – Greqi 2014 – 2020 është rezultat i një procesi të programimit të udhëhequr nga "Komiteti i Përbashkët i Programimit", i themeluar për përgatitjen e programit Interreg II IPA për bashkëpunimin ndërkufitar. Strategjia e këtij programi është:

Fig. - 4 *Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Greqi 2014 – 2020*

"Për gjetjen e ekuilibrit mes zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis popullsisë dhe rajoneve, institucioneve vendore, në përputhje me BE-në dhe politikat kombëtare, me qëllim adresimin e sfidave të përbashkëta nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta"

Prioritetet e programit në bazë të Aneksit III të rregullores IPA II (BE) Nr 231/2014, përfshijnë:

1. Promovimi i transportit të qëndrueshëm, informacionit dhe komunikimit (IC) rrjete dhe shërbime dhe investime në ujë, mbeturinave dhe energjisë sistemeve dhe pajisjeve ndërkufitare.
2. Mbrojtja e mjedisit dhe promovimin e ndryshimeve klimatike përshtatjen & zbutjen, parandalimin e rrezikut dhe menaxhimit.
3. Vlerësimin e turizmit dhe trashëgiminisë kulturore dhe natyrore
4. Rritja e konkurrencës në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimeve.

Zona përfituese ndërkufitar shtrihen nga Deti Jon në liqenet e Prespës, dhe përfshinë: Rajonet e Grevenës, Kosturit, Follorinës, Arta, Thesprotia, Janinë, Prevezë, Zakynthos, Kërkyra, Kefallinia dhe Lefkada në Greqi dhe rajonet e Vlorës, Qarku i Gjirokastrës, Qarku i Korçës dhe Qarku i Beratit në Shqipëri.

3.4.3 Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 20.12.2012, “Përcaktimi i projektit të Gazsjellësit Trans – Adriatik (TAP) si çështje e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, i cili në pikën 2 vendos “Shpalljen “zonë kombëtare” të korridorit me gjerësi 500m të Projektit TAP ”
2. Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”

3. Vendimi nr.1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, "Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015". Në këtë listë përfshihet edhe "Banesa e Vangjush Mios", monument kulture i kategorisë së I-rë.

3.4.4 Ligji për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Ligji aktual nr. 9424, datë 6.10.2005 "Për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Protokolli i Kievit) është hartuar në kuadër të Konventës "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar". Qëllimi i këtij protokolli është të krijojë kushtet për një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, përfshirë edhe shëndetin:

a. duke siguruar që çështjet mjedisore, përfshirë edhe ato shëndetësore, të merren thellësisht në konsideratë në zhvillimin e planeve dhe programeve;
b. duke kontribuar në marrjen në konsideratë të çështjeve mjedisore dhe shëndetësore në përgatitjen e politikave dhe legjislacionit;
c. duke vendosur procedura të qarta, transparente dhe efektive për vlerësimin strategjik mjedisor;
d. duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin strategjik mjedisor; dhe
e. duke integruar me këto instrumenta çështjet mjedisore dhe shëndetësore në masat dhe instrumentet e përcaktuara për zhvillim të qëndrueshëm.

3.4.5 Ligji për Planifikimin e Territorit

Ky akt ligjor me nr. 10119, datë 23.4.2009, azhornuar në vitin 2010, dhe i ndryshuar më datë 31.07.2014 ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit. Ligji ka për qëllim:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e privatë, duke bashkërenduar: mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri,
- uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
- krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale;
- nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
- garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;
- të nxisë veprimtarite e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë

natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;

- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me instrumentet planifikuese dhe ligjet mjedisore;
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
- të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
- të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese, për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;
- të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve ;
- Kërkesa për VSM për planet, ashtu si dhe në ligjet për Mbrojtien e Mjedisit, dhe atë të VSM, përshkruhet nominalisht në nenet 21, 47 dhe 48 të këtij ligji.

3.5 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË

Në këtë pjesë synohet që të jepet konteksti i politikave dhe dokumenteve të tjerë brenda së cilave funksionon Plani dhe ku eshte bazuar hartimi i VSM-së. Për këtë qëllim janë konsultuar dhe përdorur nje sërë dokumentesh, përfshirë konventat ndërkombëtare, Direktivat e BE-së dhe politikat në nivelin kombëtar.

3.5.1 Kuadri përkates ligjor që lidhet me hartimin e planeve vendor

Kuadri përkatës ligjor që lidhet me hartimin e planeve vendor është si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 107/2014, datë 29.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";
- Ligji nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës";
- Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për Mbrojtjen e mjedisit" (amenduar në 2008);
- Ligji nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për Turizmin" (me gjithë ndryshimet);
- Ligji nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për Rezervat ujore" (me gjithë ndryshimet);
- Ligji për Furnizimin me Ujë dhe Rregullimin e Sektorit Sanitar (1996);
- Ligjet dhe rregulloret e përshtatura për zhvillimin e liqenit (ndër të tjera Ligjit për Zonat e Mbrojtura, amenduar në 2008);
- Ligji mbi themelimin dhe funksionimin e mbrojtjes së tokës dhe strukturave të administratës;
- Ligji mbi themelimin e mbrojtjes së pyjeve;
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit";
- Kuadri rregullator për përgatitjen e Vlerësimeve të Impaktit Mjedisor (EIA-s) dhe një Projektligji për vlerësimin strategjik të Ndikimit Mjedisor (SEA-s).

Kuadri ligjor pritet të rishikohet, për ta plotësuar dhe bërë atë me funksional. Kjo do të garantojë një fushë veprimi të koordinuar dhe mirëadministruar në të gjithë territorin e rajonit. Gjatë hartimit të PPVBK duhet të garantohet që "ekuilibri midis interesave publike dhe private" në zhvillimin e tokës, si dhe interpretimi dhe administrimi i saktë i të "drejtës së zhvillimit", të jenë pjesë integralë e mendësisë dhe realitetit te zbatimit.

3.5.2 Konteksti Ndërkombëtar

Legjislacioni Horizontal

- Direktiva 2004/35/KE "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2001/42/KE "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva 2003/4/KE mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor;
- Direktiva 2003/35/KE mbi "Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi".

Cilësia e Ajrit:

- Direktiva 2008/50/KE mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën;
- Direktiva 2001/81/KE mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferikë;
- Direktiva 2012/33 në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse në transportin detar;
- Direktiva 2004/42/KE mbi limitimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaqe të caktuara dhe produkteve për rilyerjen e automjeteve;
- Direktiva 97/68/KE mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore;
- Direktiva 2005/55/KE mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

Ndryshimet Klimatike:

- Vendimi i Këshillit 2002/358/KE në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to;
- Direktiva 2003/87/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit 96/61/KE;
- Direktiva 2004/101/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos-s;

- Direktiva 2009/29/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/2/BE i cili përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes se karbonit;
- Direktiva 2008/101/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;
- Direktiva e Keshillit 85/337/KE "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin";
- Direktiva 1999/94/KE në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO_2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve.

Administrimi i Mbetjeve:

- Direktiva 2008/98/KE mbi mbetjet;
- Direktiva 86/278/EKE Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi;
- Direktiva 2006/66/KE Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët;
- Direktiva 94/62/KE Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet;
- Direktiva 2000/53/KE Për automjetet në fund të jetës;
- Direktiva 2002/96/KE dhe Direktiva 2012/19/EU Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Direktiva 1999/31/KE Mbi landfillin e mbetjeve;
- Direktiva 2006/21/KE Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse;
- Direktiva 2011/65/EU Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

Cilësia e Ujërave:

- Direktiva 2000/60/KE për krijimin e një kuadri ne fushën e politikave te ujit;
- Direktiva 91/271/EKE për trajtimin e ujerave te ndotur urbane;
- Direktiva 2008/56/KE për krijimin e një kuadri ne fushën e politikave mjedisore liqenore (direktiva për kuadrin e strategjisë liqenore);
- Direktiva 98/83/KE për cilësinë e ujit te pijshëm;
- Direktiva 91/676/KE për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e përdorura në bujqësi;
- Direktiva 2006/7/KE për menaxhimin e cilësisë se e ujërave të larjes;
- Direktiva 2006/118/KE për mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi;
- Direktiva 2013/39/BE për sa i përket substancave prioritare ne fushën e politikave te ujit;

- Direktiva 2009/90/KE që parashtron specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit;
- Direktiva 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

Mbrojtja e Natyres:

- Direktiva 2009/147/KE Për ruajtjen e shpendëve të egër;
- Direktiva 92/43/KE Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër;
- Direktiva 83/129/KE lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre.

Zhurmat:

- Direktiva 2002/49/KE 2 Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis.
- Direktiva 70/157/EKE mbi përafrimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me nivelin e lejueshëm të zhurmës dhe të shkarkimeve nga mjetet motorike;
- Direktiva 97/24/KE mbi disa komponentë dhe karakteristika të mjeteve motorike me dy ose tri rrota;
- Direktiva 2001/43/KE mbi gomat e mjeteve motorike dhe te rimorkiove të tyre si dhe montimi i tyre;
- Direktiva 2009/40/KE mbi kontrollet e përshtatshmërisë rrugore per mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre.

KONVENTAT:

- UNESCO Konventa e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003);
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);
- Konventa e Bernës (1976): Ruajtja e Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror Evropian;
- Konventa e Biodiversitetit (Diversiteti Biologjik) (1992);
- Konventa e Ramsarit per Ligatinat (1971);
- Konventa e Aarhusit (Konventa mbi Të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-marrje dhe Të Drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore) (1998);
- Konventa e Bonit (1979); Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shteguese të Kafshëve të Egra;
- Konventa CITES (1975): Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër;
- Konventa e Barcelonës (1976); Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregliqenore të Detit Mesdhe;
- Konventa e Espoos (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar së bashku me Amendimet dhe Protokollet;
- Konventa per Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore(2001).

Konteksti Rajonal

- Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (SEJ 2020);
- Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (KIBP);
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko - Jonian (SBERAJ);
- Programi IPA II;
- Samiti i Ballkanit Perendimor – rrjeti i korridoreve kyç rajonale të transportit.

Konteksti Kombëtar

Legjislacionit të brendshëm

Republika e Shqipërisë, ka nënshkruar dhe ratifikuar një mori aktesh ndërkombëtare, të cilat janë bërë edhe pjesë e legjislacionit të brendshëm, ku sipas nenit 59 të Kushtetutës "Çdo njeri ka të drejtë në mjedis jetësor të shëndoshë. Secili është i obliguar që ta mbrojë dhe përparojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës të qytetarëve në mjedis jetësor të shëndoshë."

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020
- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020
- Strategjia e Furnizimit me Ujë & Kanalizimet 2014-2020
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025
- Plani Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020 (draft)
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar për Territorin (draft)
- Legjislacioni përkatës mbi ekologjinë, ajrin, mjedisin detar, zonat e mbrojtura, VSM dhe VNM, administrimin e mbetjeve, trashëgiminë kulturore, zhurmat, ujin, bujqësinë, pyjet, etj. (*nje listë e detajuar e ligjeve, përshkrimit të tyre dhe sektorëve të zbatimit është dhënë në Shtojcën 2*)

Burime të së drejtës ndërkombëtare

Burime të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, në këtë rast mjedisit ujor, janë:

- Marrëveshjet ndërkombëtare: bilateral (dypalëshe), multilateral (shumëpalëshe), regjionale dhe globale;
- Aktet e organizatave ndërkombëtare: rezolutat, konventat, protokollet, etj.)
- Konventat më të njohura, detyrimet e të cilave i njeh Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë janë:
- Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore;
- Konventa e OKB-s për diversitetin biologjik;
- Konventa për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate ujore (Konventa e Ramsar-it);

- Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (Konventa e Espoo-s);
- Konventa për akses në informacion, përpjesmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore (Konventa e Aarhus-it);
- Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe habitatet e tyre (Konventa e Bernës)
- Konventa për ruajtjen e specieve migratore (Konventa e Bonn-it); etj.

Aktet ndërkombëtare dhe regjionale

Aktet ndërkombëtare dhe regjionale më me rëndësi për mbrojtjen e ambienti jetësor janë:

- "Karta e ujërave" - e miratuar nga Këshilli Evropian më 1968; kurse vitin 1970 e ka shpallur "Vit Evropian për ruajtjen e natyrës", me qëllim të ndërmarrjes së një sërë veprimtarive të tjera për mbrojtjen e natyrës dhe për rregullimin hapësinor.

Memorandumet më të rëndësishme

Si memorandume më të rëndësishme njihen:

- Memorandumi i mirëkuptimit midis Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë maqedonase, e në nënshkruar më: 29 nëntor 1996 "*Për projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit"* dhe
- Memorandumi i mirëkuptimit, i nënshkruar më 7 shtator 2000, "*Për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm"* midis Ministrisë Maqedonase të Mjedisit dhe.

Për mbrojtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare veprojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore, që mbrojnë mjedisin në Republikën e Shqipërisë, si dhe konventat, protokollet, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë janë Palë. Ato janë të detyruara të mbrojnë liqenet ndërkufitare dhe të zbatojnë dispozitat e akteve në fjalë. Sa i përket liqenit të Ohrit, ai ka një rëndësi të madhe ndërkombëtare dhe nacionale si në aspektin: juridik, po ashtu edhe në atë historik, kulturor, biologjik, gjeo- morfologjik, klimatik, hidrografik, socio-gjeografik, bio-gjeografik, biodiversitetit, etj. Liqeni i Ohrit është një nga liqenet më të vjetra në botë, i krijuar 2-3 milion vjet më parë dhe dallohet për nga ekosistemi unikat, me lloje të ndryshme të botës bimore dhe shtazore, ku pothuajse 70% e tyre janë endemike (gjenden vetëm në të) dhe specie relikte (fosile të gjalla sepse mbijetojnë si organizma të gjallë vetëm në të). Baseni i Ohrit, përfshin Liqenin e Ohrit, ultësirat dhe malet përreth tij. Baseni i Ohrit (me 2329 km. katrorë), shtrihet në kufirin dypalësh, midis dy shteteve fqinje: atë të Maqedonisë - në pjesën jugperëndimore dhe të Shqipërisë - në pjesën lindore, që do të thotë se shtrihet në kufijtë administrativë të tri komunave: Ohrit (1.070 km2 me rrethinë prej 62 vendbanimeve rurale); Strugës (me 507 km2 me rrethinë prej 53 vendeve rurale); dhe Pogradecit (me 725km2 me rrethinë prej 23 vendeve rurale). Liqeni i Ohrit ka një sipërfaqe prej afro 350 km2, prej të cilëve Republikës së Maqedonisë i përkasin 230 km. katrorë, ndërsa Republikës së Shqipërisë 120km2. Prej tij buron lumi Drini i Zi, lumë ndërkombëtar me një gjatësi prej 56 km. Nga territori i pellgut të Drinit të Zi, R.Maqedonisë i takojnë 446 km katrorë, ose 66.6%, kurse R.Shqipërisë 144 km.katrorë, ose 21.4%. Mjedisi jetësor, flora dhe fauna në të, dëmtimi i gjallesave të gjalla, është shumë i madh, kështu që rrezikohen, rrallohen, si dhe zhduken disa nga llojet e veçanta.

Në të ndikojnë shkaqe të ndryshme duke u nisur nga njeriu si gjenerator kryesor, pastaj shkaqet të tjera si: zhvillimi ekonomik, mbikullotja dhe shfrytëzimi pa kriter I pyjeve dhe bimëve, etj.

Për të mbrojtur dhe për të parandaluar dëmtimin e liqenit të Ohrit dhe liqeneve të tjera, është sjellë edhe Ligji për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare. Neni 6 i "Ligjit për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare", parashikon mbrojtjen ligjore. Si ekosisteme unikale, me vlera ndërkombëtare, liqenet ndërkufitare me pellgjet e tyre ujëmbledhëse, merren me mbrojtje të veçantë nga shteti, duke u shpallur zona të mbrojtura. Kjo bëhet duke marrë parasysh edhe statusin që e gëzon pjesa tjetër e liqenit në shtetin fqinj. Andaj, për mbrojtjen juridike të mjedisit jetësor të Liqenit të Ohrit janë marrë aktivitete të shumta si nga vendi, poashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Burime juridike me karakter ndërkombëtarë dhe regjional, për mbrojtjen e mjedisit jetësor të Liqenit të Ohrit, janë aktet:

- Deklarata e UNESCO-s (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë), me të cilën Liqeni i Ohrit dhe qyteti i Ohrit, shpallet "Zonë e trashëgimisë botërore me vlera natyrore e kulturore", në 5 shtator 1980;
- Shpallja nga Qeveria Shqiptare, sipas të cilës, pjesa shqiptare e liqenit shpallet "Peizazh i mbrojtur ujor dhe tokësor" në nëntor të v.1999;
- Në 1994, Banka Botërore në bashkëpunim me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë filluan përgatitjet për dhënien e një granti nga Fondi Global për Mjedisin dhe financimin e kostos të Projektit për ruajtjen e Liqenit të Ohrit.
- Projekti për ruajtjen e Liqenit të Ohrit, i nënshkruar nga dy shtetet fqinje, në nëntor të v.1999, sipas të cilit një ekip studijuesish nga Maqedonia dhe Shqipëria, nisën një program monitorimi për të përcaktuar gjendjen reale të liqenit.

Marrëveshjet ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor palë e së cilës janë: ish Jugosllavia më vonë Republika e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë, sa i përket Liqenit të Ohrit. Republika e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë sa i përket marrëveshjeve bilaterale ndërmjet dy shteteve fqinje, mund të themi se janë ende në fazën fillestare, por disa marrëveshjeve të mëhershme që ende janë në fuqi, të lidhura ndërmjet Shqipërisë dhe ish Jugosllavisë, si psh:

- "*Marrëveshja për çështjet të ekonomisë ujore*", e lidhur mes Shqipërisë dhe ish Jugosllavisë, në 5 Dhjetor 1956 në Beograd, parashikon masa për mirëmbajtjen e lumenjve që shfrytëzohen, masa kundër vërshimeve, kundër ndotjes së ujit, etj, për: Liqenin e Ohrit – Drinin e Zi – Drini i Bardhë – Buna – Liqeni i Shkodrës. Parashikohej që bashkëpunimi në praktikë, të realizohej përmes Komisionit Shqiptaro – Jugosllav për ekonomi ujore.

Sipas kësaj marrëveshje, të dy shtetet obligohen t'i zgjidhin çështjet lidhur me ujërat kufitare lumore dhe liqeneve, si dhe hidrosistemeve, e në veçanti të Drinit të Zi dhe Liqenin e Ohrit. Sipas marrëveshjes në fjalë, lind obligimi për të dy palët që t'i mbajnë në gjendje të rregullt shtretërit e lumenjve dhe basenin e Liqenit të Ohrit, etj. Në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë gjithmonë problem aktual ka qenë edhe peshkimi si dhe ruajtja e pastërtisë në ujërat kufitare. Për mbrojtjen e gjendjes rreth fondit të peshqve, janë dakorduar që të japin kontribut të njëjtë, sidomos në investimin e mjeteve materialo-financiare për pasurimin e fondit peshkues në liqen. Për shkak të bashkëpunimit

të pamjaftuar, hulumtimet e bëra nga Instituti hidrobiologjik në Ohër dhe Enti për peshkim në Shkup, nuk kanë qenë të plota. Për rregullimin e marrëdhënieve të tilla, *si shtesë të Marrëveshjes për ekonomi ujore, më 5.XII 1956, është nënshkruar një Protokol i veçantë për peshkim në liqenet dhe lumenjtë kufitarë*. Me këtë protokoll janë paraparë këto masa: dispozita mbrojtëse dhe kontrolluese për peshkim; masat biologjike për peshkim dhe dispozita teknike për peshkim në Liqenin e Ohrit, Prespës, Shkodrës si dhe lumenjtë Drini i Zi, Drini i Bardhë dhe lumi Bunë.

- "*Seanca e dytë e jashtëzakonshme e vitit 1961–1962"* po ashtu ka një rëndësi të veçantë, pasi Komisioni i përfaqësuar me paritet nga të dy palët, atë shqiptare dhe jugosllave, solli vendim për tharjen e fushës (kënetës) së Strugës, si dhe për ndërtimin e sistemeve të ujitjes të fushës së Strugës dhe Ohrit. Vendimi i tillë ndonëse ishte për qëllime zhvillimi dhe shndërimit të kënetës në tokë bujqësore, ajo dëmtoi së tepërmi florën dhe faunën, pasi shumë shpesë u shpërngulën, shumë lloje të bimëve dhe shtazëve u zhdukën, si rezultat i tharjes së kënetës. U dëmtua rëndë flora dhe fauna;
- "*Seanca e IX e Komisionit, e mbajtur në vitin 1970"*, ku pala shqiptare parashtron çështjen lidhur me problematikën e rritjes së nivelit të ujit në Liqenin e Ohrit, mbi kuotën maksimale të parashikuar sipas Protokolit të Seancës së II të jashtëzakonshme. Në lidhje me këtë, Komisioni solli vendim sipas të cilës pala jugosllave duhet t'i ndërmerr të gjitha masat e mundshme, që sa më shpejtë të ulet niveli i liqenit;
- "*Deklarata për qëllimin e pesë ministrive: Bosnjës, Shqipërisë, Kroacisë, Serbisë dhe Malit të zi, si dhe Maqedonisë për pjesmarrje të përbashkët për anëtarësim në EEA"*. Dokumenti është nënshkruar në Zadër në 06.06.2003 dhe është dërguar deri tek Komisioni Evropian në Drejtorinë e mjedisit jetësor;
- "*Memorandumi për mirëkuptim dhe bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe zhvillim*" ndërmjet Ministrisë Maqedonase për mjedisin jetësor dhe planifikimit hapësinor dhe Agjencionit për mjedisin jetësor të Shqipërisë (2000 Pogradec). Marrëveshja nuk është ratifikuar pasi është lidhur në mes ministrive;
- "*Ligji për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen dhe mbarëvajtjen zhvillimore të liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij*", në mes të Qeverrisë të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë; nga 20.06.2005 ("Gazeta zyrtare e RM" nr.46/05).

Disa Akte ligjore të Republikës së Shqipërisë, me rëndësi të veçantë që lidhen me veprimtarinë e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të ujërave (MMPAu) në mbrojtjen e ujërave, janë:

- *Ligji për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare.*

Ky ligj synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndalur veprimtaritë që i rrezikojnë.

Sipas ligjit në fjalë, "Liqene ndërkufitare" janë rezerva natyrore që ndodhen në kufirin ndërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë dhe shteteve fqinje, ndërsa "Pellgu ujëmbledhës" është pjesa shqiptare e pellgut, ku ujërat rrjedhin natyrshëm drejt liqenit.

- *Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës*".

Sipas Ligjit të mësipërm, Objektivat bazë parashikon individualisht dhe në bashkëpunim, Palët do të punojnë që:

- Për liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, të sigurohet mbrojtje e njëjtë, e integruar dhe zhvillim i qëndrueshëm sipas normave dhe standaredeve të Bashkimit Europian;
- Gjithë liqeni dhe pellgu i tij ujëmbledhës të marrë statusin e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore, si dhe statusin "Rezervë e biospferës" të UNESCO-s;
- Të përgatisin kushtet për miratimin e propozimit të Këshillit të Europës që zona Ohër Prespë të caktohet si një nga dy eurorajonet e vetme të Europës Juglindore.

Disa parime të përgjithshme të së drejtës së mjedisit jetësor-ujor

Aktet e ndryshme ndërkombëtare, përfshijnë një numër të madh të parimeve të përgjithshme të së drejtës së mjedisit. Si akte më të njohura janë:

- Deklarata e Stokholmit, e cila përmban 26 parime juridike ndërkombëtare, lidhur me ruajtjen edhe përparimin e mjedisit.

Kombet e Bashkuara në vitin 1978 miratojnë Projektin e parimeve, i cili përmban 15 parime për mjedisin jetësor, nga i cili duhet të udhëhiqen shtetet me rastin e ruajtjes dhe shfrytëzimit të harmonizuar të resurseve natyrore, që i ndajnë dy ose më shumë shtete. Ndër to më të rëndësishme, janë:

- Parimi e drejta e shteteve për të shfrytëzuar resurset e veta dhe e përgjegjësisë së shteteve për aktivitete, që kanë për pasojë dëmtimin e mjedisit që u takon shteteve të tjera, ose që është jashtë jurisdiksionit të shteteve;
- Parimi i shfrytëzimit human i mjedisit të njeriut;
- Parimi i lirisë së kërkimeve;
- Parimi i ndalimit të ndotjes së mjedisit;
- Parimi i dhënies së ndihmës në rast rreziku;
- Parimi i paralajmërimit për veprimet që do të mund të shkaktonin ndotjen;
- Parimi i shfrytëzimit racional të mjedisit;
- Parimi i dosmosdoshmërisë të bashkëpunimit për ruajtjen dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, etj.
- Sa i përket Parimit të shfrytëzimit human të mjedisit të njeriut, parashikon, se toka, uji, ajri, mineralet, bimët, shtazët, burimet e energjisë, janë në sasi të kufizuar dhe se duhet të shfrytëzohen në mënyrë racionale.

Kjo ilustrohet me problemin e ujërave të ëmbla që ka në botë dhe me nevojat për to, për t'u parë serioziteti i problemit. Kështu sipas të dhënave, në tërësi sasinë e ujërave të botës, ujërat e ëmbla marrin pjesë me vetëm 2.8%, kurse pjesa tjetër u takon ujërave të detit, shfrytëzimi i të cilave është i pamundshëm ose shumë i kufizuar. Prej kësaj sasie, ¾ e këtyre ujërave janë në gjendje të akullt që nuk shfrytëzohen lehtë. Mbrojtja dhe respektimi për natyrën, parashikohet edhe në Kartën botërore për natyrën, të miratuar në 28 tetor 1982, si dhe në akte të tjera ndërkombëtare;

- Parimi i lirisë së kërkimeve, po ashtu përfshihet nga kjo Kartë. Në të parashikohet që:
- burimet biologjike të mos shfrytëzohen jashtë kufirit të aftësisë së tyre natyrore për rigjenerim;
- pasuritë të cilat nuk shpenzohen me anë të shfrytëzimit duke përfshirë edhe ujin, të përdoren përsëri, ose të riciklohen;
- pasuritë të cilat nuk ripërtërihen, por që shpenzohen me anë të shfrytëzimit, do të shfrytëzohen në masë duke marrë parasysh sasinë e tyre dhe kompatibilitetin e eksploatimit të tyre, me funksionimin e sistemeve ekologjike;
- Parimi i ndalimit të ndotjes së mjedisit. Parimi në fjalë parashikon që gjatë kërkimeve dhe shfrytëzimit të mjedisit, të rezervohen nga përdorimi i materialeve toksike, ose i lëndëve të tjera me sasinë që tejkalon sasitë e lejuara, që do të shkaktonte dëmtimin e mjedisit. Në këtë aspekt: Konventa për pengimin e ndotjes së detit me hedhjen e mbeturinave nga anijet dhe aeroplanët*[23]13; Konventa e Gjenevës*[24]14 mbi detin e hapët të ndotjes së detit, ose pengimin e ndotjes së detit me naftë nga anijet ose nga naftësjellësit, ose të ndotjes që është pasojë e shfrytëzimit dhe e kërkimeve në fund të detit.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, parashikon obligimin për të gjithë shtetet që të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen, nga pasojat e dëmshme të shteteve me veprimet që i ndërmarrin, si p.sh: gropimi, shpimi, hedhja e mbeturinave, vënia e gypave, etj; Po ashtu është paraparë obligimi i shteteve që të miratojnë rregulla, dispozita dhe procedura për të penguar, zvogëluar ndotjen e ambientit ujor, pengimin e çrregullimit të balansit ekologjik; për të mbrojtur pasuritë natyrore, si dhe botën bimore dhe shtazore në det;

Konventa në fjalë, parashikon që shtetet duhet që veç e veç ose bashkarisht, të ndërmarrin masat e nevojshme për pengimin, zvogëlimin dhe kontrollimin e ndotjes së mjedisit të detit, si dhe të mos shkaktojnë ndotjen e mjedisit të shteteve të tjera, ose që ndotja të mos përhapet jashtë territorit të tyre. Këto masa përfshijnë të gjitha masat e domosdoshme për mbrojtjen dhe për ruajtjen e ekosistemeve të rralla dhe të ndjeshme, si edhe të vendbanimeve dhe të llojeve dhe të formave të tjera të florës dhe faunës së detit, që janë të rralla, të rrezikuara ose që u kanoset shfarosja.

Aktet ndërkombëtare, në pajtim me parimet e të drejtës ndërkombëtare, parashikojnë bashkëpunimin e shteteve, si dhe të sigurojnë që me aktivitetet e tyre të mos dëmtojnë mjedisin në një vend ose regjion tjetër, që ndodhen jashtë kufijve të jurisdiksionit të tyre kombëtar.

Sa i përket mjedisit jashtë kufijve shtetërorë, mbi të cilat nuk shtrihet jurisdiksioni i shteteve, aktet ndërkombëtare parashikojnë, se ai mjedis, përbën një të mirë të përgjithshme të tërë njerëzimit. Ato nuk mund të jenë objekt përvetësimi, si dhe shtrirje e sovranitetit shtetëror, qoftë me okupim paqësor ose në ndonjë mënyrë tjetër, p.sh: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit,

etj. Aktet e ndryshme ndërkombëtare, parashikojnë informimin apo paralajmërimin e shteteve, lidhur me çështjet e mjedisit. Ato kërkojnë nga shtetet që të planifikojnë aktivitete, që do të mund të shkaktonin ndotje përtej kufirit, që ta informojnë shtetin që do të mund të goditej nga kjo, me qëllim që të ketë mundësi të marrë masa efektive për mbrojtjen e mjedisit.

Përgjegjësia për mosrespekim të së drejtës së mbrojtjes së mjedisit jetësor

Aktet ndërkombëtare parashikojnë përgjegjësi individuale si dhe kolektive për mosrespektim të të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve dhe ate, si në nivel ndërkombëtar, poashtu edhe në nivel nacional. Me akte ndërkombëtare kufizohen aktivitetet e paligjshme të shteteve nëse dëmtojnë shtetin tjetër, si dhe të dëmtojë interesat e ligjshme të shteteve të tjera. Përkundrazi, sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, shtetet janë të detyruara të pengojnë dëmtimin e mjedisit të shteteve të tjera me ndotës të ajrit, të ujit, të tokës dhe nëse kjo ndodh, të paguajnë dëmshpërblimin. E drejta ndërkombëtare për dëmet që i shkaktohen mjedisit jetësor, parashikon shumë rregulla lidhur me përgjegjësinë e shteteve.

Me vendim përcaktohet se shteti përgjigjet për veprimet e organeve të veta, por edhe të personave privatë nën jurisdiksionin e tij; se çështja e ndotjes s'mund të zgjidhet vetëm me pagimin e dëmit, por është e domosdoshme të arrihet marrëveshja mbi kontrollin e aktiviteteve që mund t'i shkaktojnë dëme mjedisit, në mënyrë që kjo të pengohet ose të zvogëlohet sa më shumë që është e mundur.

Esenca e tezës sipas të cilës, çdo shtet ka të drejtë të disponojë territorin e vet pa asnjë kufizim, pa marrë parasysh dëmet që mund t'u shkaktohen shteteve fqinje, e mbrojtur nga disa autorë të vjetër (Hefter, Kluber, Briggs), ose nga disa shtete (Doktrina e Harmonit, SHBA), që ka si piknisje sovranitetin e vetëm të një shteti, e nuk i përfill të drejtat analoge të shteteve të tjera, është braktisur gati tërësisht.

Aktet ndërkombëtare, praktika gjyqësore dhe shumica absolute e autorëve bashkëkohorë, përkrahin rregullën sipas të cilës shtetet gëzojnë të drejta të barabarta, por njëkohësisht duhet t'u përmbahen kufizimeve të njëjta.

Në rast të dëmtimit nga shtetet e tjera, shtetet e dëmtuara, kanë të drejtë edhe në mbrojtje gjyqësore dhe të kërkojnë dëmshpërblim. Dëmshpërblimi mund të bëhet me rikthimin në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum), do të thot rivendosjen e gjendjes që do të ekzistonte sikurse të mos kishte ndodhur akti i ndaluar, rikthimi komplet i status quo-së, ose nëse rikthimi i gjendjes së mëparshme nuk është i mundur në tërësi ose pjesërisht, atëherë shteti që ka pësuar, mund të kërkojë pagimin e një shume të hollash, në emër të kompensimit të dëmit. Mbase ky është një satisfaksion ndaj subjektit, por nuk do të ishte ndaj natyrës. Dëmtimet e rënda dhe të pa riparueshme do të lëndonin bukurinë e mjedisit, por do të lëndonin edhe vet ekzistencën e njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla. Bukuria e mjedisit jetësor, si dhe pastërtia e tij është barometri i shëndetit tonë. Të kontribojmë të gjithë, individë dhe shtete, që ta shpëtojmë tokën nga kataklizma, që t'ua lëmë pasardhësve.

Konkluzion

Shtetet veç e veç si dhe bashkarisht bëjnë përpjekje dhe ndërmarrin masat e nevojshme për pengimin, zvogëlimin dhe kontrollimin e ndotjes së mjedisit jetësor, në një vend ose regjion tjetër, që ndodhen

jashtë kufijve të jurisdiksionit të tyre kombëtar. Ajo që është karakteristike për të gjithë shtetet, është se shpesh herë, aktet juridike mbeten te drejta fiktive (në letër), gjë e cila cenon të drejtat e natyrës për mbrojtje dhe përparim.

Disa rekomandime për mbrojtjen e mjedisit jetësor - ujor:

Në aspekt ndërkombëtar nevojitet një diplomaci pozitive mbi një bazë të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të një trajtimi në mënyrë aktive, për parandalimin e burimeve të ndotjeve dhe mbrojtjen e ujërave;

- Harmonizimi i legjislacionit nacional me atë ndërkombëtar për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor ujor, në fushat përkatëse, si dhe zbatimi i tij me përpikmëri në realitet;
- Bashkëpunim më i intensifikuar lokal, ndërmjet shteteve fqinje, regjional dhe ndërkombëtar, në mes subjekteve relevante, për mbrojtjen e ambientit ujor;
- Ndërmarrja e masave adekuate dhe konkrete për mbrojtjen dhe përparimin e ambientit jetësor, në nivel të shtetit dhe në nivel lokal (përmes institucioneve përkatëse mbikëqyrëse inspektuese);
- Ndërtimi i objekteve mbrojtëse për pastrimin e ujërave (si kolektorë etj); deponive për grumbullimin e mbeturinave; ndërtimit të stabilimenteve për pllenim të peshqve dhe shtazëve, të cilat rrezikojnë zhdukjen;
- Hulumtimi i shkaqeve që rrezikojnë mjedisin ujor, si dhe opcione konkrete në lidhje me mirëmbajtjen, përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit etj;
- Parashikimi i metodave jo ndotëse të prodhimit, që gazrat dhe ujërat që i lëshojnë fabrikat të derdhen të përpunuara, me koncentrim sa më të ulët të ndotësve si për ajrin, tokën dhe ujin;
- Administrimi i ujërave të zeza dhe përpunimi i tyre në stacione për përpunim;
- Sensibilizimi i opinionit për vetëdijësim për mbrojtjen e natyrës, nga ana e pushtetit, si dhe nga organizatat joqeveritare dhe të tjerë: përmes arsimimit, mediumeve; broshurave, mbajtjes së kampanjave për qëllime të këtilla me qytetarë të moshave të ndryshme, sidomos të gjeneratave të reja; etj.
- Studime shkencore në lidhje me mbrojtjen e florës dhe faunës ujore;
- Hartimi i programeve adekuate, si dhe projekteve për mbrojtje të mjedisit jetësor: për uljen e ndotjes nga materie të dëmshme (si fosfori i lëndëve larëse; ujërave fekale; shpërlarjet e tokës; lumenjtë që derdhen në det dhe liqen, etj);
- Administrimi më i mirë me ujrat si dhe parashikimi më i lartë i kritereve për pastrimin e ujrave të pijshëm dhe për larje, për të evituar ndotjet bakteriale;
- Mbrojtja ligjore e zonave të kallamishteve (nga kullotja, prerja, dhe djegia e kallamave) që të mos zhduken habitatet e rëndësishme për lëshimin e vezëve, të folezimit, të ushqimit e të pushimit të peshqve dhe kafshëve të tjera; si dhe sanksionimi i peshkimit të paligjshëm nën ujë gjatë periudhës së shumëzimit;
- Organizimi dhe administrimi më i mirë i industrisë së peshkimit dhe specieve të rralla, me qëllim mbrojtjen e tyre nga zhdukja.

3.6 ANALIZA, NISMA DHE PROGRAME ZBATIMI

3.6.1 Situata Ekzistuese në Shqipëri

Në Shqipëri, mungesa e planeve hapësinore dhe moszbatueshmëria e bazës ligjore janë konsideruar si dy prej pengesave më të madha për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Ritmi i përgatitjes së planeve hapësinore ka qënë shumë i ngadaltë për të parandaluar praktikën e ndërtimeve ilegale. Mosrealizimi i planeve dhe programeve territoriale, moskoordinimi dhe bashkërendimi në shkallë rajonale dhe kombëtare, konsiderohen si arsyet kryesore të pamundësisë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të koordinuar për zonën qëndrore ekonomike. Edhe pse ka patur disa tentativa për hartimin e PPV, mosarritja në fazën e implementimit apo edhe mungesa e kapaciteteve administrative të Bashkive si autoritet planifikimi, kanë shkaktuar një problem madhor. Fakti është se, për këtë hapësirë strategjike nuk ka ekzistuar një Plan i Integruar Kombëtar që të shërbejë si kuadër rregullues dhe promovues për të siguruar standarde në planifikim dhe instrumenta që mundësojnë rritjen e qëndrueshme ekonomike. Bashkitë aktuale kanë nevojë për një strategji dhe plan gjithë përfshirës që të sigurojnë përdorimin efektiv të burimeve të pakta publike, të shmangë shkatërrimin e tokës bujqesore dhe të udhëzojë si sektorin publik ashtu edhe atë privat se ku duhet t'i zhvillojnë shërbimet.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (draft)

Plani i Përgjithshëm Kombëtar është një nismë e marrë nga qeveria me propozim të Ministres për Zhvillimin Urban dhe Turizmin. Ky plan duhej të ishte bërë më parë dhe vonesa e tij ka rënduar situatën në terren, duke degraduar panoramën e përgjithshme me ndërtime të realizuara në mungesë të një plani kombëtar, dhe për më tepër kanë shkaktuar dëm ekonomik kombëtar pasi ndërkohë është stimuluar hartimi i planeve vendore dhe rajonale, të gjitha hartuar dhe miratuar në mungesë të një kornize politike kombëtare të planifikimit. Zhvillimet kaotike dhe shpesh informale në territor, si dhe mungesa e planifikimit dhe e kontrollit të territorit nga njësitë vendore, kanë dëmtuar rëndë edhe peizazhin natyror. Plani i Përgjithshëm Kombëtar do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve dhe potencialeve të Shqipërisë. Brenda këtij kuadri do të ketë një vëmendje të veçantë për rivlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të burimeve natyrore.

Qëllimi i hartimit të një Plani të Përgjithshëm Kombëtar konsiston në krijimin e platformës drejtuese dhe të garancisë ligjore të nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm urban, ekonomik, social e mjedisor në territor.

Qëllimet specifike strategjike që synon të përmbushë Plani i Përgjithshëm Kombëtar, bazuar edhe në parimet e Ligjit të PT-së, janë:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe
- interesave publike e private,

- të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë,
- të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit, të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave te tregut dhe nevojave sociale,
- të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit,
- të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve dhe potencialeve të Shqipërisë. Brenda këtij kuadri do të ketë një vëmendje të veçantë për rivlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të burimeve natyrore. Bazuar në draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar i hartuar nga AKPT dhe MZHU disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV-në e Bashkisë Pogradec janë:

RAJONALIZIMI - Një nga kërkesat që plotëson Plani i Përgjithshëm Kombëtar është krijimi i bazave për zhvillim rajonal. Tre janë tipet e Rajoneve te përcaktuara nga PPK:
- RAJONE NDËRKUFITARE
- RAJONE EKONOMIKE KOMBËTARE
- RAJONE TË SPECIALIZUARA

RAJONET NDËRKUFITARE burojnë drejtpërdrejt nga Programet IPA Crossborder (Vetëm për periudhën 2014-2020 Shqipëria do të sigurojë një mbështetje financiare prej 75milion eurosh.)
Shqipëri – Greqi (Fondi IPA 42.312.029€) përfshin: Rajonin Korçë – Selanik, Rajonin Gjirokastër – Janinë, Rajonin Sarandë – Korfuz
RAJONI KORÇË - SELANIK, ka bashëkpunim ekonomik, potencial për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në sektorin e turizmit, bujqësisë dhe të energjitikës.





Fig. – 5 *Rajonet ndërkufitare*

Fig. - 6 *Sistemi infrastrukturor*

Burimi: PPK, 2016

RAJONET EKONOMIKE KOMBËTARE:

1. Aktualisht, si një rajon i tillë i mirëfilltë performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por Plani Kombëtar deri në 2030 mundëson fuqizimin edhe të 6 rajoneve te tjera me rëndesi kombëtare.
2. Plani kombëtar e sheh Pogradecin si pjesë e një rajoni ekonomik të rëndësishëm atë të Elbasan - Pogradec - Korçë me avantazhe të larta për lidhje me rajonin Durrës-Tirane duke formuar një zinxhir të rajoneve ekonomike.

   Profili këtij rajoni: Tregëti (shkëmbim & përpunim) – Energji – Turizëm – Bujqësi

Zhvillimet Strategjike:

3. Korca, qendër primare, turistike, bujqësore por edhe energjitike.

4. Pogradeci qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror -bujqësi.

SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Objektivi: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërise së vendit dhe shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat: Organizimi i territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

TRANSPORTI

Objektivi: Multimodal dhe miqësor ndaj ambjentit konkurues

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë Kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Në sistemin e infrastrukturës së transportit për bashkinë e Pogradecit, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Dhjetë Stacione Intermodale Ndërkombëtare në Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, të cilat do të përmbushin nevojat ndërkombëtare dhe tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit me vendet e tjera .

ENERGJIA

Objektivi: Zhvillimi i një rrjeti eficient energjitik

Politika: Diversifikimi drejt energjise së rinovueshme

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

Katër Korridore energjetike: TAP – IAP – ËBR – Kosovë do të mundësojnë integrimin e sistemit energjitik të Shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës. Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit Europian dhe Kroacinë. Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit Europian;

Konventat Ndërkombëtare, Marrëveshjet bilaterale dhe projekte të tjera

Nisur nga kontektsi ndërkufitar që ka rajoni ku shtrihet kjo bashki, Qeveria Shqiptare dhe Bashkia Pogradec marrin përsipër të respektojnë detyrimet përkatëse në veçanti ndaj Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, Konventës së OKB-së për diversitetin biologjik, Konventës për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate ujore (Konventa e Ramsar-it), Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (Konventa e Espoo-s), Konventës për akses në informacion, për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore (Konventa e Aarhus-it), Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe habitatet e tyre (Konventa e Bernës) dhe Konventës për ruajtjen e specieve migratore (Konventa e Bonn-it) ku qeveria është bërë palë me nënshkrimin e tyre.

Respektimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës", nënshkruar në Shkup më 17.6.2004, dhe ratifikuar nga Parlamentet e të dy vendeve ne Mars të vitit 2005, (Ligji Nr. 4502 datë 10.03.2005). Kjo marrëveshje merr parasysh rëndësinë lokale, rajonale dhe globale të liqenit të Ohrit, si një zonë me vlera të jashtëzakonshme mjedisore, ekonomike, shkencore, estetike dhe kulturore, dhe vetëm një marrëveshje ndërkombëtare është thelbësore për ruajtjen e këtyre vlerave për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm pasi ajo garanton një mënyrë menaxhimi që u lejon Palëve të mbrojnë dhe ruajnë liqenin e Ohrit dhe pellgun e tij ujëmbledhës, duke mundësuar në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit.

Ekziston një projekt i quajtur Projekti "Lake Ohrid Conservation Project" i financuar nga GEF, i cili është zbatuar në periudhën 1996-2004 dhe ka pasur si qëllim që përmes një analize komplekse të gjendjes së liqenit të Ohrit, krijimit të strukturave të përbashkëta me palën Maqedone, si dhe konceptimit të tij si një ekosistem që duhet të menaxhohet pa kufij, të shërbente si katalizator për të inicuar projekte të tjera me qëllimin final mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore të liqenit te Ohrit dhe pellgut ujëmbledhës te tij. Sot janë duke u zbatuar pesë projekte:

1. Projekti për mbështetetjen e Parkut të Prespës dhe shpalljen e Rezervës së Biosferës Ohër-Prespë, financim i KFW-së,
2. Projekti për menaxhimin e ujit të pijshëm dhe trajtimin e ujrave të zeza, po financim i KFW-së,
3. Projekti për përdorimin e qëndrueshëm të Burimeve natyrore të tre Liqeneve ndërkufitare

Ohër, Prespë dhe Shkodër;

4. Projekti për menaxhimin e integruar të basenit të Drinit financim i GEF-it,
5. Si dhe, Projekti për qeverisjen e përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujembledhës, financim i BE dhe i zbatuar nga UNESCO.

Këto projekte kanë krijuar dhe konsoliduar vizionin e zhvillimit të rajonit, duke marrë në konsideratë kontekstin ndërkufitar të tij, si dhe detyrimet ndaj Konventave Ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.

3.6.2 Analiza e planeve dhe instrumenteve në nivel vendor

Ne rastin e territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, nuk kemi të bejmë me një analizë të thelluar të sistemeve të planifikimit, planeve rregullative, sektoriale, etj., pasi zhvillimi i qytetit dhe i njësive administrative përreth tij, është prirur kryesisht nga një zhvillim i kufizuar, pjesërisht i udhëhequr nga studime urbanistike pjesore dhe pjesërisht i karakterizuar nga zhvillime te karakterit informal, karakteristike kjo e zhvillimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në dy dekadat e fundit. Lidhur me planifikimin e territorit në nivel vendor në territorin e Bashkisë Pogradec gjatë 25 viteve të fundit është hartuar një Plan Rregullues, i cili i dedikohet territorit të vjetër të Bashkisë, atij para ndarjes territoriale. Ndërkohë, në vitet 1974 është miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit të Pogradecit një projekt ide e planit rregullues të qytetit të Pogradecit. Projekt ideja sugjeron që t'i qëndrohet 'strikt' qasjes së zonimit të propozuar në këtë dokument.

Foto – 1 *Foto të Pogradecit të vitit 1979*

Territori administrativ i Bashkisë Pogradec, është zhvilluar nëpërmjet një skanimi sipërfaqësor të kërkesave për zhvillim, duke i trajtuar këto kërkesa në terma pjesore dhe të pandërlidhura nga një strategji e çfarëdollojshme territoriale. Kjo situatë ka ndikuar në një zhvillim kaotik të territorit urban në zonat e urbanizuara. Ndërsa, në territoret suburbane dhe rurale, situata është ndryshe. Në këto zona, zhvillimet janë kryesisht informale, të cilat kanë ndikuar në shtimin e zonave të urbanizuara dhe demtimin e tokave bujqësore, duke tjetërsuar përdorimin e tyre dhe dëmtuar perspektivën e investimeve të gjera në zonat e prekura nga zhvillimi informal. Si rrjedhojë e këtyre ndërtimeve, territore të reja të urbanizuara janë krijuar në fshatrat e njësive administrative Buçimas e Udënisht (kryesisht në Tushemisht, Buçimas, Udënisht e Mëmëlisht), ndërsa zgjerimi i territorit të urbanizuar dhe densifikimi i atij ekzistues ka ndodhur në Lin.

Plani rregullues i qytetit të Pogradecit i vitit 1979

Në vitet 1979 është miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit të Pogradecit një projekt ide e planit rregullues të qytetit të Pogradecit. Projekt ideja sugjeron që t'i qëndrohet strikt qasjes së zonimit të propozuar në këtë dokument. Plani i vitit 1979 është me shumë rëndësi, pasi sistemi rrugor dhe forma urbane e strukturave është trashëguar në ditët e sotme nga plani i këtij viti. Janë shtuar edhe rrugë të reja, dhe ka patur ndryshime pas viteve '90.

Studimi urbanistik Pjesor i Bregut të Liqenit 2002

Ky plan, për brezin e Liqenit përcakton disa elemente kyçe, të tilla si përcaktimi si zonë në ruajtje e zonës të banimit me ndërtime 2-3 kate, dhe ruajtja e karakteristikave arkitektonike të saj, përcaktimin e një këndi lojrash për fëmijë, rikonstruksionin e objekteve të degraduara dhe rikthimi i tyre me funksion turistik (Oktapodi, godina e Turizmit të vjeter, etj).

Projekti i mbrojtjes së liqenit të Ohrit, kanalizimi i ujrave te zeza dhe furnizimi me ujë të pijshëm të qytetit Pogradec

Për këtë projekt ekzistonte detyra e projektimit për studimin urbanistik të qendës së qytetit dhe vija kufizuese e saj 2003. Qëllimi i kësaj detyre projektimi është realizimi i një studimi urbanistik pjesor që ruan e zhvillon zonën e qendrës së qytetit si qendër biznesi, sociale kulturore e historike të qytetit. Ky studim urban ka si objektiv krijimin e një qendre atraktive për qytetarët e turistë e huaj dhe vendas, sigurimin e trashëgimisë kulturore e vlerave historike, ruajtjen e traditës të ndërtimit, dhe në tërësi rigjallërimin e qendrës dhe krijimin e kushteve që të bëhet atraktive e në të të kalojnë kohën të lire të gjitha grupmoshat.

Plani Rregullues i bashkisë Pogradec

Në vitin 2003 është hartuar Detyra e Projektimit të Planit Rregullues të qytetit të Pogradecit i cili përfshinte kufijtë territorialë të qytetit brenda vijës së verdhë. Nga ky plan vlen të veçojmë propozimet në skemën e zonimit funksional, skemë e cila mund të orjentojë edhe zhvillimin e territorit sot pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në të përgjatë këtyre viteve. Plani në fjalë propozon shtrirjen e zonave të banimit në lindje dhe juglindje të qytetit ekzistues i ndjekur nga një rrjet rrugor kuadratik. Ndërkohë zona ekonomike sipas këtij plani duhej të shtrihej në ish zonën industriale, në rrugën drejt Korçës, dhe në rrugën e Rëmënjit. Zona e pushimit referuar propozimeve të këtij plani do të shtrihej në zonën e bregut të liqenit, përgjatë gjithë gjatësisë së tij. ***Plani i menaxhimit të peisazhit te mbrojtur të Pogradecit, 2013***

Ky është një draft final i planit të menaxhimit të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit i hartuar në vitin 2013 dhe i financuar prej Bashkimit Europian në kuadër të programit IPA 2010 për Shqipërinë. Plani bën një analizim dhe vlerësim aktual të zonës së mbrojtur, bën propozime se si kjo zonë mund të menaxhohet dhe bën një parashikim të planit financiar mbështetur në propozimet e planit të menaxhimit.



Fig. - 7 *Harta e zonimit të propozuar të peisazhit të mbrojtur të Pogradecit*

Lidhur me objektivat e planit të menaxhimit mund të thuhet se synohet përforcimi i ruajtjes së peisazhit të mbrojtur, ruajtja dhe konservimi i habitatit, zhvillimi i përdorimeve rekreative dhe turistike, zhvillimi i qëndrueshëm i agrikulturës dhe aktiviteteteve social ekonomike si dhe promovimi i kërkimit shkencor dhe edukimit. Peizazhi i mbrojtur i Pogradecit bazuar në zonime propozuar të këtij plani ndahet në katër zona:

"Zona bërthamë" - e cila është një zonë e kushtuar e rritjes së peshkut, këto zona janë caktuar në bregun e liqenit, Lin dheTushemisht. Këtu nuk lejohet gjuetia e peshkut, si dhe veprime të tjera në dëm të habitatit. Në këtë zonë duhet të ruhet bimësia në mënyrë që të ndodhë i gjithë procesi natyror.

" Zona e përdorimit të qëndrueshëm" - një zonë e cila përbëhet nga pyje të cilat janë kryesisht në degradim, si dhe liqeni i Ohrit (ngjyra jeshile në hartën sipër). Në këto zona lejohet peshkimi nga peshkatarë të liçencuar, përdorimi i lëndës drusore për ngrohje nga operatorë të liçencuar, zona plazhi, prodhimi i lajthive dhe gështenjave, etj.

"Zona e përdorimit tradicional"- kjo zonë përkon me zonat urbane, tokat bujqësore dhe vreshta të zonës së peisazhit. Në këtë zonë duhet të shmanget keqmenaxhimi i tokës dhe ujit, si dhe shmangia e përdorimit të pesticideve. Bazuar në këtë plan këto zona janë të kufizuara përsa i përket urbanizimit dhe ndërtimit të infrastrukturave kryesore. Kjo zonë përfshin dhe pjesë të zonave ekonomike.

"Zonat rekreative" – lidhen me hapësirën e aktiviteteve turistike përgjatë vijës liqenore. Lidhur me këtë zonë Plani i menaxhimit propozon një plan zhvillimi për bregun e liqenit për të minimizuar derdhjet e ujrave të zeza në liqen.



3.6.3 SITUATA EKZISTUESE NË BASHKINË E POGRADECIT

Bashkia e Pogradecit shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Ai kufizohet në veri me bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me bashkinë e Pustecit, në jug me bashkinë e Maliqit dhe në perëndim me bashkinë e Gramshit. Sipërfaqja e tij është 595 km² dhe ka 90,726 mijë banorë në përbërjen e territorit të tij.

Fig. - 8 *Pozicioni Strategjik i bashkisë Pogradec Burimi: IDRA, 2016*

Pogradeci spikatet për një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, sepse shërben si një urë kontakti, duke lidhur shumë qytete mes tyre, por edhe një pikë kalimi për në Republikën e Maqedonisë dhe

anasjelltas. Në bashkinë e Pogradecit kalon rruga nacionale Tiranë – Korçë, pjesë e korridorit të VIII-të, rruga e re lidhëse Qafë Thanë – Qafë Pllocë, si dhe linja hekurudhore Pogradec – Elbasan. Në bashkinë e Pogradecit gjenden edhe dy pikat doganore me Republikën e Maqedonisë ajo e Tushemishtit dhe e Qafë Thanës. Në territorin e bashkisë gjenden elementë të fortë territoriale, artificialë dhe natyrore, si: liqeni i Ohrit, Parku i Drilonit, Kalaja e Pogradecit, lumi Shkumbin, malet e Mokres, etj. Bashkia e Pogradecit para ndarjes territoriale përbëhej nga qyteti i Pogradecit dhe lagjet e tij periferike dhe kishte një popullsi prej 38,653 mijë banorë, ndërsa pas ndarjes territoriale pësoi ndryshime në territor, duke bërë pjesë të bashkisë edhe shtatë njësi administrative të tjera si: Udënisht, Buçimas, Proptisht, Trebinjë, Velçan, Çërravë dhe Dardhas.

Zhvillimi i territorit të bashkisë Pogradec në vite

Zbulimet e bëra nga gërmimet arkeologjike tregojnë se treva e Pogradecit ka qenë e banuar që në kohët e lashta. Kjo trevë përmendet historikisht për pozitën e favorshme gjeografike, për pasuritë dhe bukuritë e saj. Mendohet se popullsia e ka zanafillën në periudhën e neolitit të hershëm (6000 vjet p.k), e cila dëshmohet me vendbanimet palafite (shtëpi druri të ndërtuara me hunj mbi liqen). Gjatë periudhave të bakrit dhe bronzit numri i vendbanimeve u rrit së tepërmi. Dëshmitë arkeologjike tregojnë për varre të shumta pranë kishave, të cilat datojnë nga periudha e hekurit, ku edhe emra shqiptarë janë gjetur si: Dasion, Kliti, Genthi etj.

Liqeni i Ohrit në atë kohë quhej Lyhnidas (Liqeni i dritës) dhë përgjatë tij banonte fisi ilir i enkelejdëve. Sipas historianëve, në këtë trevë u themelua dhe u ngrit një qytet i rëndësishëm, jo vetëm për nga ana ekonomike, por edhe ajo kulturore. Ky vendbanim mori emrin Enkelena, pikërisht nga fisi i sipërpërmendur. Enkelejtë përmenden për një fis me organizim të rreptë e rigoroz shtetëror dhe ushtarak, si dhe një qytetërim me një kulturë të zhvilluar. Siç dihet gjerësisht, Iliria pas tri luftërave romake, ra nën sundimin e kësaj të fundit. Megjithatë Enkelena e ruajti zhvillimin e saj falë rrugës ndërkombëtare Egnatia që lidhte Dyrrahun me Kostandinopojën, ku degëzimet përshkronin qytetin dhe Mokrën (sot një fshat në bashkinë e Pogradecit).

Më 359, perandoria Romake u nda në dy pjesë, në atë Romake dhe Bizantine. Në këtë të fundit u përfshi dhe Enkelena. Në shekullin e VI filloi pushtimi i rëndë sllav, i cili la ndikim edhe në deformimin e emrave. Këtu ndërrohet edhe emri Enkelena në Pogradec (nën kala). Në fillim të Mesjetës, vendi u quajt Arbëri, mirëpo nuk zgjati shumë dhe u nda në principata. Një ndarje e tillë vijoi deri në pushtimin turk. Porta e Lartë bëri ndarjen e vendit në katër vilajete, ku Pogradeci bënte pjesë në atë të Manastirit, në sanxhakun e Ohrit. Ndarja vazhdoi deri më 1920. Përgjatë viteve të komunizmit Pogradeci ka qënë një qendër e rëndësishme e turizmit, por edhe e industrisë. Ndërtimi i hekurudhës në këtë periudhë përkon me ndërtimin e Minierës së pasurimit të hekur- nikelit në Memelisht të Pogradecit shumë pranë bregut të liqenit. Në sistemin e shtetit socialist, qysh nga viti 1946, Pogradeci ka qenë qendër e Rrethit të Pogradecit dhe në përbërje të qarkut të Korçës. Rrethi i Pogradecit kishte krijuar tashmë një traditë historike në organizimin administrativ, duke pasur në përbërje të tij Fushëgropën e Pogradecit dhe rrethinat e banuara me kufij vendore që i janë përshtatur pozicionimit gjeotopografik dhe relievit duke qënë si nënnjësi kryesore. Ndërkaq, krahina e Mokrës, edhe pse me tipare të dallueshme e të ndryshme me ato të fushëgropës së Pogradecit ka qënë pjesë tradicionale

dhe historike e organizimit të pushtetit vendor. Organizimi i ri administrativ, ka bërë një ndryshim të ndjeshëm në krahasim nga ai i mëparshëm. Kështu, krijimi i Bashkisë së Pogradecit ka në përbërje të tij një territor më të madh, të diversifikuar dhe me më shumë sfida dhe probleme në të.

Profili i njësive administrative të Bashkisë Pogradecit

Profili i Njësisë Administrative Dardhas

1. Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Niçë është një ndër qendrat e para të banuara të njësisë administrative Dardhas. Fshati i vjetër lidhej me fshatin Llëngë (sot në njësinë administrative Trebinjë), por edhe me qendra të tjera të banuara të Mokrës, Gorës dhe me qytetin e Voskopojës nëpërmjet një rruge të vjetër që ishte degëzim i Via Egnatias. Në këtë fshat ishin zhvilluar mjaft zejtaritë e ndryshme, dhe kishte një numër të madh hanesh, ku pushonin karvanet e udhëtarëve, dhe prishja e Voskopojës ndikoi keq edhe në ekonominë e këtij fshati, dhe solli largime të banorëve nga fshati drejt zonave të tjera.

2. Demografia

Njësia administrative Dardhas ka 3,566 banorë / 1175 familje (Burimi: Njësia Administrative Dardhas, 2015). Dardhasi përbëhet nga 9 fshatra:

Foto - 2 *Pamje nga rruga për në fshatin Dardhas Burimi: IDRA, 2015*

Dardhas, Osnat, Stopckë, Grunjas, Prenisht, Dërdushë, Lekas, Niçë, Stërkanjë.

3. Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Dardhas ditët e sotme janë Bujqësia dhe Blegtoria. Njësia zotëron 2412 Ha tokë bujqësore, e cila ndahet në 2184 Ha tokë arë, 187 Ha pemtore, 41 Ha vreshta, dhe 176.6 Ha gështenja. Dardhasi njihet për drurët frutorë si: qershitë, dardhat (prej nga ka marrë edhe emrin), lajthitë e kumbullat e egra. Kultivimi i tyre është bërë ndër vite nga banorët e zonës, por shitja e prodhimit në ditët e sotme, has një seri vështirësish, si mungesa e pikave të grumbullimit dhe mungesa e një pike frigoriferike për konservim.

4. Ekonomia

Në njësinë Administrative Dardhas janë 22 biznese të vogla të regjistruara, kryesisht shitore, apo lokale-kafene. Ka patur një kërkesë për një pikë grumbullimi frigoriferike (për mollët, dardhat e qershitë), por aplikuesi nuk e ka ndërtuar dot për arsye ekonomike.

5. Prognoza e zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj. Zona e Gurit të Kamjes, është e pëlqyer nga çiklistë dhe motoçiklistë të huaj, për shkak të terrenit të thyer dhe të elementeve peizazhistikë. Madje në 2015 është zhvilluar edhe Rally Albania në zonën Dardhas – Niçë - Mesmal. Me zgjidhjen e disa problemeve më imediate, zona do të merrte një zhvillim të konsiderueshëm. Ndër problemet më imediate veçohen:

1. Sistemimi i rrugës Lekas-Osnat-Dërdushë-Stërkanjë-Niçë
2. Mbjellja e arrorëve dhe vjelja e tyre
3. Krijimi i një baxhoje sipas standarteve bashkëkohore
4. Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të zeza

Profili i Njësisë Administrative Trebinjë

1. Gjeneza – historiku i fshatrave

Zona e Mokrës së sipërme ka një terren të thyer malor, ku mbizotëron mali i Kozicës, prej të cilit rrjedhin përrenj të shumtë që bashkohen në rrjedhën e lumit Shkumbin. Pikërisht, ky terren bëri që zona të arrijë t'i shpëtojë disi ndikimit të pushtuesve otomanë. Nga qendrat e para të banuara të kësaj njësie ka qënë fshati Llëngë, pranë të cilit kalonte një degëzim i rrugës Egnatia (çka bënte lidhjen më fshatin Niçë, e më tej më Voskopojën). Në shek. XVII-XVIII, Llënga pati një zhvillim të madh ekonomik, dhe u kthyer në një qendër të rëndësishme zejtarie e tregtie, që rreth vitit 1750 numëronte rreth 10,000 banorë. Prishja e Voskopojës ndikoi pashmangshmërisht edhe në fatin e Llëngës.

3. Demografia

Njësia administrative Trebinjë ka 3197 banorë / 1097 familje (Burimi: Njësia Administrative Trebinjë, 2015)

Trebinja përbëhet nga 15 fshatra: Çezëm e Madhe, Çezëm e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Pleshisht, Hoshtecë, Zemçë, Trebinjë, Potkozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë.

Foto. - 3 *Fshati Trebinjë Burimi: IDRA, 2015*

4. Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Trebinjë janë Bujqësia (60%) dhe Blegtoria (40%). Kultura kryesore është gruri.

5. ***Ekonomia***

Në njësinë Administrative Trebinjë që është ndoshta edhe njësia më e varfër e Bashkisë Pogradec, janë rreth 28 biznese të vogla, kryesisht shitore, lokale - kafene, një mulli me çekiç dhe një nallban. Biznese të mëdha të regjistruara janë një subjekt me vaska peshku dhe një TV kabllor.

6. Prognoza e zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhistike e historike. Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve, veçohen:

1. Ndërtimi i ujësjellësit që përfshin fshatrat Dunicë, Trebinjë e Pleshisht
2. Ndërtimi i rrugës për në Manastirin e Shën Marenës
3. Sistemimi dhe rivënia në punë e veprës ujitëse që i shërbente 8 fshatrave të njësisë administrative Trebinjë.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE PROPTISHT

1.Gjeneza – historiku i fshatrave

Territori i njësisë administrative Proptisht përfshin një pjesë të zonës së Mokrës së Poshtme. Mokra e Sipërme me Mokrën e Poshtme kanë disa të përbashkëta, por edhe dallime, si në folklor, veshje popullore e në të folur. Varret monumentale të Selcës, të gdhendura në gur, ndodhen në kodrën e Gradishtës të Selcës, në pjesën perëndimore të fshatit të sotëm Selcë e Poshtme.

Foto - 4 *Fshati Slabnijë Burimi: IDRA, 2015*

2.Demografia

Njësia administrative Proptisht ka 6393 banorë / 1938 familje (Burimi: Njësia Administrative Proptisht, 2015). Proptishti përbëhet nga 15 fshatra: Proptisht, Homçan, Kriçkovë, Selcë Poshtë, Homezh, Rodokal i Sipërm, Rodokal i Poshtëm, Zall-Torre, Golik, Vërri, Slatinë, Selishtë, Baribardhë, Somotinë, Slabinjë.

3. Ekonomia

Në njësinë Administrative Proptisht janë rreth 43 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (shitore, bar –bufe, e ushqimore), dhe 6 biznese të mëdha (2 HEC, 2 Antena televizive, dhe 2 miniera: 1 minierë Hekur- Nike në fshatin Baribardhë, dhe 1 minierë kromi në fshatin Rodokal i Sipërm).

4. Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Proptisht janë Bujqësia (70%) dhe Blegtoria (30%). Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, misri, tërshëra, fasulet, patate, foragjeret e perimet e ndryshme.

5. Prognoza e zhvillimit

Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve, veçohen:

1. Rikonstruksioni i kanaleve vaditëse për bujqësinë, investim që do të zgjidhte vaditjen e tokave bujqësore.
2. Sistemimi i rrugëve ekzistuese (disa km rrugë janë shtruar me kontribut vullnetar nga vetë banorët e zonës)
3. Sistemimi i ujrave të zeza e të bardha brenda fshatrave dhe paisja me matesa për ujin e pijshëm.

PROFILI i NJËSISË ADMINISTRATIVE VELÇAN

1. ***Gjeneza – historiku i fshatrave***

Velçani është një nga fshatrat e mëdhenj të Mokrës së Poshtme, dhe ndahet në disa lagje. Paria e këtij fshati, historikisht ka dominuar të gjithë zonën e Mokrës.

Edhe në këtë zonë ka gjurmë që dëshmojnë për vjetërsinë e zonës, psh. toponimet nga koha e pushtimit romak (me origjinë latine), Bishnicë nga "bosco" (pyll), Laktesh nga latinishtja "lactum", që ka kuptimin "qumësht", Shpellë nga "speleo" (shpellë), etj., që tregon më së miri praninë e banimit më të hershëm se pushtimi, sepse më parë këto qyteza thireshin respektivisht bush apo shpell, si emra tipikisht pellazg apo ilir.

Foto - 5 *Fshati Jollë*

2. Demografia

Njësia administrative Velçan ka 3725 banorë (Burimi: Njësia Administrative Velçan, 2016) dhe përbëhet nga 9 fshatra: Velçan, Buzaishte, Laktesh, Senisht, Bishnicë, Losnik, Shpellë, Jollë, Zgallë. Fshati më i madh është Velçani me 1800 banorë, dhe fshati më i vogël e më i largët është Zgalla, në vijim të fshatit Jollë.

1. Ekonomia

Në njësinë Administrative Velçan janë rreth 32 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (shitore, bar –bufe, e ushqimore), dhe 1 HEC aktiv në Bishnicë (dhe 2 të tjerë në ndërtim e sipër)

2. Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Velçan janë Bujqësia (60%) dhe Blegtoria (40%). Kulturat kryesore që kultivohen janë gruri, patatet, foragjeret e perimet e ndryshme.

3. Prognoza e zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, kryesisht të natyrës peizazhistike. Por, turizmi pengohet në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e infrastrukturës. Kërkesa për ndërtime të reja momentalisht mungojnë. Kryesisht vijnë kërkesa për mirëmbajtje e riparime, kur ka dëmtime të banesave ekzistuese.

PROFILI i NJËSISË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË

1.Territori i njësisë administrative Çërravë përfshin një pjesë të fshatrave të zonës së luginës së Çërravës (Çërrava, Nizhaveci, Leshnica), dhe një pjesë të fshatrave të Malit të Thatë (Blacë, Alarup, Bletas).

2. Demografia

Njësia administrative Çërravë ka 9853 banorë (Burimi: Njësia Administrative Çërravë, 2015) dhe përbëhet nga 10 fshatra: Çërravë, Lumas, Leshnicë, Grabovicë, Nishavec, Blacë, Bletas, Alarup, Kodras, Qershizë . Fshati më i madh është Çërrava me 1902 banorë.

3. Ekonomia

Në njësinë Administrative Çërravë janë rreth 83 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (tregti pakice, bar-kafe, TV kabllor, ambulancë e lëvizshme, profesione të lira, 1 sallon bastesh e 1 bilardo), dhe 15 biznese të mëdha (asfaltim/inerte).

4. Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet të tjera të rëndësishmë ekonomike në Njësinë Administrative Çërravë janë Bujqësia dhe Blegtoria. Veçanërisht në zonën e Çërravës dhe Leshnicës është e zhvilluar pemëtaria e vreshtaria, dhe kulturat më të kultivuara janë: mollët e gështenjat. Mollët kanë vështirësi për t'u shitur pasi nuk ka as treg, as një vendmagazinim frigoriferik të mirëfilltë. Ka vetëm një frigorifer në fshatin Grabovicë, i cili është ndërtuar me investim privat.

Foto - 6 *Fshati Alarup*

5. Prognoza e zhvillimit

Zona ka disa elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhistike e agro-turistike. Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në zonë e në jetën e banorëve, veçohen:

1. Ndërtimi i një sistemi kanalizimesh për fshatrat Leshnicë e Çërravë, ujërat e zeza të të cilave aktualisht derdhen ne lumenj që përfundojnë më pas në liqenin e Ohrit.
2. Sistemimi i ujt të pijshëm për të gjithë fshatrat e njësisë
3. Problem kryesor
4. Shpyllëzimi masiv dhe shitja e drurit për ngrohje në stinën e dimrit.

Profili i Njësisë Administrative Udënisht

1. ***Gjeneza – historiku i fshatrave***

Fshati Lin, nga gjetjet e deritanishme, mendohet të ketë qënë një një vendbanim i lashtë dhe i madh. Mbi kodër janë zbuluar mozaikët e vjetër dhe bazilika bizantine (e ndërtuar rreth shek. VI, në kohën e perandorit Justinian).

2. ***Demografia***

Njësia administrative Hudënisht ka 7894 banorë (Burimi: Njësia Administrative Udënisht, 2015) dhe përbëhet nga 6 fshatra: Memëlisht, Çervenakë, Udënisht, Piskupat, Buqezë, Lin. Fshati më i madh është Udënishti me 2712 banorë.

3. ***Ekonomia***

Në njësinë Administrative Udënisht janë rreth 30 biznese të mëdha (nga 60 që kanë qënë, para prishjes të ndërtimeve buzë liqenit). Ndër ta veçohen 5 Hotele dhe 6-7 operatorë minierash të liçencuar, ndërsa pjesa tjetër janë biznese familjare (kryesisht shitore).

4. ***Bujqësia, Blegtoria***

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Hudënisht janë Peshkimi dhe Bujqësia. Nga 150 varka të liçencuara për të kryer peshkimin e koranit (për të gjithë Bashkinë Pogradec), 100-120 varka i ka Komuna Udënisht.

5. Prognoza E Zhvillimit

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, kryesisht të natyrës peizazhistike, historike, kulturore e agro-turistike. Por turizmi pengohet në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e infrastrukturës pritëse. E ardhmja e kësaj njësie, synon drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, që nënkupton një shfrytëzim më efikas të vijës bregliqenore (është tentuar dhe zhvillimi i lundrimit, por pa sukses) dhe aseteve të shumta kulturore.

Profili i Njësisë Administrative Buçimas

1.Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Tushemisht, në vendin ku është sot, mendohet të jetë populluar jo më shumë se 200 vjet më parë, nga të ardhur prej fshatrave përreth ose nga zona më të largëta. Vendbanimi i vjetër, mendohet të ketë qënë në një vend më të ngritur (prapa kodrës së Kishës të Shën Pandelimonit). Starova ka qënë qendra administrative për tërë trevën e Pogradecit në kohën e Perandorisë Osmane, pra edhe fshati më i madh. Vetë emri "Starovë" nga sllavishtja ka kuptimin "i vjetër" (fshat i vjetër).

2. Demografia

Njësia administrative Buçimas ka 21180 banorë (Burimi: Njësia Administrative Buçimas, 2015) dhe përbëhet nga 8 fshatra: Buçimas, Vërdovë, Rëmenjë, Gështenjas, Bahçallëk, Gurras, Tushemisht dhe Peshkëpi. Fshati më i madh është Buçimasi me 7500 banorë.

3. Ekonomia

Në njësinë Administrative Buçimas, aktivitetet kryesore ekonomike janë Bujqësia dhe Blegtoria (70%), të ndryshme (20%) dhe artizanati (10%). Baza e ekonomisë ka qënë ndërtimi, por me bllokimin e lejeve janë krijuar vështirësi të shumta. Në njësinë Buçimas (kryesisht në pjesën bregliqenore) ndodhen hotele dhe restorante, të cilat krijojnë mundësi punësimi për banorët e zonës, dhe të qytetit. Në këtë njësi gjenden atraksione të ndryshme, si Parku i Drilon-it, Fshati turistik i Tushemishtit, Mozaiku i Tushemishtit, Pjesa breg liqenore, Gatimet tradicionale, etj.

4. Bujqësia, Blegtoria

Kulturat kryesore që kultivohen në njësinë Buçimas janë drithërat, pemëtaria dhe bimët medicinale. Kohë më parë është mbjellë edhe sherebelë, por më pas u shkul, për shkak të rënies së çmimit në treg.



Fig. - 9 *Diferenca e Popullsisë*

a) Situata demografike

Analiza demografike është baza mbi të cilën mbështeten të gjitha elementet planifikuese të planit të përgjithshem vendor. Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, lëvizjet e mëdha migratore te 20-25 viteve të fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt.

Se pari, duhet theksuar se momentalisht në Shqipëri ka dy lloje burimesh që përdoren në lidhje me shifrat e popullsisë:

1. Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile
2. Të dhënat e popullsisë sipas Censusit te vitit 2011



Fig. – 10 *GRUPET MOSHORE Burimi: Census dhe Gjendja Civile*

Pavarësisht se të dhënat e INSTAT për popullsinë bëjnë vlerësim të popullisë vetëm mbi bazën e Censusit (lexo Censuseve), të dhënat e Gjendjes Civile në fakt janë të dhënat që konsiderohen zyrtarisht për shpërndarjen e Transfertës së Pakushtëzuar nga Qeveria Qendrore në Bashki. Pra, nga njëra anë kemi institucionin zyrtar të statistikave kombëtare (INSTAT) që raporton një popullsi prej 2,894, 475 (2014), ndërkohë që një institucion tjetër zyrtar, si Ministria e Financave, kur bën alokimin e transfertës së pakushtëzuar përdor një të dhënë tjetër të popullsisë, sipas regjistrit të gjendjes civile, i cili qëndron në shifrat e një popullsie totale prej 4, 329, 326 banorësh (2014), një diferencë prej rreth 1,4 milion banorësh në nivel kombëtar.

Nga pikëpamja e shtrirjes territoriale dhe formësimit urban, njësitë administrative të Buçimasit dhe të Udënishtit kanë një lidhje me "organike" midis tyre duke krijuar një territor të përbashkët, afër njëri-tjetrit, dhe të lidhur nga bregliqeni. Këto 3 njësi përbëjnë edhe 73% të popullsisë të të gjithë bashkisë duke formuar kështu pikën e "gravitetit" demografik të bashkisë së re te Pogradecit. Njësite "malore" të bashkisë, Dardhas, Trebinjë, Velçan dhe Proptisht, përbëjnë 18% të popullsisë së bashkisë. Rreth 17% e popullisë, sipas Gjendjes Civile, është e moshës 0-14 vjec, që nënkupton moshën e fëmijëve, më së shumti në arsim të detyrueshëm (e rëndësishme sidomos për planifikimin e arsimit parauniversitar). Rreth 72% e popullisë është në moshen 15-64 vjeç që nënkupton moshën aktive për punë dhe 10% e popullsisë është në moshën 65 vjeç e lart, që nënkupton moshën ekonomikisht jo-aktive. Nga të dhënat që gjeneron Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), duket se mundësia e vetme që ka Gjendja Civile për të nxjerrë numrin e popullsisë mbi bazën e njësisë më të vogël administrative nuk është fshati apo lagjja, pasi kjo gjë nuk reflektohet saktë në regjistër, por është Qendra e Votimit. Ky kategorizim është i saktë në nivel Njësia Administrative (Ish –Komunë), por nuk të jep informacion në nivel fshati. Momentalisht kjo është mundësia më e mirë pasi sipas DPGJC, vetëm sistemi i adresave, i cili po zbatohet tani mund të sjellë mundësinë për të gjeneruar të dhëna në nivel fshati apo lagje. Ndërsa kemi konsideruar deri tani shifrat e dhëna nga Regjistri i Gjendjes Civile është per t'u vënë re diferenca që ekziston midis këtij numri dhe atij që ka vlerësuar Censusi i vitit 2011 për Bashkinë e Pogradecit. Numri i raportuar nga Censusi 2011 për Bashkinë e Pogradecit është rreth 32% më i ulët se numri që raporton Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile per vitin 2016 (shiko grafikun). Kjo diferencë vjen kryesisht si pasojë e migrimit (të jashtëm e te brendshem), pra personave/familjeve që janë larguar dhe jetojnë diku tjetër por që figurojnë ende në regjistrat e gjendjes civile në ato zona. Një

diferencë e tillë është e konsiderueshme dhe mund të ndikojë në përllogaritjet e ndryshme të planit të përgjithshëm vendor. Një analizë e kujdesshme e diferencave midis shifrave të Censusit 2011 dhe raportimeve të regjistrit të Gjendjes Civile, edhe në nivel Njësie Admistrative nxjerr në pah edhe disa tregues të tjerë. Sipas tabelës së mëposhtme që paraqet të dy burimet e shifrave të popullsisë, duket se diferencat më të mëdha janë në tre njësi administrative:

1. Qyteti i Pogradecit, i cili sipas Censusit të 2011 ka 20848 banorë ndërkohë që sipas Gjendjes Civile supozohet të ketë 36842 banorë. Kjo diferencë nga Censusi me 15994 persona, është pothuajse 43% më pak se sa numri i deklaruar në Gjendjen Civile, një shifër kjo e konsiderueshme për nivelet e planifikimit.
2. Njesia Administrative e Udënishtit, e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë një popullis prej rreth 11000 banorësh, ndërkohë që sipas Censusit të 2011 ka rezultuar pothujse 45% më pak me 4785 banorë.
3. Njësia Administrative e Dardhasit, e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë popullsi prej 3794 banorëh, ndërkohë që sipas Censusit ka rreth 42% më pak (2182 banorë).

Duket se këto tre njësi jane prekur më së shumti nga levizjet migratore, ndërkohe që sipas të dhënave, Buçimasi është nga ato njësi qe edhe ka pritur të ardhur nga njësi të tjera duke zbutur kështu diferencën midis të ikurve dhe të ardhurve në atë njësi.

Popullsia në Bashkinë e Pogradecit anon nga pesha e asaj rurale me 59% kundrejt asaj urbane me 41%. Ky është një raport i kundërt me treguesin në nivel kombëtar ku 57% e popullsisë konsiderohet Urbane dhe 43% Rurale (Burimi: INSTAT). Një raport i tillë i popullsisë kushtëzon edhe mënyrën dhe nivelin e investimeve të ndryshme të Bashkisë për të ofruar shërbime publike të aksesuseshme në territor, duke e vene Bashkine ne veshtiresi me te medha per investime infrastrukturore.



Fig. - 12 *Urbane vs Rurale*

Pavarësisht që për nevoja të bashkisë është e domosdoshme që të dihet popullsia reale rezidente (banuese), për efekt të përllogaritjeve të ndryshme të planit të përgjithshëm vendor, sugjerohet që shifra e popullsisë e raportuar nga gjendja civile të jetë baza. Kjo është shifra zyrtare që raportohet dhe mbi bazën e së cilës bashkia duhet të përllogarisë nivelin e volumeve të shërbimeve publike të ndryshme. Gjithsesi, për efekt të vlerësimeve specifike, Bashkia duhet të bëjë analizë ad-hoc ku duhet të marrë parasysh faktin e popullsisë rezidente (e dalë nga vlerësimet e Censusit 2011). Struktura moshore e popullsisë është e rëndësishme për të vlerësuar raportet e varësisë së atyre segmenteve që me gjasa janë të varura ekonomikisht (fëmijë + të moshuar) dhe që janë "konsumatorë neto" ndaj atyre që janë me gjasa ekonomikisht aktiv, (Prodhues Neto). Ndryshimet në këtë raport janë të domosdoshme për të parë së çfarë politikash mbështetëse janë të nevojshme nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Një nivel i lartë varësie nënkupton që popullsia aktive dhe ekonomia në përgjithësi përballet me një barrë të madhe për të mbështetur dhe ofruar shërbime sociale tek moshat e reja dhe moshat e vjetra. Të dhënat e përpunuara për Bashkinë e Pogradecit tregojnë që treguesi i varësisë për

këtë bashki është në nivele më të mira se treguesi për Shqipërinë në total, nëse do te nisemi nga të dhënat e Gjendjes Civile.

Sipas këtyre të dhënave treguesit i Varësise së Përgjithshme për Pogradecin është 38%, që do të thotë se për çdo 100 persona ekonomikisht aktive janë per t'u mbështetur 38 persona ekonomikisht jo-aktive (fëmijë dhe të moshuar). Ky tregues për Shqipërinë është 47%. Në terma konkrete kjo do të thotë se, sipas gjendjes civile, kjo Bashki ka një popullsi aktive me peshë të madhe duke krijuar një potencial të madh njerëzor për zhvillimin ekonomik. Kjo popullsi e ka moshën aktive, dhe nëse ekzistojnë mundësitë për punësim mund të bëhet një aset i rëndësishëm ekonomik.



Fig. - 13 *Ndryshimi i popullsisë, 1999 - 2011*

Gjithsesi, premisat duken se janë të tilla që Bashkia e Pogradecit, pavarësisht se nga treguesit ekonomikë është në nivele relativisht te larta të varfërisë (sidomos për njësi të caktuara administrative), ka një strukturë moshore që përbën potencial për zhvillimin ekonomik të zonës.

Lëvizjet dhe Projeksioni i Popullsisë

Projeksioni i popullsisë për periudhën e ardhshme është një domosdoshmëri për planifikimin e zhvillimit social-ekonomik të Bashkisë. Në vijim, do të paraqitet projeksioni i popullsisë për 15 vitet e ardhshme i bazuar në parametrat që parashikon INSTAT. Sipas studimit të INSTAT, në nivel kombëtar, popullsia e Shqipërisë është përfshirë, në këto 25 vite, në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe gjithashtu është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve.



Fig. - 14 *Popullsia dhe norma e rritjes së saj në % në Shqipëri*

Burimi: CENSUS, 2011

Emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë, si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik. INSTAT ka bërë një përllogaritje të projeksionit të popullsisë bazuar në 3 skenarë:

1- Skenari 1 – Vdekshmëri e Lartë, Lindshmëri e Ulët, Migrim i Lartë
2- Skenari 2 – Vdekshmëri e Mesme, Lindshmëri e Mesme, Migrim i mesëm
3- Skenari 3 – Vdekshmëri e Ulët, Lindshmëri e Ulët, Migrim i Ulët

Bashkia Pogradec do të ketë një popullsi në rënie e cila nëse bazohemi tek Gjendja Civile në vitin 2013 do të jetë 81488 banorë dhe nëse bazohemi tek Censusi do të jetë 53972 banorë.

Ky trend duhet mbajtur parasysh gjatë llogaritjeve të planifikimit për planin e përgjithshëm vendor. Pavarësisht këtij trendi kombëtar, faktorë të tjerë të zhvillimit ekonomik, nxitja për hapjen e bizneseve të reja, gjenerimi i mundësive të reja për punësim, investime, nxitja e turzimit, mund të ndikojnë ndjeshëm në ndryshimin e këtij trendi.

Fig. - 15 *Migrantë të kthyer 2011*

Konkluzione paraparake

Verifikimi i popullsisë rezidente në territorin e bashkisë duhet të jetë një objektiv i vazhdueshëm i strukturave të bashkisë. Duke qenë se shifrat e ofruara nga regjistrat e Gjendjes Civile ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga shifrat që ofrohen nga INSTAT/Censusi, është e domosdoshme që Bashkia të gjejë mekanizmat të tjerë për të verifikuar popullsinë. Mundësi për të pasur një vlerësim të përafërt nga bashkia do të ishin:

- Vlerësimi në bazë të kontratave të ujit (për qytetin e Pogradecit) duke
- gjykuar numrin aktual të abonentëve dhe duke pasur edhe nje vlerësim (trend) për kontrata te reja në 5-10 vitet e fundit. Kujdes duhet bërë për të ndarë konsumatorët biznes me konsumatorët – individë.
- Vlerësimi në bazë të kontratave me OSHEE për energjinë elektrike – në nivel të plotë bashkie. Edhe këtu duhet pasur kujdes ndarja sipas natyrës se konsumatorit (biznes – individ).

- Nga pikëpamja e planifikimit urban, dendësia dhe shpërndarja demografike e kombinuar me pozicionin gjeografik (lidhja me bregun liqenor) sugjerojnë se qyteti i Pogradecit, Njësia e Buçimasit dhe Njësia e Udënishtit, duhet të konsiderohen si një vijimësi-lidhje urbane. Kjo 3-she njësish përbën edhe 73% të popullsisë së gjithë bashkisë. Raporti dizavantazhues që ka Bashkia e Pogradecit në lidhje me popullsinë urbane vs. popullsi rurale (lexo - me shumicë popullsi rurale) në fakt zbutet dukshëm nga trajtimi i kësaj "makro-njësie" urbane pasi lidhja infrastrukturore e këtyre njësive nuk është në nivele aq problematike sa ç'është në përgjithësi zona rurale tjetër.
- Struktura moshore e popullsisë së Bashkisë se Pogradecit tregon një potencial të madh përsa i

përket segmentit ekonomikisht aktiv të popullsisë (15-64 vjec). Ne kushtet e nxitjes së mundësive për punësim, ky segment ofron nje motorr të burimeve njerëzore që mund të shtyjë pozitivisht zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Bashkia duhet t'i përgjigjet këtij segmenti me politika që nxisin punësimin.

- Nga ana tjetër, raportet e varësisë totale janë relativisht të mira duke sugjeruar se barra që i bie

segmentit moshor ekonomikisht aktiv për të mbështetur segmentet ekonomikisht jo-aktive (fëmijë + moshuar) nuk është shumë e rëndë. Në vlerësimet për mbështetje sociale që bashkia duhet të planifikojë për të ardhmen, duhet të mbajë parasysh këto raporte varësie.

- Duke vlerësuar diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt të planifikimit, të përdoret burimi i Gjendjes civile. Megjithatë, kur të diskutohen shpërndarje specifike shërbimesh (mbulim me shkolla apo me ambjente shëndetësore psh) duhen marrë parasysh edhe vlerësimet që vijnë nga përllogaritjet e Censusit të INSTAT.



Situata urbane dhe informaliteti

FIG. - *16* ***SISTEMET TERRITORIALE BASHKIA POGRADEC BURIMI: CORINE, AKPT, PËRPUNOI IDRA, 2016***

Në Shqipëri, mungesa e planeve hapësinore dhe moszbatueshmëria e bazës ligjore është konsideruar të jetë pengesa më e madhe për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rajonal. Shkalla e përgatitjes së tyre ka qenë shumë e ngadalshme për të parandaluar praktikën e ndërtimeve informale. Mosrealizimi i planeve dhe programeve, konsiderohet si arsyeja kryesore e mungesës së një zhvillimi të qëndrueshëm. Rritja e dendësisë së ndërtimeve për dekadën e fundit në këto dy qarqe ka shkaktuar një dëmtim të hapësirave publike dhe një shpërndarje të pabarabartë të shërbimeve publike. Kjo ka sjellë një mbingarkesë në zonat me zhvillim ekonomik më të lartë. Tipologjitë e ndërtimit janë:

kryesisht me karakter banimi dhe biznesi, duke lënë të njëjtin numër ndërtimesh me karakter publik shëndetësor, arsimor, kulturor. Kërkesa për zonat me zhvillim urban më të lartë ka shkaktuar një rritje deri diku të pajustifikuar të vlerës së pronës në këto territore, nëse marrim si referencë mungesën e shërbimeve dhe cilësisë së ofruar për komunitetin dhe më gjerë.



Fig. - 17 *Sistemi urban në përqindje*

Ndikim shumë të madh kanë edhe ndërtimet informale përpara viteve 2005-2006. Megjithëse, zonë me zhvillim urban dhe ekonomik, Bashkia Pogradec nuk ka ofruar në atë shkallë, sikundër shumë Bashki të tjera terren për ndërhyrje jashtë planeve dhe rregullave urbane, si hapësira me komoditet urban, me mundësi për shërbime publike, me hapësira publike, me infrastukturë ekzistuese dhe lehtësira të tjera të lidhura me ekonominë dhe mundësitë e

punësimit.

Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura

Burimi i materialeve të përdorura për të gjeneruar hartat e përdorimit të tokës, janë materialet e marra nga Corine, të mundësuara nga AKPT në fillim të projektit, të cilat në vijim janë pasuruar e përditësuar nga grupi punës pranë IDRA gjatë vizitave të shpeshta në terren e konsultimeve me specialistët në Bashkinë Pogradec dhe Njësitë Administrative.



Fig. - 18 *Përdorimi i tokës bashkia Pogradec Burimi: Corine,AKPT, Përpunoi IDRA*

Në territorin e Bashkisë Pogradec, për shkak edhe të diversitetit të relievit, vihet re një mbizotërim i dukshëm i sistemit natyror (74 %), i cili ndahet në pyje, toka me vegjetacion të ulët e kullota. Sistemi bujqësor (20%), i dyti në sipërfaqë ndërthurret shpesh me Sistemin Urban (4%), gjë që vihet re sidomos në zonën Pogradec-Buçimas. Sistemi ujor e infrastrukturor zënë rreth 1% të sipërfaqes të përgjithshme të Bashkisë.

Përdorimi i tokës në bashkinë Pogradec

Analiza e përdorimit të tokës është hartuar në bazë të kërkesave ligjore të Ligjit të Planifikimit 107/2014 dhe VKM 671 "Rregullorja e Planifikimit të Territorit".



Fig. - 19 *Përdorimi i tokës në qytetin e Pogradecit*

Analiza e përdorimit të tokës është trajtuar sipas kategorive dhe nënkategorive bazë të përdorimit të tokës ndërsa hartëzimi i materialit është kryer në sajë të të dhënave të mara nga Corine, nëpërmjet AKPT dhe azhornimit të materialit nga vizitat në terren dhe analizimit me ekspertët e grupit. Pjesa më e madhe e territorit të bashkisë përbëhet nga kategoria e përdorimit natyror dhe dhe atij bujqësor, si dhe banim. Në hartën e përdorimit të tokës janë evidentuar kategori përdorimi si hekurdha, infrastruktura rrugore, ujëra, varreza, arsim, industri dhe ekonomi, institucione, shëndetësi si dhe zona mirerare. Vihet re një përhapje më e madhe e kategorive të arsimit dhe institucioneve në zonën urbane të qytetit të Pogradecit.

Bujqësia

Sipas gjendjes së tyre rezultojnë që në Malinë, rezervuaret janë plotësisht të demtuar me çarje dige dhe me basen të mbushur me dhera. Ndërsa rezervuaret në gjendje të mirë teknike por që nuk funksionojnë sepse janë bllokuar pusetat e brendshme apo tubacione saraqineska janë ai i Qafë – Thanës, Vasidolit dhe Luadhi i Çelos. I gjithë rrejti i kanaleve ujitës me gjatësi 136.4 kml është i amortizuar por që ka dalë plotësisht jashtë funksionimit dhe per rrjedhoje edhe rezervuaret nuk funksionojnë janë Rez. Jama e Homezhit, moçalet e Homezhit.

- Lidhur me stacionet e elektropompave duhet theksuar se nga 16 gjithsej, sot është në gjendje pune vetëm një elektropompë tek stacioni Bakalicë fshati Lin. Të gjithë të tjerët janë të dëmtuar plotësisht.

Zhvillimi i blegtorisë

Kur flitet për problemet e zhvillimit të bujqësisë në zonën rurale të Bashkisë Pogradec duhet saktësuar tek infrastruktura e ujitjes dhe kullimit për rezervuaret siç kemi thënë më lart dhe jo çfarë shkruhet, ndërsa për infrastrukturën kulluese duhet thënë se në Bashkinë Pogradec janë kanale të I-rë dhe të II-të kullues si edhe KUL (kanale të ujrave të larta) 64060 ml dhe të gjithë kanë nevojë për pastrim sepse rrotacioni për pastrimin e kanaleve kullues në Pogradec është 5-7 vjet dhe këto 3-4 vjetët e fundit janë pastruar vetëm 70% e kanaleve kullues Fusha Nizhavec – Petushë.

Infrastruktura rrugore

Në këtë seksion do të shqyrtohet sistemi i infrastrukturave rrugore në tërësi, duke marrë në konsideratë klasifikimin e rrjetit rrugor, analizimin e gjendjes ekzistuese, shtrirjen, llojin e transportit, lidhjet infrastrukturore, etj.

Aktualisht, bashkia Pogradec është një nyje e rëndësishme në rrjetin kombëtar dhe ndërkombëtar të transportit si pjesë e Koridorit VIII , Rrugës Egnatia dhe Transportit Ujor Ndërkufitar në Liqenin e Ohrit . Si pjesë e Korridorit-VIII, ai bën pjesë në aksin hekurudhor dhe rrugor Durres-Vlorë –Rrogozhinë-Elbasan-Prenjas-Pogradec. Terrritori i bashkisë Pogradec përbëhet nga disa akse të rëndësishme rrugore kombëtare të cilat e ndihmojnë atë për t'u lidhur me rajonet e tjera fqinje. Në bashkinë Pogradec shtrihet rruga nacionale Tiranë – Korçë, një aks i rëndësishëm që lidh kryeqytetin me me rajonin juglindor. Kjo rrugë në territorin e bashkisë shtrihet përgjatë vijës liqenore në periferi si dhe futet në brendësi të qytetit.

Fig. - 20 *Infrastruktura kombëtare*

Një aks tjetër i rendësishëm është ai "Qukës – Qafë Plloçë", i cili tashmë ka filluar të ndërtohet dhe që do të bëjë një lidhje më efikase të Kryeqytetit me Bashkinë e Pogradecit dhe Korçës. Vlen të përmendet

edhe linja hekurdhore Elbasan – Prrenjas – Pogradec, e cila pavarësisht se sot është jashtë funskionit është një potencial i madh për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të territorit të bashkisë.

Mënyrat e transportit në bashki dhe linjat

Mënyrat e transportit që përdoren aktualisht sipas kategorizimit të bazuar në KRr në Bashkinë Pogradec janë: lëvizja në këmbë, lëvizja me mjete (autovetura) private, lëvizje e kufizuar me biçikletë, mungon shërbimi publik qytetas, i cili është konsideruar nga Bashkia si "jo efektiv", përdoren aktualisht transporti me autobus ndërmjet qytetit të Pogradecit dhe ish-komunave dhe transporti me autobus ndërqytetas. Ekzistojnë dy linja kryesore ajo e rrjetit të linjave të transportit publik dhe linjat ndërqytetase.

Verifikimi i cilësisë të infrastrukturës rrugore

Nga analiza përgjithësuese mund të nxjerim disa tregues domethënës për rrjetin rrugor të Qytetit të Pogradecit duke ju referuar dhe hartave të emërtimit të rrugëve, skemës së qarkullimit, apo dhe hartës të klasifikimit të rrjetit rrugor. Ashtu si edhe evidentohet në tabelën e mësipërme duket qartë se pjesa më e madhe e rrugëve të paraqitura në kartelë janë të pajisura me trotuare ndërsa cilësia e rrugëve varjon nga rrugë të shtruara me asfalt deri në rrugë të pashtruara.

Tipologjia e rrugëve

Rrjeti rrugor përfaqëson pjesën më vitale dhe më delikate të një zone urbane, duke e konsideruar si një organizëm të gjallë që është vazhdimisht i "ushqyer" me njerëz, mallra, energji, informacion. Rrjeti urban rrugor është i ndarë në tre kategori rrugësh:

1. primare (të përshpejtimit),
2. sekondare (rrjedhëse) dhe
3. të treta (të lagjeve dhe lokale)

Rrugët Primare janë rrugët me funksione hyrëse dhe dalëse nga qyteti dhe në shërbim të Transportit të këmbimit ndërmjet territorit urban dhe ekstra urban, si dhe të Transportit transit përkundrejt zonave urbane. Ne kategorinë e rrugëve primare Urbane përfshihen:

Autostradat Urbane – Seksionet e të cilave i kemi rekomanduar për ndërtimin e By-Paseve të qytetit të Pogradecit ;



Fig. - 21 *Sistemi rrugor, Bashkia Pogradec Burimi: AKPT, përpunoi IDRA, 2016*

Rrugët primare rrjedhëse – funksioni i të cilave është garantimi i fluiditetit të zhvendosjes së këmbimit të automjeteve edhe rrjetit të qarkullimit brenda qytetit. Ato lejojnë një nivel të lartë të shërbimit të zhvendosjes në distanca më të mëdha brenda rrjetit urban. Në këtë kategori rrugësh bëjnë pjesë rrugët e shpejta urbane, rrugët me shpejtësi të kufizuar urbane, itineraret e rezervuara të mjeteve publike të krijuara në korsitë e rrugëve të rezervuara dhe nga rrugë me korsi të

rezervuara.

Rrugët Sekondare ose rrugët lokale janë rrugë urbane me kapacitet të mesëm dhe të lartë, me funksionet e mëposhtme:

1. mbledhjen/shpërndarjen e trafikut ndërmjet rrugëve primare dhe linjat me kapacitet të ulët të rrjetit
2. nën lidhjet me njësitë bashkiake të qytetit

Rrugët lokale me funksion lidhës ndërmjet lagjeve fqinje (ç'vendosje në distanca minimale, gjithmonë brenda qytetit) ose për zonat urbane me dimensione më të mëdha, ndërmjet pikave ekstreme të lagjeve. Në këtë kategori hyjnë, rrugët e destinuara për shërbimet kryesore urbane të lagjeve.
Rrugët e treta janë rrugët urbane me kapacitet të ulët me hyrje lokale për në njësitë administrative

Linja hekurudhore

Linja hekurdhore në bashkinë Pogradec, sot është jashtë funksionit por ashtu si edhe u përmend edhe më sipër përbën një potencial të madh për zhvillimin ekonomik të bashkisë. Lidhur me këtë sot ekzistojnë disa nisma strategjike dhe zhvillimore. Një prej tyre është ajo e planifikimit të studimit të fizibilitetiti për lidhjen e hekurudhës së Shqipërisë me Maqedoninë nëpërmjet linjës hekurudhore Lin – Strugë [ii.]

Lidhja nëpërmjet ujit

Bashkia Pogradec ka mundësi për zhvillimin e linjave të transportit ujor nëpërmjet liqenit të Ohrit si për qëllime turistike ashtu dhe për shërbime transporti për teritorin që laget nga ujrat e liqenit ashtu dhe per zonën ndërkufitare Bashkia Pogradec. Megjithatë sot moli i qytetit nuk e ofron këtë shërbim dhe ka nevojë për rikonstruksion. Linja Ujore Ohër - Strugë - Pogradec është miratuar në parim nga krerët e bashkive vite më parë, por pavarësisht kësaj, burokracitë e ndryshme qeveritare bënë që projekti në fjalë të zvarritej dhe të mbetej për një kohë të gjatë vetëm në letër. Për zhvillimin e industrisë së lundrimit ka

një prognozë, por pa sukses. Deri më sot, korridori ujor Ohër - Pogradec ka qenë një drejtimësh, që d.t.th funksionim vetëm nga pala Maqedonase.

FOTO - 7 ***LIQENI I OHRIT***

Analiza dhe vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të qarkullimit

Duke ju referuar shkallës aktuale të motorizimit (numrit të automjeteve për 1000 banorë), treguesve të kërkesës për mobilitet urban të motorizuar kundrejt përmasave të shtrirjes dhe forms dhe përmasave të qytetit, shpërndarjes të vëndeve të punsimit, çerdheve, kopshteve dhe shkollave kapacitetet qarkulluese të qytetit[iii] nuk përbëjnë problem, ndërkohë që duhet të shikohet me kujdes problem i parkimeve, sidomos në periudhën e sezonit turistik dhe fundjavës, por edhe gjatë gjithë vitit. Nga ana tjetër në

territorin e bashkisë nuk ekziston një sistem i transportit publik. Prandaj është e nevojshme të rivlerësohet edhe njëherë sistemi i transportit publik edhe ai i parkimeve publike.

Zhvillimi Social dhe Ekonomik

Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015–2020, adreson çështjet e skemës së ndihmës ekonomike aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, etj. Skemat e NE-së dhe PAK-ut janë përfshirë në një reformë të gjerë për të siguruar efikasitetin dhe barazinë në akses dhe transparencën e tyre. Sfidat më të rëndësishme në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike është kthimi nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të ri-integrimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit dhe rritja e eficencës së saj. Mbulimi më i mirë i familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër është një kusht i domosdoshëm për cdo bashki. Vihet re se numri i bizneseve te medha ka pasur një rënie nga viti 2011, dhe deri në vitin 2015 ka arritur nivelin me të ulët në rënie, i njëjti fenomen dhe për biznesin e vogël që ka shënuar pikën më të ulët në vitin 2014. Por biznesi i vogël ka një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit në Pogradec. Mendohet që dhe prishjet e lokaleve për shkak të rregullimit të rrugës kanë pasur efektin e tyre në uljen e numrit të bizneseve. Për sa i takon komunave Bucimasi, Udënisht, Çërrava vihet re të kenë dhe numër biznesesh të rregjistruar më shumë se njësitë e tjera administrative. Për sa i përket Njësive Adminsitrative një veçori në lidhje me aktivitetet e tyre Bujqësore, është mos rregjistrimi i Fermerëve lokale në skemën e subvencione që bën të mundur Ministria e Bujqësisë. Mungesa e rregjistrimit të tyre, nuk u krijon mundësi fermerëve që të grumbullohen produktet e tyre nga pikat e caktuara të grumbullimit, dhe blerjen e produkteve me çmimet e stimuluara, sipas zonave. Heqja e kasës fiskale është një tjetër oportunitet që i ofrohet fermerëve për të rritur mundësinë e përfshirjes në skemat e subvencionit. Por, ndihma e Bashkisë është e pashmangshme.

PAPUNËSIA

Papunësia mbetet një nga problemet më serioze me të cilin përballet Shqipëria në përgjithësi. Ky problem, gjykuar nga të dhënat, duket se është edhe më i theksuar në rastin e bashkisë së Pogradecit. Përpara se të kalojmë në një analizë më të detajuar të shifrave të papunësisë sipas njësive administrative duhet theksuar një çështje e përkufizimit të kategorive të punësimit.

Së pari INSTAT përdor dy lloje të dhënash mbi tregun e punës:

- Të dhëna administrative (Zyrat e Punës)
- Të dhëna nga anketa e punës

ARSIMI

Nga relacionet dhe takimet me sektorin e Arsimit në Bashkinë Pogradec, vihet re se ka zona në të cilat frekuentimi i shkollave është mjaft i ulët, ka institucione ku numri i fëmijëve shkon në 10 fëmijë, ky është një fenomen që ndodh në disa zona rurale. Ka raste ku është për shkak të migrimit të familjeve dhe ka një numër të vogël fëmijësh. Ka raste ku nuk mund të përdoren një shkollë për dy fshatra kufitarë dhe ku mund te jetë më eficiente tu sigurohet fëmijëve transporti për të mos mbajtur shkolla

hapur me pak mësues dhe fëmijë. Sektori i Arsimit pranë Bashkisë duhet të njohë mirë gjendjen e numrit të fëmijëve për rregjistrim, për të mos marrë vendime të nxituara gjithsesi për ndryshimin e destinacionit të objekteve arsimorë. Ka raste kur këto institucione mund të përdoren për shkolla profesionale, qendra shëndetësore etj. Në të gjitha sugjerimet e bëra do të ketë një njohje të mirë të terrenit, të kontigjentit të fëmijëve për shkollim, dhe planifkimit dhe shpërndarjes së mirë të kapacitetit. Në zonat rurale, gjendja e analfabetizimit duhet eleminuar, arsimi i detyrueshëm 9 vjeçar duhet të jetë një prioritet për Bashkinë pasi këta banorë pa arsim s'do të kenë mundësi të përfitojnë nga mundësitë që i jepen për shkollim, veçanërisht brezat e rinj. Në Pogradec, ka disa shkolla me mbi kapacitet, me turne dhe ndërkohë ka asete të identifikuara si mundësi për shkolla të tjera, për të shpërndarë këtë kapacitet. Gjithashtu ka nevojë për hapjen e shkollave të reja. Pogradeci ka vetëm një çerdhe në të gjithë Bashkinë, hapja e institucioneve të tilla lehtëson nënat për t'i dhënë mundësi për punësim. Prandaj është e domosdoshme t'u krijohen këto mundësi.

Identiteti ekonomik i Bashkisë Pogradec

Vihet re se numri i bizneseve të mëdha ka pasur një rënie nga viti 2011, dhe deri në vitin 2015 ka arritur nivelin me të ulët në rënie, i njëjti fenomen dhe për biznesin e vogël që ka shënuar pikën më të ulët në vitin 2014. Por biznesi i vogël ka një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit në Pogradec. Mendohet që dhe prishjet e lokaleve për shkak të rregullimit të rrugës kanë pasur efektin e tyre në uljen e numrit të bizneseve. Për sa i takon komunave Buçimasi, Udënisht, Çërrava vihet re të kenë dhe numër biznesesh të rregjistruar më shumë se njësitë e tjera administrative. Për sa i përket Njësive Adminsitrative një veçori në lidhje me aktivitet e tyre Bujqësore, është mos rregjistrimi i Fermerëve lokale në skemën e subvencioneve që bën të mundur Ministria e Bujqësisë. Mungesa e rregjistrimit të tyre, nuk u krijon mundësi fermerëve që të grumbullohen produktet e tyre nga pikat e caktuara të grumbullimit, dhe blerjen e produkteve me çmimet e stimuluara, sipas zonave. Heqja e kasës fiskale është një tjetër oportunitet që i ofrohet fermerëve për të rritur mundësinë e përfshirjes në skemat e subvencionit. Por ndihma e Bashkisë është e pashmangshme.

Turizmi dhe Koha e Lirë

Turizmi si një sektor mjaft i rëndësishëm në Bashkinë Pogradec, sidomos viteve të fundit vihet re një rritje e fluksit të turistëve. Nga një anë, infrastruktura rrugore, peisazhi i përmirësuar liqenor, kushtet klimaterike të Pogradecit, shërbimi cilësor, produktet bujqësore vendase, tradita e kulinarisë janë burime të rëndësishme për Turizmin e Pogradecit. Nga tabela e mëposhtme, numri i turistëve sipas të dhënave të Bashkisë, është trefishuar nga viti 2007-2012. Në një përiudhë 5-Vjeçare është rritja e numrit të turistëve është shume e ndjeshme. Ndërkohë që ky sektor po rritet në mënyrë progresive, nga ana e Bashkisë, duhen objektiva për ta nxitur ekonominë vendase në shërbim të këtij sektori, dhe në mënyrë që ky turizëm të zhvillohet i organizuar dhe jo në mënyrë spontane. Ndërtimi i kioskave, dhe restoranteve buzë liqenit, jo vetëm kishte prishur peisazhin liqenor, por ishte në dëm të bizneseve të tjera që mund të zhvilloheshin në krahun tjetër të rrugës, ku mundësia është më e madhe për një numër më të madh biznesesh që operojnë në



fushën e turizmit. Megjithë kostot ekonomike dhe sociale që solli prishja e këtyre ambienteve pati dhe efektin e vet pozitiv. Nga ana e Bashkisë, duhet të dalë qartë mesazhi që moskoordinimi dhë rregullimi i këtij sektori sjell pasoja të mëdha për ekonominë vendase, papunësi, ulje të të ardhurave familjare, bashkisë etj. Të dhëna statististikore për numrin e turistëve në Pogradec

Fig. - 22 *Numri i turistëve Pogradec, 2012*

Zonat e pushimit/atraksionit më të preferuara nga turistët

Rrethi Pogradec	Taxi	Autobus
Burimi i Drilonit	8 min	15 min
Fshati turistik i Tushemishtit	10 min	20 min
Shpella e Najazmes	15 min	25 min
Guri i Kamjes	40 min	1 orë e 10 min
Shpella e Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Manastiri i Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Kanioni i Llëngës	2 orë e 50 min	4 orë e 30 min
Varret e Selcës	1 orë e 30 min	2 orë
Fshati turistik i Linit	20 min	35 min
Mozaikët e Linit	25 min	45 min

Tab. - 2 *Atraksionet më të preferuara*

Një veçori tjetër e këtij sektori në Pogradec është sezonaliteti. Turizmi liqenor deri tani ka qenë sezonal vetëm në përiudhën e verës. Momentalisht me intensitet më të lartë gjatë dy muajve të verës (korrik, gusht). Ky turizëm sipas Bashkisë konsiston në turizmin familjar, në hotelet e motelet ekzistuese. Kohët e fundit vihet re që ka frekuentim dhe ditor apo në fundjavë. Megjithatë, Bashkia Pogradec kërkon të promovojë më shumë opsione për turizmin përveç atij liqenor, atij kodrinoro-malor/agroturizëm, turizëm historiko-kulturor, rekreacioni etj. Është e rëndësishme që të gjitha këto qëllime dhë objektiva të jenë të pasqyruara në plane konkrete dhe sidomos në njohje si fillim të zonës dhe kapaciteteve. Disa prej Njësive Adiminsitrative të Bashkisë Pogradec mund të jenë potencial për atraksione turistike, por nuk kanë ende investimet bazë, si dhe nuk kanë ende vëmendje të mjaftueshme nga pushteti lokal për këto mundësi, dhe njohje te plotë të tyre. Bashkia Pogradec, duke njohur potencialet e Turizmit dhe efektet ekonomike që sjell ky sektor mund të zbatojë politika fiskale të diferencuara për sektorët që do të stimulojë.

Zonat e rëndësisë kombëtare në territorin e bashkisë Pogradec

Përshkrimi i zonës

Bashkia e Pogradecit është pjesë e rrjetit të zonave natyrore të mbrojtura dhe një pjesë e mirë e saj është pjesë e kategorisë së V të zonave të mbrojtura atë të "Peisazhit të Mbrojtur". Kjo zonë është shpallur zonë e mbrojtur me V E N D i M Nr.80, datë 18.2.1999.

Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ka një sipërfaqe prej 27.323 ha. Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë. Kufijtë e ZM-së përcaktohen me Vendimin Nr. 80, datë 18.2.1999 "Për shpalljen e territorit tokësor/ujor të Pogradecit "Zonë e mbrojtur", si më poshtë:

- Veri Qafë Thanë: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë);
- Lindje: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe kufiri liqenor me Parkun Kombëtar të Prespës: (maja e Pusit: 2,288m, maja e Zonjës: 2,085 m) dhe kuotat 1,912 m;
- Jug: Kuota 1,912m, kuota 1,461 dhe kuota 1,589 m;
- Perëndim: kuota 1,461, dhe kuota 1,589m, maja e Beshenikut (1,411m) maja e Shullerit (1,226



m), maja e Fushës së Madhe (1,430m), maja e Muratit (1,520), Qafa e Kotodeshit, Qafa e Thanës.

FIG. - 23 ***MONUMENTET E KULTURËS DHE ZONA E MBROJTUR***

SEKSIONI 4
PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT

4.1 MJEDISI ATMOSFERIK

4.1.1 Shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit

Në përgjithësi shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit janë:

- aktivitetet industriale;
- mjetet automobilistike dhe sasia e trafikut në përgjithësi;
- pajisjet e ngrohjes nëpër ndërtesa.

Faktorët kryesor që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë sektori i transportit dhe djegia për ngrohje që mbeten burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Kjo lidhet me numrin e madh të automjeteve që nuk plotësojnë standartet e shkarkimeve në ajër, cilësia e lëndës djegëse që përdorin, viti i prodhimit të tyre, si dhe përdorimi i automjeteve me motor pa konvertor katalitik, duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit, si dhe shkarkimet e gazta gjatë djegjes së karburantit. Gjithashtu, mos përdorimi i energjive alternative në banesat, panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta, etj, kanë ndikimin e tyre në ndotjen e cilësisë së ajrit, sidomos në shkarkimin e pluhurave, blozave dhe dioksideve të karbonit e të azotit.

4.1.2 Ndotësit e ajrit

Gjatë vitit 2014- 2015 janë ndërmarrë disa nisma ligjore që lidhen me cilësinë e ajrit të mjedisit dhe me sistemin e taksave për lëndët djegëse. VKM nr. 594, datë 10.09.2014, miratoi Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e

cilësisë së ajrit të mjedisit'. Ky ligj përbën kornizën për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe është bazuar në Direktivën 2008/50/EC dhe 2004/107/EC. Ligji hyn në fuqi në Dhjetor 2017. VKM nr 352/2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të, u miratua në datë 29.04.2015.

Cilësia e ajrit

Sektorët kryesorë kontribues janë ai i transportit, industria, bujqësia, përdorimi shtëpiak i produkteve si dhe ngrohja. Të gjithë këto sektorë çlirojnë një shumëllojshmëri ndotësash si dioksid squfuri, okside të azotit, nga druri (PM10), bujqësia (NH3, PM10), dhe industria (VOC, NOX, PM10. Dhjetëra mijëra produkte të tjera kimike përdoren nga njeriu në aktivitetin industrial dhe në jetën e përditshme. Hidrokarburet, aromatikët, polinuklearët (PAH) si (etileni, acetileni, tolueni, xilleni) metalet e rënda, pesticidet dhe herbicidet, poliklorodifenili (PCB), tretësira organike dhe metale në formë gjurmësh, përfaqësojnë faktorë të ndotjes lokale që vijnë nga burime të ndryshme.

Dioksidi i squfurit

SO2 është formuar nga oksidimi i squfurit dhe kryesisht nga djegia e lëndës djegëse me përmbajtje squfuri. Sektori i prodhimit të energjisë elektrike është burimi kryesor i SO2. SO2 është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës. Në grafikun e mëposhtëm janë dhënë vlerat mesatare vjetore të SO2 në qytetet kryesore të vendit tonë. Siç vihet re dhe nga grafiku vlerat e monitoruara në Pogradec të SO2 janë të ulta. Po ti referohemi vlerave ditore dhe orare të monitoruara vërejmë se nivelet e tyre janë më të ulta në krahasim me standartin orar dhe ditor të BE-së.

Fig. - 24 *Vlerat mesatare të SO2 Burimi: AKM, Min Mjed*



Përmbajtja më e ulët e squfurit në karburant

Për shkak se emetimet e SO2 janë direkt proporcionale me përmbajtjen e squfurit të karburantit të djegur, kjo do të krijojë zvogëlime të menjëhershme. Për shembull, të zvogëlosh nivelin e squfurit të naftës së përdorur nga automjetet, nga mesatarja aktuale rreth 2.7 në 0.5% do të zvogëlojë emetimet e SO2 nga këto mjete në rreth 80%. Duke pakësuar përmbajtjen e squfurit në karburant do të zvogëlojë gjithashtu formacionin e sulfatit dhe si pasojë emetimet e PM. Gjithashtu, pakësimet e mëdha në përmbajtjen e squfurit në karburant do të lejojnë zvogëlime shtesë në NOx dhe PM, duke përdorur mekanizmat e sigurt pas trajtimit që nuk punojnë me efekt në prani të lartë të koncentrateve të squfurit.

Vlerësimi i situatës për NO_2 (Dioksid azoti)

NO2 është një ndotës që emetohet në atmosferë si rezultat i djegies së lëndës djegëse nga proçeset industriale dhe sektori i transportit rrugor. NO2 është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë mëlçinë, mushkëritë, shpretkën dhe gjakun. Ashtu si SO2 dhe NO2 ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit.



Fig. – 25 *Vlerat mesatare vjetore për NO2 Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit*

Për NO2, burimi kryesor i ndotjes është shkarkimi i automjeteve dhe siç vihet re nga grafiku nivelet më të larta janë monitoruar në stacionet e instaluara pranë rrugëve me trafik të rënduar. Nga stacionet e instaluara tregohet se ka një nivel jo të lartë [iv] të NO2. Ky nivel mund të shpjegohet me arsye të ndryshme, si:

- prani të gjelbërimit m2/banorë dhe struktura e bimësisë për thithjen e pluhurave;
- aktivitete industriale brenda qytetit;



Fig. - 27 *Përdorimet e vlerave të Nox Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit*

Fig. – 26 *Vlerat në kufi për NO2 dhe Nox*





Fig. - 28 *Përqëndrimet e vlerave të NO_X (Burimi: AKM Tirane)*

Qyteti	Pikat e kampionimit	Periudha Maj-Qershor 2015	Periudha Maj-Qershor 2015	Periudha Gusht-Shtator 2015	Periudha Gusht-Shtator 2015	Periudha Nentor-Dhjetor 2015	Periudha Nentor-Dhjetor 2015
		Nox µg/m3	O3 µg/m3	NOx µg/m3	O3 µg/m3	NOx µg/m3	O3 µg/m3
Pogradec							
1	ne hyrje	21,3	55,4	30,6	62,7	20,49	61,23

2	DSHP	25,6	49,5	34,8	60,9	22,14	63,78

Tab. - 3 *Rezultatet e Monitorimit per tre periudhat e monitoruara per treguesit NOx dhe O3*

Vlerësimi i situatës nga pluhurat (pm10, pm2.5)

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime komike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diametër 10 dhe 2.5 micron ose më të vegjël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO2, Nox, NH3 dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike, si djegia e lëndës energjitike, ndërtimet, pluhuri natyral pezull, etj. PM2.5 nuk është monitoruar nga sistemet e institucioneve publike, por kemi nxjerrë disa të dhëna të mesatarizuara prej vetë monitorimeve të bizneseve për këtë rajon, mbështetur në listën e dhënë informative prej Drejtorisë Mjedisore të Qarkut Korçë.



Fig. – 29 *VLERAT VJETORE PËR PM10 BURIMI: SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR*

Niveli i lartë i PM10

PM10 – ose "particulate matter" është lënda e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 10µ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i kuq i PM10 tregon vlerën e lartë që i arrin 60 µg/m3. Ky nivel i përqendrimit të PM10 mund të shpjegohet me arsye të ndryshme, si:

- numri i lartë i automjeteve në një qendër të caktuar;
- lëvizja apo përdorimi i automjeteve me naftë, e pak me benzinë apo gaz;
- prania shumë e ulët e rrugëve ekologjike
- relievi i papërshtatshëm, i rrethuar nga male e kodra, ku ajri qarkullon me vështirësi;
- aktivitetet industriale brenda qytetit;
- qarkullimit të automjeteve të vjetra ose me emetime gazrash, etj.
- mos përdorimi i energjinë alternative në banesa, si panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta,

PM2.5 – ose "particulate matter" është lënda e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 2.5µ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i kuq i PM2.5 tregon vlerën e lartë që i kalon 35 µg/m^4. Ky nivel i përqendrimit të PM2.5 mund të shpjegohet për të njëjtat arsye si më sipër.

4.1.3 Gazrat me efekt serë

Shqipëria ka ratifikuar dokumentet e Konventës së Vjenës dhe Protokollit të Montrealit më 8 tetor 1999 dhe duke filluar prej 7 janarit 2000 është palë me to. Nga qenia palë në Konventën e Ozonit buron dhe detyrimi i Shqipërisë për raportimin e konsumit në vite të substancave ozonholluese, si dhe zbatimin e kuotave të caktuara nga Protokolli i Montrealit. Prej vitit 2001, Shqipëria ka planin kombëtar

të ozonit, në të cilin përfshihet plani kombëtar i heqjes nga përdorimi i substancave që hollojnë shtresën e ozonit. Plani kombëtar u hartua nga Ministria e Mjedisit me asistencën e Agjencive Implementuese, UNEP-it dhe UNIDO-s. Për të realizuar planin kombëtar të ozonit dhe gjithë aktivitetet që janë parashikuar në të, është krijuar Njësia Kombëtare e Ozonit dhe Implementimit të Projekteve – National Ozone Projects Implementation Unit (NOPIU). Konsumet e substancave ozon holluese CFC (klorfluorkarboneve) dhe HCFC (hidrogjen flourklorkarboneve) sipas viteve të shprehura me Mton/vit, janë si më poshtë:

Tab. - 4 *Lendet ozonholluese ne vite (Burimi: Raport per Gjendjen e Mjedisit, 2011)*

VITI	2006	2007	2008	2009	2010	2011
CFC	15.2	4.08	2.2	0	0	-
HCFC22	-	46.34	74.5	97.37	107.1	102.5
HCFC142b	-	-	-	-	9.07	13.12
HCFC124	-	-	-	-	1.08	-

Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosferë, ai formohet si rezultat e zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosferë si NOx, CO, NMVOC dhe CH4 në prani dhe të rrezatimit diellor. Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator, duke zvogëluar funksionimin e mushkrive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera te mushkrive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë, duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.



Fig. - 31 *VLERA VJETORE TË O3*



Fig. - 30 *Përqëndrimet e vlerave të O3*

Burimi: Agjencia Kombetare Mjedisit



Përsa i përket O3, në të gjitha pikat e monitoruara përqëndrimi është relativisht konstant. Në Pogradec përqëndrimet më të larta të ozonit i ka pranë DSHP-së.

Fig. – 32 *Vlerat mesatare të O3 për periudhën Nëntor-Dhjetor Burimi: AKM, pranë MM*

Monoksidi i Karbonit

Monoksidi i Karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesore të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, bisnesi, shtëpitë dhe industria. CO hyn në reaksion me ndotësit e tjerë duke prodhuar ozonin e niveleve të ulëta të atmosferës. Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje. Ndërsa, në stacionin e Pogradecit niveli i lartë i CO, sidomos në stinën e dimrit, është për shkak të përdorimit të druve të zjarrit si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave.

Metalet e rëndë

Plumbi është një metal i rëndë, që ndodhet në përbërjen e kores së tokës. Përqendrimet natyrore të plumbit janë të ulët, por shfrytëzimi i plumbit nga njeriu ka rritur nivelet e përmbajtjes së këtij ndotësi në atmosferë. Burimi kryesor i plumbit në ajrin urban është djegia e benzinës me plumb nga motorët e automjeteve.

Përfundime:

1. Treguesit mjedisorë të cilësisë së ajrit shprehin përmbajtjen në ajër të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta.
2. Kufizimi i shkarkimeve në ajër realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të detyrueshëm të normave të shkarkimeve.
3. Për burimet e lëvizshme, normat e shkarkimeve përcaktohen mbi bazën e treguesve mjedisorë të trysnisë në gazin e shfryrjes nga këto burime, të cilat janë: përmbajtja në të e blozës, e dioksidit dhe e oksidit të karbonit, e oksideve të azotit, e hidrokarbureve dhe e plumbit.
4. Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit të ndotjes paguajnë taksë shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotësve të shkarkuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" dhe të funksionimit të këtyre sistemeve, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

4.1.4 Mjedisi Akustik - Zhurmat

Niveli i zhurmave urbane (LAeq): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjitha burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.



Fig. - 33 *Niveli i zhurmave (Burimi:AKM Tirane)*

Zhurmat e matura në DB në disa zona dhe fshatra të qytetit të Pogradecit, Rruga nacionale në Buçimas, e cila ka dhe ndotjen më të madhe akustike si pasojë e transportit të makinave. Për zvogëlimin e impaktit të zhurmës në komunitetin urban të Pogradecit duhet të kenë përparësi të

madhe. Ndaj:

1. Të forcohet puna për zbatimin e standarteve të përcaktuara për zhurmat urbane dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre.
2. Të promovohen sigurimi i objekteve dhe masave për zvogëlimin e zhurmës urbane siç janë:
   a) Sigurimi i brezit mbrojtës të gjelbër dhe hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara e rrugës kryesore, si një nga masat më eko-miqësore për të reduktuar ndotjes.
   b) Të përcaktohen me rregullore distancat midis rrugëve dhe banesave.
   c) Të bëhen përpjekje për zvogëlimin e zhurmës, që në projektimin e ndërtimeve të reja.
3. Të përmirësohet dhe ndërhyhet në kodin rrugor. Për këtë qëllim është e domosdoshme:
   a) Të sigurohet kontrolli periodik i mjeteve të transportit që gjenerojnë zhurmë.
   b) Të parashikohen ndërhyrjet në sinjalistikën rrugore, ku të përfshihen në të sinjalet që lidhen me zhurmat si dhe vendosjen e tyre në pika të caktuara.
   c) Të sigurohet mirëmbajtja e sistemit rrugor.
4. Të përmirësohet qeverisja urbane, nëpërmjet rritjes së transparencës dhe llogaridhënies për zbatimin e suksesshëm të të gjitha politikave të menaxhimit dhe planizimit urban.
5. Edukimi i publikut është kërkesa më e rëndësishme e shoqërisë. Programet e ndërhyrjes për zvogëlimin e zhurmës mund të mos kenë sukses pa pjesëmarrjen e popullatës.
6. Duhen përdorur mjetet moderne të komunikimit për të gjeneruar ndërgjegjësim masiv ndaj ndikimit negativ të ndotjes nga zhurma.

4.2 KLIMA

Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që teritori i bashkisë së Pogradecit të futet në zonën, ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Reshjet e pakta bien në formë bore.

Fig. - 34 Harta e zonave klimatike Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Klima e rajonit në të cilin bashkia Pogradec gjendet është tipike kontinentale, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të ftohtë dhe me reshje jo të shumta.

Tab. – 5 *Krakteristikat kryesore të klimës në rajonin e Pogradecit*

Nr	KARAKTERISTIKA	TIPI
1	Tipet kryesore të klimës	Mesdhetare kontinentale para malore
2	Vendodhja e stacionit më të afërt metereologjik	Pogradec
3	Rreshjet mesatare vjetore	760 mm
4	Muaji me rreshjet më të dendura	Dhjetori

5	Muaji me rreshje dëbore më të mëdha	Janari
6	Fillimi dhe fundi i shirave të vjeshtës (p.sh herët në shtator, mesi i tetorit, fundi i tetorit)	15 Shtator - 30 Nëntor
7	Fillimi dhe mbarimi i rreshjeve në pranverë	15 Mars - 30 Prill
8	Fillimi dhe përfundimi i rreshjeve te dëborës	5 Dhjetor - 15 Mars
9	Muaji i shkrirjes së plotë të dëbores	Fillim muaji Maj
10	Fillimi dhe përfundimi i periudhës së thatë	Korrik - Shtator
11	Data e ngricës së parë	Pas 10 Nëntorit
12	Data e ngricës së fundit	10 ditëshi i parë Prillit
13	Temperatura minimale mesatare afatgjatë, muaji dhe zgjatja	Temp.mes.vjetore 6-12ºC Temp.min.vjetore (-10ºC) (-15ºC)
14	Muajt e tokës së ngrirë (lartësi 50 cm)	Janar-Shkurt deri 20 cm thellësi

Era

Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe dimër. Erërat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Erërat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme. Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë: mëngjeset karakterizohen nga luhatjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur qetësia prishet nga erërat e jugut dhe juglindjes. Shpejtësia mesatare e erës në rajonin e Ohrit është relativisht e ulët, 3.4 m/sek. Era përcaktohet si lëvizje horizontale e ajrit, ndërsa lëvizja vertikale quhet rrymë ajri. Karakteristikat kryesore të erës janë drejtimi dhe shpejtësia e erës. Drejtimi i erës është kahu nga fryn era dhe merr emrin e tij sipas një prej 16 pikave të horizontit. Lugina e lumit shërben si një drejtues për rrymat ajrore dhe po të gjykojmë nga të dhënat e stacionit meteorologjik të Elbasanit drejtimi dominues, në të gjithë stinët, janë VL (20% të rasteve) dhe JP (10.4% të rasteve). Rrymat ajrore janë një ndër faktorët kryesorë të formimit të klimës. Në territorin në studim, drejtimi i erës gjatë vitit është i ndryshueshëm. Shpejtësitë e erës në territorin në studim janë në vartësi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të shpejtësisë së erës vrojtohen në stinën e dimrit. Shpejtësitë maksimale të erës me periudhë përsëritje një herë në 50, 20, 10 vjet janë respektivisht 30-33m/s, 28-30m/s, dhe 24-27m/s (sipas Kushteve teknike Hidrometeorologjike).

Temperatura

Regjimi termik paraqet uniformitet të kënaqshëm. Vleftat e temperaturës mesatare vjetore përgjithesisht luhaten rreth 13.0o C. Temperatura mesatare e janarit lëkundet në rreth 2.9 oC. Në figurë paraqitet shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit



Fig. – 35 *Shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

Ecuria ditore e temperaturës së ajrit, në çdo stinë dhe muaj të vitit, shprehet nga një valë pothuajse sinusoidale, që karakterizohet nga një maksimum në orët e para të pasdites. Dukuria e uljes së temperaturës minimale deri në vlera negative është përgjithësisht veçori e muajve të dimrit. Por të tilla mund të vrojtohen pjesërisht edhe gjatë marsit e tetorit. Më 5 janar 1980 në Prrenjas është regjistruar temperatura minimale –19.0 o C.

Regjimi termik i ajrit dhe i tokës duhen parë në kompleks. Dihet se temperatura e ajrit dhe e tokës në të njëjtin moment nuk janë të njëllojta. Ajri nuk ngrohet drejtpërsëdrejti nën veprimin e rrezeve të diellit, por nga nxehtësia që lëshon toka. Në tërësi ecuria vjetore e temperaturës mesatare të shtresës sipërfaqësore të tokës (0 – 20 cm thellësi) është e ngjashme me atë të ajrit. Vlerat më të larta vrojtohen në muajt e verës, ndërsa ato më të ulëta në muajt e dimrit. Në ecurinë e temperaturave të tokës vërehen dy momente kryesore:

a) periudha kur temperatura mesatare rritet me rritjen e thellësisë

b) periudha kur kjo temperaturë ulet me rritjen e thellësisë.

Tendenca e rritjes së vlerave mesatare të temperaturës së tokës nga sipërfaqja në drejtim të thellësisë duket, përgjithësisht, nga fundi i muajit shtator. Dukuria e uljes së vlerave mesatare të temperaturës së tokës nga siperfaqja në thellësi, është veçori e muajve të gjysmës së ngrohtë të vitit minimum rreth kohës së lindjes së diellit.

Temperatura maksimale gjatë verës variojnë 36-38 gradë, temperatura mesatare mujore luhatet nga 20 gradë deri në 24 gradë. Gjatë dimrit bien dhe reshje dëbore, ku në rajonin tonë e përreth trashësia shkon në mbi 0.5m, ndërsa në veri në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900-1300 mm, dhe më shumë reshje bien në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme deri në muajin Shkurt. Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës rrihet nga erëra të ftohta. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rreth afërsisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është gjatë Janarit, rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17.2°C.

Reshjet atmosferike

Reshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë regjimin klimaterik të zonës. Reshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Niveli më i lartë i reshjeve normalisht shënohet në Nëntor-Janar dhe në pranverën e vonë, zakonisht në maj. Reshjet arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Reshjet mesatare të shiut në vit në basenin e liqenit shkojnë afërsisht 759 mm. Termi reshje, i perdorur në hidrologji, përfshin të gjitha format e ujit që vijnë nga atmosfera në tokë. Format kryesore të reshjeve janë: shiu, bora, breshëri, vesa etj. Reshjet atmosferike janë nga elementët më të rëndësishem të motit dhe të klimës.

Faktorët kryesore që kushtëzojnë sasinë, intensitetin, shpërndarjen vjetore, stinore e mujore të reshjeve, në zonën në studim janë: pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Është e qartë se për një pellg, përgjithësisht, reshjet janë faktori kryesor i regjimit hidrologjik, sepse ato janë vetë edhe materiali kryesor qe krijon rrjedhjen në hapësirë dhe kohë. Një karakteristikë e përgjithshme e shpërndarjes së reshjeve në pellgun e Shkumbinit është se lartësia e tyre rritet nga Perëndimi në Lindje deri në pellgjet e degëve Gostime e Rapun (inklusiv) dhe pastaj zbret nga Veriu në Jug. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishëm të motit dhe të klimës.

	Periudha e perseritjes (vjet)					Max (mm)	Min (mm)	Mesatarja (mm)
Stacioni	500	100	50	20	10			
Pogradec	1472	1296	1214	1099	1005	1209	351	763

Tab. - 6 *Reshjet vjetore (në mm) Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar,Libri Klimatologjia*

Në territorin në studim, gjatë vitit bien mesatarisht 1424 mm në Stravaj dhe 763 mm në Pogradec.

	Reshjet me te medha		Reshjet me te pakta		Raporti ndermjet reshjeve me te medha e me te pakta.
	Sasia mm	Viti	Sasia mm	Viti	
Pogradec	1209	1947	351	1953	3.44

Tab. - 7 *Vitet me reshje maksimale dhe minimale dhe raporti ndërmjet tyre. Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar,Libri Klimatologjia*

Shpërndarja e reshjeve brenda vitit në territorin në studim është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë me thatësirë që mund të zgjatë disa muaj. Ndarja e vitit në dy gjysma viti është bërë duke ndjekur kriterin pluviometrik të muajve. Si gjysmë e ftohtë e vitit është marrë inkluziv periudha tetor - mars ndërsa ajo e ngrohtë periudha prill - shtator. Muajt me më shume reshje janë Nëntori, Dhjetori e Janari, por reshjet më të shumta vrojtohen në muajin Nëntor. Muaji me më pak reshje është Korriku. Nga sasia e reshjeve mbizotëron stina e dimrit, megjithëse vjeshta në disa raste barazohet me të.

STACIONI	Periudha e perseritjes ne vjet			
	2	20	50	100
Pogradec	7	1099	1214	1296

Tab. – 8 *Lartësia e reshjeve vjetore me periudhë të ndryshme përsëritje Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

Dëbora

Në Shqipëri reshjet në formë bore bien kryesisht në muajt e dimrit dhe përfshijnë më tepër zonat malore të vendit sidomos ato që shtrihen në brendi të territorit. Mesatarja e lartësive maksimale të dëborës, për territorin në studim, është nga 15 deri 30 cm. Vlera mesatare e dendësisë së borës merret 0.13 gr/cm3. Mesatarja e lartësive maksimale të borës ndryshon me ndryshimin e lartësisë së vendit, mbi nivelin e detit sipas kësaj ligjësie (shiko Kushtet Meteorologjike të Projektimit) :

ku:

$Y = 2.3(H/100) + 3.7$

Y – mesatarja e lartësive maksimale ne cm, H - lartësia e vendit mbi nivelin e detit në m.

P.sh. për lartësinë 800 m mbi nivelin e detit, mesatarja e lartësive është 22.1 cm. Për zonën në studim (në lartësinë 800 m) vlera e pritshme për periudhën e përsëritjes një herë në 50 vjet është 22.1 x 3.4 = 75 cm. Ndryshimet klimatike nuk kanë më nevojë të paraqiten si një fenomen global që mund të ndikojë tek ekosistemet, si dhe tek sektorë të rëndësishëm të bujqësisë. Ndryshimet klimatike janë tashmë një kërcënim i njohur që, për t'u trajtuar siç duhet, duhet të merren në konsideratë në mënyrë të integruara, si pjesë e sfidave më të mëdha të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global. Ndryshimet klimatike pritet që të rrisin frekuencën dhe madhësinë e ngjarjeve ekstreme si dëmet e shkaktuara nga përmbytjet, thatësira, zjarret nëpër pyje, valë të nxehti dhe rreziqe të tjera klimatike. Pritet gjithashtu që të shkaktojnë reduktim të drithërave dhe të ujit. Ndryshimet e shpejta dhe/ose të ashpra klimatike mund të kenë një ndikim të madh në inventarin biotik të liqenit. Për më tepër, eutrofikimi i Liqenit të Pogradecit pritet të përforcohet dukshëm nga ngrohja globale. Ndryshimet e temperaturës, anomalitë në reshje dhe shpeshtësia e rritur e ngjarjeve ekstreme mund të çojë në degradimin e burimeve ujore dhe mund të shkaktojë pasoja ekstreme në ekosistem.

Liqeni i Ohrit - Stacioni Lin

Stacioni ndodhet në pjesën veriperëndimore të liqenit. Ekspeditat për marrjen e mostrave është realizuar në sezone të ndryshme vetëm në sipërfaqe të ujit. Temperatura e ujit ndryshon sipas sezonit dhe varion nga 9.9°C në 21°C. Liqeni i Ohrit është liqen i thellë dhe uji nuk qarkullon brenda vitit, si pasojë temperatura në kollonën e ujit ndryshon nga sipërfaqja në thellësi. Vlerat më të larta të përmbajtjes së BOD5 janë në verë dhe në pranverë 1.02-1.67 mg/l O2 që tregon për rritje të aktivitetit biologjik, kurse vlera më e ulët në tetor 0.48 mg/l O2. Gjithsesi janë më të ulta se vlera limite < 3 dhe ujrat vlerësohen të cilësisë oligotrofike. Vlerat e nitrateve janë të ulta në dimër dhe pranverë dhe në vlera mbi normën e lejuar 1.14-1. 8 mg N/l në verë dhe vjeshtë.

VLERËSIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT



Qëllimi i vlerësimit N & A përfshin si modelimin klimatik dhe vlerësimin e integruar të ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorët kryesorë në zonat bregliqenore të Shqipërisë. Këta sektorë kyçe janë bujqësia, shëndetësia, burimet ujore, fatkeqësitë natyrore, turizmi, dhe biodiversiteti.

Skenarët e ndryshimit të klimës

Skenarët e Ndryshimeve klimatike për temperaturë, reshje, do të thotë presion i nivelit të detit dhe rritja e nivelit të detit janë zhvilluar duke përdorur modelin MAGICC / SCENGEN (v. 5, 3, v 2).

Fig. – 36 *Harta e temperaturës në thellësine 100 metra në tokë Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

Ndryshimet e parashikuara në regjimin e temperaturës

Për shkak të ndryshimit të mundshëm të temperaturës, Zona bregliqenore shqiptare ka gjasa të bëhet më e ngrohtë. Të gjithë skenarët tregojnë një rritje të mundshme në temperatura vjetore që lidhen me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Veçanërisht:

- A1F1MI parashikon rritjen mesatare më të lartë pas 2014, me një rritje të mundshme deri në 4.8 në 2100 (skenari më i lartë/max),
- A1BAIM parashikon një rritje mesatare prej 1.7°C me 2050 dhe 3.2°C (skenari mesatar), dhe
- B1IMA parashikon rritjen më të vogël pas 2040 (skenari më i ulët/min).

Ndryshimet e parashikuara në regjimin e reshjeve

Të gjitha skenarët tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezulton se reshjet vjetore kanë mundësi të ulen deri në -8,5% (nga -56,0 deri në 47,4%) në 2050; deri në -18,1% (nga -89,7% deri 94,0%) në 2100

Disa ndikime të përgjithshme

Si rezultat i ndryshimit të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:

- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme.
- Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj , numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.
- Ditët e freskëta dhe valët e ftohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje.
- Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmbytje deri në 2100.
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.



Fig. – 37 *Harta e diellëzimit të Shqipërisë Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia*

- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat bregliqenore mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.

- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga idealia në të shkëlqyeshme.

NGJARJE TË PAZAKONTA KLIMATIKE

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin ngjarje jo të zakonta, si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura. Si vite skajore në Shqipëri janë përcaktuar vitet hidrologjike 1949, 1954, 1957 e 1985 si vite ujëpakët dhe 1963, 1970, 1978 e 1986 si vite ujëshumë. Ndër ata ujëpakët, më i thati paraqitet viti 1949. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare, në këtë vit sasia e reshjeve kanë qenë 1.6 herë më pak se norma. Gjatë këtij viti, thatësira ka qenë më e theksuar në Shqipërinë juglindore, si në Voskopojë, Leskovik, etj. i dyti për nga thatësira është viti 1953-1954, me 1.4 herë më pak reshje se mesatarja shumëvjeçare. Viti me reshje më të shumta ka qenë viti 1963, me 1.6 herë më shumë reshje se mesatarja shumëvjeçare në shkallë vendi dhe veçanërisht në zonën jugore me 2 herë më shumë se mesatarja. Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi tepër e vogël reshjesh, rreth 700 mm/vit. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me 0,7-2,5°C, pra luhatje e, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik. Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%.

Fig. – 38 *Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me diell*
Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia

Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e rreshjeve pritet të rritet me 53%.

Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:

- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;

- Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;

4.3 NDËRTIMI GJEOLOGJIK

4.3.1 Të përgjithshme

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit Pogradec, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë, të formuara në kohë e hapësira të ndryshme. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo-strukturale, zona tektonike e Mirditës, Krasta-Cukalit dhe ajo e Krujës. Territori i këtij rajoni është interpretuar, si një nga territoret me ndërtim gjeologjik, strukturor e tektonik mjaft të koklavitur. Në ndërtimin gjeologjik, veçohen një shumëllojshmëri e madhe shkëmbinjsh, me mosha të ndryshme formimi, duke filluar nga ato më të vjetër Silurian-Devonian, e deri në depozitimet e formimet Kuaternare të sotme.



Në ndërtimin gjeologjik, veçohen një shumëllojshmëri e madhe shkëmbinjsh, me mosha të ndryshme formimi, duke filluar nga ato më të vjetër Silurian-Devonian, e deri në depozitimet e formimet Kuaternare të sotme (Holocen). Të këtij territori ato përbëjnë bazamentin e tij, mbi të cilët pastaj vendosen formacionet e tjera.

Fig. – 39 *Harta gjeologjike rajoni Pogradec*

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Shtresat dhe përbërja e tyre

Zonat e mësipërme tektonike kontaktojnë midis tyre, me kontakte tektonike mbihipëse e mbulesore, por ato që ndikojnë më tepër në truall mbajtjen për shërbime civile janë depozitimet e kuaternarit si këto më poshtë.

Depozitimet Kuaternare (Q)

Në hartën gjeologjike, dallohen nga ngjyra e verdhë në bezhë. Janë formime tipike liqenore. Nga anarfologjike, këto depozitime përfaqësojnë zona kodrinore. Nga pikëpamja e përbërje litologjike ato përfaqësohen nga ndërthurje pakosh konglomeratesh, kongloranorësh me çimentim shumë të dobët deri të shkrifët (zhuro zhavorore) me ndryshime faciale si në trashësi dhe në shtrirje me kalime në kongloranorë të shkrifët, si dhe nivele argjilash e suargjilash apo argjilorërash. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin 40-50 m.

2 ***Fig. - 40*** *Hartë gjeologjike në shakllë 1:*

200,000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Depozitimet e Holocenit (Qh)

Depozitimet e aluviale të Holocenit (Qh)- Këto depozitime lidhen me formimet dhe depozitimet e tëracave të ish shtratit të lumenjve. Kanë përhapje të madhe në fushën e Pogradecit.

Depozitimet eluviale, deluviale dhe koluviale të Holocenit (Qh)- Formimet koluviale, eluviale dhe deluviale, në mjaft raste i përkasin një diapazoni më të gjërë (së paku nga Pleistoceni i vonshëm deri më sot). Ato i takojmë pothuaj në të gjitha këmbët e shpateve të kodrave dhe maleve. Ato janë formuar nga veprimi i agjentëve atmosferikë në formacionet shkëmbore relativisht të pa qëndrueshëm.

Depozitimet aluviale-kënetore të Holocenit (Qh)- Këto depozitime takohen kryesisht, në zonat fushore. Litologjikisht, këto depozitime përfaqësohen nga ndërthurrje alevritesh, rërash të imta, llum argjilor me material më të trashë, zhure e zhavore.

Shkëmbinjtë magmatikë - Në formacionin vullkanogjen mbizotërojnë bazaltet në formën e llavave jastëkore, rrymave llavore e më rrallë shkëmbinj piroklastikë. Përbërës të tjerë të formacionit vullkanogjeno sedimentar janë dhe silicorët radiolaritik e shistet argjilore-silicore, etj që zënë volum më të vogël.

Shkëmbinjtë metamorfikë $_2$ (µJ) Në këta shkëmbinj futen shkëmbinjtë metamorfikë subofiolitik dhe serpentinitet, si sekuenca shkëmbinjsh sedimentarë të dinamometamorfizuar. Shtroja metamorfike subofiolitike takohet në pjesët periferike të brezit ofiolitik, në formën e një brezi të ngushtë, në zonën e kontaktit në buzën kontinentale. Këta shkëmbinj përfaqësohen nga amfibolitet, paragnejset, rreshpet amfibolitike, mika dhe shiste granitmbajtëse, shiste të gjelbra,ofiolite, rreshpe kuarcire dhe gëlqerorë të mermerizuar. Nga pikëpamja petrokimike kemi të bëjmë me bazalte, të cilat kanë përmbajtje të ulët silici, por përmbajnë të lartë titani dhe granate.

Tektonika

Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo- strukturale, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë. Ato janë: 1-zona e Mirditës, 2-zona e Krasta-Cukalit dhe 3-zona e Krujës (Grup autoresh 1999; Aliaj 1987; Tagari etj. 1993). Përhapjen më të madhe e ka zona Mirdita, që karakterizohet nga një zhvillim i fuqishëm i magmatizmit ofiolitik, si dhe i sedimenteve të fuqishme terrigjene, që mbushin ultësirat ndërmalore të territorit të këtij rajoni. Zona tektonike Mirdita, bën pjesë në zonat e brendshme tektonike të Albanideve. Në skajin JP, P e JL të territorit, janë gjerësisht të përhapura, depozitimet flishore terrigjenë e karbonatike të zonës të Krasta- Cukalit, Krujës. Këto dy zona, në të cilën mungojnë shkëmbinjtë magmatikë, bëjnë pjesë në zonat e jashtme tektonike të Albanideve.



Fig. – 41 *Hartë e pjesëmarrjes së njësive tektono- strukturore të rajonit Korçë-Pogradec e më gjerë. (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Ato paraqiten me formacione shkëmbore sedimentare, të moshave nga Kretaku në Eocen-Oligocen i poshtëm. Në këtë sipërfaqe të këtij territori, dalin në pah një sërë rrudhash të rendeve të ndryshme. Në bërthamat e strukturave antiklkinale më shpesh takohen shkëmbinjtë e serisë karbonatike Triasiko-Jurasike, ndërsa bërthamat e strukturave sinklinale janë ndërtuar nga depozitimet flishore e flishoidale. Krahas këtyre prishjeve tektonike kryesore kemi dhe prishje të tjera të një rendi më të ulët, të cilat shoqërojnë thyerjet kryesore të mësipërme, të karakterit mbihipës po drejt P. Si rezultat i zhvillimit të fuqishëm të tektonikës regjionale mbulesore kemi zhytjen e njëra tjetrës (shoqëruar dhe me ngushtim apo pykëzim) të zonës tektonike Krasta Cukali nën zonën tektonike të Mirditës dhe zhytjen e zonës së Krujës nën zonën e Krasta Cukalit. Lëvizjet neotektonike aktuale sot, kanë diferencuar relievin e sotëm. Prania e lëvizjeve neotektonike vihet re në ekzistencën e formimit të tarracave lumore të lumenjve, që takohen në këtë territor, në fund të grykave depërtuese të lumenjve.

4.4 MJEDISI UJOR

4.4.1 Burimet ujore dhe burimet ujore sipërfaqësore (vlerësimi i tyre)

Në bashkinë e Pogradecit kanë përhapjen akuiferë të llojeve të ndryshme. Sipërfaqen më të madhe në shkallë Bashkie e zënë akuiferët poro-çarje me ujëmbajtje mesatare deri të ulët, të cilët shtrihet në dy krahët e lumit Shkumbin dhe zënë rreth 46% të gjithë sipërfaqes së tij. Akuiferi karbonatik karstik zënë rreth 18 % të gjithë sipërfaqes së tij. Ato ndërtojnë pjesët më të larta malore si mali i Thatë etj. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë resurse ujore nënëtokësore shumë të mëdha dhe kryesorët për furnizimin me ujë të territorit të bashkisë.



Fig. - 42 *Hidrografia Burimi: IDRA, 2015*

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, kanë përhapje shumë të vogël dhe të kufizuar në bashkinë e Pogradecit dhe shtrihen në zonat fushore pranë liqenit. Ky akuifer zë rreth 5% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në zonën Buçimas-Pogradec dhe nuk paraqesin interes për furnizim me ujë. Akuiferi jo pak i rëndësishem është edhe akuiferi me porozitet të çarjeve me ujëmbajtje mesatare deri të ulët. Ky akuifer zë një siperfaqe rreth 12% të territorit të bashkisë dhe shtrihet në pjesën perëndimore të liqenit të Ohrit. Në figurën jepen sipërfaqet e tipeve të ndryshme të akuiferëve për bashkinë e Pogradecit.

1- akuiferë me porozitet ndërkokrrizor e ujëmbajtje mesatare të ulët (5%),
2- akuifer me porozitet poro/çarje dhe ujëmbajtje mesatare deri të ulët (46%),
3- akuifer me porozitet çarje me ujëmbajtje mesatare deri të ulët (12%)

4- akuifer me porozitet çarje-karst me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme-shumë e lartë-e ulët (18%)



5- joakuifer me porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësorë në sasi të shfrytëzueshme (19%).

Fig. – 43 *Sipërfaqet e akuiferëve sipas llojeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Akuiferi poro-çarje i Miocenit të poshtëm e të mesëm (N1-N2).

Këto depozitime janë të zhvilluara kryesisht në pjesën qendrore dhe të brendshme të rajonit dhe përfaqësohen nga:

a. Mioceni i mesëm, që takohet kodo në pjesën perëndimore sidomos në afërsi të fshatrave Çaushti, Kakac, Zervaskë deri në perëndim të Pogradecit tek mali i Shylerit.

b. Depozitimet e miocenit të sipërm.

Tab. – 9 *Akuiferet e Pogradecit*

Akuiferi	Resurset dinamike të UN, m3/s	Shfrytëzimi i UN,m3/s	Përdorimi
Akuiferi i poroz i Pogradec	0.05	0.02	Për ujë komunal
Akuiferi poro-çarje i Gorë-Moker	0.07	0.07	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi çarjesh	0.1	0.1	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi karstik i Mali i Thatë-Rakickë	3.15	0.5	Furnizim me ujë të pijshëm
Jo akuifere	0.07	0.05	Furnizim me ujë të pijshëm
Shuma	3.44	0.74	

Akuiferët me porozitet çarje

Ujërat nëntokësore të këtij grupi janë të lidhura me shkëmbinjt kompaktë dhe të çarë të ultrabazikëve. Kanë perhapje në formë rrypi në skajin veri-perëndimor të rajonit në studim, në perëndim të liqenit të Ohrit që nga qyteti i Pogradeci e deri në fshatin Lin. Ato takohen edhe në formë njollash në skajin veri-perëndimor në fshatin Peshkëpi.

Akuiferët me porozitet çarje - karst

Akuiferët me porozitet çarë-karst me ujëpërcjellshmëri që ndryshon në kufij shumë të gjerë, vende-vende me vlera shumë të larta të saj, lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë të Triasikut të Sipërm, Jurasikut, Kretakut, Paleocenit dhe Eocenit. Tipi i këtij akuiferi ka përhapjen më të madhe në bashkinë e Pogradecit dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 110.26 km2, e përkthyer në përqindje për siperfaqen që zë ky akuifer në territorin e bashkisë shkon në 18 % e sipërfaqes së tij. Në këto akuiferë fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar, e për rrjedhojë ata mbajnë resurse ujore të mëdha. Në zonat karstike koefiçienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.6 - 0.7. Nga këto akuiferë furnizohet me ujë të pijshëm qytetin e Pogradecit, Buçimasi, Gështenjas, Lini, dogana Qafë-Thanë etj. me rreth 0.5 m3/s. Sasi të tjera të rëndësishme përdoren në bujqësi dhe industrinë e lehtë. Ky akuifer ka prurje dinamike Qd=3 m3/s.

Fig. – 44 *Shpërndarja hapësinore e fenomenit karstik (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar*)

Akuiferi karstik Mali i Thatë

Akuiferi karstik i antiklinalit të Malit të Thatë, i cili ndërtohet nga formacione karbonatike të T3-J1 dhe Cr2, Pg1-2 etj. të Triasik-jurasikut, kretakut e Eocenit me karst sipërfaqësor shumë të zhvilluar. Në këtë akuifer kemi përfshirë Malin e Thatë që vazhdon edhe në Maqedoni me Galiçicën. Akuiferi ka kurrizet të buta me shpate të pjerrëta në të dy anët e antiklinalit.



Fig. - 45 *Harte Hidrogjeologjike e rajonit Korce – Pogradec*

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



Fig. - 46 *Hartë e përshkueshmërisë së ujërave nëntokësorë*

(Burimi: UNDP, S. GURI1)

Burimi i ushqimit të ujërave nëntokësore janë kryesisht reshjet atmosferike dhe Liqenet e Prespës. Ujërat nëntokësore që grumbullohen në këtë strukturë drenojnë në drejtim të veri-perëndimit nëpërmjet burimeve të Tushemisht-Volorekë dhe Shën Naum në Maqedoni, por një pjesë e këtyre ujërave drenojnë brenda në liqenin e Ohrit.

Akuiferi kastik Çervenakë dhe Qafë-Thanës

[1] S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi i 'Hot Spoteve" Shqiptarë, 2012

Këto akuiferë shfaqen në formë njollash afër fshatrave Rrëmenjë, Vërdovë, Guri i Kuq, Çervenakë deri afër Qafë Thanës. Ky akuifer përfaqësohet nga gëlqerorë konglomeratik dhe gëlqerorë me rudiste. Gëlqerorët janë masiv dhe të shtresëzuar me çarje të shumta e të karstifikuara.



Fig. – 47 *Hartë e përshkueshmërisë ujore të shkëmbinjëve sipërfaqësore (S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi i 'Hot Spoteve" Shqiptare 2012)*

Lumenjtë

Arteriet lumore kryesore, të bashkisë Pogradec janë: 1-Lumi i Shkumbinit që buron nga malësitë e Vallamarës dhe përshkon krahinën e Mokrës, me të cilin në territorin e bashkisë Pogradec bashkohen lumi i Llëngës, i Bishnicës, i Dushës, i Radicinës dhe dhjetra përrenj me burime në të dyja anët e luginës së tij;

2- Lumi i Çërravës;

3- Lumi i Drilonit;

4- Lumi i Rëmenjit;

5- Lumi i Ërdovës;

6- Lumi i Qytetit dhe

7- Lumi Tërhanit.

Liqenet

Në territorin e bashkisë Pogradec, liqenet kanë vlera të veçanta nga lloji dhe origjina e tyre. Liqenet që ndodhen në këtë territor janë:



1-Liqeni i Ohrit (Pogradecit),

2-Liqeni i Madh,

3-Liqeni i Lukovës,

4-Liqeni i Llëngës,

5-Liqenet e Gur Topit.

Fig. – 48 *Hartë e potencialeve të pritshme ujore (S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi i 'Hot Spoteve" Shqiptarë, 2012)*

BURIMET UJORE DHE VLERËSIMI i TYRE

Ujërat siperfaqësore

Veçoritë: Liqeni është formuar në periudhën e Pliocenit, me moshë 2-4 milionë vjeçare, duke u futur ndër katër liqenet më të vjetër të botës. Ai ka formë vezake me brigje të rregullta, me vijë bregliqenore 88km dhe sipërfaqe 358km2, nga e cila rreth 1/3 i takon

Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës arrin në 1487km2. Vendoset në lartësinë 695m mbi nivelin e detit me thellësinë mesatare 145m dhe atë maksimale që arrin 289m. Niveli i ujit në liqen është mjaft i qëndrueshëm. Furnizimi kryesor me ujë i liqenit bëhet nëpërmjet rrugëve nëntokësore nga liqeni i Prespës, i vendosur 157m me lart, që dalin pranë bregut Shën Naum-Drilon, me prurje të përgjithshme 15m^3/sek. Rreth 26% e ujrave vijnë në liqen nga lumenjtë e përrenjtë që derdhen në të. Ai shquhet për pastërtinë dhe tejdukshmërinë e madhe të ujrave me ngjyrë të kaltër në blu. Liqeni ka shkarkimin e vetëm në lumin Drin (është burimi i këtij lumi), me mesatarisht 22,2m^3/sek.

Tërësia ujore e Liqeneve

Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80 km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700m dhe 2027m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh). Liqeni i Madh ndodhet në kuotën 1851m mbi nivelin e detit me një sipërfaqe 0.05km^2, ndërsa Liqeni i Vogël ndodhet në kuotën 1706m me sipërfaqe 0.035km^2.

Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e rajonit Pogradec janë përqëndruar në:

- Kërkesën më të madhe për burimet ujore (bujqësia dhe turizmi) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i burimeve të ujërave nëtokësore është më i ulët;
- Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar të një numri të madh shpimesh privatë për furnizim me ujë pijshëm dhe industri;
- Shfrytëzimi pa kriter i shumë shpimeve të vjetër e të rinj të kryer në akuiferë me presion;
- Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Në zonën ku ka pasur aktivitet minerar, sidomos ato toka që ndodhen pranë dhe në kontakt me Liqenin, përmes analizave të elementeve Ni, Cu, Cr, Pb rezulton, se përmbajtja e këtyre elementëve në tokë janë më tepër sesa është norma e lejuar dhe vlerësohen si shumë toksike. Monitorimet dhe vlerësimet e kryera për ndotjen e tokës rreth objekteve industriale dhe minierave kanë arritur në përfundimin se:

- Intensiteti i ndotjes varet nga origjina e metaleve në tokë. Zonat industriale në periferi të ndikimit të ndotjes mund të veprojnë në rajonet përreth deri 4 km, por autorët e ndryshëm identifikojnë një zgjatje të ndikimit të saj deri në 8 km.
- Të gjitha zonat e monitoruara janë të ndotura nga dy ose më shumë metale. Kjo mund të jetë rezultat i sfondit gjeologjik ose aktivitetit të njeriut, ose një kombinimi të tyre.
- Tokat pranë zonës industriale ku zhvillohet aktiviteti i industrisë minerare karakterizohen nga përqëndrim shumë i lartë i nikelit.

Në përgjithësi në të gjitha fushat e përfshira në studim, metalet e rënda të përqëndruara janë tepër të larta, në krahasim me vlerat e regjistruara që konsiderohen toksike, ose dhe me normat e lejuara nga BE-ja dhe vendet e tjera.

Nga procese monitorimi të kryera më parë është evidentuar një nivel i lartë i përmbajtjes së përgjithshme të metaleve të rënda në të gjitha tokat përreth objekteve minerare. Gjithësesi, ende ka nevojë për studime të mëtejshme monitorimi.

Burimet ekzistuese të ndotjes

Burimet ujore

Karakteristikat e përgjithshme të këtyre ujrave janë paraqitur këtu poshtë:

- Turbiditet i lartë, meqënëse regjimi i rrjedhjes është i rrëmbyer, ujrat transportojnë sasi të mëdha lëndësh në suspension.

Fig. - 49 *Harta hidrografike e rajonit Pogradec*

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

- Ndotje bakteriale e lartë. Ndotja e shkaktuar nga njeriu ose industria është praktikisht ekzistente.
- Temperatura e ulët. Këto ujra e kanë origjinën nga burime ose nga shkrirja e borës ose e akullnajave.
- Tregues ngjyrë të ulët. Këto ngjyra nuk kanë kohë të tresin lëndët vegjetale, të cilat janë burimi kryesor i ngjyrës.

Ndotja e ujit të pijshëm

Në rajonin në studim, në adresë të sigurimit të shëndetit publik, mjaft e rëndësishme është cilësia e ujit të pijshëm. Por, ky ujë nuk shfaq probleme higjieno-sanitare, sepse kemi:

- Furnizimi me orar të pakufizuar, duke siguruar presion konstant të ujit;
- Jo amortizim të rrjetit ujësjellës;
- Ndërhyrjet nuk janë pa kriter në tubacionet e ujësjellësve;
- klorinimi jo më shumë seç duhet i ujit;

Por, nga ana tjetër mund të shfaqë së shpejti problem sanitar sepse:

- kemi ruajtje të dobët të brezave të mbrojtjes sanitare të vendburimeve ujore, për shkak të ngritjes mbi to të ndërtesave apo mbjelljes së tokës fare pranë burimit, duke përdorur edhe shumë kimikate;

Të gjithë këta faktorë bëjnë që shëndeti publik të jetë nën kërcënimin e vazhdueshëm të përhapjes së sëmundjeve me rrugë hidrike. Nga ana tjetër, në rajonin në studim mungojnë pjesërisht ose tërësisht të dhënat nga ekzaminimet bakteriologjike të ujit, për shkak të mungesës së laboratorëve dhe personelit.

Ndotja në ujërat Liqenore

Lëndët ushqyese (fosfori dhe azoti) të pranishëm në ujrat e përrenjve, sidomos mbas ndotjes me lëndët ushqyese të fabrikëps së rritjes së peshkut pranë Volorekut dhe në ujrat e përdorura shtëpiake (ende jashtë skemës së mbledhjes për trajtim) favorizojnë rritjen e algave dhe të bimëve ujore, gjë që përshpejton eutrofizimin e liqenit. Në verë, këto alga dhe bimë ujore, shkaktojnë degradimin e karakteristikave kimike dhe fizike të ujit: turbiditetin, treguesin e ngjyrës, shijen dhe ngjyrën. Madje, zhvillimi i algave dhe i bimëve ujore modifikon vazhdimisht përmbajtjen në ujë të oksigjenit të tretur.

Por, algat e vdekura depozitohen në fundin e liqenit, gjë që çon në zmadhimin e shtresës së llumit.

Kriteret e vlerësimit global të cilësisë së ujrave sipërfaqësorë

Këto kritere jepen në pasqyrën përmbledhëse, e cila fikson pesë klasa cilësie sipas përdorimit që duhet të kënaqin ujrat sipërfaqësorë. Çdo klasë përmbledh vlerat e shumë parametrave.

- Klasa 1A - Ajo karakterizon ujrat të konsideruara të paprekura nga ndotjet, të afta të kënaqin përdorimet më ekzigjente. Zakonisht, këto ujra kanë ngjyrë blu.
- Klasa 1B - Të një kualiteti pak më të ulët këto ujra, gjithashtu mund të kënaqin të gjitha përdorimet. Ngjyra e tyre është e gjelbër.
- Klasa 2 - Kualiteti i këtyre ujrave mund të konsiderohet i pranueshëm për ujitje, përdorime industriale, si dhe për prodhimin e ujit të pijshëm pas një trajtimi shumë të avancuar. Pirja për kafshët në përgjithësi është e lejuar. Peshqit, aty jetojnë normalisht, por riprodhimi i tyre nuk është gjithmonë i garantuar. Aktivitetet çlodhëse janë të mundura vetëm në qoftë se kontakti me ujin ndodh për arsye të jashtë zakonshme. Ngjyra e tyre është e verdhë.
- Klasa 3 - Cilësia e këtyre ujrave është mediokre; e aftë vetëm për ujitje, për ftohje dhe për lundrim. Në këto ujra mund të ekzistojë jeta e peshqve, por ajo mund të zhduket në periudhat e prurjeve të vogla dhe të temperaturave të larta. Ngjyra e tyre është e kuqe.
- Jashtë klase - Këto ujra i kalojnë vlerat maksimale të lejuar në klasën 3 të aftë për një ose disa parametra. Ato konsiderohen të papërshtatshme për pjesën më të madhe të përdorimeve dhe mund të përbëjnë një rrezik për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Ngjyra e tyre është e zezë.

Pasqyra përmbledhëse

- Cilësia e një uji varet nga një sërë parametrash (temperatura, amoniaku NH4, merkuri Hg).
- Zakonisht cilësia e një uji përcaktohet nga parametri i matur më i disfavorshëm.
- Kjo cilësi, sipas vlerave të përcaktuara në pasqyrë, arrihet në jo më pak se 10% të matjeve më të këqija të këtij parametri.

MONITORIMI i KLOROFILËS NË LIQENIN E PRESPËS, VITI 2015

Liqeni i Prespës

Të dhënat mbi përmbajtjen e klorofilës a të fitoplanktoneve në tre stacionet e Liqenit të Prespës gjatë periudhës të monitorimit Prill-Shtator 2015.

Muajt	Kl a (µg /dm3)		
2015	Liqeni i Prespës Gorricë AL_LK_109	Liqeni i Prespës Liqenas	Liqeni i Prespës Gollomboç
Maj	1,725	1,346	1,956
Korrik	4,6	2,23	2,694
Shtator	4,273	3,555	2,574

Tab. – 10 *Monitorimi i Klorofiles ne Liqenin e Prespes (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*

Të dhënat e tabelës tregojnë se trendi i përqëndrimit të klorofilës 'a' vjen në rritje për të arritur maksimumin në Shtator, dhe se përqëndrimi më i lartë arrihet në stacionin e Gorricës.



Tab. – 11 *Paraqitje grafike e të dhënave për treguesin klorofila a, për cdo stacion për çdo periudhë monitorimi për Liqenin e Prespës. (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*

	Treguesi: Klorofila a (µg /dm3)	Viti 2015	Viti 2015 Mesatare vjetore
Liqeni i/ Prespes	Stacioni Gorricë	3,532	2,772
	Stacioni Liqenas	2,377	
	Stacioni Gollomboc	2,408	

Tab. – 12 *Mesatarja vjetore e klorofilës a në tre stacionet e Liqenit të Prespës gjatë vitit 2015 (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*

Rezultatet mbi sasinë e klorofilës 'a' në Liqenin e Prespës tregojnë se biomasa është më e pasur në stacionin e Gorricës, më pas në Gollomboc dhe së fundi në Liqenas, dhe se trendi mujor i vlerave vjen në rritje nga Maji në Shtator.

Liqeni i Prespës

Në Liqenin e Prespës për të tre stacionet e monituara në pranverë 2015, vlerat e treguesit TSIC gjithashtu përshkruajnë gjendje oligotrofike, por tendenca është drejt mezotrofisë, duke filluar nga Korriku.

Muajt	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)		
2015	Liqeni i Prespës Gorricë AL_LK_109	Liqeni i Prespës Liqenas	Liqeni i Prespës Gollomboç
Maj	35,9	33,5	37,2
Korrik	45,6	38,5	40,3
Shtator	44,8	43,0	39,9

Tab. - 13 *Të dhënat mbi vlerat e TSIC të kampioneve të ujrave në Liqenin e Prespës (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*



Tab. – 14 *Paraqitje grafike e të dhënave për treguesin TSIC, për cdo periudhë monitorimi në Liqenin e Prespës (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*

Grafiku tregon trendin në rritje të vlerave të treguesit TSIC, që flasin për shtim të biomasës fitoplanktonike dhe për rrjedhojë edhe për një nivel të shtuar të ndotjes së ujërave nga Prilli në Shtator. Vlerat më të larta të indeksit trofik të mesatarizuar për të tre periudhat e monitorimit i ka stacioni i Gorricës, ujërat e të cilit sipas metodologjisë Karlson janë mezotrofike, të pasuara nga dy stacionet e tjera që janë në prag mezotrofie.

Liqeni i Prespës 2015	TSIC (Kriteri Karlson bazuar në klorofilën a)	Gjendja trofike
Gorricë	42,1	Mezotrofi
Liqenas	38,3	Prag-Mezotrofie
Gollomboc	39,1	Prag-Mezotrofie

Tab. – 15 *Gjëndja trofike e mesatarizuar për tre stacionet e Liqenit të Prespës të monitoruara gjatë 2015 (Burimi: Axhensia Kombëtare e Mjedisit, Raport i Monitorimit Mjedisor, 2015)*

- Në Liqenin e Prespës përqëndrimi i klorofilës 'a' vjen në rritje nga pranvera në vjeshtë, duke arritur maksimumin në muajin Shtator në stacionin e Gorricës.

- Vlerat e treguesit TSIC në Liqenin e Prespës flasin për shtim të biomasës fitoplanktonike dhe për rrjedhojë edhe për një nivel të shtuar të ndotjes së ujërave nga Prilli në Shtator. Vlerat më të larta të indeksit trofik të mesatarizuar i ka stacioni i Gorricës me ujëra mezotrofike, të pasuara nga dy stacionet e tjera në prag mezotrofie.

PËRFUNDIME

1. Në bashkinë e Pogradecit kanë përhapjen akuiferë të llojeve të ndryshme. Depozitimet e papërshkueshme, kryesisht flishi (jo akuiferët) kufizojnë akuiferët karbonatikë.
2. Këto depozitime luajnë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve për drenim e ujërave nëntokësorë, nga këto masivë, me burime me prurje të madhe. Jo akuiferët zenë siperfaqen me rreth 19 %.
3. Akuiferët karbonatikë karstikë, kanë përhapjen të madhe në territorin e bashkisë dhe zenë rreth 18% të sipërfaqes së tij, por jane më të rëndësishmit në bashkinë e Pogradecit.
4. Akuiferët me porozitet poro-çarje dhe çarje është i dyti për nga rëndësia e resurseve ujore në bashkinë e Pogradecit. Këto akuiferë kanë përhapje në pjesën perëndimore dhe jugore të Liqenit të Ohrit.
5. Prurja e burimeve luhatet nga 0,001 deri në 3000l/sek. Burimet nën 1l/sek drenojnë në depozitimet flishore ose në kuota të larta në depozitimet karbonatike. Burimet me prurje të larta drenojnë në kuota të ulëta, pranë liqenit të Ohrit.
6. Resurset e përgjithshme dinamike të ujërave nëntokësorë në territorin e bashkisë së Pogradecit janë vlerësuar minimalisht 3.44 m3/s. Prej tyre, aktualisht, shfrytëzohen 0.7-0.75m^3/s.
7. Përbërja kimike e ujërave nëntokësorë është e mirë, e tipet hidrokimike që mbizotërojnë janë Hidrokarbonat-kalcium, Hidrokarbonat-kalcium-magnezi, etj.

REKOMANDIME

Për studimin e mëtejshëm hidrogjeologjik të Bashkisë Pogradec dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të zonave të banuara e turistike rekomandojmë:

- mbrojtjen e burimeve karstike, si akuiferi me i rendësishëm i Bashkisë së Pogradecit.
- mbrojtja e burimeve kryesore lidhet me mbrojtjen e Liqeneve Prespa, të cilët kanë lidhje të mirë hidraulike dhe kontribuojnë në masen 30-50% të burimeve karstike dhe shpejtësia e lëvizjes së ujit është shumë e madhe. (Ndotësi mund të vijë në burimet e Tushemishtit, Volorekës, Gështënjasit për 7-8 orë).
- përcaktimin e zonave sanitare të burimeve të akuiferit çarje-karst, si akuiferi kryesor i Bashkisë, si dhe më i prekshmi ndaj ndotjeve të ndryshme.
- sistemimin e hedhurinave drejt pikës së transferimit.
- ndalimin e nxjerrjes së gurëve nëpërmjet karrierave të gurit në akuiferin karstik, apo ndalimi i shfrytëzimit të mëtejshëm.
- shtimi kryesor i kapaciteteve ujore të jetë akuiferi, me porozitet çarje-karst, i cili ka dhe rezervat kryesore dhe më të mëdha në Bashkinë Pogradec, si burimet: Lini, Gështenjas-Volorekë, Peshkëpi, etj.

- të kryhet monitorimi i vazhdueshëm i akuiferëve, por në mënyrë të veçantë në akuiferin karstik për treguesit cilësorë e hidrokimikë të tyre.
- të shpërngulet fabrika e rritjes së peshkut në ujërat dalëse pranë Drilonit.

4.5 MORFOLOGJIA, TOPOGRAFIA DHE RELIEVI

Përfytyrim topografik i përgjithshmëm

Bashkia e Pogradecit shtrihet në vijën bregore në jug të liqenit të Ohrit, i vendosur përgjatë kodrave në formën e një teatri, shkallaret e të cilit zbresin drejt Liqenit. Ka një pozicion fushor në lartësinë 694m mdv. Në veriperëndim, Pogradeci zotërohet me pamje e vëzhgim të relievit prej një kodre me lartësi rreth 800m, ku ka qenë edhe një qendër banimi e hershme e Dasaretisë (Enkelana). Në juglindje vijon me fushën e Starovës, pas së cilës vijnë sistemi kodrinor rrethues jugor, për gjithë rrethinën e tij. Sistemi rrugor është paralel me vijën kryesore bregore ku veçohen dy prej tyre: njëra si shëtitore e qëndrës, ndërkaq tjetra është përvijim i rrugës që lidh qytetin me Shën Naumin, e përpara tij me qëndrën turistike të Drilonit.



FIG. - 50 ***RELIEVI I BASHKISË POGRADEC***

Gjeohapësira e bashkisë Pogradec përbëhet nga disa elementë të relievit si: Fushëgropa e Pogradecit, Krahina e Mokrës, Malësia e Gorës, Kurrizi malor: Maja e Beshenikut - Qafë Thanë, Gjeohapësira kodrinoro- malore : Dardhas- Alarup dhe qyteti i Pogradecit.

Fushëgropa e Pogradecit

Fushëgropa e Pogradecit zë në sipërfaqe prej 15.7 km2. Syprina liqenore zë një sipërfaqe prej 98,5 km2. Ajo ka formën e një trapezi me bazë të vogël, në veri prej 2,9km dhe në Jug 7,4km (Këndi veriperëndimor i Pogradecit deri në Tushemisht). Lartësia e syprinës ujore të liqenit është 694 metër mbi nivelin e detit. Niveli lartësor i fushës fillon nga një "0" relative dhe deri në fillimin kodrinoro-malor shkon në lartësinë, ku fillon hipja e relievit për në Qafë Plloçë. Në këtë kufi kodrinor, lartësia është 820 metër.

Hapësira liqenore

Ka një sipërfaqe prej 111,4km2. Është sa 1/3 e gjithë sipërfaqes së Liqenit të Ohrit. i krijuar rreth dy milion vjet më parë nga mbushja me ujë e gropës tektonike, Liqeni i Ohrit është i dyti për nga madhësia në Shqipëri pas atij të Shkodrës. Gjerësia e tij në veri, drejt Linit, me vijën kufitare është 3.6km, ndërsa në bregun Pogradecit, 6.8 km. Duke u larguar nga bregu në largësinë 1.5 km, thellësia arrin 10m, në 5 km, arrin 100 metër thellësi. Thellësia më e madhe e tij është 255 metra.

Krahina e Mokrës

Mokra ka tipare të veçanta, të relievit gjeohapësinor, të shtrirjes, historisë dhe kulturës. Është një nga krahinat më të hershme të banuara. Përfshin 47 fshatra, të cilat shtrihen në Mokrën e Sipërme dhe Mokrën e Poshtme e mbështjellë e tëra në faqet malore që bjenë nga kreshti malor i cili fillon nga mali Valamares, Qafa e Panjës e deri tek Guri i Kamjes. Mokra përfshin në vete tre njësi administrative vendore: Proptisht, Trebinjë dhe Velçan dhe ka një sipërfaqe prej 376km2.

Lumi i Dunshës takohet me Shkumbinin në veri të fshatit Çezma e Vogël, në lartësinë 533.9 metër. Përroi i Homçanit që bashkohet me përroin e Selcës së Sipërme, zbret nga lartësitë 1344 metër. Në lumin e Slabinjës zbret lumi dhe lugina e Dunshës që përfshin ujrat që vijnë nga faqja e Trebinjës, Povelan, Potkozhan, Kalivaç dhe përroi që rrjedh nga Guri i Bardhë dhe Dunica prej një relievi që ngrihet gjer në qafën e Panjës e Guri i Kamjes. Përroi dhe lugina e Homçanit (lartësia 912 metër) mbledh ujrat që zbresin nga maja e Korijes (1343 metër). Në verilindje të Mokrës është lugina e Homezhit (750 metër) me ujra që zbresin në harkun kreshtor të majës së Fushës së madhe (1429 metër), maja e Shullërit të Kaprit (1343 metër), maja e Ahishtes së Gegës (1513 metër) me përrenj që zbresin nga lartësitë në jug të Çervenakës. Kufiri perëndimor i Krahinës së Mokrës fundon në gjeohapësirën midis fshatrave Stravaj (e Librazhdit) dhe Senisht (e njësisë administrative të Velçanit). Vija përmbyllëse në jugperëndim të Mokrës është kreshti malor që zë fill nga maja e Lenijes , Qafa e Mushkës (1825 metër). Guri i Kamjes (1461 metër) është jo vetëm një monument natyre në kreshtin fundor të krahinës së Mokrës, por pika dhe këndi juglindor ndarës midis tre nënkrahinave: Ujëmbledhësit dhe Fushëgropës së Pogradecit në Lindje, të Malësisë së Gorës (fshatrave të Bashkisë së Maliqit në Jug si dhe vetë Krahinës së Mokrës).

Kurrizi malor: Maja e Beshenikut - Guri i Kuq - Qafë-Thanë

Ka një sipërfaqe prej 89km2. Kreshti ndarës në lindje të malësisë së Mokrës, që lidhet me masivin dhe kurrizin malor përfshin lartësinë 1411 metër (maja e Beshenikut në lindje të fshatit Kalivaç) vijon me kurrizorin drejt majës së Shullërit (1226 metër). Kreshti ndarës vijon me një platformë të thyer drejt majës së Fushës së Madhe (1429 metër) në lindje të fshatit Homezh (njësia administrative e Proptishtit). Në veri merr drejtim përkah majës së Fushës së Moçalit, majës së Fushës së Madhe, majës së Shullërit të Kaprit (1343. 3 metër) maja e Ahishtes së Gegës (1513.5 metër). Ky kresht ndan dy njësitë e Bashkisë së Pogradecit: Mokrën me fushëgropën e Pogradecit. Si reliev ka drejtimin veri-jug. Lartësitë kurrizore janë të përafërta me prirje uljeje gjer në Qafë – Tanë : 940 metër. Lartësia më e madhe është në majën e Ahishtës së Gegës (1513 metër). Lugina dhe përrenj zbresin nga lartësitë drejt lindjes, si përroi i Varreve, që zbret në jug të fshatit Memëlisht (i njësisë së Udënishtit) përroi i Torbilit, përroi i fushës së Moçalit.

Gjeohapësira ujëmbledhëse lindore Guri i Kamjes - Kalivaç - në kufijtë e Fushëgropës së Pogradecit

Ka një sipërfaqe prej 32 km2. Është një formë e faqes malore me ujëmbledhje dhe rrjedhje në drejtim të lindjes. Në veri kufizon nga qafa e Kalivaçit (maja e Beshenikut, 1411 metër) me rënie në rrjedhje të përroit të Kishës që zbret në periferinë jugperëndimore të Pogradecit. Ndërkaq, kufizimi perëndimor vijon në jug deri tek Guri i Kamjes (1425 metër) që është edhe një monument natyror. Duke filluar që

nga veriu prej kreshtit malor dhe faqeve përkatëse rrjedhin: përroi i Kishës, që zbret në këndin jugperëndimor të Pogradecit, përroi i Vërdovës, Përroi i Rrëmenjit dhe përroi i Gështenjasit.

Malësia e Gorës Jugore

Ka një sipërfaqe prej 18 km2. Është veriu i krahinës së Gorës, që mbështetet dhe kufizohet më Malësinë e Mokrës. Kjo gjeohapësirë ka në përfshirje të saj fshatrat Niçë, Stërkanj, Osnat, Lekas, Dërdushë (të njësisë së Dardhasit). Si reliev përfshin luginat dhe ujrat që rrjedhin në jug nga kreshti malor i krahinës së Mokrës, nga kurrizi i Mesmalit (bashkia e Maliqit) dhe ujrat dhe luginat që zbresin nga qafa e Panjës deri tek Guri i Kamjes për në Osnat. Luginat dhe përrenjtë përkatës vijojnë në Stërkanj (i njësisë administrative të Dardhasit), që është edhe fshati këndor e fundor i Bashkisë së Pogradecit.

Gjeohapësira: Dardhas – Çërravë - Alarup

Ka një sipërfaqe prej 97km2. Kjo gjeohapësirë është plotësim i relievit kodrinoro-malor të pjesës jugore të Bashkisë së Pogradecit. Ajo kufizohet nga perëndimi me malësinë e Mokrës dhe të Gorës, në Jug me Bashkinë e Maliqit, në veri me hapësirën e fushëgropës së Pogradecit, në Lindje nga kufiri shtetëror me Maqedoninë. Në perëndim, fshatrat kufitarë me Gorën janë Prenisht (1100 metër) që i përket njësisë administrative të Dardhasit, Grunjas (920 metër), Osnat, që përfshihen në njësinë e Dardhasit. Në këtë gjeohapësirë përfshihen 13 fshatra në dy njësi administrative vendore: Dardhas, Stropckë, Leshnicë, Çërravë, Qershizë, Grabovicë, Pretushë, Nizhavec, Blacë, Bletas, Lumas, Alarup, Peshkëpi. Kufizimi lindor është kufiri shtetëror me Maqedoninë duke përfshirë Peshkëpinë dhe Alaraupin. Në Bletas fillon reliev intensiv ngjitës për në Malin e Thatë. Në jugperëdim shtrihet Blaca (lartësia 1017 metër), Nizhavec (lartësia 955 metër), Pretushë (lartësia 986 metër), Veliternë (lartësia 820 metër) deri në kufi me Grunjasin (lartësia 1009 metër).

4.6 BIODIVERSITETI - FLORA DHE FAUNA

4.6.1 HABITATET UJORE

Liqeni është një nga rezervatet biologjike më të pasura dhe më të çmuara të Europës. Ai shkëlqen si një sistem unikal, pasi karakterizohet nga një biodiversitet me shumë specie endemike të florës dhe faunës. Në liqen, rriten rreth 17 lloje peshqish nga të cilët 10 janë endemike ndërsa 7 të tjerët me vlera komerciale. Familja Salmonidae, e përfaqesuar nga Korani me kater racat e tij, e mbyll ciklin biologjik brenda Liqenit. Si shumë specie të tjera, edhe korani kthehet per t'u riprodhuar ne vendin e lindjes, ndërsa në kushtet e liqenit inkubimi i vezëve zgjat 55-70 ditë. Rendimenti i ulët i riprodhimit natyral (5-7%) inkurajon edhe shtimin artificial (me rendiment 70-75%) dhe që realizohet nga të dy shtetet. Rajoni i Liqenit të Pogradecit dallohet për vlerat e mëdha peisazhistike, pamjen e mrekullueshme, ujin e kaltër me kodrat për rreth, zonën fushore dhe Malin e Thatë me kapelen e dëborës. Këto kontraste të harmonizuara japin mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave të mëdha mjedisore dhe ekonomike të Liqenit të Pogradecit ka edhe një projekt të Bankës Botërore. Ende liqeni e zona për rreth janë të rrezikuara seriozisht nga mbetjet industriale historike, derdhja e ujrave të zeza të disa shtëpive të pakontrolluara deri në nivel të një ish Komune dhe lëndëve kimikate në të, erozioni i tokës, pesticidet e përdorura dhe prurjet e ngurta, etj.

Vegjetacioni higrofil

Shoqërimet bimore kryesore të këtij vegjetacioni u përkasin klasave Alno-Populetea dhe Salicetea purpurea. Përbërësit kryesorë të pyjeve aluvionale të zallishteve të lumit të Shkumbinit dhe degëve të tij janë: Platanus orientalis, Alnus incana, Populus alba, Salix alba, Salix purpurea, Salix amplexicaulis, etj. Në ujërat me rrjedhje të shpejtë marrin prioritet shoqërimet me Platanus orientalis apo të ashtuquajtura rrapishte. Krahas këtyre formacioneve të dominuara nga rrapi (Platanusorientalis) vihen re edhe formacione të dominuara nga Populus alba. Në katin shkurror të këtyre pyjeve vërehen llojet bimore: Salix elaegnos, Tamarix parviflora, Rubus ulmifolius, Crataegus monogyna, Rosa sempervirens, Vitex agnus castus etj. Në ujërat me rrjedhje të qetë, në moçalishte buzë ujërave me substrat lymor dhe toka eutrofike marrin prioritet shoqërimet me Alnus incana (asocacioni Alnetum-incanae), Alnus glutinosa, Salix alba. Elemente dominante të këtij shoqërimi janë Alnus incana, Ulmus minor, Populus alba dhe Fraxinus ornus. Gjithashtu, në këto rrjedha janë të pranishme shoqërimet bimore të klasës Phragmitetalia meAsociacionin kryesor Phragmites australis, si dhe shoqërimet bimore të shavarit (Typha angustifolia). Një asociacion i tillë tregon një plasticitet të lartë ekologjik.

Llojet pyjore

Llojet kryesore të drurëve janë dushqet dhe konkretisht qarri dhe ahu, si dhe fletore të tjerë, shumë të pakët, si panja e malit, etj. Përgjithësisht parametrat e tyre jane nën ata normalë, për shkak të trajtimit jo të mirë. Veç dushqeve, lloj tjetër është ahu. Në sasi të vogël gjenden edhe llojet panje dhe shkoze.

4.6.2 FAUNA

Amfibet dhe reptilet (herpetofauna)
Herpetofauna e zones gëzon një pasuri llojore të rëndësisë mesatare.

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	Bombina variegata	LRnt
2	Bufo bufo	LRt
3	Bufo viridis	LRnt
4	Rana balcanica	VU
5	Rana dalmatina	LRlc
6	Rana graeca	LRnt
7	Triturus vulgaris	LRlc

Tab. – 16 *Amfibët e pranishëm në zonë((Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)*

VU – te Perkeqesuara, LRnt – Rrezik i Ulet pothuajse te kercenuara, LRcd - Rrezik i Ulet ne varesit te masave mbrojtese, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura.

Llojet më të zakonshme të amfibeve përfshijnë Bombina variegata dhe Rana balcanica. Midis reptileve vlen të përmendet prania e Natrix natrix, Elaphe quatrolineata, Malpolon monspensulanum, Testudo hermanni etj. Të gjithë amfibët e pranishëm në zonë vlerësohen si të kërcënuar në kontekstin kombëtar. Vetëm Rana balcanica i përket kategorisë Vulnerabel. Statusi i llojeve të tjera i takon kategorisë Rrezik i Ulët. Pothuajse të gjithë reptilet e rajonit futen në listën e kuqe të vendit. Pjesa më e madhe i takon kategorisë Rrezik i Ulët, dy lloje (Elaphe quatrolineata, Elaphe situla) cilësohen si të Përkeqësuar (Vulnerabel).

Tab. - 17 *Reptilet e pranishëm në zonën e projektit (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)*

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	Anguis fragilis	NE
2	Coluber caspius	
3	Coluber gemonensis	LRnt
4	Coluber jugularis	LRlc
5	Coronella austriaca	LRnt
6	Elaphe longissima	LRnt
7	Elaphe quatrolineata	VU
8	Elaphe situla	VU
9	Emys orbicularis	LRnt
10	Lacerta viridis	LRlc
11	Malpolon	NE
12	Natrix natrix	LRlc
13	Natrix tessellata	LRnt
14	Podarcis muralis	NE
15	Testudo hermanni	LRnt
16	Vipera ammodytes	LRlc

CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura.

Shpendët

Në zonë janë të pranishëm rreth 39 lloje shpendësh, të cilët jepen në tabelën e mëposhtme së bashku me statusin kombëtar të ruajtjes.

Nr.	Emertimi latin	Stat. Kom
1	Ixobrychus minutus	
2	Nycticorax nycticorax	VU
3	Ardeola ralloides	VU
4	Egretta garzetta	VU
5	Ardea cinerea	VU
6	Ciconia ciconia	CR
7	Anas penelope	
8	Anas crecca	
9	Anas platyrhynchos	
10	Pernis apivorus	EN
11	Circaetus gallicus	
12	Circus aeruginosus	
13	Circus cyaneus	
14	Circus pygargus	
15	Accipiter nisus	EN
16	Buteo buteo	VU

17	Falco naumanni	VU
18	Falco tinnunculus	VU
19	Falco columbarius	VU
20	Falco peregrinus	VU
21	Perdix perdix	
22	Coturnix coturnix	
23	Phasianus colchicus	CR
24	Rallus aquaticus	
Nr.	Emertimi latin	Stat. Kom
25	Tyto alba	VU
26	Strix aluco	LRnt
27	Asio otus	LRnt
28	Asio flammeus	
29	Upupa epops	VU
30	Jynx torquilla	LRnt
31	Picus viridis	LRlc
32	Dendrocopos major	
33	Dendrocopos syriacus	
34	Dendrocopos minor	
35	Acrocephalus scirpaceus	LRnt
36	Acrocephalus arundinaceus	
37	Sitta europaea	LRnt
38	Remiz pendulinus	VU
39	Corvus frugilegus	

Tab. – 18 *Shpendët e pranishëm në zonë (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)*

CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, DD – Mungese te Dhenash, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura. NE – Te Pavleresuara

Në bazë të tabelës vërejmë se prej 39 llojeve të shpendëve të pranishëm në zonë 22 prej tyre jane të rrezikuar në shkallë kombëtare. Prej këtyre 17 lloje i përkasin kategorive të larta të rrezikimit (CR, EN,VU).

Gjitarët

Në zonë numërohen rreth 20 gjitarë nga të cilët 6 janë të rrezikuar në shkallë kombëtare. Prej këtyre 3 lloje bien në kategoritë e larta të rrezikimit (CR,EN,VU). Nga mishngrënësit takohen dhelpra (Vulpes vulpes), baldosa (Meles meles), dhe nuselalja (Mustela nivalis). Në mjediset ujore të zonës takohet rrallë edhe lunderza (Lutra lutra). Pyjet dhe mjediset ujore të zonës janë zona me rëndësi të veçantë për lakuriqët e natës (lloje te gjinive Rhinolophus, Myotis, dhe Pipistrellus), të cilët i vizitojnë ato për ushqim dhe pirje uji. Gjitarët e pranishëm në zonë së bashku me statusin e tyre kombëtar të ruajtjes janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Speciet	Emri shqip	Statusi kombetar i ruajtjes
Erinaceus concolor	Iriqi	
Talpa sp.	Urithi	
Crocidura sp.	Hundegjati	
Rhinolophus ferrum-equinum	Lakuriqnate hundpatkua i madh	LRcd
Rhinolophus blasii	Lakuriqnate hundpatkua i Blasius-it	LRnt
Rhinolophus euryale	Lakuriqnate hundpatkua i	VU
	Mesdheut	
Myotis myotis	Lakuriqnate veshmiu i madh	
Myotis blythi	Lakuriqnate veshmiu i vogël	
Pipistrellus pipistrellus	Pipistreli i zakonshëm	
Pipistrellus savii	Pipistreli i Savi-it	
Pipistrellus kuhli	Pipistreli i Kuhl-it	
Lepus capensis	Lepuri	
Microtus epiroticus	Miu i Ondrias-it	
Microtus thomasi	Miu i Thomasit	LRnt
Apodemus sylvaticus	Miu i pyllit	
Mus spicilegus	Miu i maqedonise	
Vulpes vulpes	Dhelpra	
Lutra lutra	Lutra, lunderza	VU
Meles meles	Baldosa	EN
Mustela nivalis	Nuse lalja	

Tab. – 19 *Llojet e gjitarëve (Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)*

Fauna në habitatet tokësore

Tokat kullosore, arat dhe arat e braktisura të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë speciesh zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël (Rendi: Passeriformes/Harabelorët). Në dimër, fushat e hapura përdoren nga tufa trishtilash shoqëruar nga harabela të tjerë të vegjël. Në verë, fushat e hapura sigurojnë terrene shumëzimi për Shkurtën - Coturnix coturnix. Gardhet dhe pemët e ndryshme frutore në vendet e hapura vizitohen nga Gushëkuqi - Erithacus rubecula, Cerla e zakonshme - Miliaria calandra, Harabeli - Passer domesticus, Cerri - Troglodytes troglodytes, lauresha (Alaudidae) dhe shumë lloje trishtilash. Zonat shkurrore sigurojnë një habitat të rëndësishëm dimërimi për shumë lloje zogjsh, të cilët shumëzohen në lartësi më të larta dhe lëvizin poshtë në zonat shkurrore për t'iu larguar motit të keq. Zogjtë tipikë janë Bilbilthi kokëzi - Sylviaatricapilla, Bilbili kokëzi gushëbardhë - Sylvia melanocephala, Cerla - Emberiza spp, Bilbili i kënetave - Cettia cetti, etj. Gjatë stinëve të pranverë-verës, shkurret mbajnë një gamë të gjerë speciesh zogjsh, si Bilbilthi gushëkuq - Sylvia cantillans, Përqeshësi i vogël i ullinjve - Hippolais pallida, etj. Gjatë migrimit, shkurret përdoren edhe si zona ku mund të ndalojnë edhe lloje si Pupëza - Upupa epops, Gargulli - Merops apiaster, Qafëdredhësi - Jynx torquilla, Mëllenja - Turdus merula, etj. Avifauna në pyjet tranzite (bimësia drunore ndërmjet shkurreve dhe pyjeve të larta) dominohet nga zogj të vegjël

(Rendi Passeriformes). Më karakteristikët janë Bilbili (Sylvia spp), Gushëkuqi (Erithacus rubecula), Cerri (Troglodytes troglodytes), Pupëza (Upupa epops), Cerla (Emberiza spp), Mbretëthi dhe Mbretëthi vetullbardhë (Regulus regulus and R. ignicapillus), Gardalina (Carduelis carduelis), Mëllenja (Turdus merula) dhe Grifsha (Garrulus glandarius). Brezat gjethegjerë të përziera bartin një numër llojesh zogjsh karakteristik si qukapikët (fam. Picidae), Qukapiku i gjelbër - Picus viridis, Qukapiku i zakonshëm larosh - Dendrocopos syriacus, Qukapiku i vogël larosh - Dendrocopos minor, etc.), trishtilët (Trishtili i madh - Parus major, Trishtili i kaltër - Parus caerueleus, Trishtili i madh i murrmë - Parus lugubris), mëllenjat dhe përsëri grifshat.Lloji i gjitarit më të zakonshëm në zonën e Peizazhit të Mbrojtur është vidra (Lutra lutra (VU), e cila është një tregues i mirë biologjik i gjendjes së ekositemit. Gjithashtu takohen edhe gjitarët e mëdhenj si ariu - (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), kaprolli (Capreolus capreolus) dhe derri i egër (Sus scrofa). Lakuriqët e natës përfaqësohen kryesisht nga Myotis nattereri, Nyctalus leisleri, Rhinolophus ferruequinum, R. blasii. Gjitarë të tjerë dhe më shumë të përhapur në zonën e mbrojtur të liqenit të Pogradecit janë shqarthi (Martes foina), vjedulla (Meles meles), nuse-lala (Mustela nivalis), dhelpra e kuqe (Vulpes vulpes), ketri i kuq (Sciurus vulgaris), lepuri (Lepus europeus), iriqi (Erinacues concolor), gjeri (Glis glis), gjumashi i lajthisë (Muscardinus avellanarius), minjtë e drurit/arave (Apodemusflavicollis, A. sylvaticus, A. mystacinus), hundegjates (Crocidura sp), urithi (Talpa stankovici) dhe miu i fushës (Microtus sp).

Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit shërben si bio - korridor për gjitarët e mëdhenj midis zones qendrore Rajcë-Shebenik-Jabllanicë dhe Guri i Nikës-Holtë-Lukovë, në Shqipëri.

Amfibët dhe zvarranikët janë të zakonshëm në zonën e mbrojtur. Gjatë ciklit të tyre të jetës ata janë të lidhur me habitate të ndryshme, sidomos me habitatet ujore për riprodhim dhe funksione të tjera. Llojet kryesore më të përhapur që mund të vëzhgohen kryesisht në zonën e liqenit të Pogradecit janë: Triturus cristatus, T.Vulgaris, Salamandra salamandra, Bombina variegata, Rana balcanica, Rana dalmatina, Rana graeca, Bufo viridis, Hyla arborea, Emys orbicularis dhe Natrix natrix. Zvarranikët tokësorë më të përhapur në peizazhin e mbrojtur të Pogradecit janë Podarcis muralis, Lacerta viridis, Testudo hermanni etj. Zvarranikë të tjerë janë nepërka me bri (Vipera amoodytes) dhe gjarpërinjtë kolubrid (Coluber spp, Coronella austriaca).

Habitati i liqenit

Flora dhe fauna dhe shkalla e biodiversitetit në liqenin e Pogradecit është e lidhur shumë me cilësinë e ujërave të liqenit dhe kushtet e ekosistemit. Liqeni i Pogradecit ka një bimësi të pasur prej 125 bimësh ujore. Llojet më të zakonshme janë Phragmites australis, Potamogeton spp., Chara spp, Ceratophyllum spp., Myriophyllum spp. Gjashtë zonat e njëpasnjëshme të bimësisë përcaktohen në vijim:

- Zona 1: Chara spp.,
- Zona2: Potamogeton spp.,
- Zona 3: Zona e kallamishteve - Phragmites australis,
- Zona 4: llojet me gjethe pluskuese,
- Zona 5: Zona Palustrine dhe Zona: Charatea.

Bimësia luan një rol të rëndësishëm duke funksionuar si filtër biologjik dhe mekanik për ndotësit organikë dhe inorganikë. Bimësia ujore ka gjithashtu një rëndësi të madhe në erozion dhe në kontrollin e rrjedhjes së ujit. Për më tepër, bimësia krijon një habitat natyror për lloje të ndryshme vertebrorësh dhe jovertebrorësh dhe funksionon si vend shumëzimi për shumë peshq dhe mbrojtje prej grabitqarëve. Fauna bentike e liqenit të Pogradecit përmban një dendësi dhe shumëllojshmëri të lartë speciesh. Në zonë gjenden lloje arkaike, endemike e të rralla dhe liqeni është i famshëm për këtë. Sfungjeri i rrumbullakët Ochridospongia rotunda gjendet vetëm në liqenin e Pogradecit dhe është një lloj endemik e i rrallë. Grupi më i përhapur dhe më i madh në numër janë Gastropodet (kërmijtë), dhe shumica e tyre në liqen janë lloje endemike. Niveli i lartë i endemizmit përfaqësohet gjithashtu nga taksonë të tjerë, të tillë si Tricladida, Olighochaeta, Hirudinea, Ostracoda, Amphipoda dhe Isopoda. Fito dhe zoo-planktoni, mikroalgat, janë tregues biologjikë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në regjimin/cilësinë e ujit. Fitoplanktoni përfaqësohet më shumë nga Cyclotella ocellata, Achnanthes minutissima, Achnanthes biasolettiana, Fragilaria capucina, etj., të cilët janë lloje oligotrofike dhe oligomesotrofike. Sidoqoftë, gjenden edhe lloje të ujërave eutrofike ose politrofike, si Coccones ipediculus, Cymbella minuta, Gomphonema minutum, etj. Zooplanktoni mund të përdoret gjithashtu si tregues ndjeshmërie i kushteve të ekosistemit të liqenit. Komunitetet e zooplanktonit në liqen përmbajnë më së shumti Rotiferet – Gastropuss tylifer, Keratella cochlearis, Filina terminalis; Molusqet – Dreissenadhe Krustacete – Dafnia pulicaria dhe Eudiaptomus gracilis. Fauna e peshqve të liqenit të Pogradecit përfaqëson një përqindje të lartë (60%) të llojeve të peshqve endemikë.

Në liqen gjenden 21 lloje natyror peshqish (shikoni Shtojcën II), 11 prej të cilëve shfrytëzohen për qëllime tregtie. Dy salmonidet, korani - Salmo letnica dhe belushka - Salmothymus ohridanus , janë deri më tani llojet më të rëndësishme në peshkim pasuar nga gjuhëza (Alburnus alburnus), krapi (Cyprinus carpio), ngjala (Anguilla anguilla) dhe gurneci (Rutilus rubilio ohridanus). Gjatë viteve të fundit, në liqen janë hedhur lloje peshqish jo natyror si ylber (Oncorhynchus mykiss), barkuleci (Gambusia affinis) apo sharoku laraman (Lepomis gibbosus). Këto lloje nuk janë të afta të riprodhohen në mënyrë natyrore dhe tani konsiderohen si të zhdukura. Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Pogradecit është shumë i pasur me shpendë uji. Numri më i lartë i tyre është shënuar më 1999 ku u identifikuan 23 specie. Shpezët më të përhapura të ujit janë Bajza - Fulica atra, Murrcaku - Netta rufina dhe Rosa laramane me xhufkë - Aythya fuligula. Kredharaku i vogël i zi (Podiceps nigricollis) dhe kredharaku i vogël (Tachibaptus ruficollis) kanë gjithashtu një dendësi të konsiderueshme në liqen. Për më tepër, pas popullatave të rëndësishme të llojeve më të përhapura për Shqipërinë, liqeni i Pogradecit është i rëndësishëm gjithashtu edhe/ose për llojet e rralla e te kërcënuara, të tilla si karabullaku i vogël (Phalacorcorax pygmaeus me një popullsi afër 100 specie dhe Pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus). Lejleku i bardhë (Ciconia ciconia) e përdor liqenin si pikë ndalimi gjatë migrimit dhe Shqipja e fushës (Circus cyaneus) janë prezente me individë të pakët gjatë dimrit së bashku me Patën ballë bardhë (Anser albifrons).

4.6.3 Pyjet

Pyjet dhe shkurretat mesdhetare

Brezi i pyjeve, tipet e grumbujve pyjore, shkurret mesdhetare që shtrihen në territorin e bashkisë dhe shtrirjes së tyre sipas zonave fitoklimatike, përfaqësojnë formacionet bazë të bashkëshoqërimeve bimore që rriten në kushtet aktuale të stacionit prodhues dhe mjedisit.

Tipet e grumbujve pyjore më kryesore janë:

- Pyjet e ahut
- Pyjet me gështenjë
- Pyjet me qarr
- Pyje qarri me dushqe të tjerë
- Pyje me bunge
- Pyje Shpardhi me dushqe të tjerë
- Pyje me pishë të zezë
- Pyje me Bredh të bardhë
- Pyje ahu me bredh të bardhë

Pyje geshtenje –Geshtenjas

Pyjet dominojnë nga pikëpamja fitosociologjike dhe i përkasin rendit quercefalia pubescentis dhe bashkëshoqërimeve të aleancës Quercion frainetto-cerris e Carpinia orientalis.

Llojet prodeminus janë pyjet me ah (Fagus silvatica) pyjet me qarr (Quercus cerris) pyjet e ahut shoqërohen dhe me llojin Bredh (Abies alba) e qarrin.

Pyje me qarr dhe pyje qarri me dushqe të tjerë, pyje qarri me shkozë

Pyje me bunge

Pyje shpardhi me dushqe të tjerë

Pyje me pishë të zezë

Pyjet e bredhit (Abies alba) Bishnice-Ujì i ftohte

Pyje ahu dhe pyje ahu me bredh të bardhë (Guri i Nikës)

-Pyje me bredh të bardhë

Shperndarja e pyjeve dhe kullotave sipas ekonomive pyjore

Fig. – 51

Fig. - 52

Harta ekonomia pyjore Rrezhan



Fig. - 53

Fig. – 54




EKONOMIA PYJORE GESHTENJAT E POGRADECIT
H A R T A
EKONOMIA PYJORE
DARDHAS-PRETUSHE
Shkalla 1:35000
EKONOMIA PYJORE ALARUP
EKONOMIA PYJORE
DERDUSHE
RRETHI I KORÇES
SPJEGUSI I HARTES

Fig. - 55


H A R T A
LIQENI I OHRIT
RRETHI I LIBRAZHDIT
EK.P. MOKER NR.1
SPJEGUSI I HARTES

Fig. - 56



Fig. - 57

Fig. - 58



Fig. - 59



Fig. - 60

Pyjet dominohen nga pikëpamja fitosociologjike dhe i përkasin rendit quercetalia pubescentis dhe bashkëshoqërimeve të aleancës Quercion frainetto-cerris dhe OstriCarpinino orientalis. Llojet me predominus janë pyjet me qarr (Quercus cerris), pyjet e ahut (Fagus silvatica) të shoqëruara me shpardhin e Qarrin.

Vlerësimi i sipërfaqes së fondit pyjor

Vlerësimi i sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor deri tani janë bërë të disponueshme në qarqe dhe deri në nivelin e rrethit. Sipërfaqja e fondit pyjor, duke ju referuar inventarit të pyjeve të vitit 2014 i zhvilluar në sistemin Gis, mbulon rreth 52% të sipërfaqes totale të Shqipërisë, brenda së cilës ndodhen pyjet dhe sipërfaqja e klasifikuar, si toka pyjore, etj. Zënë 16% dhe pylli zë 36%.

Tab. – 20 *Sipërfaqia e rrethit te Pogradecit e ndarë sipas k.perdorimit te territorit*

Emertimi	Sip. Totale ha	Siperfaqia e kultivuar		Siperfaqia pyjore		Kullota		Te tjera	
		ha	%	ha	%	ha	%	ha	%
Pogradeci	71541	17506	26	29581	40	6600	9	17854	25

Karshi sipërfaqes totale te rrethi pyjet dhe kullotat zënë 50.5% te sipërfaqes.

Fig. - 61 *Grafiku i shpërndarjes së pyjeve në bazë të njësive Administrative*



Proptishti Velcani Trebinja Dardhasi

Tab. – 21 *Ndarja e sipërfaqes pyjore dhe kullosore sipas kategorisë së përdorimit të territorit, qeverisjes dhe njësive të qeverisjes vendore(sipas trasferimit të fundit të pyjeve dhe kullotave bashkisë Pogradec).*

Nr	Njësia Qeverisje vendore	Pyje+ Kullota etj. ha	**Pyje ha**	**Qeverisja e pyjeve**			**Kullota ha**	Inpr-duktive ha	Djerr ha	Sipërf-aqe me bimësi pyjore ha	Ujore ha
				Trungishte (Pyje të lartë) ha	Cungishte (Pyje të ulët) ha	Shkurre ha					
1	Proptisht	4146	3607	41	3514	52	410	129	-	-	-
2	Velçan	7085	6101	4026	2063	12	944	28	-	-	11
3	Trebinjë	7798	6407	3064	3088	255	1175	214	2	-	-
4	Dardhas	3894	3466	998	2468	-	360	48	8	12	-
Shuma:		**22923**	**19581**	**8129**	**11133**	**319**	**2890**	**419**	**10**	**12**	**11**

Pyjet dhe kullotat e bashkisë duke i referuar sipërfaqes së rrethit mbulojnë 32% të sipërfaqes.

Tendencat e sipërfaqeve pyjore (Konkluzione)

Duke analizuar sensin evolutiv të llojeve pyjore të dy dekadave vihet re një zvogëlim të sipërfaqeve të llojeve halore në 3.3% dhe përhapjen e pyjeve të përziera në 4% me dominace llojet fletore. Ndërkohë tkurrja e sipërfaqes së pyjeve halore gjate kesaj periudhe argumentohet me praktikat e keq menaxhuara gjatë ndërhyrjes me teknika trajtimi dhe prerje të lejuara të gabuara pa kontroll si dhe dëmtimet e shkaktuara nga zjarrret dhjetë vjecarin 2000-2010 e në vazhdim. Një trend i vërtetë për siperfaqet pyjore, vecanërisht i pyjeve që mbeten në dispozicion për furnizimin me material drusor është përmbysur tani. Nga vitet 1990-2015, zonat pyjore me lëndë drusore janë pakësuar ose pothuajse nuk ka (nuk kanë ngelur as 30% e sipërfaqeve në gjithë Shqipërinë). Gjatë viteve të fundit, cdo vit është humbur 1.5% e sipërfaqes pyjore në dispozicion për furnizimin e popullsisë me dru zjarri. Kjo ka ardhur si rezultat i dëmtimeve nga prerjet pa leje, zjarret si dhe ndryshimin e statusit të funksionit të pyjeve nga prodhues në funksion mbrojtës, rekrativ, etj.

Në pyjet tona nuk ka shumë humbje në siperfaqe por ka humbje në vëllim dhe në qeverisje. Pyjet trungishte kanë kaluar në cungishte, ngastra pyjore me material drusor kanë kaluar në siperfaqe me bimësi pyjore ose sipërfaqe pyjore. Trungishte me moshë të re pa volum drusor.

Shperndarja e materiait drusor sipas ekonomive pyjore

Drute e zjarrit

Një nga prodhimet kryesore të pyllit, përveç lëndës së rrumbullakët janë dhe drutë e zjarrit që përdoren nga popullata për ngrohje. Drutë e zjarrit vijnë nga shfrytezimi i lendës së punimit rreth 10-15% ,nga ngastrat e vecanta për dru zjarri dhe si rezultat i përmirësimeve,rehabilitimit të sipërfaqeve të degraduara,rrallimet e pastrimet e pyjeve të rinj si në trungishte e cungishte. Drutë e zjarrit që vijnë si rezultat i shfryëtzimit të lëndës drusore që sot nuk i lejon ligji i moratoriumit, kurse ngastra të veçanta për dru zjarri në rrethin tonë nuk ka, për këtë arsye po të shikosh tabelën “për nevojat reale për dru zjarri dhe plotësimin” vihet re se nga 109,258m3 dru zjarri që i nevojitet sot popullatës plotësohen vetëm 31,154m3 ose 28% e sasisë, duke llogaritur prerjen 3-4 më shume se rritja vjetore e pyjeve si dhe

përdorimi i fashinave në zonat që kanë pyje në afërsi dhe diferenca si rreth jemi 78,104 m3 dru zjarri zbuluar për vitin 2016. Kjo diferencë do të rritet, nëqoftëse shteti nuk merr masa për zëvendësimin e druve të zjarrit me alternativa të tjera ose të sjellë drune e zjarrit nga jashtë vendit. Përmirësimi i pyjeve të lisit (një sipërfaqe prej 11,000ha) në një kohë sa më të shkurtër do të sillte rritjen e prodhimit të këtyre pyjeve dhe do të rriste në menyrë graduale sasinë e drusë së zjarrit për komunitetin.

Vegjetacioni dhe biodiversiteti

Tipet e grumbullit pyjor

Formacionet më të përhapura dhe që janë formacione bazë dhe shtrihen në ekonomitë pyjore të rrethit janë:

1. Formacioni i ahishteve (Fagus silvatica) me Abies Boriss regia-(Bredhi maqedonise) në gëlqerore.
2. Formacioni pyjor i ahut (Fagus silvatica) me Abies alba (Bredhin e Bardhe) në shkëmbinj gëlqerorë.
3. Formacioni pyjor Querecus petrea me Carpinus betulus,QarriQuercus cerris) me mëllezën (Ostria carpinifolia)
4. Formacioni pyjor i Gështenjës (Castanea sativa) me Quercus petrea në shkembij silicore.
5. Formacioni pyjor Pinus nigra (Pisha e zeze) me Abies alba (B. e bardhe) me Fagus silvatica (Ahun) në gëlqerorë.
6. Formacionet bimore të pyjeve të quercus frainetto e quercus cerris si dhe prëzjerja e tyre me shkurret si Carpinus betulus, Ostria carpinifolia,takohen në pjesën më të madhe të pyjeve nga lartesia 600-1200m mbi nivelin e detit.
7. Pyjet mbizotërohen nga pikpamja fito-sociollogjike dhe i përkasin rendit quercetalia pubescentis dhe bashkëshoqerimeve të aleances Quercion frainetto-cerris dhe Ostrio-Carpinino orientalis.Llojet me predominus janë pyjet me qarr (Quercus cerris), pyjet e ahut (Fagus silvatica) të shoqëruara me shpardhin e Qarrin. Pyjet e rrethit tonë kanë një pontecial prodhus jo të pakët nëqoftëse do të merren masa për përmirësimin e pyjeve të lisit dhe ahut, që janë një nga resurset e pashterëshme për prodhimin e druve të zjarrit. Sipas kadastrës së vitit 2014 pyjet tanë kanë një prodhimtari prej 868,047m^3 lëndë punimi dhe druja e zjarri zë 50% e volumit drusor që është tregues për një zhvillim jo normal të këtyre pyjeve.

ORIGJINA E PYLLIT

Pyjet që qeverisen si trungishte ku bëjnë pjesë pyjet e lartë të ahut dhe pyjet me pishë të zezë kanë origjinë farore, në një siperfaqe prej 8,130 ha, kurse pyjet e ulët cungishtet e lisit dhe një pjese të ahut që ndodhet në afërsi të fshatrave duke u prere disa here kanë shkuar në nje regresion negativë me origjinë llastarore. Këto pyje kanë një prodhimtari më të ulët dhe një jetëgjatësi më të shkurtër krahasuar me trungishtet me origjinë farore.

Natyraliteti

Shkalla e natyralitetit të pyjeve tregon intensitetin dhe historinë e ndërhyrjeve njerëzore, intensitetet e ndryshme të shfryëtzimit të zonave pyjore, të cilat karakterizohen jo vetëm nga pjesa e mbetur e

grumbujve pyjorë në vendndodhjen, por edhe në ndryshimin e strukturave dhe komuniteteve të ndryshme të specieve brenda tyre. Shkalla e natyralitetit e përshkruar është klasifikuar në tre kategori:

- Zona pyjore të pa shqetësuara nga njeriu (natyrale).
- Zona pyjore gjysëm natyrale të shqetësuara nga njeriu, me ndërhyrjet e tij.
- Plantacione.

Për gjendjen që kanë sot pyjet tanë, përfshihen në klasifikimin e dytë si pyje gjysëm natyrore, ku faktori njeri ka ndikuar negativisht ose pozitivisht në këto sipërfaqe pyjore.

Biotopet e vecanta

Biotopet janë sipërfaqe të veçanta që kanë sipërfaqe më të vogla se 1ha, ku kanë lloje drunore të rrallë (shoqerime pyjore të rralla) në formë njollash, ku inventarizohen veçmas ose kur janë më shumë se 1 ha pershkruhen si ngastra të veçanta: Në ekonominë pyjore Bishnicë, pjesa ekonomike 'uji i ftohtë' kemi llojin ilex aquifolium (ilqja) ngastra nr. 36a., si dhe plepishtja në Bishnicë (Populus tremula) ngastra 7a dhe 18a.

Rezervat gjenetike

Janë sipërfaqe pyjore ngastra që ruhen dhe trajtohen për prodhimin e farave pyjore të cilat do të mbillen në fidanishtet pyjore për gjeneratat e reja. Ruajtja dhe përdorimi i burimeve gjenetike pyjore, janë çështjet thelbësore për të përshpejtuar përshtatjen gjenetike të drurëve dhe popullatave të tyre në mjedise të reja, për të ruajtur kapacitetin adaptivë të tyre dhe evolucionin e mëtejshëm të pyjeve.

Për të ardhmen, menaxhimi i pyjeve do të favorizojë evolucionin nëpërmjet seleksionimit natyror, duke inkurajuar kështu zhvillimin e kombinimeve të reja gjenotipike, gjithashtu do të ndimojë dhe në ruajtjen e pontecialit evolutiv të grumbullit pyjor natyror.

Fauna dhe gjuetia

Shtrirja gjeografike e territorit të rrethit të Pogradecit ka krijuar kushte për rritjen e zhvillimin e shumë kafshëve dhe shpendëve të egra si: Lepuri i egër, Ariu, Ujku, Dhelpra, Baldosa, Derri i eger, Kaprolli, Dhia e egër. Nga shpendët, Thëllëza e malit, e fushes, Qukapiku, etj. Aktualisht nuk zhvillohet aktivitet gjuetie, sepse është e ndaluar nga ligji për moratoriumin e gjuetisë për dy vjet.

Cilësia e grumbullit pyjor

Cilësia e grumbullit ka të bëjë me % që zë lënda e punimit në llojet drusore dhe shprehet ne tre kritere:

- E ulët – Lënda e punimit zë gjer në 40% të vëllimit për halorët dhe 25% për fletorët;
- Mesatare – Lënda e punimit zë 40-60% për halorët dhe 25-50% për fletorët;
- Lartë – Lënda e punimit zë mbi 60% për halorët dhe 50% për fletorët.

Duke qënë se pyjet tanë janë të shfrytëzuar, edhe sot kemi pyje me moshe të re. Pyjet tanë hyjnë në kriterin e parë të ulët. Për rritjen e cilësisë së grumbullit pyjor, përmiresimi i pyjeve të lisit (cungishteve), si dhe ndërhyrja në pyjet e rinj të Ahut me moshë 20-60 vjet është një nga detyrat më të rëndësishme të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve, ku për një periudhë 10 vjecare të arrihet në kriterin mesatar të cilësisë së grumbujve, pra për të rritur raportin e lëndës së punimit, karshi drusë së zjarrit.

Prodhimet jo drusore

Pyjet kudo ku shtrihen në zonat veriore apo zonat e ulëta bregliqenore janë një burim tradicional, jo vetëm për lëndën drusore, por dhe për shumë produkte të tjera, të cilat nxirren nga pyjet duke përfshire taninën, rrëshirën, bimë mjekësore, fruta, rrënjë, këpurdha, mjaltë, bimë dekorative dhe tufa zbukuruese. Prodhimet jo drunore, si aktivitete të dyta në 10 vjecarin e fundit janë rimëkëmbur e rikthyer në rrugën tradicionale të zhvilimit në mënyrë të veçantë, sektori i bimëve mjekësore. Bazuar ne inventarin kombëtar të bimëve mjekësore gjejnë shtrirje në 45% të territorit. Ne nje vit eksportohen bimë mjekësore me nje vlere prej 11.5 milion euro. Rrethi i Pogradecit eshte i pasur me bimë mjekësore dhe etero vajore dhe keto zënë rreth 40% të sipërfaqes pyjore e kullosore. Llojet me kryesore jane Trëndafili i egër, Murrizet, Sherebela, çaji i malit, njëmije fletëshi, balsami, rigonet e ndryshme, dëllinje zeze, e kuqe, molla e egër, mëllagat e ndryshme, qumështorkat, salepet, etj., që kanë një vlerë të pa llogaritshme. Studime konkrete deri tani nuk ka. Po behen përllogaritje në bazë të njësive administrative, ekonomive pyjore dhe fshatrave, ku vleresimi dhe vjelja e prodhimeve jo drusore në pyll do te ndikojë pozitivisht në rritjen e të ardhurave për komunitetin.

Rritja në vellim dhe prodhimtaria e pyjeve

Vleresimi i materialit drusor në rritje të klasifikuar në pika themelore e informacionit për zbatimin dhe vlerësimin e teknikave të menaxhimit të qëndrushem të pyjeve. Vëllimi i pyjeve është 868,047m3 nga keto: lëndë e trashë 43,098m^3, e mesme 124,342, e hollë 275,735m^3 dhe dru zjarri 424,872m^3. Në pyjet e lartë, vëllimi është 51%, kurse në pyjet e ulët 49%. Nga keto pyje volume për ha është vleresuar në trungishte në 60-70m3/ha, kurse cungishtet 15-20m3/ha. Rritja vjetore e pyjeve të ulët shkon në nga 0.9-1.5m^3/ha ne vit dhe trungishtet ne 3-4m^3/ha në vit. Sektori pyjor vazhdon të vuajë nga probleme si:

1. pakësimi i investimeve,
2. prishja në praktikë e mbarështrimit dhe mirëmbajtjes së pyjeve,
3. mungesa e mbikqyrjes dhe e zbatimit të ligjit,
4. situatat anarkike të kaluara,

si rrjedhoje burimet bazë u pakësuan në mënyrë të ndjeshme. Në të njëjtën kohë, ristrukturimi ekonomik shkaktoi uljen e efiçencës së shfrytëzimit të pyjeve dhe përpunimit të drurit, ndërsa rritja e ndjeshme e prejeve të pa ligjshme çrregulloi çmimet e tregut dhe efektin e proçedurave të reja për shitjen e lëndës së drurit.

Mundësia e shfrytëzimit

Në kuadrin e menaxhimit të pyjeve, në përgjithësi do të parashikohen vetëm ndërhyrje silvikulturore duke qenë se pyjet tanë në moshë të re dhe me këto ndërhyrje do të përmirësohet gjendia e tyre. Materiali drusor që do të përdoret sidomos druja e zjarrit do të përdoren për nevojat e popullatës.

Ndërhyrjet do të jenë prerjet sanitare, rrallimet si dhe nxitja e ripërtritjes dhe përmirësimit të gjendjes aktuale të pyjeve cungishtë në përmirësimin dhe mbrojtjen e tyre.

Menaxhimi i rreziqeve

Karakteristikat specifike të habitateve të veçanta, ose specieve të rrezikuara duke përfshirë rreziqet dhe masat e nevojshme për një mbarështrim ekologjik e të qëndrueshëm të pyllit janë vlerësuar në terren në nivel ekonomie.

Llojet e kercenuara

Habitatet e pyjeve të rrezikuara, disa nga këto janë tipike dhe të veçanta për vendin tonë si tipet e pyjeve dushk-frasher, pyjet e bredhit, pyjet e ahut, pyjet e pishës.

Habitate tepër të rrezikuara - Habitatet e gështenjes, pishës, bredhit

Habitate te përkeqësuara - Habitati i pyjeve me panje mali

Habitate më pak të rrezikuara-Dushk me ilqe, pyjeve me shkozë.

Funksioni i pyjeve-Kryesisht pyjet i ndajmë në pyje me funksion prodhimi, pyje me funksion mbrojtës dhe funksion ndërmjetes pyje mbrojtës –prodhues. Sipërfaqia e pyjeve tonë kryhesisht kanë funksion prodhues, ku vetëm 10-12% e sipërfaqes është me funksion mbrojtës dhe mbrojtës –prodhues. Në këto sipërfaqe përfshihen sipërfaqet pyjore në basenet e liqeneve malore, rezervuarve, pjerrësitë e mëdha si në shkëmbin e Llengës, liqenet e Lukoves, Pyjet e pishës së zezë në basenin e Liqenit të Pogradecit etj.

Sistemi i menaxhimit të pyjeve - Pyjet menaxhohen ose qeverisen në tre forma:

- Pyje trungishte, bëhet fjalë për pyjet e lartë të ahut, që kanë një prodhimtari të lartë të materialit drusor dhe kanë origjinë farore. Këta pyje zëne një sipërfaqe prej 8,100ha. Sot janë pyje të rinj me një zhvillim të mire vegjetativ.
- Pyje cungishte-Kryesisht janë pyjet e lisit, ahut dhe të gështenjes me një sipërfaqe prej 11,133ha që kanë një prodhimtari të ulët dhe janë me origjinë llastarore.
- Shkurret-Janë pyjet me lloje si shkoza ,bushi,mëllëza,lajthitë të cilat kane nje siperfaqe prej 319 ha qe prodhojne dru zjarri të nje sasie të vogel.

Në rrethin tonë, ekonomitë pyjore janë të mbuluara me plane menaxhimi, por i ka kaluar afati i përdorimit të tyre dhe të dhënat që janë sot për të kryer një menaxhim të qëndrushëm të pyjeve nuk janë të sakta, prandaj është e domosdoshme ribërja e tyre në një afat sa më të shkurtër.

Tipet e kullotave

Tipet e kullotave që kemi janë: Kullota Alpine Ballkanike me sesleria comosa, Festuca riloensis, corvex curvua, etj.

Sipërfaqia e pyjeve, kullotave dhe tokat pyjore dhe disponushmeria e furnizimit me material drusor

Në analizat e bëra, sipërfaqia e pyjeve është zvogëluar në masën 1.2-1.3%. Kjo ulje është konstatuar me shumë në 10 vjeçarin e fundit, kurse në pyjet tona, kjo ulje është 0.5-0.6%. Duke ju referuar elementëve të përbërjes së fondit pyjor rezulton:

- Evidentohet një ndryshim i cili ka sjellë zvogëlimin e sipërfaqes për rrjedhojë janë zvogëluar dhe resurset pyjore si dhe përfitimet e komunitetit që nxirret prej tyre.

- Pamvarësisht se sipërfaqia nuk ka ndonjë zvogëlim të madh, por ajo ka humbur treguesit cilesorë, ku një pjesë e sipërfaqes pyjore është qeverisur si trungishte, nga ndërhyrjet e gabuara të faktorit njeri, ato janë kthyer në cungishte, në pyje me vlerë cilësore të ulët dhe trungishtet me material drusor në sipërfaqe me bimësi pyjore ose sipërfaqe me filizeri ahu me moshë të re, pra jane humbur treguesit sasiorë.
- Ajo qe ka ndryshuar më shumë është se sipërfaqia e pyjeve me funksion kryesor prodhimin e lëndës drusore, e cila llogaritesh gati 60%, ku në mënyrë të përmbledhur sensi evolutiv i zhvillimit të pyjeve sëbashku me format e menaxhimit, identifikohet me një zhvillim që nuk vihet re, por në fakt këto zhvillime jane në kahe të kundërt.
- Shpërndarja e vellimit të materialit drusor, e cila sot nuk është uniforme në raport me klasat e moshave dhe kategorive diametrike të drurëve, përbërjes morfollogjike të llojeve të drurëve, krijon një problem për qeverisjen e qëndrueshme, multifunksionale e afatgjatë të pyjeve.
- Ulja e prodhimtarisë së pyjeve ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e sasisë së materialit drusor në dispozicion për furnizimin me lendë drusore, dhe veçanërisht dru zjarri të shoqerisë në nivel lokal dhe kombëtar.

Përfundime

Sipërfaqja e pyjeve, kullotave dhe tokat pyjore dhe disponueshmëria e furnizimit me material drusor

Treguesit e mësipërm na afron një prespektivë të plotë të resurseve, pyjore, kullosore dhe është një burim i vlefshëm informacion për politikat pyjore kombëtare dhe lokale e programeve pyjore që janë zbatuar. Shtrirja dhe në veçanti ndryshimet në sipërfaqet në fondin pyjor e kullosor në vlerësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve për një vendimmarrje të proceseve politike dhe ekonomike. Në analizat e bëra kohët e fundit sipërfaqja e pyjeve është zvogëluar në masën 1.2-1.3% kjo ulje është konstatuar më shumë në 10 vjeçarin, kurse në pyjet tona kjo ulje është 0.5-0.6%. Duke ju referuar elementëve të përbërjes së fondit pyjor dhe dimensionet e disponueshmërisë së pyjeve, si pjesë për prodhimin e lëndës drusore, aq e domosdoshme për plotësimin e nevojave të shoqërisë në këtë moment rezulton:

- Evidentohet një ndryshim i cili ka sjellë zvogëlimin e sipërfaqes, për rrjedhojë janë zvogëluar dhe resurset pyjore si dhe përfitimet e komunitetit që nxirret prej tyre.
- Pavarësisht se siperfaqja nuk ka ndonjë zvogëlim të madh, por ajo ka humbur treguesit cilësorë, ku një pjesë e sipërfaqes pyjore është qeverisur si trungishte, nga ndërhyrjet e gabuara të faktorit njeri, ato janë kthyer në cungishte, në pyje me vlerë cilësorë të ulët dhe trungishtet me material drusor në sipërfaqe me bimësi pyjore ose sipërfaqe me filizeri ahu me moshë të re, pra janë humbur treguesit sasiorë.
- Ajo që ka ndryshuar më shumë është se sipërfaqja e pyjeve me funksion kryesor prodhimin e lëndës drusore e cila llogaritesh gati 60%, ku në mënyrë të përmbledhur sensi evolutiv i zhvillimit të pyjeve së bashku me format e menaxhimit, indentifikohet me një zhvillim që nuk vihet re, por në fakt këto zhvillime janë në kah të kundërt.

- Shpërndarja e vëllimit të materialit drusor e cila sot nuk është uniformë në raport me klasat e moshave dhe kategorive diametrike të drurëve, përbërjes morfologjike të llojeve të drurëve, krijon një problem për qeverisjen e qëndrueshme, multifunksionale e afatgjatë të pyjeve.
- Ulja e prodhimtarisë së pyjeve ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e sasisë së materialit drusor në dispozicion për furnizimin me lëndë drusore dhe veçanërisht dru zjarri të shoqërisë në nivel lokal dhe kombëtar.
- Kontributet e ekosistemeve pyjore, duke afruar produkte drusore e jo drusore, energji të rinovueshme, duke ndikuar në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, në zbutjen e ndryshimeve klimaterike, fiksimin e karbonit përmbajnë në vetvete objektivat e së ardhmes, për rritjen teknologjike, hapësira mediatike dhe sidomos vëmendje politike.
- Pyjet për më tepër se 30 vjet janë sakrifikuar nga mos zbatimi I ligjit dhe politikave në periudhën e tranzicionit dhe krizave ekonomike, për mbijetesën dhe uljen e varfërisë së popullsisë që aktualisht jeton në zonat e thella malore.
- Pyjet ngelen mbulesa më thelbësore e tokës e cila luan dhe funksione, për konservimin e diversitetit biologjik të florës dhe faunës, për rregullimin e regjimit hidrik, për luftën kundër shkretëtirëzimit, degradimit të tokave, gërryerjeve, rrëshqitjeve dhe përmbytjeve, ndërkohë i afrojnë shoqërisë, hapësirë për kohë e lirë, mundësi argëtimi, pushimi dhe kënaqesie, me ajrin e freskët ujin e pastër e të kthjellët si dhe peisazhin e bukur që krijojnë kudo që ndodhen.
- Cilësitë me karakter mulifunksional të pyjeve ne duhet ti zhvillojmë jo ti kërcënojmë, duhet ti mirëmbajmë dhe jo ti braktisim nga mungesa e një menaxhimi të qëndrueshëm, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës.

Shtyllat e menaxhimit të qëndrueshem të pyjeve

- Mirëmbajtja, përmirësimi dhe shtimi i burimeve natyrore
- Mirëmbajtja e Ekosistemit pyjor, shëndeti dhe vitaliteti i pyjeve
- Mirëmbajtja dhe inkurajimi i funksioneve prodhuse të pyjeve
- Mirëmbajtja, konservimi dhe përmirësimi i diversitetit biologjik të ekosistemeve pyjore
- Mirëmajtja, përmirësimi dhe nxitja e funksioneve mbrojtës në menaxhimin e pyjeve.
- Mirëmajtja e funksioneve të tjera ekonomike dhe kushtet.

Konkretisht

- Përmirësimi i pyjeve të lisit, rehabilitimit të tyre në një kohë sa më të shkurtër për rritjen e prodhimtarisë së tyre.
- Kryerja e prerjeve silvikulturale në trungishtet e pyjeve te ahut, nxjerrja prej tyre të materialit drusor si dru zjarri dhe shkurtimin e kohës për futjen në shfrytëzim të tyre.
- Pyllëzimin e kanaleve, brigjet e lumenjve, krijimi i brezave mbrojtës në fushë dhe futjen e llojeve me rritje të shpejtë.
- Pyllëzimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga erozioni dhe tokave të refuzuara kryesisht afër qendrave të banuara për të krijuar një mjedis të pëlqyeshëm nga faktori njeri.
- Të kryhen investime për përmirësimin e kullotave dhe rritjen e kapacitetit kullor të tyre.

- Të shkohet drejt dhënies në përdorim të fondit pyjor personave fizikë me banim në fshat në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyre për material drusor.

4.6.4 Zonat e Mbrojtura në Bashkinë Pogradec

KUADRI KOMBËTAR PËR RUAJTJEN E NATYRËS

Rrjeti i sotëm i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, mbulon një sipërfaqe prej 165,455 hektarë e barazvlefshme me 5.8 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, planifikohet që deri më 2020, ZM-të të mbulojnë 25 % të territorit shqiptar. Në vitin 2002, Parlamenti Shqiptar aprovoi dy ligje të rëndësishëm (Ligji Nr. 8934 i datës 05.09.2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligji Nr. 8906 i datës 06.06.2002, "për Zonat e Mbrojtura", (i amenduar me Ligjin nr. 9868, datë 4.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 "Për zonat e mbrojtura") që së bashku krijuan një strukturë të re ligjore për Zonat e Mbrojtura. Ligji jep gjithashtu parimet e zhvillimit të turizmit mjedisor, të përfitimeve të tjera ekonomike si dhe ato të përcjelljes së informacionit dhe edukimit në drejtim të publikut.

KATEGORITË MENAXHUESE TË IUCN-SË PËR ZONAT E MBROJTURA

I. Mbrojtje Strikte (Rezervat Strikt Natyror)
Sipërfaqe tokësore ose liqenore me ekosisteme të veçantë ose përfaqësues, karakteristika gjeologjike me/ose lloje të rëndësishëm. Karakteristika të vlefshme për kërkim shkencor dhe monitorim mjedisor.

II. Konservim i ekosistemeve dhe rikrijim (Parqet Kombëtare) Zona Natyrore tokësore ose/dhe liqenore, të krijuara për (a) mbrojtjen e tërësisë ekologjike të një apo më shumë ekosistemeve për brezat e sotëm dhe të ardhëm, (b) përjashtimin e shfrytëzimit për qëllime të kundërta me ato të ZM-së dhe (c) dhënien e një baze të zhvillimit shpirtëror, shkencor, edukues dhe vizitues, ku gjithësecila duhet të jetë pro-mjedisore dhe pro-kulturore.

III. Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) Zona që përmbajnë një, ose më shumë, veçori natyrore/kulturore me vlera të jashtëzakonshme ose unikale për shkak të rallësisë së pazakontë, cilësive përfaqësuese, estetike ose kulturore.

IV. Konservim me anë të menaxhimit aktiv (Rezervat Natyror i Menaxhuar) Sipërfaqe tokësore ose liqenore subjekt i nderhyrjeve aktive me qëllime menaxhimi për të siguruar mirëmbajtjen e habitateve dhe/ose përmbushjen e kërkesave të llojeve të veçanta.

V. Konservim i Peisazheve Tokësore/Liqenore (Peisazh Tokësor/Detar i Mbrojtur) Sipërfaqe tokësore ose/dhe liqenore ku ndërveprimi shumëvjeçar i njeriut me natyrën ka dhënë një hapësirë me karakter të theksuar estetik, ekologjik dhe/ose kulturor me larmi të lartë biologjikë në shumë raste. Sigurimi i tërësisë së këtij ndërveprimi tradicional është jetik për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe evolimin e një zone të tillë.

VI. Përdorim i qëndrueshëm i ekosistemeve natyrore (Zonë e Përdorimit të Shumëfishtë) Zona ku dominojnë sistemet natyrore të pamodifikuara, të menaxhuara për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen afat-gjatë të larmisë biologjike. Njëherazi, ato mbështesin një përdorim të qëndrueshëm

të prodhimeve dhe shërbimeve natyrore për të siguruar nevojat e komunitetit.

4.7 TIPET E GJEOMONUMENTEVE TË BASHKISË SË POGRADECIT

4.7.1 Përshkrimi i zonës

Bashkia e Pogradecit është pjesë e rrjetit të zonave natyrore të mbrojtura dhe një pjesë e mirë e saj është pjesë e Kat.-V të Zonave të Mbrojtura, atë të "Peisazhit të Mbrojtur". Kjo zonë është shpallur zonë e mbrojtur me vendim Nr.80, datë 18.2.1999.



Fig. – 61 *Monumentet e kulturës dhe zona e mbrojtur*

Peisazhi I Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit ka një sipërfaqe prej 27.323 ha që ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Maqedoninë. Kufijtë e ZM-së përcaktohen me Vendimin Nr. 80, datë 18.2.1999 "Për shpalljen e territorit tokësor/ujor të Pogradecit "Zonë e mbrojtur", si më poshtë:

- Veri Qafë Thanë: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë);
- Lindje: kufiri shtetëror (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe kufiri liqenor me Parkun Kombëtar të Prespës: (maja e Pusit: 2,288m, maja e Zonjës: 2,085 m) dhe kuotat 1,912 m;
- Jug: Kuota 1,912m, kuota 1,461 dhe kuota 1,589 m;
- Perëndim: kuota 1,461, dhe kuota 1,589m, maja e Beshenikut (1,411m) maja e Shullerit (1,226 m), maja e Fushës së Madhe (1,430m), maja e Muratit (1,520), Qafa e Kotodeshit, Qafa e Thanës.

Monumentet Arkeologjike të bashkisë Pogradec

1. Kalaja e Pogradecit, me mure mesjetare të shek. V-VI pas Krishtit, në bazë të së cilës ndodhen mure pellazgjikë parahistorikë të mijëvjecarëve 3-2 para krishtit.
2. Varret monumentale te Selces se Poshtme shek. IV-III para Krishtit.
3. Bazilika e Linit, me mozaike shek. V-VI pas Krishtit.
4. Vendbanimet prehistorike të Zagradës, pranë Linit;
5. Rrënojat e kishës Bazilike në Lin dhe shumë kasha të tjera.
6. Kalaja e Bllacës që lidhet me banimet e njerëzve të dalë nga jetesa në shpella (shpella e trenit), e cila ka vazhduar me mure të shek V – VI pas krishtit.

Tipet e gjeomonumenteve të bashkisë së Pogradecit

Gjeomonumentet në Bashkinë e Pogradecit janë të rëndësisë ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Për nga origjina e tyre, dominojnë gjeomonumentet me origjinë: stratigrafike, mineralogjike-ekonomike,

gjeomorfologjike (erozionale-lumore, karstike, atmosferike), tektono-strukturore, paleontologjike-paleoambientale, hidrogjeolo-gjike-termominerale etj. Konkretisht, kemi gjeomonumentet e klasifikuara, si më poshtë:

I-Parqet Natyrore:

1. Pogradeci Peisazh i Mbrojtur
2. Guri i Nikës, Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara

II-Gjeomonumentet:

a) ***Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:***

1. Liqeni i Pogradecit (Ohrit), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, neotektonikliqenor

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare:

1. Guri i Kamjes (V-a-8), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik
2. Burimi i Drilonit, Gjeomonument hidrogjeologjik-karstik.

Fig. – 62 *Harta e Gjeomonumenteve, Pogradec (Burimi : Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

c) Gjeomonumente lokale:

1. Burimet e Tushemishtit, Gjeomonument hidrogjeologjik-karstik;
2. Gadishulli i Linit, Gjeomonument tektono-strukturor;
3. Mullarët e Gurtë-Trebinjë (V-a-7) Format erozionale Trebinjë, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik;
4. Gurët "nusja dhe dhëndëri" Senisht, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik;
5. Piramida e Tokës së Qafë Panjës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks erozional;
6. Fragment i shkëputjes tektonike të grabenit të Ohrit (Pogradec), Gjeomonument tektono-strukturor;
7. Shpella e Memlishtit, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik;
8. Shpella e Radokalit, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik;
9. Shpella e Baribardhës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik;
10. Shpella e Shën Marenës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik;
11. Kanioni i Llëngës (V-b-23), Gryka e Llëngës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks;
12. Shpella e Najazmës (Tushemisht), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, karstik;

13. Bashkimi i Lumit Shkumbin me atë të Dushës, Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks erozional lumor;
14. Liqenet e Lukovës, Gjeomonumentgjeomorfologjik kompleks, akullnajor;
15. Mali i Niçës (V.-a-10), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik;
16. Mali i Bletës (V.-a-11), Gjeomonument gjeomorfologjik kompleks, erozional atmosferik;
17. Miniera e qymyrgurit Alarup (IX.-2), Gjeomonumentpaleontologjik-paleoambiental.

Në varësi të mënyrës së formimit, karakteristikave që paraqesin dhe veçorive të tjera është kryer ky klasifikim:

- gjeomonumente gjeomorfologjike komplekse, të formuar si rezultat i proceseve erozionale gjeologjike (lumore, atmosferike, akullnajore, karstike, neotektonike lumore e liqenore), etj.,
- gjeomonumente janë të karakterit hidrogjeologjik;
- gjeomonumente të karakterit tektono-strukturor;
- gjeomonument i karakterit paleontologjik-paleoambiental;
- janë monumente arkeologjike;
- monument kulti.

PARQET NATYRORE

1. Pogradeci

Peisazhi i Mbrojtur Pogradeci ndodhet në Bashkinë e Pogradecit. Sipëfaqja aktuale e tij është 27,323 ha. Ai përfaqëson një Zonë të Mbrojtur ndërkufitare. Në të, përfshihet liqeni tektonik më i thellë i Ballkanit (290 m) dhe një nga më të rëndësishmit në Europë e më gjërë. Së bashku me liqenet e Prespës përbëjnë bërthamën më të rëndësishme të një Rezerve Biosferë. Është një zonë e rëndësishme turistike dhe pushimi, edhe për zhvillimin e aktiviteteve tradicionale kulturore e artistike me vendet fqinje, për të cilin është gatitur plani i menaxhimit me anë të projektit SELEA.

2. Guri i Nikës

Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara Guri i Nikës ndodhet në Bashkinë e Pogradecit. Sipërfaqja aktuale e tij është 2200ha. Ai rrethohet nga ekonomi pyjore e kullosore të rëndësishme si: Qafë Panja, Bishnica, Guri i Topit, Valamars etj. dhe karakterizohet nga një shkallë e lartë biodiversiteti bimor, shtazor e habitatesh.



Fig. – 63 *Harta e zonave natyrore të mbrojtura*
Burimi : Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Gjeomonumentet

a) Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare:

1. Liqeni i Pogradecit (Ohrit)

Liqeni i Pogradecit për nga mënyra e formimit është një gjeomonument tepër i veçantë. Eshtë me origjinë tektonike si rezultat i uljes së madhe të një pjese të sipërfaqes së tokës në trajtë grabeni. Ky fenomen gjeologjik ndodhi nën efektin e dy zonave të fuqishme tektonike, ajo perëndimore Qafë Thanë-Lin-Peshkopi dhe ajo lindore Ohër-Alarup.

Foto – 8 *Liqeni i Pogradecit Foto A. Fezollari*

b) Gjeomonumente me vlera kombëtare:

1. Guri i Kamjes (V-a-8) Ky gur ndodhet pranë fshatit të Dardhës të ish Komunës së Dardhasit të Bashkisë Pogradec, në afërsi të Qafës së Lipovës, 1461 m mbi nivelin e detit. Është i gjatë rreth 100 m, i gjërë rreth 80 m dhe i lartë 70m.

Foto – 9 *Guri i Kamjes Foto A. Fezollari*

2. Burimi i Drilonit - Burimi i Drilonit (Zagorçan) gjendet në të dalë të fshatit Zagorçan, në drejtim të Volorekës nga i cili rrjedh lumi i Drilonit. Burimi ka diametër 10 m dhe lartësi 5 m mbi nivelin e liqenit. Ai rrethohet nga një bimësi e dendur higrofile dhe ka një botë të pasur shtazore dhe pamje e bukuri të pakrahasueshme natyrore. Burimi krijon një mjedis shumë tërheqës. Fatkeqësisht, vërehen shenja ndotje

dhe dëmtim të botes së gjallë, për shkak të fabrikimit të rritjes së peshkut në burimin e daljes së ujit, por me mundësi ripërtëritje të vlerave të dëmtuara.

Foto – 10 *BURIMET E TUSHEMISHTIT DHE DRILONI FOTO L. MOISIU, A. FEZOLLARI*

b) Gjeomonumente me vlera lokale:

Foto – 11 *Burimet e Tushemishtit Foto L.Mosiu*

15. Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80 km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700 m dhe 2027 m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh). Liqeni i Madh ndodhet në kuotën 1851 m mbi nivelin e detit me një sipërfaqe 0.05km2, ndërsa Liqeni i Vogël ndodhet në kuotën 1706 m me sipërfaqe 0.035 km2 me sipërfaqe 0,035 km2.

2. Gadishulli i Linit Gadishulli i Linit gjendet në Liqenin e bukur të Pogradecit, në Lin të ish Komunës Hudënisht. Ky gadishull është i gjatë 2km, i gjerë 1,5km. Ai ndodhet rreth 22km në veri të Pogradecit, në kuotën 784,9m mbi nivelin e detit dhe ngrihet rreth 90 metra mbi liqen si një roje gjigande e tij. Ky gjeomonument ka vlera shkencore

Foto – 12 *Pamje nga Gadishulli i Linit (Foto A. Fezollari, D. Mazelli)*

(gjeologjike, gjeomorfologjike e biologjike), didaktike, kulturore, arkeologjike, gjeoturistike dhe fetare. Ai vizitohet nëpërmjet rrugës automobilistike Pogradec-Lin apo Tiranë-Lin dhe ka infrastrukturë të përshtatshme. Në gadishull, nuk ka ruajtje të mirë të mozaikëve të Linit vlerat e të cilave janë të mëdha, ndërkohë që nga papastërtia po dëmtohet bota e gjallë ne liqen. Pushteti vendor duhet të përdorë gjithë kompetencat e mundësitë për të ruajtur vlerat e shumta të gadishullit të Linit.

3. Mullarët e Gurtë-Trebinjë (V-a-7), Format erozionale Trebinjë - Mullarët e Gurtë-Trebinjë ndodhen në juglindje dhe në afërsi të fshatit Trebinjë të Mokrës, rreth 2km larg ish komunës me të njëjtin emër, Bashkia e Pogradecit, 1150 m mbi nivelin e detit. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi kombëtare, të grupit gjeomorfologjik-kompleks dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, kulturore ekologjike dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës automobilistike Pogradec-Vërdovë-Varrezat e Grekut-Trebinjë ose Prrenjas-Proptisht- Trebinjë. Infrastruktura nuk është e mirë.

Foto – 13 *Pamje nga Mullarët e Gurtë-Trebinjë (Foto A. Muça, D. Mazelli)*

4. Gurët "nusja dhe dhëndëri" Senisht, - Gurët "Nusja dhe Dhëndëri"Senisht gjenden në afërsi të fshatit Senisht të ish Komunës Mokër, 1000 m mbi nivelin e detit. Ata përfaqësojnë dy gurë 3 m të lartë, me përbërje gëlqerore konglomeratesh me çimentim dhe me fortësi jo të njëjtë, të modeluar nga karsti erozioni dhe era në formën e "nuses" dhe të "dhëndërit".Gojëdhënat thonë se Dhëndëri dhe Nusja së bashku me krushqit që i shoqëronin, të mallkuar nga pala e çupës, u gurtësuan sepse e rrëmbyen nusen.

Foto – 14 *Pamje nga Gurët "nusja dhe dhëndërri" Senisht*

5. Piramida e Tokës së Kalivaçit (Koka e Balos) - Guri me emrin "Koka e Balos" ngrihet në formën e një piramide me faqe vertikale e me përmasa: gjerësi 2m, gjatësi 3m e lartësi 4m. Ai ndodhet në kuotën 1180m mbi nivelin e detit. Objekti përbën një mbetje erozive me kapele të gurtë në krye, të formuar nga veprimtaria e erës. Pjesa konglomeratike ngrihet solide e me formë interesante pasi janë gërryer pjesët argjilore e të çimentuara dobët. Aktualisht, është i ruajtur shumë mirë, por ekziston rreziku i rënies për shkak të erozionit të mëtejshëm të bazës. Është e nevojshme që nga ana e bashkisë të forcohet bazamenti dhe të rrethohet objekti.

6. Piramida e Tokës së Qafë Panjës - Objekti përfaqësohet nga një gur që ngrihet pranë rrugës në formën e një piramde të lartë me përmasa: gjerësi 2m, gjatësi 3m e lartësi 8m dhe ndodhet në kuotën

1489m mbi nivelin e detit. Kjo piramidë përbëhet nga konglomerate të çimentuara mirë me lëndë çimentuese ranoro-silicore që i përkasin moshës akuitaniane me rreth 30 milionë vjet. Objekti përfaqëson një mbetje erozive të modeluar me mjeshtëri nga veprimtaria e vazhdueshme e erës e cila ka larguar materialin më të dobët argjilor e ranor.

7. Fragment i shkëputjes tektonike të grabenit të Pogradecit - Fragment i shkëputjes tektonike të grabenit të Ohrit (Pogradec) ndodhet në afërsi të qytetit të Pogradecit dhe të rrugës këmbësore për në Mokër. Ai përbën një shkëputje normale dhe të dukshme të kontaktit tektonik midis gëlqerorëve dhe mollasës në buzën perëndimore të grabenit të Ohrit. Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, gjeologjike, tektonike, didaktike dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002.

8. Shpella e Memlishtit - Shpella e Memlishtit ndodhet në afërsi të Gurit të Kuq dhe fshatit homonim. Ajo përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Kretës së sipërme. Është e gjatë deri në 400m, e gjerë rreth në 10m dhe e lartë afërsisht 25m. Ajo ka konkrecione me bukuri mahnitëse. Ky gjeomonument ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike), didaktike dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës Pogradec-Memlisht.

9. Shpella e Rodokalit - Shpella e Rodokalit ndodhet në afërsi të fshatit Rodokal. Ajo përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Kretës së sipërme, ende të pa eksploruar plotësisht. Ajo fillon me një pus vertikal dhe vazhdon me një galeri 300m të gjatë, deri 25m të gjerë dhe rreth 15m e thellë. Ky gjeomonument ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike), didaktike dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës Pogradec-Rodokal.

Foto – 15 *Pamje nga Shpella e Baribardhës*

10. Shpella e Baribardhës - Shpella e Baribardhës ndodhet në afërsi të fshatit me të njëjtin emër, 1052m mbi nivelin e detit. Ajo përbën një shpellë karstike të formuar në gëlqerorët e Kretës së sipërme që ende nuk është eksploruar. Ajo është 30m e gjatë, deri në 4m e gjerë dhe e lartë deri në 3m. Ky gjeomonument ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike), didaktike, ekologjike,kulturore dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës Pogradec-Baribardhë.

Foto – 16 *Pamje e Rrugës Shën Marenë Pogradec*

11. Shpella e Shën Marenës - Shpella e Shën Marenës gjendet në afërsi të manastirit e kishës me të njëjtin emër, në verilindje të fshatit Jollë (Zgallë), kuotën 1100m mbi nivelin e detit. Ajo ruhet në gjendje të mirë e në mënyrë natyrale, vizitorët e shumtë interesohen për bukuritë e saj por edhe si vend kulti. Kjo shpellë përbën një gjeomonument me rëndësi

lokale, të grupit gjeomorfologjik dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, fetaredhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002 dhe vizitohet nëpërmjet rrugës Pogradec-Qafë Panjë-Manastiri Shën Marenë me infrastrukturë pjesërisht të përshtatshme.

12. Kanioni i Llëngës - Kanioni është formuar nga Lumi Shkumbin, në gëlqerorët nga veprimtaria karstike dhe erozive e Përroit të Llëngës, degë e Shkumbinit. Kanioni është rreth 1000m i gjatë, 15-20m i gjerë, 300m i thellë dhe ka shpate të thepisura, ka drejtim juglindje, veriperëndim dhe përbën një ekosistem interesant karstik. Ai përbën një formë të bukur e të rrallë të relievit dhe në distancë duket sikur ngushtësia e grykës kërkon të bashkojë bukurinë mahnitëse të dy shpateve të lumit. Ai vizitohet nëpërmjet itinerarit: rruga automobilistike Pogradec-Vërdovë-Varrezat e Grekut-Qafë Panjë-Shën Marenë me infrastrukturë jo të përshtatshme.

Foto – 17 *Pamje nga Kanioni i Llëngës (Foto A. Fezollari)*

13. Shpella e Najazmës (Tushemisht), - Shpella e Najazmës ndodhet në afërsi të fshatit Tushemisht, 700m mbi nivelin e detit, pranë pikës kufitare të kalimit në Maqedoni.

Foto – 18 *Pamje nga Shpella e Najazmës (Tushemisht)*

Ajo është shpellë karstike, e formuar në gëlqerorët e Triasit të sipërm-Jurës së poshtme, e gjatë deri ne 12m, e gjerë deri në 2m dhe e lartë deri në 3m. Në të, ndodhet një koloni lakuriqësh nate. Prej saj, del me zhurmë një burim karstik uji. Legjenda e lidh edhe me fenë. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit gjeomorfologjik dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, historike, fetare dhe gjeoturistike. Ai është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676. dt. 20. 12. 2002.

14. Bashkimi i Lumit Shkumbin me atë të Dushës. Ky gjeomonument ndodhet përballë fshatit Zëmçë që i përket ish komunës së Proptishtit, në kuotën 1180m mbi nivelin e detit. Në rrjedhjen e ujit pranë Urës së Slabinjës, brigjet ngushtohen shumë dhe në mënyrë të menjëhershme. Terreni i kodrave me rënie graduale dhe gjelbërimi i stinës së verës, janë elementë të një kontrasti që nuk i shpëton syrit të njeriut.

15. Liqenet e Lukovës - Liqenet e Lukovës gjenden në shpatin lindor të Malit të Gurit të Topit, në afërsi të fshatit Bishnicë të ish Komunës Velçan të Bashkisë së Pogradecit, rreth 80km nga qyteti i Pogradecit, në lartësitë 1700m dhe 2027m mbi nivelin e detit. Janë dy liqene akullnajorë (Liqeni i Vogël dhe Liqeni i Madh). Liqeni i Madh ndodhet në kuotën 1851m mbi nivelin e detit me një sipërfaqe 0.05km2, ndërsa Liqeni i Vogël ndodhet në kuotën 1706m me sipërfaqe 0.035km2 me sipërfaqe 0,035km2.

16. Mali i Niçës (V.-a-10), - Ky mal ndodhet në afërsi të Trebinjës, Pogradec. Aty dallohen shumë forma e mbetje erozionale me veçori e bukuri nartyrore të rralla. Ky përbën një gjeomonument me rëndësi lokale, të grupit tektono-strukturor dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, didaktike dhe gjeoturistike.

Foto – 19 *Pamje nga Liqenet e Lukovës Pogradec*

17. Mali (Guri) i Bletës - Mali i Bletës ndodhet në krahinën e Gorë-Mokrës, në kurrizin malor Guri i Kamjes-Mali i Kozelit-Mali i Bletës. Ai ka lartësi 1409m dhe formon një piramidë erozionale madhështore, me formë të rregullt dhe duket si ishull i veçuar i ndërtuar nga formacionet mollasike, e sidomos nga konglomeratet e Akuitanianit. Shumë pak në perëndim të këtij Guri, në kuotën rreth 1350m, ndodhet edhe një shpellë. Ky Gur përbën një gjeomonument me rëndësi lokale dhe ka vlera shkencore, gjeologjike, didaktike dhe gjeoturistike.

18. Miniera e qymyrgurit Alarup - Kjo minierë ndodhet në lindje të Pogradecit, pranë fshatit Alarup, ku dalin shtresat e qymyrgurit me gjurmë të trungjeve të ngurtësuar si dhe të gjetheve. Këto dëshmojnë për bimësinë e kontinentit në kohën e formimit të qymyreve gjatë Miocenit.

Fig. – 64 *Harta tregon kufijtë administrativë (zona e mbrojtur, kufiri i komunave, shteti, etj.), rrjetin rrugor, rrjetin hidrologjik, si dhe vendndodhjen e monumenteve natyrore.*

Në jug të liqenit gjendet rruga e asfaltuar që lidh qytetin e Pogradecit me kufirin maqedonas. Rrjeti rrugor kompletohet nga rrugë pyjore, sidomos në pjesën perëndimore të zonës.

PËRCAKTIMI I ZONAVE TË MENAXHIMIT

Propozimi për Zonimin e Zonës së Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 18.2.1999 që e shpall territorin tokësor dhe ujor të Pogradecit "Zonë të Mbrojtur" nuk e ndan zonën e mbrojtur në nënzona. Plani aktual përfshin një propozim për zonimin ose ndarjen në zona të Peizazhit të Mbrojtur të liqenit të Pogradecit. Zonimi përcakton se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të ndodhë në nënzona të ndryshme, brenda zonës së mbrojtur në terma të menaxhimit të burimeve natyrore, menaxhimit të burimeve kulturore, mundësisë për hyrjen e turistëve, lehtësirave dhe zhvillimit të zonës së mbrojtur, mirëmbajtjes dhe veprimeve.

Zona Qendrore

Liqeni shërben si shtëpi për një numër llojesh endemik peshqish. Aktivitetet e peshkimit janë shumë intensive dhe ka një nevojë urgjente për vende, në të cilat peshqit mund të shtrojnë vezët e të shumohen. Si zona qendrore propozohen dy nënzona të liqenit për shkak të rëndësisë së tyre si zona shumimi për peshqit, kryesisht për koranin dhe krapin.

- e para gjendet në bregun e liqenit, pjesa veriore e Peisazhit të Mbrojtur, afër Linit;
- zona e dytë e propozuar ndodhet në bregun e liqenit, juglindje të Liqenit të Pogradecit, ana shqiptare, afër Tushemishtit.

Në këto zona, peshkimi është plotësisht i ndaluar, po ashtu edhe gjuetia dhe aktivitete të tjera që mund të dëmtojnë biodiversitetin e zonës. Është propozuar edhe një zonë kryesore tokësore në pjesën më të lartë të Malit të Thatë, mbi 1450m lartësi. Kjo zonë karakterizohet nga male të larta me bimësi malore dhe alpine. Sipas një studimi botanik në Parkun Kombëtar të Prespës, kjo zonë ka rëndësi të veçantë për llojet endemike si dhe për nivelin e lartë të biodiversitetit. Kjo zonë kryesore krijon edhe një bio-korridor midis tre zonave të mbrojtura: Parkut Kombëtar të Galicicës, Parkut Kombëtar të Prespës dhe Peisazhit të Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit. Tokat barishtore të Zonës Kryesore të propozuar mbulojnë pjesën më të madhe të rripit malor subalpin. Për shekuj të tërë kjo zonë është përdorur si kullotë për emigrimin sezonal vertikal, d.m.th delet dhe bagëtitë çoheshin në mal gjatë verës dhe mbaheshin në lugina gjatë dimrit. Bari i thatë prodhohej/grumbullohej në male (kryesisht në gropa apo të ashtuquajturat gryka). Pjesa veriore e Malit të Thatë, në drejtim të Kufirit Shtetëror me Maqedoninë (në jug të Malit Magaro) është në mbrojtje të rreptë (zona 1, zonë qëndrore) dhe pjesa lindore e Parkut Kombëtar të Prespës, që është propozuar së fundmi si zonë qëndrore.

Kodi i habitatit	***Prioriteti***	***Klasifikimi sipas Direktivës së BE-së për Habitatet***
4060		Shqopishte alpine dhe të Borealit
4090		Shqopishte endemike të rajoneve malore të Mesdheut me Ulex europaeus
6170		Kullota alpine dhe subalpine në vende shkëmbore gëlqeore
6180		Kullota mezofile Makaroneziane
6210		Kullota të thata gjysëmnatyrore dhe facies shkurrore mbi substrate gëlqerore (Festuco-Brometalia) (* site të rëndësishme për Orkidetë)
6220		Pseudo- stepë me lloje barishtore dhe njëvjeçare të klasës Thero-Brachypodietea Br.-Bl. 1947

Tab. – 22 *Llojet e habitateve që gjenden në pjesën shqiptare të Parkut Kombëtar të Prespës dhe Zonës së Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit me fokus tek kullotat*

Tabela tregon habitatet kullosore të mbrojtura nga Direktiva e BE-së për Habitatet (Direktiva 92/43/EEC, Versioni 2007).

Zonat qendrore të propozuara janë sipërfaqe me përparësi, të cilat lejojnë zhvillimin e proceseve ekologjike të pacënuara dhe iu ofrojnë strehë llojeve të rrezikuara, të rralla dhe endemike. Pritshmëritë,

si pasojë e vendosjes së zonës qëndrore, janë që llojet indikatore të tregojnë një përmasë të qëndrueshme apo në rritje të popullatave.

Zonat e propozuara përfshijnë edhe hapësirat pyjore. Këto janë pyje dhe zona barishtore të shkatërruara, por duke qenë se në këto zona nuk do të ketë ndërhyrje të mëtejshme nga ana e njeriut, pritet gjerësisht që të ndodhin ndryshime. Kjo mund t'i mundësojë Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit që të zgjerojë zonën e tij qëndrore të vlefshme edhe nëpërmjet pyjeve të braktisura ose të mbi përdorur, toka barishtore e madje edhe hapësira bujqësore. Hapësira e zonës qendrore në pyll duhet të ruhet mirë dhe në të nuk duhet të lejohen as gjuetia dhe as kullotja e bagëtive. Kjo nënkupton bllokimin e rrugëve hyrëse që çojnë në zonën qendrore. Objektivi për menaxhimin e zonës qendrore është sigurimi i një hapësire natyrore të mjaftueshme për të lejuar proceset natyrore të suksesionit të lirë ekologjik pa shqetësime nga veprimet humane.

Në zonën qendrore është rreptësisht i kufizuar për çdo lloj aktiviteti i njeriut, duke përfshirë gjithashtu edhe mbledhjen e luleshtrydheve, kërpudhave apo bimëve mjekësore. Kërkimet në këto zona do të mund të bëhen vetëm me leje të veçanta nga administrata e Zonave të Mbrojtura.

Emri i Zonës	***Kërcënimet kryesore/presionet***	***Objektivat e ruajtjes***	***Masat***
Zona Qëndrore Mali i Thatë nga lartësia 1450 m	• Mbi kullotja • Nën kullotja • Mbledhja e bimëve mjekësore	• Mbrojtje strikte • Ndalimi i ndikimit negativ nga ana e njeriut	• Parandalimi/ndalimi i kullotjes dhe prerjes së paligjshme • Bllokimi i rrugëve hyrëse • Ndalimi i gjuetisë së paligjshme • Kontrolli i mbledhjes së bimëve mjekësore
Zona Qëndrore e Liqenit të Pogradecit Hapësirat për shumëzim të peshqve pranë bregut të liqenit	• Peshkimi i paligjshëm • Dëmtimi i hapësirave për vendosjen e vezëve të llojeve të peshqve	• Terrenet delikate të vendosjes së vezëve të peshkut	• Ndalimi i të gjitha aktiviteteve industriale, si edhe të peshkimit e gjuetisë

Tab. – 23 *Karakteristika të zonës qendrore të Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit*

Zona e Përdorimit të Qëndrueshëm

Zona e përdorimit të qëndrueshëm në Peisazhin e Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit përbëhet kryesisht nga hapësirat pyjore me një nivel të lartë të degradimit dhe impakt të rëndë të kullotjes së bagëtive dhe prerjen e pemëve për dru zjarri. Qëllimi është zhvillimi i këtyre zonave në përmbajtje të qëndrueshme për të ardhmen. Liqeni i Pogradecit përfshihet gjithashtu në zonën e përdorimit të qëndrueshëm edhe pse qëndrueshmëria e aktiviteteve të peshkimit mund të vihet në pikëpyetje. Liqeni ka një cilësi uji relativisht të mirë dhe aktivitetet kryesore që zhvillohen këtu janë peshkimi dhe pak gjueti e shpendëve të ujit. Përfshirja në zonën e përdorimit të qëndrueshëm përfaqëson një qëllim administrimi më shumë sesa gjendja aktuale. Zonat malore të Malit të Thatë karakterizohen nga malet e larta me bimësi malore dhe alpine. Toka përdoret kryesisht për rritje

bagëtish, mbledhjen e druve të zjarrit, bimëve mjekësore dhe aromatike. Zona e përdorimit të qëndrueshëm të Peisazhit të Mbrojtur është përcaktuar me qëllim që të lejojë vetëm banorët vendas që të përdorin burimet natyrore. Kjo zonë zë pjesën kryesore të të gjithë sipërfaqes së zonës së mbrojtur mbuluar nga pyjet dhe kullota. Megjithatë, të gjitha aktivitetet njerëzore që zhvillohen në veçanti në këtë zonë duhet të parashikojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e gjithë ekosistemit, duke u dhënë mundësi edhe brezave të ardhshëm që të përfitojnë nga ekosistemet aktuale. Në këto zona lejohen këto aktivitete njerëzore si:

- Prerja e druve për zjarr në pyjet e caktuara të komunës sipas planit të menaxhimit të pyjeve dhe sistemit të licencimit të komunitetit;
- Menaxhimi i pyjeve të gështenjave për lëndë drusore dhe prodhim arrorësh;
- Kullotja e bagëtive në kullotat dhe livadhet e caktuara për këtë qëllim;
- Peshkimi vetëm nga peshkatarët e licencuar duke respektuar plotësisht kufizimet e parashikuara me ligj;
- Gjuetia vetëm nga gjuetarët e licencuar duke respektuar plotësisht kufizimet e parashikuara me ligj;
- Mbajtja e bletëve;
- Banjo dielli dhe not në zonat e caktuara të liqenit;
- Ngjitja në male, çiklizmi vetëm në shtigjet e caktuara për këtë qëllim.

Fig. – 65 *Harta e Peisazhit te Mbrojtur Tokesor / Ujor te Pogradecit*

Zona e Përdorimit Tradicional

Zona e përdorimit tradicional përbëhet kryesisht nga toka bujqësore, pemishtet dhe vreshtat. Pjesa më e madhe e bujqësisë në zonat rreth fshatrave përdoret për konsum vetjak dhe për tregti në tregjet lokale të Pogradecit dhe përgjatë rrugëve. Prodhimi i fruta-perimeve është thelbësor për ekonominë lokale dhe i nevojshëm për vazhdimësinë e jetës. Uji është shumë i rëndësishëm për prodhimin bujqësor. Uji i pastër nga malet përdoret për ujitje në të gjitha aktivitetet bujqësore që zhvillohen në rajon. Zona e përdorimit tradicional përfshin tokat e punueshme që përdoren nga pronarët privatë. Menaxhimi i zonës së mbrojtur brenda kësaj zone do të orientohet drejt zbatimit të praktikave të mira të menaxhimit për ruajtjen e dheut dhe të ujit. Përdorimi i tepruar i plehrave dhe pesticideve duhet të shmanget, ashtu siç duhet të shmangen edhe ndërtimet abuzive. Në fakt, këto zona janë të kufizuara sa i përket urbanizimit dhe ndërtimeve madhore të infrastrukturës. Zona e përdorimit tradicional përfshin gjithashtu një pjesë të tokës ekonomike.

Zona Rekreacionale

Zona rekreacionale e Peizazhit të Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit lidhet kryesisht me aktivitetet turistike që zhvillohen përgjatë liqenit. Hotelet dhe restorantet ndodhen zakonisht në rrethinat e Pogradecit dhe në brigjet jugore dhe perëndimore të liqenit. Turistët shijojnë klimën e përshtatshme dhe peshkun në restorante. Për të gjitha komunat brenda zonës së mbrojtur, turizmi përbën një burim të rëndësishëm të ardhurash dhe ka mundësi që kjo zonë rekreacionale të zgjerohet në vitet e ardhshme. Objektivi kryesor i menaxhimit për këtë zonë është reduktimi i mbetjeve të ngurta që gjenerohen nga mbi popullimi në plazh gjatë verës, përmes zhvillimit të një infrastrukture për turizmin miqësore me mjedisin. Ndërkohë,

*ekziston një nevojë urgjente për përgatitjen e një plani të zhvillimit urban për brigjet e liqenit me synim minimizimin e ndotjes së ujit të liqenit nga shkarkime të patrajtuara të ujërave të zeza p*ër shumë raste veç e veç, *por të mbledhura bëjnë ndikim akumulativ.*

Planet e Menaxhimit për Peisazhin e Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit

Për secilin prej objektivave afatgjatë dhe objektivave afatshkurtër që u korrespondojnë, parashikohen një sërë veprimesh që duhen zbatuar për të siguruar përmbushjen e objektivave. Në këtë kapitull, çdo veprim i identifikuar për arritjen e objektivave paraqitet në formën e tabelave.

Për secilin prej veprimeve, identifikohen këto elemente:

- Autoriteti/et përgjegjës/e për zbatimin;
- Periudha dhe kohëzgjatja e pritshme;
- Tregues objektiv të verifikueshëm;
- Forcimi i sistemit të menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Me ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme, presim të arrijmë

- Mbikqyrjen dhe menaxhimin e Zonës Së Mbrojtur Të Peisazhit të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit-së në mënyrë profesionale dhe efektive nga DSHP-ja në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Menaxhimit;
- Nivel të lartë i performancës menaxhuese nga personeli i trajnuar i administratës lokale;
- Përfshirjen e të gjithë aktorëve lokalë në një proces të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës për të kontribuuar në menaxhimin e burimeve të peisazhit të mbrojtur dhe në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimin e aktiviteteve njerëzore;
- Marrjen parasysh të bashkëpunimit ndërkufitar në planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zonës së mbrojtur.

Monumentet kulturore, historike dhe natyrore të peisazhit të mbrojtur

Në zonën e mbrojtur ndodhen 7 Monumente Natyrore (Kategoria III e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri) si më poshtë (numri i tyre korrespondon me vendndodhjen e tyre në Hartën 1 më sipër):

Monumentet Bio

- Qiparisat e Kishës së Shën Mërisë ;
- Sallkeni i Tushemishtit ;
- Shpella e Najazmës;
- Fragmenti i shkëputjes tektonike të Ohrit.

Monumentet Gjeografikë

- Shpella e Memlishtit

Monumentet Hidrike

1- Burimi i Drilonit (5).

Në zonë ndodhen edhe disa ndërtesa të rëndësishme historike kulturore, ku përfshihet:

- Rrënojat e Kishës Paleokristiane në Lin. Gjatë gërmimeve janë gjetur mozaikë nga shekujt IV dhe V. (Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë.);
- Rrënojat e Kishës Bizantine në Lin. Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë;
- Kalaja e Pogradecit.

PËRFUNDIME

Në Bashkinë e Pogradecit, ka interesim dhe vëmendje për:

- identifikimin e gjeomonumenteve të tjerë të karakterit lokal, të cilët nuk janë kapur ende nga ana e jonë;
- mbikqyrjen dhe menaxhimin e Zonës Së Mbrojtur Të Peisazhit të Teritorit Tokësor/Ujor të Pogradecit-së në mënyrë profesionale dhe efektive;
- përfshirjen e të gjithë aktorëve lokalë në një proces të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës për të kontribuuar në menaxhimin e burimeve të peisazhit të mbrojtur dhe në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimin e aktiviteteve njerëzore;
- marrjen parasysh të bashkëpunimit ndërkufitar në planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zonës së mbrojtur;
- rivitalizmin e potencialeve natyrore;
- në përgjithësi, infrastruktura për të vizituar gjeomonumentet është jo e përshtatshme, duke minimizuar mundësitë për vëzhgimin e tyre nga vizitorë vendas apo të huaj;
- rruga do rriste mundësinë që brezat që do vijnë të njihem me gjeologjinë dhe gjurmët e saj në terren duke njohur trashëgiminë gjeologjike si pjesë e trashëgimisë së një vendi.

Gjithsesi, do donim të sugjeronim që:

- Të bëhet kujdes nga ana e Bashkisë për ruajtjen dhe reklamimin e këtyre objekteve të një rendësie të madhe e të papërsëritshme nga ana turistike, shkencore, didaktike, etj;
- Këto gjeomonumente të identifikuara duhen të bëhen pjesë e planeve urbanisitike zhvillimore të bashkisë Pogradec;

- Në zonën e Liqenjve të Lukovës, mund të ndërtohet një kamping veror dhe dimëror i administruar nga ish komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Turizmit;
- Në ruajtje të nivelit të liqenit të madh të Lukovës, njësia administrative që e ka brenda territorit duhet të ndërhyjë urgjentisht për mbylljen e kanalit që shkarkon ujrat e liqenit, duke rrezikuar tharjen e tij;
- Agjensia Rajonale e Pyjeve duhet të hartojë plane për pyllëzimin në zonën e kodrave (kurorën) për rreth Liqenit të Pogradecit;
- Pushteti vendor duhet të përdorë gjithë kompetencat e mundësitë për të ruajtur vlerat e shumta të gadishullit të Linit;
- Paisja dhe vendosja e tabelave me informacion përgjithësues dhe gjeologjik pranë gjeomonumenteve është një nga rekomandimet që grupi e propozon me insistim;
- Për këtë Bashki propozohen gjashtë itinerare turistike, të cilat duhen të kihen parasysh nga institucionet bashkiake per promovimin dhe nxitjen e gjeoturizmit.

VIZIONI, KËRKESAT E KOHËS DHE REKOMANDIME

1- Administrimi i gjeomonumenteve të integrohet në politikat, planet, programet që ndërmerren në nivel Bashkie.
2- Sensibilizimi i komuniteti vendas, i cili jeton në afërsi të gjeomonumenteve për rëndësinë e ruajtjes së tyre.
3- Vendosja e tabelave për gjeomonumentet kombëtare dhe lokale në vendndodhjen e tyre me shpjegime përkatëse të shoqëruara me harta, shpjegim gjeologjik të formimit të tij dhe foto të ndryshme.
4- Organizimi i ekspeditave me nxënës të shkollave të ciklit parauniversitar për njohjen e fenomeneve gjeologjike, si dhe dukurive që kanë lënë gjurmë në kufijtë administrativë të bashkisë së Pogradecit.
5- Duhet të kemi ndërthurje të turizmit modern me atë tradicional.
6- Monumentet kulturore duhet të kene zone tampon.
7- Nga evidentimet rezulton se bashkia Pogradec ka një pozicion gjeografik tepër të favorshëm duke pasur parasysh shtrirjen pranë korridoreve kombëtare lidhëse, si dhe pozicionim pranë pasurive natyrore të shumta.
8- Zhvillimi i territorit të bashkisë Pogradec është ndjekur kryesisht nga një mënyrë spontane zhvillimi dhe e pabazuar në dokumente planifikimi. Por ekzistojnë strategji, direktiva dhe plane menaxhimi të shumta lidhur me peisazhin natyror të mbrojtur të Liqenit të Ohrit.
9- Zona e peisazhit të mbrojtur të Pogradedcit përfshin në të një larmishmëri të madhe të habitateve ujore, florës, faunës dhe sipërfaqeve ujore.
10- Ekzistojnë potenciale natyrore të pashfrytëzuar, siç janë liqenet e Lukovës, të cilat po rrezikohen ndjeshëm nga veprimtaritë njerëzore shkatërruese (ndërtimi, përdorimi për vaditje, etj.)
11- Pavarësisht planeve të menaxhimit dhe direktivave për mbrojtjen e peisazhit të mbrojtur të Liqenit të Pogradecit, kjo zonë rrezikohet seriozisht nga mbetjet industriale, derdhjet e ujrave të zeza dhe aktivitete të tjera njerëzore.

12- Një filozofi që e shoqëron përjetësisht Planin e Përgjithshëm Urban duhet të jetë ajo e mosprekjes së zonës pranë bregore liqenore, që d.t.th asnjë vepër apo objekt në anën ose në zonën midis rrugës dhe bregut të liqenit. Kjo duhet të jetë një koncept i panegociueshëm, ku rruga do të jetë si një 'filldispanjë' që ndan zonën prourbane me atë proliqenore.

13- Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati për të ruajtur traditen dhe uniformalitetin.

14- Në zonën e mbrojtur të Kat.-V, nuk duhet të ketë:

- zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën qendrore ;
- zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën e përdorimit të qendrueshëm, në zonën e përdorimit tradicional dhe në zonën e rekreacionit, në rastet kur ato zenë vend në pamjen estetike të Liqenit, ose kur bien me pamje nga liqeni ose kur bien brenda zonës ujëmbledhëse, ose kur bien në zona gjeologjike karstike, pavarsisht se ato lejohen mbasi pajisen me Leje Mjedisore.

16. Aktivitetet industrriale do të lejohen mbasi të pajisen me Leje mjedisi, vetëm në rastet kur ato zënë vend jashtë zonës së mbrojtur të kësaj kategorie (peisazh i mbrojtur), në rastet kur ndodhen jashtë kufijve të zonës buferike për gjeomonumentet e natyrës dhe të kulturës, dhe në rastet kur ndodhen prapa kodrave brenda zonës së mbrojtur, por jo në zona karstike.

17. Në vijen e futjes së zonës tokësore me status unesco është futur lini, driloni, por e vështirson situatën rezervatet me peshkun në drilon dhe dampat minerare të gurit të kuq.



Fig. – 65/1 *Harta e propozimit për korridoret ekologjikë kulturor, urban e turistik, lokal e nderrajonal.*

4.8 INFRASTRUKTURA MJEDISORE

4.8.1 Menaxhimi i ujrave të përdorur

Direktiva mbi trajtimin e mbetjeve urbane (Directive 91/271/EOK) është një nga mjetet më të rëndësishme të politikave për menaxhimin e ujërave në Evropë. Qëllimi është për tëmbrojtur mjedisin nga efektet negative të ujërave të ndotura urbane nga zonat e banimit (qytetet / fshatra) dhe ujërave të zeza industriale të biodegradueshme nga industria ushqimore. Direktiva kërkon mbledhjen e duhur të ujërave të zeza dhe rregullon shkarkimet duke specifikuar minimumin e llojit të trajtimit të parashikuar dhe vendos vlerat maksimale apo ndotësit kryesorë (ngarkesës organike dhe ushqyesve). Zbatimi i plotë i Direktivës është parakusht për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Kornizën e Direktivës së BE-së (DKM - 2000/60 / EC) dhe Direktivën mbi Strategjinë Liqenore (Direktiva 2008/56 / EC).

Kanalizimet e ujrave të zeza dhe ujrave të shiut

Bashkia e Pogradecit për trajtimin e ujërave të zeza, është mbështetur me projekte nga Qeveria Gjermane. Ujërat e zeza të këtij Qyteti janë të sistemuara dhe e kanë Impiantin përkatës të përpunimit të tyre. Ato mblidhen në kolektor që në hyrje të qytetit, pranë buzës së Liqenit deri në afërsi të lagjes 1 Maji (stacionit të pompimit). Rreth 3km larg ndodhet impianti i përpunimit, në Guras-Zagraçan, i cili përfundon pranë fshatit Vërdovë dhe linja tjetër është ajo Tushemisht-Drilon, e cila lidhet me impiantin në Guras. Megjithatë vlen të përmëndet se territoret e ish-komunave nuk i kanë të sistemuara kanalizimet e ujrave të zeza dhe nuk janë pjesë e sistemit të Impiantit të Pastrimit. Këtu bëjnë pjesë territoret e ish-komunave të zonës së Mokrës, por edhe njësia administrative e Hudënishtit, e cila ka dalje të drejtpërdrejtë në liqenin e Ohrit.



Fig. – 66 *Zonat ku janë projektuar impiantet e trajtimit të trajtimit të ujërave të zeza dhe janë në funksionim ose pranë fazës së funksionimit.*

Trajtimi i ujrave të përdorura me lagunazhe natyrore

Duke qenë se rajoni në fjalë sidomos zonat suburbane, kryesisht ndërtimet dhe banesat vendosen në zona të ngritura mund të sigurohet trajtimi i ujrave të përdorura me anë të lagunazhit natyror. Për aq kohë sa ato nuk sistemohen në një magjistral pranë. Fatmirësisht, të gjitha banesat rrafin drejt një zone të ulët fushore, ku gjendet një copëz tokë moçalore ose tokë djerr pranë një lumi ose përroi, ku me pak kujdes për secilin fshat mund të zgjedhesh një siperfaqe për të ngritur një teknologji të thjeshtë, të trajtimit të ujrave të përdorura.



Fig. – 66/1 Profil tërthor i një lagunazhi natyror për trajtimin e ujrave të përdorura.

Ky ujë vjen në mënyre gravitative, pa kosto energjie në drejtim të këtij sheshi, ku një basen i gatitur sipas një profili vertikal me argjila e zhavore, e më pas me kallamishte filtruese arrihet të pastrohen ujërat e ngarkuara (të zeza ose të përdorura), me lëndë nitrite, fosfate, duke u kthyer deri në ujra të kategorisë së tretë, të cilat lehtësisht mund të derdhen në përrenj

ose liqene ose mund të përdoren për qëllime të tjera. Në rasitin e banesave që bien jashtë skemës gravitative të përgjithshme të fshatit rekomandohen ndërtime të gropave septike ekologjike, të cilat parashikohen me dhomëza të përbëra dhe të ndërtuara me mure hermetikisht të izoluara, ku uji i ingarkuar me nitirite dhe fosfate mund të transformohet në ujë të pranueshëm për tu derdhur në ujërat sipërfaqësorë, por rast pas rasti ka një skemë specifike enkas për të.



Fig. – 66/2 Pamje nga sipër e një lagunazhi natyror për trajtimin e ujrave të përdorura.

Fig. – 66/3 Pamje nga sipër e një lagunazhi natyror për trajtimin e ujrave të përdorura.

4.8.2 Menaxhimi i mbetjeve te ngurta

Shkurt mbi strategjinë e mbetjeve urbane

Studimi mbi mbetjet, nga njëra anë informon shoqërinë civile dhe publikun, nga ana tjetër jep gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, përsa i përket grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe groposjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë. Secila Bashki duhet të zhvillojë strategjinë e vet të depozitimit të mbetjeve, ku rindarja në shesh grumbullimi dhe më pas vendgroposja, pa dyshim luajnë rolin më të rëndësishëm. Strategjia duhet të mbështetet mbi:

- Vlerësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbanë në shesh grumbullim;
- Pastrimin dhe disifektimin e vendeve përreth kontenierëve;
- Larjen dhe disifektimin e kontenierëve;
- Mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane gjatë ditës; dhe
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme.

Rryma e Mbetjeve	% Mesatare në Hedhjen e Mbetjeve Bashkiake	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/ditë (0.7kg/person/dite)	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/vit (256kg/person/vit)
		2,228,7 Dite	812,360 Tone
Organike	49.36	1,106	403,690
Dru	1.43	33	12,045
Letre	5.37	125	45,625
Kartoni	6.13	190	69,350
Total te Biodegradueshme	62.3	1,454	530,710
Plastike me densitet te ulet	8.46	198	72,270
Plastike me densitet te larte	4.75	111	40,515
Qelq	5.75	134	48,910
Tekstile	5.27	123	44,895
Metale - Ferroze	0.56	13	4,745
Metale - Me Ngjyra	0.57	13	4,745
Mbetjet Spirulore	0.17	4	1,460
Produkte Gome	0.2	5	1,825
Mbetje Inerte	7.2	168	61,320
Mbetje nga produkte sanitare	3.25	76	27,740
WEEE	0.31	7	2,555
Bateritë	0.02	1	365
Prodhime të Mbetjeve nga Rafshet	1.08	25	9,125

Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit

Tab. – 24 *Shkarkimet e mbetjeve*

Më tej, duhet të fokusohet në vlerësimin e zgjedhjes së metodave dhe teknologjive për trajtimin e integruar të mbetjeve urbane apo të ndikimeve pozitive dhe negative në mjedis dhe shëndetin njerëzor. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë sesi janë zbatuar masat zbutëse në rastin e ndikimeve negative dhe të masave të kontrollit dhe montorimit, si nga kompania dhe autoriteti mjedisor.

Menaxhimi i mbetjeve në vend

Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel te ulët në vendin tonë. Me sistem për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Sasia e mbetjeve që riciklohet është 10%. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vend grumbullimet e mbetjeve. Përveç landfill-eve të Sharrës dhe Bushatit dy venddepozitime të tjera të mëdha po planifikohen të bëhen brenda një afati te shkurtër (2013): një në Korçë/ Maliq (mbështetur nga KFW) dhe një tjetër në Sarandë/Bajkaj (mbështetur nga Banka Botërore).

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme si në rang Vendi dhe Bashkie

Nuk ka një sistem të sigurtë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është shumë i dobët

dhe pjesa më e madhe e grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme kryhet nga sektori privat duke i mbledhur ato së bashku me ato familiare apo bashkiake.

Menaxhimi i mbetjeve bashkiake me anë të landfill-eve në nivel kombëtar

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës menaxhon një program të rëndësishëm investimesh që kontribuon në zhvillimin e infrastrukturës, duke përfshirë dhe infrastrukturën e sektorit të mbetjeve. Bazuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025 është parashikuar që menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve të bëhet në nivel rajonal për 12 qarqet ekzistuese. Objektivi kryesor është mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, dhe ndërtimi I venddepozitimeve rajonale sipas standarteve të BE. Aktualisht janë të ndërtuara disa landfille në përputhje me standartet europiane.

Mbetjet inerte dhe vend depozitat e tyre

Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjve, afër atyre urbane, (shpesh të përziera me to), ku edhe sot këto mbetje inerte (ndoshta edhe të reja), gjenden anës së rrugëve dhe në shpatet e përrenjve dhe lumenjve. Mbetjet e inerteve, nën ndikimin e agjentëve atmosferik, erërave dhe reshjeve, sjellin ndotje të ajrit, të ujërave dhe të ambientit përreth, duke dëmtuar botën akuatike.

Të dhëna për mbetjet spitalore

Gjatë muajit shkurt 2014 AKM ka hartuar një relacion mbështetur në të dhënat e marra mbi mbetjet spitalore gjatë kontrolleve të vazhduara tek Spitalet, Klinikat dhe qendrat Shëndetësore. Nga inspektimi i AKM-së, spitali rajonal i Pogradecit në bashkinë Pogradec është edhe gjeneruesi më i madh i kësaj rryme. Po ashtu spitali së bashku me disa njësi të tjera farmaceutike, laboratorë apo klinika dentare kanë nënshkruar një kontratë me kompaninë MEDI-TEL Sh.p.k në Tiranë për trajtimin e mbetjeve spitalore.

"Varrezat" e Automjeteve

Vatra ndotjeje janë edhe 'varrezat' e automjeteve që gjenden të shpërndara dhe prodhojnë ndotje të përditëshme si në ujrat dhe në tokat përreth. Ato përmbajnë sasi të konsiderueshmem substancash me shkallë të lartë ndotjeje, përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Konkretisht një varrezë makinash është pranë fshatit Mëmëlisht; tre të tilla janë pranë fshatit Hudënisht; një është në afërsi të fshatit Plloçë, rrugës për në Qytetin e Korçës.

Industria e riciklimit

Në shumicën e rasteve, industria e riciklimit varet nga lëndët e para të riciklueshme që importohen në Shqipëri. Egziston një politikë dominuese dhe e përhapur, e gjoja sistemimit të mbetjeve në një gropë që zakonisht është e pa studiuar dhe jo e legjitimuar. Instrumentet ekonomike për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme. Pothuajse nuk ekzistojnë kompani riciklimi në Bashkinë e Pogradecit, por që një pjesë shumë e vogël e mbetjeve arrin të mblidhet nga kontribuesit romë si ekologjistët e parë të qytetit dhe të vendit.

Problemet e administrimit të mbetjeve

- Problemet e administrimit të mbetjeve janë të shumta dhe të ndryshme si p.sh.:
- Zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve;
- Pjesa me e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve, të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore;
- Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe aktualisht në vendin tonë nuk kompostohen këto mbetje me qëllim që të reduktohet sasia e tyre në venddepozitime;
- Pjesa më e madhe e mbetjeve të krijuara (në peshë) janë të prirura të jenë substanca inerte, në veçanti mbetjet e ndërtimeve, por rreziqet më të mëdha janë të lidhura me vëllime të vogla (kryesisht industriale) të mbetjeve të rrezikshme;
- Mbetjet komunale kanë nevojë për një grumbullim të kushtueshëm dhe të zgjeruar, transportim dhe rregullim;
- Kondita të veçanta duhet t'u aplikohen kategorive të ndryshme, si p.sh. mbetjet nga shëndetësia.

Sektori i mbetjeve paraqet një nga sfidat më të rëndësishme që ndesh Shqipëria.

***Paradokset e menaxhimit të mbetjeve* në Bashkinë e Pogradecit**

- Grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë;
- Nuk kryhet asnjë lloj përpunimi;
- Vendosen në depozitime të shkrifta, toka buke;
- Hidhen pranë sistemeve ujore (lumenj, perrenj);
- Digjen jo rrallë në gjendje të lirë;
- Jashtë kushteve të kontrollit mjedisor;
- Përzihen me mbetje spitalore, farmaceutike, dhe industriale apo të rrezikshme, si edhe ato elektronike.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë e Pogradecit

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane sipas legjislacionit në fuqi është i decentralizuar, që do të thotë se kryhet në nivel njësie administrative. Aktualisht në Bashkinë e Pogradecit, mund të vërehet një dallim i theksuar në sistemin e menaxhimit të mbetjeve nga qyteti te fshatrat. Në qytet, grumbullimi i mbetjeve bëhet nëpër kontejnerë grumbullues, të cilët pastrohen rregullisht. Problemi kryesor në Pogradec është mungesa e kompanive të kualifikuara për grumbullimin edhe riciklimin e mbeturinave prej kartoni e plastike, dhe transportimi i tyre drejt pikave të riciklimit në qytete të tjera është i pamundur për shkak të kostos të lartë. Mbetjet trajtohen nga subjekte private, të cilat nga pikat e grumbullimit i transportojnë në venddepozitimin e përcaktuar. Venddepozitimi ku trajtohen mbetjet ndodhet në vendin e quajtur Përroi i Shtogut, në territorin e Njësisë administrative Buçimas, në distancë

13km nga qyteti i Pogradecit. Ky venddepozitim ka shërbyer dhe shërben si i tillë deri në ndërtimin dhe vënien në përdorim të landfillit rajonal të Maliq-it. Në këtë venddepozitim të përbashkët depozitohen mbeturinat shtëpiake e inerte të qytetit Pogradec, Njësisë Administrative Buçimas dhe Njësisë Administrative Hudënisht. Këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim, dhe megjithëse janë të përqëndruara, sjellin ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale. Venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushteve teknike të përcaktuara nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike, dhe rjedhja e ujërave nga venddepozita krijon ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore. Sasia e mbetjeve shtëpiake gjatë vitit 2015 për Bashkinë Pogradec ka qënë si më poshtë:

- Qyteti i Pogradecit 10.990 ton / vit (gjenerimi i mbetjeve 1kg/person në ditë);
- Nj. A. Çërravë 2592 ton /vit (gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë);
- Nj. A. Hudënisht 1900 ton /vit (gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë);
- Nj. A. Buçimas 3600 ton /vit (gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë);
- Nj. A. Dardhas 288 ton /vit (gjenerimi i mbetjeve 0.6 kg/person në ditë);
- Për Nj. A. Proptisht, Trebinjë e Velçan – nuk administrohen të dhëna .

Mënyrat e trajtimit deri më sot

Si kudo, edhe në Bashkinë e Pogradecit, më përpara mbetjet urbane, me përbërje të tilla si: mbetje organike, mbetje inerte, mbetje letre, mbetje plastike, mbetje qelqi, hekurishte, madje edhe ato sanitare, hidheshin ku të mundnin, duke ndotur ambjentin për faktin se të gjitha mbetjet e lehta si plasmaset dhe grimcat e tjera largohen nga era, të tjerat dekompozohen por sidomos djegjet në natyrë duke sjellë ndotje të theksuara kudo në ambjentin rrethues, si në ajër, në ujëra dhe në toka, duke dëmtuar kështu si florën, faunën dhe gjithë botën e kafshëve si dhe njerëzit. Është llogaritur që në Qytetin e Pogradecit grumbullohen rreth 35-40 ton mbetje urbane, menaxhimi i të cilave bëhet problem veçanërisht në sezonin e verës. Këto mbetje trajtohen nga subjekte private, të cilat nga pikat e grumbullimit i transportojnë në venddepozitën e re, të përcaktuar, që ndodhet në lindje të fshatit Alarup, rreth 13km larg, në vendin e quajtur Përroi i Shtogut. Për këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim të tyre, të cilat përsëri edhe pse janë të përqendruara, sjellin aksese në ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale, nga djegja e tyre në natyrë etj, rrisqet negative të të cilave i kemi përshkruar më lart. Vet venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushtet teknike të përcaktuara, si nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike etj. Rrjedhja e ujërave nga venddepozita krijon ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore.

Mbetjet inerte dhe vend depozitat e tyre

Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjve, afër atyre urbane, (shpesh të përziera me to), ku edhe sot këto mbetje inerte (ndoshta edhe të reja), gjenden anës së rrugëve dhe në shpatet e përrenjëve dhe lumenjve. Mbetjet e inerteve, nën ndikimin e agjentëve atmosferik, erërave dhe reshjeve, sjellin ndotje të ajrit,të ujërave dhe të ambientit përreth, duke dëmtuar botën akuatike. Sasia

e mbetjeve inerte gjatë vitit 2015 për qytetin e Pogradecit ka qënë 700 ton/vit. Për sasinë e mbetjeve inerte për 2015 për njësitë administrative nuk ka të dhëna të sakta.

Mbetjet urbane në territorin e ish - Komunave

Largimi i mbetjeve urbane nga disa rrugë kryesore bëhet një herë në javë me anë të një kamiançine, por pa patur mjetet e nevojshme për menaxhimin e duhur të tyre. Aktualisht, situata është akoma dhe më e rëndë, sepse ky shërbim, prej rreth një viti mungon krejtësisht dhe koshat për depozitimin e këtyre mbetjeve nuk ekzistojnë në asnjë rrugë të fshatrave që përbëjnë këto ish-komuna. Kjo situatë është paradoksale, përderisa rajoni në fjalë ka nën funksionin e vet edhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane përcaktuar në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar). Çdo ditë e më tepër këto mbetje urbane përbëjnë një shqetësim të vazhdueshëm për banorët e këtyre zonave, të cilët e perceptojnë kërcënimin real që po iu ushtrohet. Gjithashtu, një mjedis i papërshtatshëm është krijuar edhe për zhvillimin e bizneseve lokale ekzistues apo të rinj. Nga kqyrjet tona në terren, konstatuam që në çdo anë të rrugëve, në kanalet kullues dhe në kanalet vaditës gjenden grumbuj mbeturinash, të cilat hidhen kryesisht nga familjarët dhe bizneset private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këto njësi administartive. Kjo situatë ishte edhe më alarmante gjatë rrugës nacionale, madje dhe në rrugët e rrëpirat brenda e midis lagjeve të fshatrave. Ajo çfarë e përkeqëson edhe më tepër situatën është mungesa e ndërgjegjësimit publik lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ashtu si dhe një mungesë e përgjithshme e dëshirës qytetare për të kërkuar të drejtat e tyre mjedisore pranë autoriteteve përgjegjëse.

Rrugët dhe masat për mbylljen e dampave ekzistuese

Nëse një ditë, madje të afërme, mbetjet do të sistemohen në landfillin eMaliqit, problem do të ngelet për Bashkinë e Pogradecit mbyllja e vatrave apo vendeve ku janë hedhur deri më sot ato. Ndaj propozohen rrugët kryesore sesi ato mund të sistemohen dhe rehabilitohen.

Tab. – 25 *Masat e propozuara për rehabilitimin dhe mbylljen e fushës së mbetjeve (Burimi: Bashkia Pogradec)*

Hapat	Përshkrimi
Rekomandime për punën në fushë deri në mbylljen e saj	Në mënyrë që të reduktohet prodhimi i lëngut kullues nga mbetjet, zona e depozitimit të mbetjeve duhet të mbahet sa më e vogël që të jetë e mundur. Mbetjet e hedhura në rrugë duhet të hiqen. Rrethimi duhet të pastrohet nga mbetjet. Skarpatet e pjerrëta në skajet verilindore, veriore dhe veriperëndimore të fushës duhet të zbuten. Për këtë qëllim, mbetjet e hedhura atje duhet të shtyhen drejt qendrës së pllajës.
Rekomandime për studime të zonës	Meqë fusha e mbetjeve ndodhet në një zonë të ndjeshme, para planifikimit të masave të rehabilitimit, do të duhet të kryhen një sërë vlerësimesh.
	Është i nevojshëm një vlerësim i ndikimeve ose rreziqeve mjedisore që shkaktohen nga fusha e mbetjeve (sa i përket ujit, tokës, ajrit dhe në veçanti furnizimit me ujë të Pogradecit).
	Nevojitet të kryhet vlerësimi hidro-gjeologjik për të identifikuar shkallën e ndotjes në puset ekzistuese të ujit dhe në ujërat nëntokësore në përgjithësi. Duhet të llogaritet niveli i ujërave

	nëntokësore në vende specifike. Një studim topografik është i nevojshëm para planifikimit të masave të detajuara të rehabilitimit.
	Kërkohet gjithashtu vlerësimi i potencialit të degazimit dhe nevojës për hartimin e masave efektive për mbledhjen dhe trajtimin e gazit të vend depozitimit (gjendja e mbetjeve në nivele të ndryshme të vend depozitimit, përqëndrimi i gazit, lagështia e materialit të depozituar në nivele të ndryshme, gjendja e ujërave nëntokësore).
	Më pas do të vlerësohet gjendja/ cilësia/ sasia e fraksioneve të pranishme për t'u përdorur në ndërtimin e shtresës së drenazhit, shtresës së sipërme me dhé (kore humusike) dhe ndërtimin e rrugëve (për të ulur kostot e ndërtimit).
Masat e rehabilitimit	Duke marrë parasysh mundësinë financiare, do të hartohen zgjidhje efektive për të reduktuar rreziqet e shkaktuara nga lëngu kullues i vend depozitimit: • Përmirësimi i rrjedhjes së ujërave sipërfaqësore • Përmirësimi i normës së avullim-djersitjes me anë të masave për mbjelljen e bimëve • Izolimi i sipërm me shtresë argjilore dhe/ose HDPE

	Në varësi të rezultateve të vlerësimeve dhe studimeve që do të kryhen më parë, masat e rehabilitimit si më poshtë mund të jenë të nevojshme: • Punime gërmimi (shtyrja e mbetjeve për t'i mbledhur, formimi i skarpateve të përshtatshme, etj.) • Dhé për sistemimin/ profilizimin • Nivelimi dhe ngjeshja e mbetjeve • Drenazhimi i gazit (shtresë drenazhi dhe tubacione) • Shtresë izoluese minerale dhe/ose artificiale • Shtresë drenazhi dhe sistem për mbledhjen e ujërave sipërfaqësore • Përmirësimi i pellgut të lëngut kullues (ose ndërtim i ri)
	Sistemi i mbulimit të sipërm – projektimi i masave të mbjelljes së bimëve dhe pemëve, të cilat do të përmirësojnë normën e avullim-djersitjes: • Vlerësimi i potencialit të gazit të vend depozitimit (nëse vlerësohet të ketë një potencial të madh gazi, pemët duhet të mbillen më vonë) • Vlerësimi i trashësisë dhe cilësisë të shtresës së sipërme me kore humusike.

Nevojat për masa rehabilitimi për mbylljen e fushave të vogla janë shumë më të vogla krahasuar me ato të fushave të mëdha të mbetjeve.

Tab. – 26 *Masat e propozuara për rehabilitimin dhe mbylljen e fushave të mbetjeve Burimi:Bashkia Pogradec*

Hapat	***Përshkrimi***
Kushtet e kuadrit të vlerësimit	Në varësi të përmasave të fushës së mbetjeve, sasisë së mbetjeve të depozituara, ndjeshmërisë së mjedisit dhe distancës nga vendet e banuara lind domosdoshmëri që: Shtyrja e mbetjeve dhe mbulimi me dhe gjatë vitit 2017 duhet bërë për tëmbyllyr përfundimisht këtë pikë depozitimi me anë të një sistemimi të thjeshtë me izolim sipërfaqësor. Ky vlerësim duhet të bëhet pak kohë para zbatimit të masave të rehabilitimit dhe para fillimit të punës në vend depozitimin e ri sanitar.
Koncepti i rehabilitimit i rekomanduar	Alternativa e vetme për këtë lloj të fushave të mbetjeve duhet të jetë mbulimi me dhe i mbeturinave gjatë rehabilitimit dhe shkëputjes prej saj përfundimisht Për pastrimin e pikave të nxehta mjedisore të vogla brenda dhe pranë qendrave të banuara, bashkitë duhet të organizojnë fushata pastrimi me përfshirjen e banorëve, para zbatimit të masave të rehabilitimit. Nëse transportimi i mbetjeve nuk është i mundshëm, këto fusha të vogla mbetjesh do të rehabilitohen në vend. Masat e mundshme do të jenë gërmimi, shtyrja e mbetjeve së bashku, mbulimi me dhé të ngjeshur të papërshkueshëm dhe vendosja e një shtrese toke me bimësi.

Duke marrë në konsideratë masat e ngjashme të rehabilitimit në Shqipëri gjatë viteve të fundit, kostot për transportimin përllogariten rreth 2 Euro/m³/km. Në disa raste rehabilitimi në vend mund të kushtojë më pak, megjithatë ndikimet mjedisore nuk mund të ndreqen plotësisht.

Sasia dhe mercellogjia e mbetjeve urbane në Bashkinë e Pogradecit

Nga përllogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezulton se në këtë zonë mund të formohen jo më tepër se 200 ton mbetje urbane në ditë ose rreth 6'000 ton në muaj, që po ti shpërndajmë në njësinë e madhe, nga njëra anë nuk përbën ndonjë ndotje të madhe, por nga ana tjetër paraqet vështirësi për grumbullim dhe sistemim të tyre.

Materiali	Përbërja në %	Sasia ton/vit 2009	Sasia ton/vit 2015	Potenciali per Kompostim
Organik	53,70	17248	18860	18860
Letër dhe karton	10,54	3385	3702	3702
Plastikë e ricikluesshme	13,70	4400	4812	
Qelq	5,25	1686	1844	
Metale	0,70	225	246	
Lëndë Drusore	0,62	199	218	218
Tjetër	15,50	20,80	5444	
Totali i vlerësuar	100,00	100,00	100,00	22780

Tab. – 27 *Përbërja e mbeturinave në rajonin në studim*

Nga monitorimi i situatës rezulton se gjenerimi i mbetjeve urbane ka pasur tendencë rritje, ndërsa gjenerimi i mbetjeve inerte ka pasur luhatje. Pavarësisht investimeve për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane, ai mbetet ende një problem shumë i rëndësishëm që ndikon mjedisin dhe shëndetin, veçanërisht në zonat rurale. Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e bashkisë Pogradec, jemi mbështetur në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është

- 1 kg/ditë për qytetin dhe
- 0.6 kg/ditë për fshatrat e njësive administrative Dardhas, Udënisht, Buçimas e Çërravë

(Burimi Bashkia Pogradec).

Direktivat Europiane mbi mbetjet

Direktivat Europiane mbi të gjitha caktojnë objektivat, procedurat dhe kriteret e përgjithshme, detyrime të veçanta e të rëndësishme dhe kohën për të arritur këto objektiva. Në vendet anëtare të BE, administrata lokale krijon ligjin dhe rregulloren me anekset teknike për realizimin dhe funksionimin e landfillit (vend-groposje). Për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve është vendosur një rend prioriteti në hierarkinë e mbetjeve:

a) Parandalim;
b) Përgatitje për ripërdorim;
c) Riciklim;
d) Rikuperim tjetër, p.sh. rikuperim energjie;

e) Groposje.

Theksojmë nevojën e trajtimit të këtij shërbimi që në grumbullimin, largimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta urbane, e cila konsiston në:

- zbrazjen e kontejnerëve me makinën e përshtatshme teknologjike vetëshkarkuese;
- mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10m nga çdo kontejner;
- Pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30m2 rreth çdo pike grumbullimi;
- Dezinfektimin e brendësisë së kontejnerëve dhe sipërfaqes përreth, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori;
- Rivendosja e kontejnerëve të sistemuar në vendin e caktuar;
- Transportin e mbeturinave në fushën e përpunimit të tyre me makinat teknologjike vetëshkarkuese.
- Kontejnerët të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike në mjedisin urban të paracaktuar nga njësia vendore përkatëse. Dezinfektimi bëhet pas zbrazjes së çdo kontejneri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike.

Karburantet

Është për t'u theksuar se që nga fshati Lin deri në Tushemisht janë ndërtuar një numër i madh karburantesh, (mbi 20 të tillë). Po kështu, vetëm në Qytetin e Pogradecit, që nga hyrja deri afër rrugës për në Tushemisht janë 6 pika karburanti. Këto karburante sjellin ndotje në ajër, në rrugët dhe ambientet përreth tyre me avujt dhe praninë fizike të produkteve të hidrokarbureve, si naftë, benzinë, vajra etj.

Përfundime

- Mungesa e menaxhimit të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve Urbane ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të plehrave, të cilat shkaktojnë ndotje të mëdha që lidhen me tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrin dhe erën (aromat).
- Sistemimi i Mbetjeve Bashkiake është kryer dhe vazhdon të kryhet, në mënyrë primitive. Aktualisht nuk bëhet asnjë lloj ndarje dhe trajtimi.
- Teknika që përdoren aktualisht janë ripërdorimi, riciklimi dhe groposja, ku dy të parat (riciklimi dhe rikuperimi) funksionojnë në rrugë gjysëm-informale ose plotësisht informale private, ndërsa e fundit është e organizuar me mangësitë e veta në nivel politikash publike.
- Zgjidhjet teknike për eliminimin e mbetjeve të ngurta me një kosto efektive duhet të jenë të pranueshme edhe nga ana sociale.
- Menaxhimi i mbeturinave urbane është më kompleks se thjesht vend depozitimi i tyre në vend groposje të kontrolluar inxhinierike (landfill).

Sugjerime

Për sa më sipër, në kushtet e reja ku do të ndodhet Bashkia Pogradec lidhur me mbetjet urbane shihet i nevojshëm një plan i ri menaxhimi për mbeturinat, ku të spikasin masat, rrugët dhe mekanizmat për:

1. Mënyrën e ndarjes së mbetjeve qysh në burim, për të cilën do të propozonim atë të ndarjes me dy kazanë prej 1,7m3, plastik, hermetikisht të mbyllur që mund të futesh, jo të tërheqësh prapa, ku njeri do të jetë për mbetjet e thata (plastikë, karton, letra, qelq, metalike) e tjetri për mbetjet e njoma (kuzhine, organike).
2. Gjetjen dhe ngritjen e një sheshi i quajtur pikë transferimi, i cili do të shërbejë për ri ndarjen e mbetjeve, duke krijuar lëndë të parë e të ndryshme deri në] masën 80% për kompanitë e riciklimit, si dhe duke zvogëluar sasinë e tyre deri në 20% për drejt landfillit të Maliqit.
3. Mbetja e tepruar dhe e pa biodegradueshme, që rezulton nga para trajtimet e mësipërme, ku riciklimi, të drejtohet për në Landfillin Ekologjik Rajonal të Maliqit.



Fig. – 66/4 Skemë e para trajtimit të mbetjeve urbane në një pikë transferim

4.9 ENERGJIA

Sektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40.43%, sektori i banesave 26.06%, industria 16.32%, sektori i shërbimeve 8.51% dhe bujqësia e të tjerat 8.68 %.

Fig. – 67 *Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori*

Në vitin 2010, sektori i banesave ka konsumuar 45.7% të energjisë elektrike. Pas tij vjen sektori i industrisë me 18.3%, më pas sektori i shërbimeve me 21.3%, dhe në fund vjen sektori i bujqësisë me 1.8%. Vlen të theksojmë, se pas vitit 2008 KESH-i, nëpërmjet një harmonizimi të kënaqshëm të importeve gjithvjetore të energjisë elektrike, si dhe me përpunimin racional të rezervës hidroenergjetike në kaskadë, arriti të kryejë furnizimin e plotë të konsumatorëve të vendit tonë me energji elektrike. Prodhimi më i ulët vjetor, gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa, prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, të mbështetur vetëm në HEC-e. Po kështu, për periudhën 2007-2011 vërehet një rritje e ndjeshme e prodhimit vendas të naftës brut, duke arritur në vitin 2011 në 891 000 ton (nga rreth 320 000 ton, që ka qënë në vitin 2000), ndërkohë që përpunimi i naftës brut në rafineritë e vendit ka pësuar rënie, si në vlerë absolute, por për më tepër në vlerë relative, në krahasim me prodhimin e naftës brut në vend, duke bërë, që të rritet gjithmonë e më tepër eksporti i naftës bruto.

4.9.1 Situata Aktuale

Energjia elektrike në dispozicion e përftuar nga të gjitha burimet, në vitin 2014 u ul me 0,8 përqind krahasuar me vitin 2013. Sasia e energjisë së prodhuar në vend dhe shkëmbimi i energjisë elektrike rezultoi 7.794 GWh.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike përbën 60,6 përqind të energjisë në dispozicion për konsum. Sasia gjithsej e prodhuar në vend gjatë vitit 2014 është 4.726 GWh nga 6.959 GWh e prodhuar gjatë 2013, e cila rezultoi me rënie prej 32,1 përqind.



Fig. – 68 *Grafiku i bilancit te pergjitshem te energjise Burimi INSTAT*

Burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike është prodhimi nga hidrocentralet. Sasia e energjisë së prodhuar prej tyre është ulur 32,1 përqind krahasuar me një vit më parë. Prodhimi nga hidrocentralet publike përfaqëson 72,1 përqind të prodhimit neto vendas, ndërsa prodhimi i energjisë nga prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë përbën 27,9 përqind.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) rezultoi me rritje prej 44,5 përqind duke arritur vlerën 3.356 GWh nga 2,323 GWh në 2013.



Fig. – 69 *Energjia e instaluar e HEC-eve per cdo basen ujor Burimi Strategjia Kombetare per Menaxhimin e Integruar te Ujerave*

Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) ishte 288 GWh në vitin 2014 nga 1.425 GWh që përbënte një vit më parë. Në krahasim me vitin 2013, **humbjet në rrjet** janë ulur 15,8 përqind nga 3.306 GWh në 2.783 GWh. Ato përbëjnë 35,7 përqind të sasisë së energjisë të disponueshme për konsum. Humbjet në shpërndarje përbëjnë 94,2 përqind të humbjeve në rrjet, të cilat rezultuan me rënie 15,3 përqind

Konsumi i energjisë elektrike nga konsumatorët në vitin 2014 është rritur 10,1 përqind krahasuar me një vit më parë, nga 4.551 GWh në 5.011 GWh. Konsumi i energjisë elektrike nga familjarët dhe jo familjarët u rrit respektivisht me 10,2 dhe 9,9 përqind. Për të llogaritur nivelin e konsumit të Energjisë në nivel Bashkie janë përdorur llogaritjet e mëposhtme.

Konsumi Familjar

	Popullsia	Numri i familjeve ne Shqiperi	Konsumi Familjar (MWh	Mesatare konsumi per familje (MWh)
Shqiperi	2,886,026	721,507	2,522,261	3.5
Bashkia Pogradec	61,530	15,817	55,293	

Tab. – 28 *Konsumi familjar i energjisë në Bashkinë Pogradec Burimi: INSTAT, Përllogaritjet IDRA*

Shenim: Në lidhje me popullsinë ne Bashkinë Pogradec janë përdorur të dhenat që dalin nga CENSUSI 2011 pasi mbi atë bazë jane llogaritur edhe të dhënat në rang vendi (popullsia e Shqipërisë)

Konsumi jo familjar

	Nr. i Bizneseve Aktive (2015)	Konsumi jo familjar (MWh)	Mesatare konsumi për biznes (MWh)
Shqipëri	132,745	2,546,991	19.2
Bashkia Pogradec	1,667	31,985	

Tab. – 29 *Konsumi jofamiljar i energjisë në Bashkinë Pogradec Burimi: INSTAT, Përllogaritjet IDRA*

Shënim: Në numrin e bizneseve të raportuara nga INSTAT për vitin 2015 janë hequr bizneset e deklaruara si "Fermer" për arsye se konsumi i tyre i energjisë në mënyrë të përgjithshme është familjar dhe jo biznesor.

Humbjet

Duke marrë për bazë të njëjtin trend të humbjeve si në nivel kombëtar (55% e konsumit familjar dhe jo-familjar) përllogaritet që humbjet në nivelin e bashkisë së Pogradecit të shkojnë në 48 003 MWh. Tabela përfundimtare e konsumit të energjisë në Bashkinë e Pogradecit paraqitet më poshtë.

	Ne Mwh
Përdorimi nga konsumatorët	87,278
Familjare	55,293
Jo Familjare	31,985
Humbje	48,003
TOTALI i KONSUMIT	135,281

Tab. – 30 *Humbjet e energjisë në Bashkinë Pogradec Burimi: INSTAT, Përllogaritjet IDRA*

Energjia për ngrohje

Burimi kryesor i përdorur për ngrohje në Bashkinë e Pogradecit, sipas të dhënave të INSTAT është druri. Të dhënat e Censusit 2011 tregojnë se rreth 97% e Njësive Ekonomike Familjare përdorin drurin si burim kryesor për ngrohjen.

Njesia Administrative	***% NjEF qe perdorin Dru per ngrohje***	***Nr. Familjesh qe perdorin Dru per ngrohje***
Bucimas	98.74	3755
Cerrave	99.52	1657
Dardhas	99.25	526
Udenisht	98.79	1468
Pogradec	93.16	5629
Proptisht	99.37	1111
Trebinje	98.66	590
Velcan	99.13	570

Tab. – 31 *Energjia per ngrohje në Bashkinë Pogradec. Burimi: INSTAT, Përllogaritjet IDRA*

4.9.2 ENERGJITË E RINOVUESHME

Energjia nga burimet hidrike. Rreth 98% e prodhimit aktual të energjisë elektrike në Shqipëri është hidroenergji. Aktualisht, përdoret rreth 40% e potencialit hidroenergjitik të vendit, nga 4500 MW kapacitet potencial teorik, me një mesatare potenciale gjeneruese totale prej 16 TWh në vit. Në dekadën e fundit, qeveria shqiptare ka inkurajuar ndërtimin e HEC-eve. Deri në vitin 2015, janë nënshkruar 173 kontrata koncesionare për ndërtimin e 540 hidrocentraleve të vegjël, 104 prej të cilëve janë në veprim dhe 75 janë në ndërtim e sipër. Furnizimi potencial hidroenergjetik i këtyre 540 HEC-eve të dhënë me koncesion është rreth 2,100MW. Këto H ec-e janë zhvilluar në pjesët malore të vendit, ku mund të shfrytëzohet energjia potenciale e ujit, por



Fig. – 70 *Harta e Hidrocentraleve te Shqiperise*

lënia prej pothuaj 2% në lumenjt ekzistues, dhe marrja prej 98% e ujit në tub, e kthen më tepër në problem këtë aktivitet, sesa në zhvillim.

Energjia Diellore mund të shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe fare pak për prodhim energjie elektrike. Ajo pothuajse nuk shfrytëzohet. Potenciali teorik për shfrytëzimin e energjisë diellore në rajonin e Pogradecit shkon deri në 1200 kWh/m2. Kjo lloj energjie mund të përdoret, si për raste familjare dhe për rast komunal, ku për secilin rast ka projekt pilot dhe shembull pozitiv.

Energjia e Erës

Nga vlerësimet paraprake konstatohet, se erëra me shpejtësi mbi 5 m/s për lartësinë 10m, rezultojnë të jenë rreth 2200 orë, kurse për lartësitë nga 50 deri 75m orë në vit, me shpejtësi mbi 5 m, rezultojnë të jenë rreth 3000 orë. Eshtë konstatuar, se vendet më të përshtatshme për ndërtimin e parqeve me erë, për prodhimin e erergjisë elektrike janë zona masivi malor Pogradec-Moker-Korcë dhe zona e Devollit. Deri në tremujorin e parë të vitit 2012, nga ERE dhe nga METE, janë licensuar disa kompani të ndryshme për të ndërtuar parqe eolike, që shfrytëzojnë energjinë e erës, me një fuqi të instaluar në shkallë vendi prej rreth 1600MW, një pjesë e së cilës është në shkallë regjionale Korçë-Pogradec. Energjia me anë të fermave me mulli ere mund të jetë një nga alternativat më të mira për sigurimin e energjisë.

Energjia e biomasës përftohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Biomasa, si lëndë energjetike përdoret në formën e saj tradicionale për ngrohje dhe gatim, nëpërmjet druve të zjarrit apo mbetjeve të tjera të agrikulturës. Sipas vlerësimeve paraprake të përafërta, energjia e biomasës në vendin tonë është rreth 7 Mtoe, kurse energjia e biomasës e siguruar nga mbetjet bujqësore është llogaritur në rreth 130 toe/vit, ku rajoni i Pogradecit zë vend kryesor në këtë porodhim.

Energjia gjeotermale. Sipas studimeve në Shqipëri ekzistojnë disa zona në të cilat ka mundësi shfrytëzimi i energjive gjeotermale. Në qendrën e Ultësirës Perëndimore, dendësia e fluksit të nxehtësisë është 41.3 mW/m2. Në Masivin Malor të Pogradecit, llogaritet që dendësia e fluksit të nxehtësisë të luhatet nga 40 mW/m2 deri në 61. 8 mW/m2.

4.9.3 Probleme në menaxhimin e energjisë

Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (më shumë se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tonë elektroenergjetik është shumë e varur nga kushtet hidrike.



Fig. - 711 *Hartë e vizionit për zhvillimin e industrisë dhe energjisë.*

Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar është rreth 1531MW dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e vendit, duke qënë se është nga burimet hidrike, ka natyrë propabilitare, që lëviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri në 7,7 miliard kWh/vit, në varësi të kushteve hidrike (rreth 7,7 miliarde kWh në vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor është rreth 4.2 miliard kWh. Duke patur në konsideratë, që kërkesa për energji elektrike në vendin tonë, aktualisht është 7.342 TWh/vit, dhe prodhimi vendas rreth 4.2 TWh/vit, pra është i pamjaftueshëm, bën të detyrueshëm që aktualisht, mbulimi i nevojave duhet të përballohet nëpërmjet importit të energjisë elektrike.

Nga ana tjetër, duhet të vëmë në dukje, që kapacitetet importuese të vendit tonë janë të limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve të limituara, që kanë linjat tona të interkonjeksionit me vendet fqinjë, por edhe të linjave të interkonjeksionit të vendeve të rajonit, pasi vendi ynë është pikë fundore në rrjetin rajonal të energjisë elektrike. Duhet theksuar gjithashtu, se importi i energjisë elektrike është vështirësuar edhe për shkak të rritjes së defiçitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Bosnje Hercegovinës, janë importues neto të energjisë elektrike.

Ndërtesat e banimit në Shqipëri, shndërrimi i tyre për shkarkime të ulta karboni në të ardhmen

Kërkesa për energji në sektorin e ndërtesave të banimit përbën një sfidë të veçantë. Në vitin 2013 konsumi përfundimtar i energjisë në këtë sektor ishte i barabartë me 30% të kosumit kombëtar (EUROSTAT 2015), ndërkohë që ky sektor ishte përgjegjës për shfrytëzimin në masën 60% të energjisë elektrike, si pjesë e konsumit përfundimtar të energjisë. Cilësia e shërbimit të pajisjes me energji elektrike është shumë më e ulët se mesatarja e Bashkimit Europian. Shqipëria, si një vend anëtar nënshkrues i Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është e detyruar të zbatojë legjislacionin e BE-së për eficiencën e energjisë. Arritja e këtyre objektivave kërkon përpjekje më ambicioze, krahasuar me të sotmen në fushën e politikave, dhe investime më të mëdha për eficiencën e energjisë prej konsumatorëve. Sipas vlerësimeve tona, konsumi përfundimtar i energjisë në vitin 2015, në sektorin e banimit, për shërbimet e energjisë termike, ishte 4.9 miliardë kËh, nga të cilat 54% përmbusheshin nga energjia elektrike, 37% nga lënda drusore dhe 9% nga gazi i lëngët. Sektori shkarkoi 96 mijë tonë CO_2, i bashkëlidhur ky me konsumin e gazit të lëngët. Konsumi i druve të zjarrit dhe i gazit të lëngët do të ulet respektivisht me rreth 11% në vit dhe 10% në vit. Në vitin 2030, ngrohja e hapësirës do të jetë përgjegjëse për 56% të konsumit përfundimtar të energjisë, ndërsa për ngrohjen e ujit kjo do të jetë vetëm 15% dhe për ftohjen e hapësirës 29%. Këto përfshijnë futjen e kredive me normë të ulët interesi për 90% të familjeve në shtëpi të veçuara ose gjysëm të veçuara, si dhe futjen e ndihmës në formë grantesh për pjesën e mbetur prej 10% të këtyre familjeve. Lënda drusore zë ende rreth 35-40% të energjisë për ngrohje në banesa, kryesisht në zonat rurale.

Institucionet publike, shembuj në përdorimin e energjive të rinovueshme.

- Ngrohja e hapësirave të banimit përfaqëson afërsisht 50-60% të energjisë së përdorur në ndërtesë.

- Humbjet e nxehtësisë nëpërmjet mureve rrethuese të ndërtesës është rreth 20% të energjisë për ngrohje të përdorur në të.
- Nga dritaret humbet deri në 50% e nxehtësisë për shkak të transmetimit dhe ventilimit nëpërmjet tyre.
- Humbjet e nxehtësisë nga dyshemeja janë 10%
- Humbjet e nxehtësisë nga çatia/tarraca janë 20%.

Rajoni ynë ka më shumë se 240 ditë me diell dhe se përdorimi i panelit diellor për ujë të ngrohtë sanitar mbulon më shumë se 60% të nevojës së energjisë të përdorur për ngrohjen e ujit të ngrohtë? Vendosja e termoizolimit dhe përmirësimi i strukturës mbështjellëse të ndërtesës sjell ndër të tjerash:

- Rinovim dhe transformim shumë të shpejtë dhe të dukshëm të ndërtesave të vjetra dhe një pamje shumë më të mirë të tyre;
- Komoditet termik të ndërtesës;
- Shmangie të formimit të nyjeve termike dhe kondesimit të avujve të ujit në ndërtesë;
- Mbrojtje të fasadës së ndërtesës kundrejt agjentëve të jashtëm atmosferikë;
- Jetëgjatësi në kohë për fasadën në pamje dhe funksion.

Filozofia e shfrytëzimit të energjisë

- Një filozofi që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet) apo në zonen suburbane (fshat) të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit çati, pse jo pjesë të kësaj çatie të përshtatura me pajisje si panele diellore për përfitim energjie.

- Mbulimi me çati na siguron jo vetëm termoizolim apo kursim energjie, sepse në rastet me mbulim prej solete, kemi kthim të energjisë diellore, për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd jo estetik.

- Një koncept tjetër i Planit të Përgjithshëm Urban që duhet të shoqërojë vendimmarrjet Bashkiake është arritja apo sigurimi i ndërtesave me Energji 0, të paktën e atyre që ndërtohen rishtaz, kjo d.t.th që të gjitha ndërtesat e planifikuara për ndërtim, do ti nënshtrohen një procesi analitik të shfrytëzimit të energjive alternative. Në kësi rastesh, rrjeti do të punojë me dy kahje, edhe të marrë nga rrjeti kombëtar, por edhe një zgjidhje lokale dhe specifike (mulli ere, panele diellorë, biomas) t'i transmetojë energji rrjetit kombëtar. Këto quhen ndertesa të tipit me energji 0 dhe në rastin, kur jep më shumë seç merr quhen ndërtesa me energji pozitive në përputhje të plotë me legjislacionin Europian.
- Të gjendet masat zbutëse lidhur me ndotja elektromagnetike që buron prej linjës prej 400 kV, i cili përbën një hot spot më vete në ndikim të drejtpërdrjt me 150 familjet që ndodhen nën këtë linjë.

Propozime

1. Duke qenë se vendimmarrja shqiptare është treguar dorëlëshuar në dhënien e Hec-eve të shumtë mbi lumenjt shqiptarë (mbi 500 të tillë), ku bëjnë pjesë edhe lumenjt e Bashkisë

Pogradec, sugjerojmë që në sistemet lumore duhet të zbatohen praktika të sistemit propocional, ku 33.3% e sasisë ujore të konsiderohet e paprekshme si prurje ekologjike, 33.3% të tjera si të paprekshme për produktet bujqësore dhe 33.3% t'iu përkasi prurjeve energjitike, dhe në varësi të kushteve klimaterike, raportet bujqësi dhe energji mund të shkëmbejnë sasira të caktuara për muaj të caktuar.

2. Të abrogohet neni 39, i Ligjit 111, viti 2012, "Për menaxhimin e burimeve ujore", pika 'd', ku thuhet: Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355) – dhe të bëhet: ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 300 ditë në vit (Q300).
3. HEC-et në kategorinë e katërt dhe të pestë të zonave të mbrojtura mund të lejohen me Leje Mjedisi, por me kushtin që të ruhet Q (sasia) e 6 muajve ose afërsisht 50% dhe 40-50% mund të jetë prurje energjitike.

4. Nga pikëpamja hidrologjike, Shqipëria ka vështirësi për të përmbushur kërkesat e brendshme për energji, për shkak të luhatjes së reshjeve që janë thelbësore për funksionimin e hidrocentraleve. Ndërkohë, përdorimi i ujit nga hidrocentralet e vogla bie ndesh me kërkesën e bujqësisë për ujitje. Ky konflikt vërrehet kryesisht në stinën e thatë të verës kur kërkesat për ujë janë të larta dhe prurjet të pakta.

4.10 PRESIONET NATYRORE

4.10.1 Rreziqet nga lëkundjet e tokës - risku sizmik

Në bazë të hartës sizmotektonike të Shqipërisë, (Sh. Aliaj, 1988) rajoni në fjalë bën pjesë në zonën sizmogjene Shkodër-Mat-Librazhd-Korcë me aktivitet sizmik deri në 8 ballë ose me magnitudë 5.5 deri në 6.0. Në kuadrin rajonal, linja sizmogjene Shkodër-Peje është një prej epiqendrave më të forta të tërmeteve, që përshkojnë këtë segment. Kjo linjë është më shumë se 100km e gjatë dhe vetëm në shekullin e kaluar kanë ndodhur një sërë tërmetesh të forta me aktivitet sizmik deri në 6,6 ballë. Në bazë të përpunimit statistikor për të gjithë të dhënat e tërmeteve të ndodhur në vendin tonë, duke marrë për truall mesatar shkëmbinj të shkrifët si ranor, argjila e suargjila, siç ndodhen në këtë zonë studimi, mendojmë se kemi të bëjmë me intesitet tërmetesh të paktën deri në 7-8 ballë ose me magnitudë 6.0 deri në 6.9. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik në formë propabilitare qyteti i Tiranës dhe rrethinat e tij përfshihen në zonen ku lëkundjet e truallit me intensitet I0=8 ballë (PGA=0.2 g) ndodhin çdo 200-250 vjet.

Fig. – 72 *Harta Sizmologjike (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Tërmetet - Janë rreziqe të vazhdueshme ndaj veprave inxhinierike, për faktin se janë goditje dhe lëvizje të menjëhershme dhe me energji të lartë të tokës mbi themelet e objekteve inxhinierike. Zona në studim bën pjesë në zonën neotektonike kontinentale të vendit tonë, në treven e brendshme me regjim në tërheqje. Kjo zonë karakterizohet nga lëvizje diferenciale të fuqishme gjatë etapës neotektonike me regjim në tërheqje horizontale. Struktura e kësaj zone paraqitet me vargje malore në trajtë horsti të ndara me ultësira në trajte grabeni. Zona bën pjesë në sektorin jugor, në vargun lindor që fillon me bllokun e malit të Thatë dhe vijon në jug me blloqet malore të Moravës, Gramozit e Gërmenjit.

Fig. - 73 *Harta Sizmike (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Në këtë varg vendoset grabeni i gropës së Pogradecit i rindërtuar në Pliocen-Kuaternar. Në hartën e elementeve të rrezikut të bashkisë, janë hedhur vatrat e tërmeteve kryesore, të cilat mund të jenë brenda territorit të qarkut, ose në afërsi të tij, por që ka ndikuar në territorin e bashkisë Pogradec. Këto tërmete janë klasifikuar si historike (tërmete të rëna që nga lashtësia deri në vitin 1900) dhe tërmete të matur instrumentalisht (tërmete të rëna nga viti 1900 deri sot). Në këtë zonë janë gjeneruar tërmete të forta, si me 18 Shkurt 1911 në liqenin e Ohrit me M(magnitude) = 6.7 shkallë rihter dhe intensitet I0=9 ballë, më 28 Janar 1931 M=5.8 shkallë rihter dhe I0= 8-9 ballë, tërmet tjetër është regjistruar me 26 Maj 1960 me M=6.4 shkallë rihter dhe I0=8-9 ballë. Me 18 Janar 1958 është regjistruar tërmeti me M= 4.7 shkallë rihter dhe I0=6-7 ballë. Më 12 Qershor 1995 me M=3.0 dhe thellësi 10 km (Koçiaj, S. 1976; Muço, B. 1996). Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementet e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

A) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriter territori është ndarë në 4 nenzona:



1. Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VI ballë
2. Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VII ballë
3. Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VIII ballë
4. Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet IX ballë

Fig. – 74 Harta e Rrezikut Gjeologjik, Pogradec (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

B) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të mara në konsiderate, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektoreve me bazë kriterin morfologjik. Duke patur parasysh edhe shkallën e hartës 1:50,000 dhe për pasojë edhe detajimet që mundëson kjo shkallë, territori është ndarë në tre sektorë, pavarësisht ndarjes në zona dhe nënzona të përshkruara me lart. Këta sektorë janë:

a. Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili përputhet me njësinë fushore. Në hartë, ky sektor paraqitet me ngjyrë jeshile. Pjerrësia e trojeve të këtij sektori nuk i kalon 2°. Këtu futet fusha e Bucimasit, Pogradecit. Në këtë sektor, me përjashtim të brigjeve të shtreterve aktuale të lumenjve dhe përrenjve, nuk priten as në të ardhmen zhvillime të elementeve të rrezikut gjeologjik. Për këtë arsye, ai konsiderohet si një sektor i qetë dhe jo kërcenues ndaj ndërtimeve që kryhen në të. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, duhet të jenë të thjeshta dhe të marin në konsiderate vlerësimin e parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës.
b. Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë, ky sektor paraqitet me ngjyrë të verdhë, duke zënë pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë. Ndërtimet që bëhen në këtë sektor për momentin janë të pa cënuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit, apo avancimit të zonave nën errozion, pjesë të këtij sektori mund të klasifikohen si sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund ti kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse perkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
c. Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shembjeve (subsidencave) në fushat minerare të shfrytezuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën errozion. Duke patur parasysh dinamiken e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori b (Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, me ngjyrë të verdhë).

Parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëhere studimi gjeologo-inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

Rreziqet nga tektonikat dhe neotektnikat aktive

Nga pikëpamja tektonike, kemi të bëjmë njëherësh me disa zona tektonike të mëdha, që përbëjnë element të madh strukturor në Albanide. Si pjesë përbërëse e saj, rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shume aktive dhe në reliev shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe levizjet, megjithëse jo të shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë

përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim është e prekur nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputja tektonike vepron në kuadrin e regjimit aktiv ngjeshës, në kohët e sotme Holocenike paraqitet me ritme më të ulta të aktivitetit. Theksojme se, shkëputja nga thellësia dhe në vetvete shpreh njëheresh dhe aktivitetin sizmik të rajonit.

Linjat tektonike aktive - Krijojnë zona të paqëndrueshme në hapësira të gjera, paqëndrueshmëri e cila vjen si rezultat i jonjëtrajtshmërisë së lëvizjës së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedime të diferencuara të trojeve. Edhe pse këto levizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcenuese në rastet e ndodhjes së tërmeteve. Tipike janë rrafshi mbihypës i zonës Mirdita mbi depozitimet e zonës së Krasta Cukalit me kënde të butë-mesatarë deri të fortë, tektonika rregjionale etj. Linja tektonike të cilat janë tepër aktive dhe kërcënojnë një zonë të gjerë rreth saj veprat inxhinierike si banesa, rrugë, tunele, linja tensioni, etj.



Fig. – 75 *Harta Aktive e Shkeputjeve ne Shqiperi (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Risqe nga lëkundjet e tjera të tokës

Duke u bazuar në ballafaqimin sizmotektonik të mësipërm rezulton se zona e shkëputjeve sizmogjene ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen tërmete me potencial sizmik të pritshëm Mmax=6.0-6.9.

- Zona në studim ndodhet jo larg nga thyerjet tektonike, që mund të gjenerojnë lëkundje të tokës në formën e tërmeteve;
- Zona në studim ndodhet pranë rezervuarëve e liqeneve ujorë, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim përgjithsisht ndodhen në, mbi dhe pranë tokave të mbushura me dhera të hedhura, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim ndodhen edhe mbi formacione me shkëmbinj magmatik, ku nuk është e mundur të shkarkojnë ujëra nëntokësorë, dhe bëjnë që të mos shkaktohen lëkundje të tokës;

Megjithatë, parimi më i mirë për një investitor është të ndërtojë një godinë të mirë edhe pranë qendrës së tërmeteve sesa një godinë të dobët larg tij.

Risku i lëngëzimit të truallit

Procesi i lëngëzimit të truallit ndodh, si në rastet kur formacioni përbëhet ose ndërtohet prej ranorëve ose rërave, dhe në rastet kur ai përbëhet prej argjilave, të cilat në rastet e tërmeteve ose të lëkundjeve të tokës për shkaqet e sipërmendura bëhen shkak për lëvizje të reja subsidente ose lëvizje të tokës në formë rrjedhjeje. Shpesh këto procese lidhen me mungesën e një migrimi anësor të ujërave, duke bërë që të ushtrohet presion për të dalë lart, duke lëngëzuar në këtë mënyrë rërat. Tërmeti i ndihmon akoma më shumë këto procese. Lëngëzimi i argjilave ndodh, kur zëvendësohen poret me ujëra të kripura me

ujëra të ëmbla, kur struktura argjilore dobësohet shumë dhe gjatë tërmeteve ose vibrimeve transformohet në masë viskoze, që rrjedh në drejtimin poshtë. Në rastin tonë përqasen raste nga këto probabilitete, duke i dhënë vlera pozitive ndikimeve prej këtyre parametrave.

Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdeshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve, etj.

SUGJERIME

Dëmtimi i objekteve, nëse nuk do të merren masa antisizmike do të konsistojnë:

- Në prishjen e qëndrueshmërisë së truallit, ku do të vendoset bazamenti.
- Në rënien në rezonancë të periodës lëkundëse vetjake të objektit me atë të lëkundjeve sizmike të tërmetit.
- Në veprimin dhe ndjerjen e tërë forcës goditëse të tërmeteve.

Për sa më sipër, rekomandohet që:

- Objektet duhen ndërtuar solid, me disa breza e të lidhur mirë;
- Të përdoren si taban shtresa të rekomanduara nga studime enkas gjeoteknike;
- Të mënjanohen ujërat sipërfaqësorë;
- Të përdoren material ndërtimi me cilësi të kontrolluar;
- T`i kushtohet kujdes cilësisë së punimeve të ndërtimit të objekteve;

Rreziqet nga subsidenca

Subsidenca është e pranishme në rastet kur kemi shfrytëzim të ujrave nëntokësorë ose të trupave të tjerë të lëngët në thellësi të tokës si hidrokarbure etj. Në rastin tonë do të kemi të bëjmë me shfrytëzim të ujrave nëntokësorë, pasi jo e gjithë zona është ujë mbështetëse. Pra, subsidenca nga shfrytëzimi i ujërave do të jetë i përfillshëm dhe mund të formohet hinka depresive, për shkak të shfrytëzimit irracional të ujit. Subsidenca do të formohej edhe në rastin nëse do të kishim një formacion:

- mbi sedimente të ngjeshëshme kokrrizimi në argjila, që rrudhen dhe fryhen, të cilat ndryshojnë përbërjen e ujit;
- në dekompozimin e lëndëve organike;
- në nxjerrjen e ujërave të naftës, në miniera, në shembjen e minierave, që shtrihet mbi gëlqerorët që treten me shumë çarje, pranë sipërfaqeve, duke u shfaqur nëpërmjet çarjeve strukturale, çarjeve të sipërfaqeve, prishjeve, shkëputjeve, etj.

Zonat që prodhojnë ujëra nëntokësorë ose ato që ndodhen mbi sipërfaqe të shfrytëzuara minerare lidhet me këto mundësi, duke bërë që të mund të preken nga këto ndikime negative.

Rreziqet nga vullkanet

Në rajonin në studim nuk njihen raste të shpërthimit apo të rreziqeve të kanosura prej vullkaneve ose hiri të tyre. Nuk njihen gjithashtu, as ndikimet e tyre, si rrjedhjet argjilore apo gazi helmues.

Rreziqet nga tokat

Përhapja e vogël e formacioneve të sotme të Kuaternarit, bimësia e varfër dhe shumë e varfër, relievi pothuajse i coptuar dhe reshjet tipike të zonës favorizojnë siç duhet proceset pedogjenike, për pasojë krijohen mundësi për mosformimin e shtresës së dhéut.



Fig. - 76 *Rreziqet nga ndërhyrjet antropogjene dhe natyrale të brigjeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Rreziqet nga Radoni

5-10% e ndërtimeve kanë përqëndrime të rrezikshme të radonit. Ajri i brendshëm në ndërtesa ka 1-2 pci/l. (piko/curie për 1 litër ajër). Ajri i tokës ka 20-100 pci/l. dhe i ujërave nëntokësorë që çlirohet nga toka ka 100-3000 pci/l. Gjysma e zbërthimit të radonit është rreth 4 ditë. 40% e ndotjes me radon përthithet nga toka me shkëmbinjë magmatik ose shiste argjilor, që janë të pasur në silica dhe alumin, si dhe argjilat e zeza të pasura me fosfor që çlirojnë në sasi radonin. Shkëmbinjë të tjerë që çlirojnë radonin janë dhe ata metamorfikë si shiste, gnejse etj. Sa më të mbyllura të jenë ndërtimet aq më shumë përqëndrohet edhe radoni. Përqendrime më të mëdha janë në dimër se sa në verë për shkak të avullimeve. Përqëndrimet e larta mbi normën e lejuar shkaktojnë kancer në mushkëri. Bazuar në interpretimet e bëra mendojmë se ndotja nga radoni është e shumë e përfillshme, për shkak se treguesit e sipërmendur rezultojnë të jenë pjesëmarrës në formacionin tonë në sipërfaqe e në thellësi, ose në zonat përreth saj.

Investitorët duhet të marrin masa, duke bërë zbutjen e saj me anë të izolimit të themeleve, ventilimit të përshtatshëm për raste zyrash apo ndërtimesh, etj.

Rreziqet nga estuaret dhe tokat e lagëta

Zona jonë e studimit nuk ndodhet larg tokave apo brigjeve në kontakt me estuaret dhe tokat e lagura, për pasojë mund të vuajë efektet negativë, që shoqërojnë këto elementë ekologjikë. Zona jonë e studimit ndodhet afër tokave apo brigjeve në kontakt me lumenj e përrenj, për pasojë mund të vuajnë efektet negativë, që shoqërojnë këtë element ekologjik.

Fig. – 77 *Harta e Rrezikut nga permbytjet*



Rreziqet nga përmbytjet

Brenda sektorit të kërkuar ndodhen me shumicë burime uji, edhe pse sipërfaqja ujëmbledhëse është e madhe. Vetë konfiguracioni i terrenit dhe përbërja formacionale

krijon premisa për depozitime uji. Në shumë sektorë të zonës në studim shtrihet formacioni magmatik, me prurje ujore dhe depozitime të kuaternarit me ujë, por që fryhen disi për pellgun ujëmbajtës në rastet e reshjeve të bollshme dhe ndodh që fryhen edhe më. Duke llogaritur përmbytjet për njëzet vitet e fundit mund të ndërtohet harta e rrezikut të përmbytjeve, që sipas shpërndarjes së reshjeve me probabilitet 1% siguri rajoni në studim ndodhet në rastisjen me bollshmëri reshjesh deri në 110mm. Për të gjetur më ekzaktësisht kalimin e pllotave të lumit që kalon pranë duhet të përdoret metoda e karbonit C-14 në materialet organike, si dhe duke dalluar mbulesat vegjetative.

Foto – 20 *Foto nga Rreshqitja ne Trebinje (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Fenomenet e rrezikut gjeologjik, përhapja dhe përshkrimi i tyre

Në territorin e Bashkisë së Pogradecit gjejnë përhapje shumë elementë të rrezikut gjeologjik, të cilat krijojnë shqetesime dhe dëmtime të veprave inxhinierike që kryhen në këtë territor. Më poshtë po përshkruajmë këto rreziqe, duke dhënë edhe fushëpërhapjen e tyre.

Rrëshqitjet. Janë një fenomen i përhapur në territorin e Bashkisë. Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, janë hedhur rreth 88 rrëshqitje të njohura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera. Gjithashtu duhet theksuar se territore të ngjashme me ato ku kemi konturuar rrëshqitjet e njohura, janë po aq të rrezikshme sa ato në të cilat ende nuk ka ndodhur rrëshqitje, por me krijimin e kushteve edhe ato shpate rrezikohen nga i njëjti fenomen.

Rrëshqitja e Pevelan, Trebinjë - Rrëshqitjet kanë prekur si shkëmbinjtë e bazamentit ashtu edhe mbulesën e dherave të Kuaternarit. Faktorët kryesorë të ndodhjes së tyre janë ndikues (ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura, tektonika,etj) dhe iniciues (errozioni, përmbajtja e lartë e ujrave nëntokësorë, rreshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme, etj.)

Rrëzimet. Ndodhin në zonën malore, atje ku pjerrësia e shpatit i kalon 40 gradë, dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të butë në profilin e shpatit. Ky fenomen ndihmohet edhe nga zhvillimi i madh i tektonikave bllokore dhe ndrydhëse, të cilat e kanë copëtuar së tepërmi bazamentin shkëmbor.

Shembjet. (Ose të ashtuquajturat subsidenca). Përputhen me zonat minerare të braktisura. Klasifikohen si fenomene rreziku më kërcënuese se të gjithë elementet e tjerë të rrezikut gjeologjik. Kanë ndodhur dhe rrezikojnë të ndodhin në fushat minerare qymyrgurore, tashmë të mbyllura të Alarup, Vërdovë, minierat e hekur-nikelit Guri i Kuq, Çervenakë, minierën e kromit Pojskë, etj. Shfrytëzimi i shtresave të qymyrit dhe xherorëve në thellësi, ka krijuar hapësira boshe nëntokë, të cilat rrezikojnë shembjen e materialit të sipërndodhur dhe për pasojë deformimin e sipërfaqes së tokës nga ai reali. Këto janë zona

tepër të rrezikshme për objektet inxhinierike, sepse shembja ndodh në mënyrë të menjëhershme dhe vertikalisht. Për pasojë ndodhin çedime nga disa mm deri në disa metra të cilat mund të rezultojnë katastrofike si për veprat inxhinierike, ashtu edhe për banorët.

Fig. – 78 *Harta e Vulave te Erozionit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Vatrat e errozionit - Është një fenomen i përhapur në territorin e Bashkisë Pogradec. Zona të tëra, kryesisht në fushëpërhapjen e formacioneve argjilore e flishore, janë të prekura nga ky fenomen, i cili nga ana e tij është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve 80-90 të shekullit të kaluar. Errozioni shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: errozion sipërfaqësor dhe - errozion fundor.

Erozioni sipërfaqësor prek zona të mëdha të fshatrave të rrëzës së malit të Thatë dhe në luginën e lumit Shkumbin. Në këtë territor kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike molasike e flishore argjilore. Ekspozimi ndaj faktorëve ekzogjenë të alterimit, si rezultat i mungesës së pyjeve natyrale, bën që sipërfaqe shumë të gjëra të denudohen me shpejtesi të frikshme. Si rezultat i rënies së shirave me intensitet të lartë, bëhet largimi i menjëhershem i materialit të shkatëruar dhe krijimi i kushteve për avancimin në thellësi të proceseve alteruese të shkëmbinjve rrënjësorë. Erozioni fundor zhvillohet më së shumti në fushëpërhapjen e depozitimeve flishore dhe mekanizmi në këtë rast është krejt i ndryshëm nga ai i përshkruar për erozionin sipërfaqësor.

Në rastin e ***erozionit fundor*** ndodh që pakot litologjike me fortësi të lartë (gëlqerorë e ranorë) të vendosen ne kuota hipsometrike më të larta se ato më të buta (argjilat). Për këtë shkak në rast reshjesh të bollshme coprat e shkëmbinjve të fortë lëvizin nëpër shpate dhe sidomos në shtretërit e përrenjve e përroskave që kalojnë në shkëmbinj argjilo- alevrolitorë, duke punuar mbi ta dhe duke i gërryer në drejtim të thellësisë. Në këtë mënyrë, ata bëjnë thellim të shtretërve të tyre me shpejtësi të madhe dhe i bëjnë të paqëndrueshëm shpatet anësore të tyre. Në këtë rast krijohet një proces zinxhir midis erozionit dhe fenomeneve të rrëshqitjeve duke u kombinuar me njëri - tjetrin dhe duke qënë shkaktare të njëri - tjetrit. Shtretërit e lumenjve - Janë trajtuar si fenomene rreziku gjeologjik për vetë natyrën e tyre të paqëndrueshme. Kjo natyrë rrjedh nga dy aspekte: 1-përbërja litologjike, e cila në shumicën e rasteve

Foto – 21 *Foto nga zonat Karstike (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

është e tipit dhera pa kohezion; dhe 2-prezenca e lartë e ujrave rrjedhës sipërfaqësorë, të cilët kanë energji e cila varet nga stadi i zhvillimit të lumit dhe nga sasia e rreshjeve që bie në territor. Këto zona (shtretërit e lumenjve) përbëjnë rrezik për veprat inxhinierike të ndërtuara mbi to, por në raste të veprave rrugore ato kalohen me ura, vitet e fundit janë ndërtuar dhe duke u ndërtuar disa Hec-e, ato ndodhen nën kërcënim të vazhdueshëm të këtij elementi rreziku.

Kone depozitimi - Janë trajtuar si fenomene rreziku dhe janë konturuar në territorin e Bashkisë dy tipe konesh depozitimi: deluviale dhe proluviale. E përbashkëta e tyre është grumbullimi në territore jo shumë të gjëra i coprave me rrumbullakim të keq, të cilat shpesh ndodhen në kufijtë e ekuilibrit natyror, i cili mund të prishet nga çasti në çast. Konet e depozitimit me orrigjinë deluviale lokalizohen në fundet e shpateve të ndërtuara nga shkëmbinj të fortë dhe mund të kenë pamje të brekçieve të shpatit apo të koluvioneve. Këto formime përbëjnë një rrezik të vazhdueshëm për objektet inxhinierike të ngritura përgjatë, sipër apo poshtë tyre. Rreziku rritet edhe më tepër kur ato janë relativisht me moshë të re (lëvizjet e reja neotektonike) dhe të pa çimentuara me llumra gëlqerorë apo argjilorë. Konet e depozitimit me origjinë proluviale janë bazamente shumë të mira për ndërtimet (përbërja e tyre litologjike gëlqerore apo shkëmbinj të tjerë me fortësi të madhe), por që janë pre e rrezikut të madh të shkatërrimit të tyre si rezultat i prurjeve të menjëhershme dhe të bollshme në kohë rrebeshesh. Këto prurje duke qënë të përbërë nga shkëmbinj të fortë dhe duke patur energji shumë të lartë, shkatërrojnë çdo gjë që gjejnë përpara, duke përfshirë edhe objektet inxhinierike që gjenden aty.

Zonat karstike - Këto zona rreziku gjeologjik shfaqen në fushëpërhapjen e shkëmbinjve gëlqerorë. Tipik është masivi gëlqeror i Malit të Thatë, në të cilin shfaqen në mënyrë të theksuar pasojat e një procesi karstik që ka prekur masivin si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi. Në sipërfaqe shfaqet një reliev tipik karstik me gropa, hinka, puse dhe fusha karstike, të cilat shpesh kamuflohen nga mbushje deluvionesh me përbërje dherash të shkrifët. Në brëndësi të masivit zhvillohen hapësira karstike të fshehta, të cilat e bëjnë të paqëndrueshëm truallin që reflektohet në sipërfaqe dhe nga çasti në çast ky truall mund të pësoje lëvizje vertikale nga lart- poshtë.

4.10.2 Zjarret

Zjarret në pyje kanë shkaktuar dëme të konsiderueshëm, me pasoja të mëdha negative për ekosistemet, si humbjen e biodiversitetit, shkretëtirëzimet, gërryerjen e tokës, prishjen e rregjimit ujor, por mbi të gjitha humbjen e funksioneve biologjike, të cilat pasohen me humbje të mëdha social-ekonomike. Sipërfaqet e djegura, gjatë periudhës 1990-2014, janë të madhësive të ndryshme, me nivelin më të lartë në vitin 2007, me 30,856 ha

Viti	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Nr. i zjarreve	273	184	659	676	585	110	490	735	601	628	915	327	140	771	143	174	176	1,190	348	189	246	559	600	97	47
Sip. e djegur (ha)	417	250	1,011	522	705	153	410	1,847	680	689	3,675	941	690	4,419	491	1,041	767	30,856	1,476	1,229	1,133	3,492	4,707	184	17

Tab. – 32 *Zjarret ne pyje per periudhen 1990-2014 Qendra Rajonale-Ballkanike e Monitorimit te Zjarreve ne Pyje, peiudha 1990-2014*

Përveç pyjeve prodhues, zjarret kanë djegur edhe zona të mbrojtura, në sipërfaqe të konsiderueshme, duke u humbur vlerat dhe rëndësinë që kanë patur. Për sa u përket shkaqeve, në shumicën e rasteve ata nuk kanë qënë natyrorë. Temperaturat e larta vetëm kanë favorizuar përhapjen e tyre. Zjarret, në

mënyrë të veçantë ata të 10 vjeçarit të fundit, në shumicën e rasteve, kanë qënë faza përmbyllëse e prerjeve të paligjshme, për zhdukjen e këtyre gjurmëve, në sipërfaqet e shfrytëzuara me dhe pa kontrata, sepse pikërisht këto sipërfaqe janë djegur prej tyre. Kjo mbetet arsyeja kryesore për pjesën më të madhe të rasteve, duke konfirmuar shkakun kryesor të tyre, faktorin njeri. Pasojat janë katastrofike, jo vetëm se është eliminuar tërësisht mundësia e ripërtëritjes, për shkak të djegies së drurëve farorë, por sepse është djegur edhe gjenerata e re, e instaluar, duke pakësuar sipërfaqen pyjore. Aktualisht këto sipërfaqe nuk janë pyje, por djerrë ose me bimësi pyjore dhe praktikisht të pamundura për t'u ripyllëzuar. Sipërfaqet e djegura gjatë periudhës 2007-2014, sipas statistikave zyrtare, rezultojnë shumë më të vogla se ato të monitoruara dhe evidentuara nga Sistemi Europian i Informacionit për Zjarret në Pyje. Sipas SEIZP, sipërfaqet më të mëdha u përkasin vitit 2007, me 122.311 ha, vitit 2011, me 28.203 ha dhe viti 2012, me 43.795 ha, kundrejt raportimeve zyrtare për vitet respektivë, prej 30.856 ha, 3.492 ha dhe 4.707 ha

4.10.3 Erozioni i tokës dhe Shkretëtirëzimi

Evidentimi i gjendjes së erozionit në Bashkinë e Pogradecit

Njësia gjeomorfologjike malore, që kap rajonin e përbërë nga shkëmbinj magmatik shumë kompakt, bën pjesë në territoret me copëtim horizontal të lartë dhe me energji mesatare deri në të madhe. Veprimtaria abrazive dhe erozioni sipërfaqësor është gjithashtu faktor i rëndësishëm, që nxit prishjen e qëndrueshmërisë së shpateve. Ai është karakteristik në shpate me ndërtim shkëmbinjsh mesatarisht të fortë, për shkak të gradientit të pjerrësisë së shpateve të tij. Mbulesa vegjetale (pyllëzimi) luan rol në qëndrueshmërinë e shpateve kodrinore të rajonit në studim. Bimësia, sidomos ajo me lartësi të vogël (shkurret) i bën shpatet e këtyre kodrave të qëndrueshme.



Fig. – 79 *Proceset e erozionit (Burimi: Studim mbi erozionin, S. Guri, Sh. Lushaj, UNDP, 2012)*

Zonat krtitike ne njesite administartive

Në kushtet e mungesës së mbulesës bimore, erozioni në këtë rajon sikundër në shumë zona të tilla të ngjashme të vendit, varion nga 20.1-34.2ton/ha/vit. Ndërkohë që në sipërfaqet e pjerrëta, përrenjtë transportojnë 70-100ton/ha/vit. Në tokat e larta, me pjerrësi më të madhe se 30% dhe në vartësi të mbulesës bimore, shkalla e humbjes së tokës nga erozioni është në kufij më të lartë. Pasojat e një erozioni të tillë intensiv janë të shumta dhe të ndjeshme për shkak se:

- profili i terrenit ka qenë i dëmtuar rëndë;
- toka e punueshme ka qenë e vogël dhe e drenazhuar.

Format e erozionit të dherave të evidentuara në rajonin në studim janë:

- Erozioni natyral ose gjeologjik;
- Erozioni sipërfaqësor;
- Erozioni i thellë;

- Erozioni i dherave në brigjet e lumenjve dhe përrenjve;
- Rrëshqitjet masive dhe lëvizjet e dherave;

Një tjetër çështje në ekspertizën tonë, në lidhje me erozionin e dherave është:

1. Erozioni i pikave të shiut – i cili përfshin bashkëngjitjen e pjesëve nga mbushja e dherave me anë të impaktit dhe lëvizjes së tyre.
2. Erozioni i shpëlarjes masive të dherave, i cili lidhet me transportimin nga ujërat në rrjedhje sipërfaqësore të caktuara.

Zakonisht, shkëputja e dherave nuk ndodh menjëherë, sepse shiu bie në një sipërfaqe të caktuar të dheut. Nëse dheu është i ngopur, uji do të infiltrohet në tokë në një madhësi që varet nga struktura e dheut, cilësia e dheut dhe mbulimi i bimësisë, strukturat biologjike të dheut, përmbajtja e dheut, dhe kushtet e sipërfaqes. Nëse rritet madhësia e precipitimeve, vlera e kapacitetit të infiltrimit të ujit do të fillojë të mblidhet dhe atëherë mund tëndodhë shkëputja. Nëse shirat vazhdojnë për një periudhë tR, atëherë ne duhet të presim si më poshtë :

$$fp = fc+(fo-fc)e-ktR$$



Fig. – 80 *Skema e nën-modelit të transportit (Burimi: Studim mbi erozionin, S. Guri, Sh. Lushaj, UNDP, 2012)*

Bazuar në situatën aktuale dhe eksperiencën e botës, duket qartë edhe sipas studimit tonë se erozioni i dherave kontrollohet nga variabla si:

- Klima;
- Topografia;
- karakteristikat e dheut;
- bimësia;
- dhe praktikat e përdorimit të tokës.

Vlerësime për gërryerjen e sipërfaqes së tokës nga erozioni ujor

Rezultatet eksperimentale dhe studimore gjatë monitorimit katër vjeçar të erozionit në një zonë të ngjashme për nga veçoritë e dherave janë si më poshtë:

Nr	Mbulesa bimore	Gërryeshmëria e tokës ton/ha/vit				
		Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Mesatare për vitet e studimit
1	Livadhore shumëvjeçare	6.2	9.1	10.8	7.9	8.5
2	Bimë prashitëse	16	21.2	24.7	23.3	21.3
3	Bimë vetiveri	8	10.6	12.4		10.3
4	Pa bimësi	18.5	19.4	22.4	20.3	20.1

Tab. – 33 *Gërryerja e tokës(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Faktorët Natyrorë

Faktorët natyrorë kanë krijuar një sfond të erozionit, i cili ishte i pranishëm para zonave të banuara nga njerëzit. Këta faktorë janë si më poshtë:

- Pjerrësia e lartë e terrenit; dhe
- gjatësia e shpateve.



Rreth 84% e sipërfaqes së territorit shtrihet në lartësinë mbi 600m mbi nivelin e detit. Pjerrësia është një nga faktorët nxitës të veprimit të erozionit me intensitet.

Fig. – 81 *Modeli dixhital i gradimit dhe harta e pjerrësisë së shqipërisë (shkalla: 30 x 30 m, burimi: copyright © 2009 earth remote sensing data analysis center) (Burimi: Studim mbi erozionin, S. Guri, Sh. Lushaj, UNDP, 2012)*

Faktorët njerëzorë – ndërhyrjet për aktivitetet ekonomike

Përdorimi i tokës - Zgjerimi i kufizuar i sipërfaqes së mbuluar me pyje dhe kullota (vetëm 51% e sipërfaqes së zonës në studim) e bën tokën më të ekspozuar ndaj erozionit. Gjatë viteve të tranzicionit, mijëra hektarë pyje të larta u prenë, kryesisht në zonat malore dhe para-malore, ku potenciali i erozionit është i lartë. Në tokë të zhveshur, intensiteti i erozionit dhe niveli i humbjes së tokës është i lartë, më shumë se 100ton/ha/vit, kështu shtimi i prerjeve rrit intensitetin e erozionit. Zonat më të prekura janë në afërsi të zonave malore ku kemi shpyllëzime dhe prerje drurësh., etj.

Mbikullotja – Erozioni intensifikohet edhe nga mbikullotja në më shumë se 40% të sipërfaqes pyjore.

Mungesa e investimeve për mbrojtjen ndaj erozionit. Gjatë viteve të tranzicionit, infrastruktura për mbrojtjen ndaj erozionit, përmbytjeve, pritave, mbrojtjes së lumenjve, jo vetëm që është dëmtuar, por investimet për ndërtesat e reja kanë qenë thuajse minimale.



Fig. – 82 *Zonat burimore të erozionit të tokës bujqësore dhe natyrore në rajon (Burimi: Studim mbi erozionin, S. Guri, Sh. Lushaj, UNDP, 2012)*

Në rajonin tonë në fjalë, erozioni llogaritet i përfillshëm sepse:

- formacioni bazohet kryesisht në argjila;
- kemi të bëjmë me pjerrësi shpatesh;
- klima është gjysëm aride dhe shirat nuk janë sistematikë;
- nuk ka tashmë mbulesë të bollshme vegjetative.

Problemet e shtuara të erozionit



Pyjet – Rajoni ynë akoma përdor në masë, sidomos në zona rurale, dru për djegie, ku 40% e lëndës shkon dëm ose lihet në mëshirë të fatit. Prerjet kalojnë 2-3 herë rritjen e pyjeve, gjë që ka bërë që situata sot të jetë e vajtueshme, ku përveç disa zonave të mbrojtura si Vithkuqi, druri më i lartë është jo më shumë se 2-3m.

Fig. - 83 *Përmbajtja e lëndës humuse n*ë Shqipëri e në Pogradec

Normat e humbjes

Shkalla e lartë e humbjeve të tokës mund të gjendet me vlera më shumë se 10 ton për hektar, por vlera edhe më shumë se 100 ton për hektar shfaqen në shumë zona të Bashkisë. Nga një skaj në tjetrin, norma mesatare e humbjes së tokës është 31,5 ton për hektar/vit, i cili është shumë më tepër nga treguesi i lejueshëm prej 10 ton për hektar/vit.

Vizitat në terren

Bazuar në udhëtimin në fushë dhe disa matje të rastësishme, gjithashtu, në llogaritjet tona duke zbatuar Ekuacionin Universal te Humbjes së Tokës në disa pika, ku ka ndërhyrë projekti erozionit ne nxorëm disa rezultate dhe këtu janë treguar si shembuj të erozionit për të kalibruar modelin. Këqyrja tipike e fushës është treguar në aneksin e këtij raporti.

Përfundime

Pozicioni gjeografik i rrethit të Pogradecit dhe faktorët klimaterikë e tokësore nuk janë shumë të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, që ka bërë të mundur që një pjesë e sipërfaqes së tokave bujqësore të braktisen dhe të përdoren për kullota për blegtorinë.

Shtimi i sipërfaqeve të eroduara është si rezultat i:

- Shpyllëzimit të sipërfaqeve pyjore dhe prishjes së ekulibrave në ekosistemet kullosore, hapjen e tokave të reja para viteve 90;
- Prerja e materialit drusor për nevoja të ndryshme nga popullata lokale dhe persona të ndryshëm;
- Mbikullotja e vazhdueshme, krasitja pa kriter e drurëve sidomos në zonat per rreth fshatrave;
- Mos sistemimi i rrjedhjeve të përroskave si dhe dëmtimi i veprave hidroteknike ekzistuese;
- Djegia e sipërfaqeve te masiveve pyjore dhe kullosore nga banorët;
- Intensiteti i reshjeve rezulton nga mesatar deri tek i larti çka ka ndikuar dhe në shtimin e fenomenit të erozionit;
- Për lartësinë mbi nivelin e detit 1000m periudha e thatësirës rezulton 3 muaj, për lartësinë 1250m 1 muaj dhe për lartësinë 1600m nuk ekziston fare;
- Pyjet kanë prejardhje gjysëm natyrore, ku janë zbatuar prerjet e njëpasnjëshme, ku si rezultat i rigjenerimit natyror në një pjesë të vogël ruajnë strukturën natyrore;
- Cilësia e sipërfaqeve kullosore varion nga e dobët deri në të mirë dhe në ato sipërfaqe ku vërehen prania e drurëve dhe e shkurreve prodhimtaria e biomasës arrin deri ne 15-20kv /ha;

- Problemet kryesore në sipërfaqet kullosore janë mbikullotja, kullotja e paligjshme të cilat kanë dëmtuar bimësinë barishtore dhe ate pyjore;
- Reziqet e biodivesitetit që janë evidentuar kanë qënë shfrytëzimi intensive i sipërfaqeve pyjore, kullotja intensive, hapja e tokave të reja, prania e zjarreve aksidentale. Këto të fundit janë në një masë të konsiderueshme;
- Sipas treguesve të reshjeve për lartësinë mbi 1000m mbi nivelin e detit, rreziku i erozionit klasifikohet i kategorisë së dytë, ndërsa për lartësinë 1250m e lart i kategorisë së tretë;
- Sipërfaqet e abandonuara dhe djerr meqenëse nuk jane marrë në konsideratë, mund të thuhet se janë mjaft të predispozuara për t'u nënshtruar fenomenit të erozionit dhe mund të klasifikohen në klasën e katërt te tija.

REKOMANDIME

Për të ardhmen në shërbim të përmirësimit të gjendjes rekomandojmë:

- Rigjenerimin dhe ripërtritjen e bimësisë ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes nga kullota dhe ripyllëzimeve;
- Disiplinimi i rrjedhjeve ujore në përroska dhe përrenj.

Frenimi i rrëshqitjeve dhe mbrojtja e tokave nga gërryerja, rekomandohet një sërë masash komplekse kundër më kryesoret dhe emergjente janë:

1. Ndërhyrja në grumbujt pyjorë me kurordëndësi nën 04, ku numri i drurëve është i rrallë dhe bimësia barishtore është e dendur me punime ndimëse për te siguruar ripërtëritjen e tyre.
2. Ndërhyrja në parcelat e eroduara me shkallë mbulimi të vogël deri në mesatare me punime biollogjike si:
   - Pyllëzime me farë e fidana, si dhe pyllëzime të kombinuara.
3. Ndërtimi i veprave si prita të bëhen në pellgjet ujëmbledhes në pjesën e sipermë të baseneve (përroskave).
4. Ndërtimin e veprave të ndryshme hidroteknike të karakterit inxhinerik, me mure të thatë, me gabona në vendet që rrëshqasin, si dhe me llaç çimento.
5. Kryerja e punimeve përmirësuese agroteknike në kullota si:
   - Kontrolli dhe shkulja e barneve të këqia në këto sipërfaqe ;
   - Plehrimi i tyre me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre ;
   - Rimbjellja e llojeve te vlefëshme në sipërfaqet që janë dëmtuar ;
   - Krijimi i plantacioneve me shkurre me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në pikat kritike dhe duke kontrolluar erozionin ;
   - Nxitja e popullsisë lokale drej zhvillimit të turizmit rural, duke patur parasysh vlerat qe afron zona ;
   - Kryerja e studimeve të reja lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave agro-pyjore per zonën.

4.11 KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE NË BASHKINË POGRADEC

4.11.1 Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre

Në territorin e bashkisë Pogradec, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuaternar. Këto shkëmbinj dhe dhera i përkasin zonave tektoniko- faciale të "Mirditës","Krasta-Cukalit" dhe Kruja. Për qëllime gjeologo-inxhinierike, në kemi bërë një rivlerësim dhe rigrupim të kufijve moshore litostratigrafike, kriteri vlerësues i së cilit ka qënë evidentimi i përbërjeve litologjike me veti të përafërta gjeoteknike dhe sjellje afërsisht të njëjtë ndaj strukturave inxhinierike. Në territorin e Bashkisë, në sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësorë, si edhe dhera të Kuaternarit të tipit mbulesor me shkëmbinjt që ndahen në tre grupe:

1- Shkëmbinj të fortë

2- Shkëmbinj mesatare

3- Shkëmbinj të butë

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh), e cila për shkëmbinjtë e fortë ka vlera me të mëdha se 500 bar (ose kg/cm2), për shkëmbinjtë mesatarë 50-500 bar dhe për shkëmbinjtë e butë< 50 bar.

Është ky tipar i shkëmbit së bashku me llogaritjen e aftësisë së mbajtjes së tij që na lejojnë të llogarisim shkallën e konstruksionit të një vepre të caktuar urbane ose banimi.

Kushtet gjeomorfologjike

Territori i Bashkisë Pogradec shtrihet në një hapësirë kontraste të madhe përsa i përket morfologjisë së relievit. Ai fillon që nga male të larta, në lindje, në jug e deri në bregun e liqenit të Ohrit, dhe luginën e lumit Shkumbin. Brenda këtij territori gjenden zona fushore të sheshta, ose gati të sheshta, pllaja, shpate kodrash të buta deri mesatare, shpate malore të pjerrëta deri të thikëta, shpate të luginave lumore të formave të ndryshme, deri në kanione, si dhe liqeni i Ohrit. Për lehtësi vlerësimi të gjithë territorin e Bashkisë e kemi ndarë në 3 njësi kryesore morfologjike:

1-Njësia morfologjike fushore;

2-Njësia morfologjike kodrinore;

3-Njësia morfologjike malore.

Njësia morfologjike fushore

Zonimi i territorit mbi bazën e kushteve gjeologo – inxhinierike

Për kryerjen e zonimit të territorit të Bashkisë Pogradec, është patur parasysh që në përputhje me shkallën e hartës, të jepen të dhëna të trojeve të ndryshme dhe përshtatshmërisë së tyre ndaj ndërtimeve që kryhen mbi to, nëpërmjet vetive të tyre gjeoteknike, si dhe të dhëna për ekspozimin e këtyre trojeve ndaj elementeve të rrezikut gjeologjik. Pra, bëhet një kombinim i të dhënave që disponohen për territorin, duke e ndarë atë në zona, nënzona dhe sektorë, të cilët në vetvete kanë kushte të përafërta gjeologo- inxhinierike dhe që janë të ekspozuar ndaj rrezikut gjeologjik në shkallë të caktuar.



Fig. – 84 *Harta Gjeologo-Inxhinierike Pogradec*

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të, janë marrë në konsideratë 3 kritere:

- Kriteri litologo-gjeologo-inxhinierik;
- Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik;
- Kriteri morfologjik.

Kriteri litologo-gjeologo-inxhinierik ka qenë kriter bazë, mbi të cilin është ndarë territori në zona që karakterizohen nga një farë shkalle homogjeniteti i kushteve ndërtuese të trojeve që gjenden në to. Me këtë kihet parasysh kryesisht vetitë fiziko-mekanike (granulometria, peshat specifike, volumore dhe të skeletit, porozitetiti, rezistenca, koeficientet e deformimit, përajrimi, çarshmeria, etj), vetitë ujore (ujëmbajtja, ujëdhënia, përshkushmëria, konsistenca, etj) dhe shkalla e ndryshimeve që ndodhin në trojet e ndërtimit nga prezenca e ujrave.



Fig. - 85 *Harta e Zonimit Pogradec (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Duke u bazuar në këtë kriter, territori ndahet në 5 zona (Konomi, N. 1998, 2002):

- Zona e përhapjes së Shkëmbinjve të fortë, në hartë paraqitet me vija horizontale;
- Zona e përhapjes së Shkëmbinjve mesatarë, në hartë paraqitet me vija vertikale;
- Zona e përhapjes së Shkëmbinjve të dobët, në hartë paraqitet me kombinim të vijave horizontale dhe atyre vertikale;
- Zona e përhapjes së dherave pa kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta majtas;
- Zona e përhapjes së dherave me kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta djathtas.

Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik mund të jetë i lidhur me kriterin morfologjik, dhe lidhja e tyre është organike dhe e pandashme, ose mund të mos jetë i lidhur me të.

PËRFUNDIME

1. Sa i përket klasifikimit litologjik të Shkëmbinjve, në Bashkinë e Pogradecit, kanë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Siluriani e deri në Kuaternar.

2. Sipas klasifikimit gjeotektonik të shkëmbinjve në territorin e Bashkisë Pogradec gjenden llojet shkëmbore: të fortë, mesatarë dhe të butë. Po ashtu kanë përhapje dhe dherat të klasifikuar dhera me kohezion dhe dhera pa kohezion.
3. Sa i përket anës morfologjike, territori i Bashkisë së Pogradecit ndahet në njësi morfologjike: fushore, kodrinore dhe malore, me rritje të kuotave kryesisht nga perëndimi për në lindje dhe nga jugu për në veri.
4. Si element të rrezikut gjeologjik të evidentuar në Bashkinë e Pogradecit janë: rrëshqitjet, shembjet, rrëzimet, erozioni i tokës, shtretërit e lumenjve, konet e depozitimit, zonat karstike, linjat tektonike dhe tërmetet.
5. Studimi i kryer ka evidentuar zonat me rrezikshmëri të lartë (zona e ngjyrosur në hartë me ngjyrë të kuqe), zonat me rrezikshmëri mesatare (e ngjyrosur me ngjyrë të verdhë) dhe zonat me pak rrezik apo të parrezikuara, me ngjyrë jeshile.

REKOMANDIME

1. Për ndërtime specifike, duhen studime të veçanta në shkallë të detajuar. Kështu që vetitë fiziko mekanike të përbërësve litologjikë, të treguara në këtë tekst, nuk duhet të shfrytëzohen për llogaritje të ndërtimeve të veçanta në çfarëdo pjese të territorit të Bashkisë Pogradec.
2. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, duhet të jenë të thjeshta dhe të marrin në konsideratë vlerësimin e parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës.
3. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
4. Është e domosdoshme që gjeologu inxhinierik, duhet të jetë pjesë e vendim marrjes, në Këshillin Bashkiak të Pogradecit, për rastet e planifikimit të territorit, si dhe për rastet e ndërtimeve të çdo lloj kategorie.

4.12 ASPEKTE GJEOMJEDISORE TË BASHKISË POGRADEC

4.12.1 Ndikimet mjedisore të Industrisë Minerare

Bashkia e Pogradecit, e përbërë nga 8 njësi administrative, (Qyteti i Pogradecit, Udenisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan), disponon një gamë mineralesh si: krom, hekur-nikel, nikel-silikat, qymyr guri, argjila, kuarcite, gurë dekorativ, gurë gëlqeror, ranor, konglomerate, inerte lumi etj, shfrytëzimi i të cilave, krahas rëndësisë ekonomike sjell edhe impakte negative në ndotjen e mjedisit. Përveç shfrytëzimit me punime nëntoksore apo në qiell të hapur, (me karriera), të këtyre mineraleve, burime ndotjesh janë edhe stoqet e mineralit apo të sterileve të tyre, sidomos fabrikat e pasurimit të hekur-nikelit, të kromit etj, me dambat e tyre përkatëse, sidomos dambat dhe stoqet e fabrikave të shkrirjes të mineraleve të bakrit, për vet përbërjen e tyre lëndore (kimizmin), granulometrinë e imët dhe

sasinë e madhe të materialit të tyre si dhe mos mbajtjen nën kontroll rigoroz. Këto paraqesin rrezik potencial për mjedisin.



Fig. – 86 *Bllok diagrama e lejeve të shfrytëzimit në Bashkinë e Pogradecit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Konkretisht për këtë Bashki, probleme gjeomjedisore sjellin kryesisht minierat dhe karrierat e kromit, të hekur-nikelit, të materialeve të ndërtimit, inertet lumore etj, (me stoqet e sterileve të tyre), si në: Guri i Kuq, etj. Nga veprimtaria e agjentëve atmosferik, këto stoqe dhe damba sjellin pasoja në ekosisteme, pra janë të predispozuar për të krijuar ndotje të theksuara në toka, ujëra, dhe bëhet shumë pak për rehabilitimin e ambienteve të ndotura. Ka damba që janë rehabilituar dhe mbuluar me bimësi spontane, (A.K. e Mjedisit, 2014). Po kështu edhe karrierat e shumta që janë aktivizuar për prodhimin e materialeve të ndërtimit, si dhe shfrytëzimi intensiv dhe i pa kontrolluar i inerteve në shtretërit e lumenjve, sjellin ndotje të theksuara në mjedisin ku veprojnë. Nga aktiviteti minerar i këtyre punimeve shkaktohen transformime gjeomekanike dhe ndotja e ujërave dhe e tokave.

Foto – 22 *Miniera e kromit (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Karrierë për gur gëlqeror - "Përroi i Gllavës", Çërravë-Pogradec

Aktiviteti minërar privat, në rrethin e Pogradecit ka filluar në vitin 2001 dhe janë dhënë rreth 30 leje minerare. Këto leje shfrytëzimi kanë një shpërndarje jouniforme dhe pikërisht janë: 7 për shfrytëzimin e mineralit të kromit, 13 për shfrytëzimin e mineralit të Fe-Ni dhe nikel silikat, 2 për shfrytëzim kuarci dhe 7 për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, ku pothuajse të gjithë kanë montuar impiante të thyerje-fraksionimit të gurit gëlqeror që prodhohet si dhe disa pika shfrytëzimi për inerte lumore.

Foto - 23 *Pamje e impianit të thyerjes së kuarcit; "Mademi", Peshkëpi, lumi i Çërravës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Natyrisht që këto punime për shfrytëzimin e këtyre mineraleve të mësipërme, sjellin ndotje kryesisht në ajër me pluhurat e tyre, por edhe në ujëra dhe në toka, me sterilet e shumta që prodhohen. Përgjithësisht i ndikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit janë LNP, PM10, PM2,5, PM1, (në µg/m3). Përveç këtyre ndotësve kryesorë, që ndikojnë në cilësinë e ajrit, janë edhe kimikatet, materialet biologjike, që shkaktojnë shqetësime ose dëmtime tek njerëzit dhe organizmat e tjerë, duke ndikuar negativisht në mjedisin natyror.

Foto – 24 *Miniera e kromit Pojskë" Pogradec. Pamja e tranverbangut, H +770 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Punimet minerare të shfrytëzimit, në përgjithësi kryhen jashtë rregullave dhe kritereve të caktuara, pra rrjedhimisht sjellin prishje të ekuilibrave natyrorë si:

- nga ana morfologjike, ku sipërmarrësit nuk i rehabilitojnë, pra nuk i mbyllin gërmadhat (karrierat), grykat e puseve, hyrjet e galerive, (duke sjellë rrezik për njerzit dhe kafshët), dëmtojnë bimësinë, kullotat dhe tokat bujqësore). Shpesh ka dalja të hinkave në sipërfaqe nga shembja e punimeve nëntokesore ;
- nga ndotjet e ajrit, të ujërave dhe të tokave, kryesisht me pluhurat e madhësive të ndryshme, deri PM10, PM2,5, PM1, që rrjedhin nga plasjet e minave, nga thyerjet dhe fraksionimet për prodhimin e inerteve të ndërtimit, nga transportimi i tyre etj; nga plasjet eksplozive, nga makinat e transportit, motorrët e makinerive etj ;

Foto – 25 *Minierë kromi Hija e Zezë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

- nga largimi nëpërmes agjentëve atmosferik, nga këto stoqe karrierash, të favorizuara nga vet pozicioni kodrinor me reliev të thyer, që lehtësojnë transportimin e tyre drejt kuotave më të ulta, në toka, në përrenj, lumenj dhe liqene (Goskolli, E., etj., 2003); Shushku, B., etj., 2013).

Fabrikat e pasurimit dhe dambat e tyre

Në Bashkinë e Pogradecit kemi ish fabrikat e pasurimit të hekur-nikelit. Këto fabrika nga stoqet me mbetje të ngurta dhe me shllame, (me një term të përgjithshëm, me sterilet e tyre), krijojnë ndotje kryesisht kimike dhe mekanike të ambjentit, si në ujëra, në sedimentet e rrjedhjeve ujore, po kështu në tokat bujqësore dhe kullotat. Materiali i dambave është ndotës serioz edhe për faktin se kemi të bëjmë me material të bluar, deri në pudër (0,074mm), gjë që rrit në mënyrë të ndjeshme sipërfaqen aktive të tyre me agjentët atmosferik, pra bëhet i favorshëm dhe i gatshëm për tu futur në reaksione kimike. Edhe mbetjet teknologjike të fabrikave të pasurimit janë një burim ndotjeje edhe për se në mbetjet në fjalë depozitohen dhe reagent të ndryshëm. Por, përveç shkarkimeve industriale që thamë më sipër, në ndotjen e ujërave rol kryesor luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, bujqësore, blegtorale etj, të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujërave të lumenjve, liqeneve dhe të gjithë mjedisit.



Fig. – 87 *Harta Gjeomjedisore, Bashkia Pogradec (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Industria Ndërtimore

Në Bashkinë e Pogradecit përveç ndotjeve nga industria minerare, (aktualisht minierat e Cr, karrierat e guroreve për material ndërtimi, aktivitetet e konsumit të gjërë, të cilat janë dhe shkaktarët kryesorë të ndotjeve të ujërave dhe të tokave, si dhe të rritjes së përqëndrimit të pluhurit në ajër, probleme në këtë aspekt sjell edhe Industria Ndërtimore, që nga hapja e bazamenteve të rrugëve, transportimi i këtyre dherave, ku pothuajse nuk zbatohen as normat elementare për mbrojtjen e mjedisit, duke dëmtuar rrugët si dhe hedhja ku të munden e këtij materiali, si rasti i fundit në Liqen. Po kështu edhe pluhurat e shumta që vijnë nga inertet që përdoren në fabrikat e betonit, të cilat ndodhen brenda ose shumë afër qendrave të banimit. Probleme kryesore në ndotjen urbane sjellin pluhurat dhe materialet inerte të prishjes së ndërtimeve të vjetra ose të atyre të ndërtuara pa leje. Përmbajtja e grimcave totale (LNP) dhe atyre të respirueshme (PM10, PM2.5, PM1), në atmosferën urbane të këtyre qyteteve nuk është sinjifikative, ku në përgjithësi është brenda normave të lejuara të Standartit Shqiptar (Ministria e Mjedisit, 2012&2013).

Hot Spotet

Të ashtuquajturat ''Pika të nxehta'' ose ''Hot Spote'', krijohen nga mbetjet e rrezikshme, (MbRr), të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që sjellin efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje edhe të shkaktojnë vdekje). Menaxhimi i situatës së mbetjeve të rrezikshme (MbRr) në vend, e shprehur me anë të "Hot Spoteve", është përcaktuar qartë nga projektet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fig. – 88 *Hot Spotet nga minierat e Shqipërisë, (studim i pjesshëm nga UNEP). (Burimi: S. GURI, UNDP)*

Konkretisht, si lloje prioritare të MbRr, në 35 sheshet e përcaktuara (UNEP, (2008); UNDP, 2010), janë konsideruar mbetjet që dalin nga:

- minierat dhe proceset minerare;
- mbetjet e naftës dhe mbetje të tjera të hidrokarbureve;
- mbetjet acide apo solucionet bazike;
- mbetjet nga rrëshirat, adesivet (ngjitësit);
- mbetjet nga bojërat, ngjyrosjet, pigmentet etj; - mbetjet e arsenikut;
- mbetjet nga lëkurat, gëzofët dhe industria tekstile etj;
- mbetjet nga trajtimet e sipërfaqeve të metaleve.

Siç e kemi thënë më sipër, konkretisht për Bashkinë e Pogradecit si ''Pika të nxehta'' ose ''Hot Spote'', janë cilësuar:

- Damba e minierës së Fe-Ni Guri i Kuq në Pogradec, me sipërfaqe rreth 3 ha, e cila me grimcat shumë të vogla të këtij minerali, ndotë liqenin e Pogradecit ;
- Fabrika e përpunimit të Fe-Ni e Gurit të Kuq Pogradec, me dambën e saj në breg të këtij Liqeni, me rreth 100 000 m3 sterile;
- Damba e përhershme mbi fshatin Hudenisht, me rreth 300,000 ton material (kokrrizor dhe shllamor), e cila sjell ndotje në Liqen, në biodiversitetin e tij, sidomos në faunën si për shembull zhdukja e Karavidhes, specie e rrallë e liqenit, e ngjashme me karkalecin e detit, (UNEP, (2008); UNDP, (2010); Guri, S., etj., 2011-2013).

Fig. – 89 *Hotspotet në bashkinë Pogradec Burimi Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi i 'Hot Spoteve" Shqiptare, 2012*

Çështjet ambientale

Çështjet ambientale i përkasin pjesëve të propozuara për përdorim të sheshit dhe rehabilitimit të asaj pjese të sheshit. Më poshtë përfshihen problemet operacionale:

- Shqetesimi qe shkaktohet nga nxjerrja e ngarkeses jashte dhe ngarkimi per ne vagonat hekurudhore;
- Shqetësimi nga instalimi i konvejerëve midis galerive dhe vendit ku grumbullohet xeherori jashtë tyre;
- Shqetësimet nga punimet nëntokësore, të tilla si plasjet, pompimi dhe rrjedhja e ujrave nëntokësore, kthimi i cilësisë së ajrit;
- Zhurma dhe pluhuri nga konvejerët xeherorë ;
- Hedhja e shkëmbinjve të mbetjeve nëntokësore si në siperfaqe, ashtu edhe nëntokë;
- Menaxhimi i ujrave nëntokësorë;
- Ndërhyrjet e dukshme të strukturave të reja;
- Ndikimet potenciale nga operacioni pilot i shpëlarjes në stok, të tilla si zhurma, pluhuri, shkarkimet/derdhjet e acidit, ose të produkteve të shpëlarjes në tokë, ose në liqen, ndotja e liqenit kur të shpëlahet stoku dhe kur të rilëvizet trashësia e mbetjeve;
- Rehabilitimi dhe rivegjetimi i sheshit të mbetjeve.

Problemet ambientale të lidhura me rehabilitimin e zonave jo-operacionale të ish-sheshit minerar përfshijnë sa më poshtë:

- Sistemimi me banesë i atyre që kanë zaptuar ish ndërtesat e minierës;
- Nxjerrja jashtë përdorimit dhe rilëvizja e uzinës së abandonuar brenda ndërtesave;
- Realizimi i vlerës së ndonjë aseti;

- Shkatërrimi i banesave dhe strukturave të abandonuara dhe hedhja e materialit të padobishëm;
- Rehabilitimi i shërbimeve dhe përdorimeve ekzistuese;
- Rilëvizja dhe hedhja e të gjithë materialit ndotës për të qenë në standartet e kërkuara për përdorimin industrial;
- Stabilizimi i grumbujve (dampave) ekzistues të mbeturinave;
- Ri-profilizimi i sheshit duke përdorur materialet ekzistuese të mbetura;
- Instalimi i sistemit drejtues të ujrave sipërfaqësorë;
- Rinovimi i sheshit për të qenë në standartet industriale (në bashkëpunim me autoritetet e Pogradecit);
- Monitorimi i ujrave nëntokësorë dhe stabiliteti i shpatit (rrëshqitjes) – si pjesë e monitorimit ambiental të sheshit në vazhdim.

Këto aspekte do të kishin të bëjnë me formën e mbylljes dhe programin e rehabilitimit për tërë sheshin. Programi mund të kryhet në faza, kështu që fillimisht rehabilitohet zona e kërkuar për operacionet e reja, si pjesë e proçesit minerar, me pjesën e mbetur të sheshit për tu rehabilituar në një tjetër fazë me reflektimin e programeve të mëtejshme të investimit dhe të ardhurave nga projekti.

Mbyllja

Mbyllja e pjesës operacionale të sheshit kur miniera të pushojë së funksionuari, do të ndjekë gjerësisht shembullin e ngjashëm me atë të ekzekutuar qysh herët në zonën jo-operative.
Nxjerrja jashtë përdorimit e punimeve nëntokësore dhe rilëvizja e aseteve, si p.sh. thërmuesit, të ndjekur me mbylljen (vulosjen) e të gjitha galerive dhe oxhaqeve, duke bërë arranxhimin e duhur për shkarkimin e ujit të drenazhuar.
Nxjerrja jashtë përdorimit, rilëvizja e aseteve dhe shkatërrimi i objekteve ndihmëse sipërfaqësore do të bëhet më tej, dhe faza finale do të përfshinte rehabilitimin dhe monitorimin e përgjithshëm të sheshit.
Një plan mbyllës konceptual do të përfshihej në vlerësimin e impaktit ambiental dhe dokumentin për financim bankar, i cili do të jetë i moderuar, në se do të jetë e nevojshme, gjatë jetës së minierës, përpara përgatitjes së planit final të mbylljes, pikërisht përpara mbylljes së planifikuar.

Karburantet

Pikat e furnizimit të automjeteve me karburant, siç dihet janë të shpërndara gjithandej, deri në zemër të qyteteve. Për Pogradecin është për tu theksuar se që nga fshati Lin deri në Tushemisht janë ndërtuar një numër i madh karburantesh, (mbi 20 të tillë). Po kështu, vetëm në Qytetin e Pogradecit, që nga hyrja deri afër rrugës për në Tushemisht janë 6 pika karburanti. Këto karburante përveç ndotjeve që sjellin, si në ajër, në rrugët dhe ambientet përreth tyre, me avujt dhe praninë fizike të produkteve të hidrokarbureve, si naftë, benzinë, vajra etj, paraqesin gjithnjë rreziqe imediate nga zjarret apo shpërthimet e mundshme të tyre, nga difektet e mundshme apo nga pakujdesitë e punonjësve gjatë punës.

Pra, ato ju qëndrojnë banorëvë si bomba mbi kokë.

'Varrezat' e Automjeteve

Vatra ndotjeje janë edhe 'varrezat' e automjeteve që gjenden të shpërndara në shumë pika të hapësirave të bashkive të vendit, të cilat prodhojnë ndotje të përditshme si në ujrat dhe në tokat përreth. Ato

përmbajnë sasi të konsiderueshme substancash me shkallë të lartë ndotjeje, përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Edhe pse në të gjithë Shqipërinë ka qendra dhe reparte për çmontimin e automjeteve të tilla, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pajisura me masat e mjaftueshme për parandalimin e ndotjes ose praktika të sigurta pune. Konkretisht një varrezë makinash është pranë fshatit Memëlisht; tre të tilla janë pranë fshatit Hudënisht; një është në afërsi të fshatit Plloçë, rrugës për në Qytetin e Korçës.

Rast studimor (shembull)

Monitorimi i ndotjes së tokave - ***Pogradec (Gur i Kuq)*** **-** Nga një vështrim i vlerave të matura për metalet, të cilat konsiderohen me përmbajtje toksike pohojmë se nikeli gjendet pa shumë ndryshim midis pikave të monitorimit, deri në 40 herë më tepër se limiti i lejuar nga BE, kromi deri në 20 herë më tepër, kobalti deri në 6 herë dhe plumbi deri në 2 herë. Gjithashtu, nivele mjaft të larta vërehen edhe për manganin, i cili luhatet nga 1086-1396 µg/kg. Pra përmbajtja e metaleve të rënde në tokat pranë këtyre minierave në vlera kaq të larta është me pasoja në kultivimin e bimëve në këtë zonë, aq më tepër që konsiderohet zonë turistike. Prandaj studime të mëtejshme, që do të saktësojnë transferimin e ndotjes edhe në hallkat e tjera të zinxhirit ushqimor do të jenë me mjaft interes.

PËRFUNDIME

1. Aktiviteti Minerar në vite, si minierat e mbyllura, ato aktuale, punimet minerare sipërfaqësore (karrierat), si për mineralet metalore, edhe për jometaloret, (për gurët dekorativ, gëlqerorët, ranorët, argjilat etj), fabrikat e pasurimit të mineraleve, kanë sjell ndotje në shkallë të ndryshme të ajrit, (me gazrat dhe pluhurat që çlirojnë), dëmtim të sipërfaqeve dhe ndotje të tokave me sterile, si dhe ndotje të ujërave, nga shpërlarja këtyre punimeve dhe stoqeve të tyre).
2. Industria Ndërtimore (sidomos në dekadat e fundit), ka sjellë ndotje të mjedisit me pluhurat dhe mbetjet inerte të shumta që prodhohen, si nga shembjet, ndërtimet, transporti, ku pothuajse në të gjitha këto procese nuk zbatohen normat për mbrojtjen e mjedisit.
3. Shfrytëzimi intensiv i shtretërve të lumenjëve ka sjellë rrisqe negative në ekosistem dhe në vet ekuilibrin natyror të këtyre lumenjëve, (shembje dhe humbje tokash bujqësore, rrezikim shtëpishë, shpesh devijim shtretërish dhe përmbytje tokash), si dhe ndotje të ujërave nëntokësore, meqënëse lumenjtë shërbejnë si akuifer ujëdhënës për to.
4. Zhvillimi i bisneseve të ndryshme ka sjellë sasira të mëdha dhe të pakontrolluara të mbetjeve, ku në mungesë të shesh depozitave ose landfilleve të përshtatshme, janë hedhur vend e pa vend, (sidomos në brigjet e lumenjve), mbetje urbane, spitalore dhe industriale, pra edhe mbetje të rrezikshme, duke ndotur ajrin, tokën dhe ujërat.

REKOMANDIME

1. Trajtimi me projekte të posaçme i ujërave sipërfaqësore dhe atyre që dalin nga minierat, pra projekte për neutralizimin e ujërave të minierave, të stoqeve të minierave dhe sterilet e dambave të fabrikave të pasurimit etj.
2. Sistemimi i karrierave me taraca dhe mbushja e hapësirave të tyre me sterile të stoqeve përkatëse si dhe mbyllja e grykave të puseve të kërkim-shfrytëzimit, si dhe të galerive;
3. Duhet të krijohet koncepti i menaxhimit të mbetjeve të rrezikëshme, sepse deri më sot pothuajse ato konsiderohen si mbetje të thjeshta urbane.
4. Duhet të krijohet koncepti i ndarjes që në burim, i mbetjeve urbane nga MbRr, sipas një kompozimi "praktik" të koshave të riciklimit, në përputhje me strategjinë e Ministrisë së Mjedisit si: Të riciklueshme (të thata); Organike/të ndryshme (të njoma); Të rrezikshme.

4.13 PASURITË MINERALE TË BASHKISË PPOGRADEC

4.13.1 Studjueshmëria E Pasurive Minerale



Boksitet

Boksitet në bashkinë Pogradec vendosen në gropat karstike të krijuara nga qarkullimi i ujerave sipërfaqësore në kohëra të gjata gjeologjike dhe me pas të mbushura me mineral boksiti.

Fig. – 90 *Harta e burimeve metalore, Pogradec*

Minerali Bakër

Në bashkinë e Pogradecit kemi vetëm shfaqjen sulfurore të bakrit në objektin "Guri i Topit" që ndodhet në kufi me bashkinë e Gramshit. Këto sulfure janë të tipit kuarc-pirit dhe përgjithësisht vendosen në afërsi të kontaktit të shkëmbinjve ultrabazikë me ato vullkanogjene.

Vendburimet e Hekur-Nikelit



Një pjesë e mirë e këtyre vendburimeve kanë qenë në shfrytëzim deri në vitet 1990. Në mënyrë të shkurtuar po përshkruajmë vendburimet si më poshtë:

Vendburimi Guri i Kuq

I përket bashkisë së Pogradecit dhe është vendburimi kryesor në këtë rajon. Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhatet nga 0.97-1% dhe FeO=48.7%. Rezervat në gjendje janë: Q = 53.077.063 ton.

Fig. – 91 *Vendburimi i Hekur- Nikelit Guri i Kuq (Burimi Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Objekti Krasta e Blacës - Përmbajtja e Al2O3 shkon nga 22-24% dhe FeO shkon në 23,21%. SiO2- luhatet deri 27.5%.

Objekti Saselishtë - Përmbajtja e Al2O3 shkon nga 43.06% dhe Fe2O3 shkon në 23,68%. SiO2- luhatet deri 9.73%. Boksitet janë lëndë e parë për prodhimin e aluminit, kur moduli Al2O3/ SiO2 shkon nga 3-4%.

Fig. – 92 *Boksitet Krasta e Blacës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*



Vendburimi Guri i Përgjegjur - Rezervat në gjendje janë: Q = 1 401 754 ton.

Vendburimi Çervenakë - Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhatet nga 0.95% dhe FeO = 44.5%. Rezervat në gjendje janë: Q = 5 108 981 ton.

Vendburimi Gradishtë - Në baze të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhatet në 0.69% dhe FeO=45.7%. Rezervat në gjendje janë: Q = 245 000 ton.

Vendburimi Rodokal - Në bazë të analizave të kryera rezulton se përqindja e Ni luhatet në 1.07% dhe FeO- 45-50%. Mosha mineralizimit është para kretakut. Rezervat në gjendje janë: Q=714 066 ton.

Vendburimi Debrovë - Rezervat në gjendje janë: Q = 3 850 000 ton.



Fig. - 93 *Harta minerale e rajonit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Konkluzione

Rezervat e Fe-Ni në bashkinë e Pogradecit janë të konsiderueshme, të shfrytëzuara dhe të përdorura deri në vitet 1992 për nevoja të kombinatit metalurgjik Elbasan. Tani shfrytëzohen vetëm 3% e tyre me karrierë pasi çmimi i tregut është i ulët dhe nuk lejon shfrytëzimin nga nëntoka.

Minerali i kromit

Vendburimi Pojskë - Është vendburimi më i madh në bashkinë Pogradec. Vendburim me rezerva të konsiderueshme për shfrytëzim, nuk jep ndikime në mjedis gjatë shfrytëzimit pasi punimet kryhen nga nëntoka. Sot, ai shfrytëzohet nga subjekt privat.

Objekti Memëlisht 4 - Është objekt pranë fshatit Memëlisht të bashkisë Pogradec. Gjendja aktuale: Në aktivitet shfrytëzimi nga subjekt privat.



Fig. – 94 *Harta e Pasurive Minerale (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Objekti Gjordukë - Është një objekt në afërsi të Çervenakës të bashkisë së Pogradecit. Rezerva të zbuluara deri në 14.7 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 5 mijë ton (C1-2000: C2-3000) me përmbajtje mesatare të Cr2O3=33%.

Objekti Bregu i Pishës - Është një objekt në afërsi të Vendburimit të Pojskës të bashkisë së Pogradecit. Rezerva të zbuluara deri në 10.4 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 9 mijë ton (C1- 7000: C2-2000) me përmbajtje mesatare të Cr2O3- 43%.

Objekti Hija e Zezë - Është objekt në afërsi të Vendburimit të Pojskës, Bashkisë Pogradec. Rezerva të zbuluara deri në 4.7 mijë ton. Të mbetura pas shfrytëzimit 4 mijë ton (C1-3000: C2-1000) me përmbajtje mesatare të Cr2O3- 42%.

Objekti Guri i Pëllumbit - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. Vendburim me krom të pasur që duhet kërkuar në drejtim të JL, sipas planit te zhytjes.

Objekti Masha e Kolnekut - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. E lidhur me rrugë auto. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar në drejtim të JL, sipas planit të zhytjes.

Fig. – 95 *Harta e aktivitetit industrial ne zonen e mbrojtur (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Objekti Bregu i Tollovicës - Është objekt në afërsi të fshatit Rodokal të bashkisë së Pogradecit. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar në drejtim te JL, sipas planit te zhytjes. (Dhima, K.,etj. Viti 1998).

Objekti Çervenaka Perëndimore - Është objekt në afërsi të Minierës së Fe-Ni Çervanakë të bashkisë Pogradec.

Objekti Çervenaka - Është objekt në afërsi të Minierës së Fe-Ni Çervenakë të bashkisë Pogradec. Vendburim me krom të varfër që duhet kërkuar sipas zhvillimit të duniteve.

MINERALET JOMETALORË (MINERALET DHE SHKËMBINJTË INDUSTRIALË)

Vendburimi i argjilave Alarup - Ndodhet në Bashkinë e Pogradecit në afërsi të fshatit Alarup nga ku ka marre emrin dhe vendburimi. Janë disa dalje të cilat janë emërtuar Alarupi-1; Alarupi-2; Alarupi-3; Alarupi-4. Argjilat kanë trashësi të konsiderueshme, ngjyre gri në të kuqërremtë nga prania e hekurit.

Vendburimi i argjilave Zdërvaskë - Ndodhet në rajonin e Pogradecit në afërsi të fshatit Zdërvaskë nga ku marrë emrin dhe vendburimi. Përbërja kimike e tyre është: SiO_2=57%; Al_2O_3=23,89%; Fe_2O_3= 3.6%; CaO-2,0. Rezervat mbi 100 mijë ton.

Kuarci dhe rërat kuarcore - Zajet kuarcore Çërravë-Peshkëpi - Natyra e zajeve është konglomeratike, ku brenda konglomerateve takohen mjaft zaje me kuarc të pasur. Rezervat janë mbi 2 milion ton në gjithë zonën Çerravë-Peshkëpi. Perspektiva për të ardhmen: Zajet e kuarcit kur janë të cilësisë mbi 96 janë përdorur në industrinë e porcelanit. (Kadilli, B., etj. Viti 1976).

Rërat kuarcore Alarup-Peshkëpi - Vendndodhja administrative: Bashkia Pogradec. Fshati Alarup-Peshkëpi. Depozitime tipike aluviale të kuaternarit të vendosura në gropat ndërmalore. Burimi i ushqimit vjen nga masivi i Vardarit.

Gëlqerorët - Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në bashkinë e Pogradecit. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për t'u përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative. Mund të përmenden këtu Vendburimi Gurras, zona e Tushemishtit dhe vendburimin Gradishtë - Saselishtë.

Gurët dekorativë - Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në bashkinë e Pogradecit. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për tu përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative. Ndër to mund të përmendim vendburimin e Linit i cili ndodhet 1 km larg fshatit Lin. Gurët e këtij vendburimi janë gëlqerorë të mermerizuar. Vendburimi ka rezerva të konsiderueshme mbi 700,000 m3 dhe perspektiva është e hapur për rëndësinë që kanë për përdorim në fushën e ndërtimit.

Vendburimi i gëlqerorëve konglomeratikë Petrushë - Vendburimi ka rezerva të konsiderueshme mbi 1 700 000 m3 dhe perspektiva është e hapur. (Pine, V., etj. Viti 1970).

Shkrifërimet - *Objekti i zhavorreve Çërravë*

Përmasat e objektit janë gjatësi 300m e gjerësi mesatare 80-100m e trashësi 7-10 m. Këto shkrifërime përbëhen nga zhavorr i trashë 10%; zall 50%; Guralec 20%; Rëra 13% e alevrite 7%. Si minerale përbërës është kuarci që është dhe më i rëndësishmi pastaj vjen kalciti, graniti, magnetiti, titanomagnetiti, limoniti, granatet, piroksenet, etj. Në këtë objekt mbi 80% e materialit ka formë të rrumbullakosur. Rezervat janë mbi 105 000 m3 ose 190 000 ton dhe perspektiva është e hapur në të gjitha drejtimet.

LËNDËT E PARA ENERGJETIKE

Qymyret - Qymyrmbajtja e bashkisë së Pogradecit, lidhet me depozitimet molasike të ultësirave të mbivendosura mbi zonat e brendshme dhe ato të jashtme si dhe janë të moshave të ndryshme. Në rajonin e bashkisë Pogradec bëjnë pjesë disa vendburime të rëndësishme të qymyrit të cilat një pjesë e mirë e tyre janë shfrytëzuar pjesërisht duke plotësuar nevojat ekonomike të kohës. Mund të përmendim këtu: Vendburimi i qymyreve Velçan (i Mokrës), vendburimi Dardhas – Vërdovë, vendburimi Grunjas, Malinë, Potkozhan, Qafëpanjë – Llëngë.

Torfa, *Objekti i torfave Biçimas* - Objekti ndodhet në fushën e Buçimasit (Starovë). Shtresat torfike shtrihen në një gjatësi 2.2 km dhe gjerësi 550 m. Këto shtresa janë të vendosura midis depozitimeve kuaternare në intervalet 3-100 ml thellësi të shpimeve ose midis kuotave 565-690 m.

Nafta dhe gazi

Siç shihet nga figura i gjithë territori i bashkisë Pogradec përfshihet në bllokun nr. 6, i cili është nën administrim të kompanisë "Albpetrol" Sh.a. Në bllokun nr. 6 deri tani nuk janë zbuluar vendburime nafte dhe gazi.

Fig. – 96 *Blloqet e kërkimit të naftës në territorin Shqiptar(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Objektet e kërkimit

Në njësitë e përmendura më sipër ende nuk është vërtetuar ndonjë objekt kërkimi, megjithatë nisur nga treguesit gjeokimik, strukturor e facial mendohet se ekzistojnë premisa për të prognozuar objekte me interes për kërkim.

Përfundime

1. Bashkia Pogradec është e pasur në gjeoresurset natyrore.
2. Në bashkinë Pogradec kanë përhapje të mëdha mineralet metalore, kryesisht: Krom 25 vendburime dhe objekte; V.b . Hekur-Nikeli 6; Qymyre 10; Argjila 12; Gëlqerorë 16 dhe gurë dekorativë 11 objekte.
3. Këto pasuri kanë ndikuar dhe ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së kësaj zone.
4. Mineralet e dobishme jometalore për bashkinë e Pogradecit janë përdorur për industrinë e ndërtimit si material inert, për veti dekorative, si dhe atë të prodhimit të agregateve karbonatike të përdoruara gjerësisht në infrastrukturën rrugore, etj.
5. Lënda e parë karbonatike (gëlqerorët), argjilat që gjenden në territorin e bashkisë plotësojnë kushtet sasiore e cilësore të nevojshme në fushën e industrisë së ndërtimit, infrastrukturës.
6. Të dhënat e fituara për lëndën e parë argjilore, në vendburimet e këtij rajoni na çojnë në përfundimin se janë të përshtatshme për tu përdorur në industrinë e qeramikës së trashë (tulla, tjegulla) dhe të çimentos.
7. Për shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë interes të veçantë kanë rërat kuarcore, gëlqerorët si dhe gurët dekorativë për të cilat duhen shfrytëzuar të gjitha studimet e mëparshme duke u pasuruar me studime të reja për rëndësinë e madhe që kanë për ekonominë.
8. Është ndërtuar harta e pasurive minerale për Bashkinë e Pogradecit në shkallë 1: 50000, me të dhëna në tekst sipas llojeve të mineraleve, të shoqëruara me materiale grafike (prerje, harta, etj.), me një nivel të mirë paraqitje dhe prezantimi.
9. Kompanitë dhe subjektet private do të kenë njohuritë e nevojshme, për të ndërmarrë hapat e mëtejshme për investime në fushën e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të pasurive minerale për bashkinë e Pogradecit.

Sugjerime

1. Përpunimi i këtyre pasurive në afërsi të vendburimeve do të rrisë të ardhurat ekonomike si dhe interesin për shtimin e rezervave gjeologjike me punime kërkim-zbulimi.

2. Për mineralin e kromit: Të vazhdojë kryerja e studimeve gjeologjike për vlerësimin sasior dhe cilësor të shfaqjeve të mineralizuara të pa konturuar me punime kërkim-zbulimi.
3. Për mineralin e Hekur Nikelit: Rezervat e Fe-Ni në bashkinë e Pogradecit janë të konsiderueshme. Rivënia në eficencë e V.b kërkon ngritjen e industrisë së çelikut, nikelit dhe kobaltit.
4. Të rivlerësohet efektiviteti i përdorimit të qymyreve të gjithë rajonit të bashkisë si lëndë djegëse për përdorim në prodhimin e tullave, tjegullave, prodhimit të energjisë, në situatat e sotme të rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

4.14 POPULLSIA

Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, lëvizjet e mëdha migratore të 20-25 viteve te fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt.

Fig. – 97 *Strategjia e zhvillimit territorial Pogradec. Burimi IDRA*

Së pari, duhet theksuar se momentalisht në Shqipëri ka dy lloje burimesh që përdoren në lidhje me shifrat e popullsisë:

1. Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile
2. Të dhënat e popullsisë sipas Censusit të vitit 2011

4.14.1 Mjedisi socio-ekonomik

Ndihma Ekonomike

Niveli i lartë i varfërisë, sidomos për zona të caktuara, në Bashkinë e Pogradecit konfirmohet edhe nga të dhënat që ekzistojnë për Ndihmën Ekonomike, me të cilën trajtohen familjet në nevojë. Sipas të dhënave të bashkisë janë 4 509 familje në të gjithë Bashkinë që trajtohet me ndihmë ekonomike, duke përbërë rreth 16% të totalit të gjithë familjeve sipas regjistrit të gjendjes civile. Duke marrë parasysh faktin që regjistri i gjendjes civile përgjithësisht përmban popullsi më të madhe se sa ajo që është realisht prezente në zonë (përfshin emigracionin dhe migrimin e brendshëm) kjo shifër (16%) është edhe më e madhe në realitet. Duke veçuar Bashkinë e Pogradecit dhe Njësinë e Buçimasit (ku trajtohen respektivisht 7% dhe 12% e familjeve të regjistruara në gjendjen civile) në të gjitha njësitë e tjera shifrat janë shumë të larta, duke shkuar deri në pothuajse 1 në 3 familje të trajtuara me Ndihmë Ekonomike në Velçan, Udenisht, Trebinjë apo Dardhas. Për të vlerësuar edhe nga një burim tjetër këtë situatë që duket tejet problematike, janë parë edhe të dhënat e Censusit 2011, të rikategorizuara sipas njësive të bashkisë së re. Duke pasur parasysh që Censusi ka marrë në analizë vetëm familjet që janë gjetur si rezidente në zonë, shifrat janë edhe më të larta, duke shkuar edhe në 1 në 2 familje të trajtuara për zona si Dardhasi (50%), Udenisht (53%) dhe Velçan (57%). Mesatarja e bashkisë është shumë më lart se mesatarja kombëtare që ka dalë nga Censusi, duke nënkuptuar një nivel shumë më të lartë varfërie në këto zona. Bashkia e Pogradecit (me fonde të deleguara) paguan rreth 17 milion lekë (të reja) në muaj për këto familje (që përkthehet në rreth 1,5 milion Euro në vit për ndihmë ekonomike). Duhet specifikuar që shuma mesatare që përfitojnë familjet në ndihmë ekonomike është rreth 3 700 lekë/muaj. Nisur nga shifra e pasqyruar nga bashkia Pogradec, numri i personave që trajtohen me

Ndihmën Ekonomike është 4509, pra 16% e numrit të familjeve në Bashkinë Pogradec. Fshati Udenisht ka numrin më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike 829, pra 37 % e numrit total të familjeve. Në vend të dytë është fshati Velçan 298, përkthyer në përqindje 32% e numrit total të familjeve për këtë njësi. Ndërsa qendra Pogradec ka numrin më të ulët të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, 808 nga 12 367 gjithsej, pra 7% e familjeve të kësaj njësie përfitojnë ndihmë ekonomike.

"Pagesa e Aftësisë së Kufizuar" (PAK) sfida është për të përmirësuar cilësinë e jetesës nëpërmjet kësaj skeme dhe jo thjesht ndihmë monetare. Aktualisht PAK është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre. Aktualisht Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më i lartë se masa e NE-së. Fondi PAK dhe NE për rrethin e Pogradecit, gjatë periudhës janar 2016

Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social

Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale. Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabël në nivel kombëtar. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që mund të mbulojë më gjerë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase, veçanërisht në zonat rurale dhe jo vetëm në ato urbane. Kryesisht organizatat aktive në qytetin e Pogradecit ofrojnë shërbime sociale në fusha të ndryshme si psh: Mbështetje për komunitetin Rom dhe Egjiptian; mbështetje për target grupin e persona që janë të gjymtuar duke i pajisur ato me proteza; mbështetje social-psikologjike për personat e dhunuar fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht; lobim në institucionet vendore dhe qendrore të vendit për të drejtat e barazisë gjinore; mbështetje të fëmijëve jetimë; mbështetje për fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

4.15 ANALIZA SWOT / Konkluzione & Rekomandime

ANALIZA E PIKAVE TË FORTA E TË DOBTA, SI DHE E MUNDËSIVE DHE KËRCËNIMEVE

Tab. - 34 *Analiza SWOT*

S

-Pozicion gjeografik i favorshëm si pjesë e Korridorit të VIII dhe pjesë e rrjeteve të zonave natyrore të mbrojtura.
-Shtrirja pranë liqenit të Ohrit
-Pasuri të mëdha natyrore, monument arkeologjike, gjeomonumente, monumente kulkturore, historike dhe natyrore të shumta (Kalaja, Monumentet e Selcës, Bazikila e Linit, Guri i Kamjes, Burimi i Drilonit, Guri i Nikës, liqenet e Lukovës etj).
-Bashkia Pogradec ka pasuri të shumta minerale të hekur nikelit (Gur I Kuq, Gur I Përgjegjur, Gradishtë, Rodokal, Debrovë).
-Përmbajtje të lartë të lëndëve të para ergjitike si qymyri (Velçan vendburimi Dardhas – Vërdovë, vendburimi Grunjas, Malinë, Potkozhan, Qafëpanjë – Llëngë).
- 70% e popullsisë, moshë aktive për punë.

W

- Zhvillimi i territorit udhëhiqet nga zhvillime spontane të pabazuara në dokumen-teplanifikimi dhe kryesisht në bazë të zhvillimeve individuale.
- Nivele të larta të ndotjes së ajrit nga pluhurat PM, 10 dhe PM 2,5 dhe CO.
- Prezencë e pikave të nxehta mjedisore (Guri i Kuq, fabrika e përpunimit Fe – Ni,
- Damba mbi Udënisht dhe Pika e depozitimit të mbetjeve).
- Sistemi hekurudhor dhe ujor është jashtë funksionit.
- Niveli i lartë i papunësisë dhe analfabetizmit në zonat rurale.
- Ka mungesë të infrastrukturës bujqësore; veçanërisht të pikave të grumbullimit dhe sistemeve të vaditjes dhe kullimit.
- Toka bujqësore është e pakët dhe e refuzuar
- Mungesë e strukturave akomoduese për turistët.
- Administrata publike e papërgatitur nga ana organizative dhe financiare për të përballuar zgjerimin e territorit dhe ofrimin e shërbimeve pas ndarjes territoriale.
- Situatë e vështirë financiare, detyrime të shumta të papaguara
- Mungesë e bazës së të dhënave mbi pronën publike
- Gjendje fizike e keqe e infrastrukturave rrugore në territorret e ish- komunave
- Mungesë e dokumenteve strategjike lokale mbi sektorin e turizmit
- Zona të caktuara rrezikojne përmbytjen për shkak të proçeseve erozive
- Shfrytëzim jo- efiçent i potencialit turistik të vijës liqenore

O

- Mundësi bashkëpunimi ndërkufitar me Shtetin Maqedonas (Ohër, Strugë).
- 59% e popullsisë jeton në zonat rurale, kjo i jep mundësi zhvillimit të bujqësisë dhe blegtoirisë.
- Kualifikimi i fuqisë punëtore drejt sektorit të bujqësisë dhe turizmit nëpërmjet shkollave profesionale.
- Bazuar tek kushtet fizike dhe natyrore bashkia mund të zhvillojë turizmin multisezonal.
- Aksi i ri lidhës Qukës – Qafë Pllocë mundësi shumë e mirë për zhvillimin e zonës së Mokrës dhe lidhjen më të mirë me Bashkinë Korçë dhe pjesën tjetër të territorit të bashkisë Pogradec.
- Mundësi për mbrojtjen e peisazhit të mbrojur dhe Liqenit të Ohrit nëpërmjet programeve ndërkombëtare.
- Mundësi i rivitalizimit të transportit hekurudhor nëpërmjet programeve ndërkombëtare
- Mundësi e zhvillimit të turizmit rajonal (Ohër, Strugë, Korçë).
- Menaxhim e integruar të mbetjeve nëpërmjet Landfill-it të Maliqit.

T

- Projeksion në rënie i popullsisë në 2031 në 81,488 banorë (10.000 banorë më pak).
- Mosmarrja pjesë në skemat e subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë do të ulë mundësitë për zhvillimin e bujqësisë.
- Rreziku i mosofrimit ndihmës nga qeveria qëndrore, Fondi i rajoneve apo Ministria e Financave për shlyerjen e detyrimeve të papaguara.
- Konkurushmëri e lartë në sektorin turistik dhe bujqësor nga Bashkia Korçë dhe Komuna e Strugës dhe e Ohrit.
- Konkurueshmëri e lartë e ne sektorin bujqësor nga Bashkia Korçë dhe shteti Maqedonas

4.15 PROJEKTET PILOTË

Projektet test janë propozuar me qëllim që të testojnë veçori të caktuara të zhvillimit nga prioritetet e bashkisë. Zhvillimi i tyre pritet të promovojë mënyrën e re të drejtimeve prioritare që do të marri bashkia, si nga pikëpamja investimit ashtu edhe nga pikëpamja e funksionalitetit. Në territorin e bashkisë Pogradec janë përcaktuar dy projekte kryesore pilot të cilat janë identifikuar në bashkëpunim të ngushtë me grupin e punës dhe komunitetin. Këto projekte janë përcaktuar të detajohen më tepër se të tjerat, pasi për bashkinë Pogradec përbëjnë një potencial të fortë për zhvillimin e tij si nga ana e zhvillimit të territorit si dhe për zhvillimin ekonomik në tërësi.

Plani i Përgjithshëm Urban propozon projekte të tipitit Pilot, në rastin e Pogradecit përgjate rrugës Pogradec Tushemisht në të djathtë të saj mendohet të ndërtohet një kuartall apo lagje e përbërë nga një bashkësi pallatesh 4-5 katësh të distancuar nga njeri-tjetri dhe të distancuar nga liqeni, të cilat kërkojnë një diskutim më të madh. Ne do të mendonim se ndërtimet pranë Liqenit në segmentin boshllëk urban midis qytetit dhe Drilonit duhet me patjetër në anën e djathtë të rrugës dhe mund të prezantohen në formë shkallarësh, ku vija e parë të jetë një katëshe për njësi sherbimi, vija e dytë me tre kate dhe vija e tretë me 5 kate, shoqëruar me distanca dhe hapësira distancë publike.

Ne do të propozonim që segmenti ekologjik Pogradec-Tushemisht të ishin edhe të lidhur apo të bashkuar, edhe të ndarë, në mënyrë të tillë që secila zonë të ndiente frymëmarjen e vet, brenda një bashkësie të madhe. Në këtë kuadër, midis Pogradecit dhe Tushemishtit mund të ketë vend për ndërtime, por jo që ta lidhi 'mot a mot' apo fizikisht Pogradecin me Tushemishtin. Kjo do të thotë ndryshe nga plani pilot i propozuar të kemi një lagje midis Pogradecit dhe Drilonit, me hapësira të tipit 'Gap' ose ndryshe me ndërprerje.

Projekti i parë pilot shtrihet në NjA Buçimas dhe konkretisht në fshatin turistik Tushemisht dhe përgjatë rrugës Pogradec – Tushemisht, vazhdimi i rrugës së vilave deri në afërsi të hotel Volorekës.

Fig. – 98 *Projekti pilot në Tushemisht, Buçimas*

Ky projekt pilot është një koncept i mundshëm i zhvillimit të kësaj zone dhe sigurisht në detajimet teknik të mëvonshme mund të pasurohet me elementë të tjerë shtesë ose mund të modifikohet. Principi bazë i këtij projekti është përdorimi i rrugës paralele të bregut të liqenit, si akses kryesor ndaj zonës së "agri- hoteleve". Agri - hotelet janë hotele në funksion të turizmit liqenor të cilat rrethohen nga parcela me përdorim bujqësor. Ndërkohë, rruga e bregut të liqenit hiqet për t'u zhvendosur me një shëtitore e cila do të përmbajë në të hapësira për kafe, park lojrash për fëmijë, korsi biçikletash si dhe zona vrapimi dhe fitnesi. Në zonë propozohen tre zona parkimi për vizitorët, klubet e lundrimit, si dhe rrugë aksesi të reja, të cilat lidhin hotelet me rrugën kryesore. "Agri – hotelet" e propozuara në këtë projekt pilot përfaqësojnë një tipologji alternative të zhvillimit të territorit, e cila i jep mundësinë turistëve të kenë një lidhje më të fortë me liqenin e Ohrit dhe fushat me prodhimet bujqësore. Ato do të kenë një densitet të ulët dhe çdo apartament do të ketë pjesën e parkimit. Midis çdo hoteli ka një distancë prej 100m. Kjo tipologji është aplikuar në vitet 1950 në Amerikë dhe ka evoluar me kohën.

Fig. – 99 *Koncept ideja e projektit pilot, Tushemisht*

Projekti i dytë pilot shtrihet në NjA Udënisht dhe konkretisht në fshatin Lin dhe propozimet e tij ndikojnë, pothuajse gjithë territorin e fshatit. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë ndërtimin e një hoteli shumëkatësh, i cili do të shërbejë edhe si një element arkitekturor spikatës i fshatit, përmirësimin sistemimit të ujrave të zeza, propozimin e një shkolle të re dhe ambjente sportibe, shtrimi i rrugës kryesore si dhe sigurimin e pikave për marrjen me qera të biçikletave, propozmin e një hoteli të tipit Bad and breakfat si qëndër kryesore për infomrimin e vizitorëve, zgjatimin e rrugicave në formën e urave të drurit drejt liqenit dhe pyllëzimin e kodrës së Linit.

Vlen të thuhet se këto projekte janë dy projekte pilot që paraqesim një koncept – ide të mundshme por jo përfundimtare. Janë disa koncepte që mund të ndryshojnë dhe evolojnë gjatë hartimit të projektit teknik.

Fig. – 100 *Projekti pilot Lin, Udënisht*

Fig. – 101 *Koncepti i zhvillimit të fshatit Lin*



SEKSIONI 5
TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0")

5.1 Toka

Përdorimi i tokës bujqësore dhe pyjeve

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, vëllimi i përdorimit aktual të tokës bujqësore dhe pyjeve do të mbetet në nivelin aktual. Infrastruktura përkatese nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive; prandaj krijimi i kësaj infrastrukture mund të jetë i paplanifikuar, gjë e cila do të ketë një efekt negativ në përdorimin aktual të hapësirës, si dhe në vëllimin e përdorimit aktual tokës bujqësore dhe pyjeve.

Përdorimi i burimeve natyrore

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura perkatëse nuk do të ndërtohet apo modernizohet në mënyrë të tillë që dheu i gërmuar dhe mbetjet nga ndërtimet të trajtohen, në mënyrë që shumica e tyre të ripërdoret në një kantier ndërtimi të infrastrukturës apo të riciklohet në materiale ndërtimi. Ndërhyrjet infrastrukturore të paplanifikuara apo të rastit, pengojnë gjithashtu përdorimin e sasive të mëdha të materialeve të ndërtimit të prodhuara nga riciklimi i këtyre materialeve në kantieret e tjera të ndërtimit apo nga përpunimi i llojeve të tjera të mbetjeve, të cilat përdoren për të prodhuar materiale ndërtimi të cilësisë së njëjtë me materialet e ndërtimit që merren direkt nga burimet natyrore.

5.2 Ajri

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifikë, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rrugë, të cilat pengojnë trafikun e qetë dhe me barrë më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale. Pavarësisht nga fakti se kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturore pritet të vijë nga sektori i transportit, dhe më konkretisht nga përdorimi i automjeteve me më shumë efiçencë energjetike, trafiku i ç'organizuar dhe kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit, do të sillte si

pasojë tejkalimin e maksimumit të emetimeve të ndotësve, sidomos të NOx dhe CO. Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në zonat urbane dhe arritja e standardeve të përshkruara në lidhje me cilësinë e ajrit të ambientit janë objektivat kryesore të cilat bazohen në masat për mbrojtjen e mjedisit në Plan. Në qoftë se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet dhe në këtë mënyrë nuk do të mundësohet ulja e nivelit të emetimit të ndotësve që kontribuojnë në shfaqjen e grimcave PM10 dhe PM2,5. Kështu që nuk do të realizohet objektivi i përcaktuar mjedisor në lidhje me cilësinë e ajrit deri në vitin 2020.

5.3 FAKTORËT KLIMATIKË

5.3.1 Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike nuk do të trajtohet në mënyrë sistematike gjatë planifikimit dhe rregullimit. Theksi kryesor është vendosur në reduktimin e ndjeshmërisë ndaj përmbytjeve, borës dhe ngricave. Çdo ndërtim i ri apo rikonstruksion i infrastrukturës duhet të analizohet në lidhje me ndjeshmërinë e tij ndaj fenomeneve ekstreme të motit, ndërsa kostot financiare të dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës duhet të vlerësohen paraprakisht. Bazuar në analizën e ndjeshmërisë së infrastrukturës ndaj fenomeneve ekstreme të motit, duhet të planifikohen masa të qëndrueshme për të reduktuar efektet negative të ndryshimeve klimatike në infrastrukturë në nivele ekonomikisht dhe shoqërisht të pranueshme. Në mungesë të politikave, investimeve në infrastruktura mbrojtëse dhe të manaxhimit të fragmentuar të burimeve natyrore në pellgjet ujëmbledhëse, do të kenë efekte negative si:

- humbje në tokën bujqësore dhe në disa territore të banuara afër fushave;
- rritje e presionit ndaj qendrave urbane për strehim, punësim dhe infrastruktura;
- tendenca për të lëvizur më në thellësi të *hinterland*-it malor, por kushtet e vështira gjeografike dhe klimatike, si dhe mungesa e masave institucionale ndaj efekteve të ndryshimit klimatik, do të frenojnë dëshirën që këto zhvendosje të ndodhin në masë dhe të organizuara.

Si rezultat, zhvendosjet sporadike do të fragmentojnë më tej territorin duke rrezikuar burimet më të vlershme që do të pakësohen gjithnjë e më shumë. Njerëzit do të zgjedhin të vendosen në zonat më lehtësisht të arritshme dhe me burime më lehtësisht të vjelshme.

5.3.2 Masat zbutese ndaj ndryshimeve klimatike

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifikë, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rrugë, të cilat pengojnë trafikun e qetë dhe me barrë më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale. Zbatimi i masave për zbutjen e ndryshimeve klimatike duke ulur emetimet e gazit serrë në sektorët që mbulon Vendimi Nr 406/2009/KE do të jetë dukshëm në rrezik. Edhe në

rastin e emisioneve të gazrave me efekt serë, kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturore pritet të vijë nga sektori i transportit, dhe më konkretisht nga përdorimi i automjeteve me më shumë efiçencë energjetike. Megjithatë, trafiku i ç'organizuar dhe i kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit e reduktuar gjithnjë e më shumë në qendrat urbane, do të sillte si pasojë tejkalimin e maksimumit të emetimeve të gazrave me efekt serrë të përcaktuara deri më vitin 2020.

5.4 UJI

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura dhe politika përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj, ndërtimi i infrastrukturës së re mund të mos marrë në konsideratë karakteristikat ekzistuese natyrore (sipërfaqet mbrojtëse, përshkueshmërinë e tokës dhe ndikimin në cilësinë e ujërave nëntokësore, etj). Rreziku i aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të cilat ndikojnë në statusin kimik të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë është dukshëm më i madh në sektorin e transportit. Plani parashikon edhe rivitalizimin e transportit hekurudhor. Në qoftë se Plani nuk adaptohet, transporti i mallrave më i shpeshtë në infrastrukturën rrugore, do të rrisë mundësinë e ndotjes për shkak të aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të substancave të rrezikshme.

5.5 BIODIVERSITETI

Me adaptimin e Planit, infrastruktura përkatëse do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Për shkaqet e sipërpërmendura, infrastruktura do të planifikohet, që do të thotë gjithashtu më pak nevojë për të kryer ndërhyrje të reja infrastrukturore. Si rezultat, hapësira nuk do të fragmentohet në mënyrë të panevojshme dhe nuk do të preken rrugët migratore të kafshëve të egra. Masat e aktiviteteve të Planit duhet të përfshijë krijimin e kalimeve të përshtatshme për kafshët e egra nëse fragmentet ekzistuese provojnë se janë të papërshtatshme apo të pakalueshme (vendkalimet janë penguar nga gardhet ose vdekshmëria e kafshëve në rrugë është rritur). Nëse masat e Planit nuk zbatohen, vdekshmëria e kafshëve në rrugë dhe lidhjet midis popullatave mund të përkeqësohen, gjë e cila mund të ndikojë në biodiversitetin e zonave përkatëse. Masat e parashikuara përfshijnë masa për të reduktuar nivelin e zhurmës në mjedisin natyror, të cilat do të kenë një ndikim lokal pozitiv të përhershëm te kafshët e egra. Nëse masat nuk zbatohen, zhurma në mjedisin natyror do të rritet për shkak të ndërhyrjeve infrastrukturore të pakontrolluara dhe të paplanifikuara.

5.6 MBETJET

Sektori i grumbullimit / trajtimit / riciklimit të mbetjeve është një ndër sektorët më problematikë në Shqipëri, për vetë natyrën e tij ndërlidhëse me një sërë sektorësh të tjerë (ajri, toka, uji, shëndeti etj). Aktualisht ky sektor ka një sërë problematikash, të cilat kanë gjetur reflektim dhe adresim në Plan.

Këto problematika përfshijnë: praninë e zonave të ndotura të njohura si Hot-Spote që akoma nuk janë sistemuar; vend depozitime të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme); kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues apo mungesa e tyre aty ku duhet; menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele të ulëta; mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore; mungesa e landfilleve për mbetjet e rrezikshme; ndarja në burimin e mbetjeve / riciklimi akoma nuk praktikohet në Shqipëri; kuadri ligjor, megjithëse i përgjigjet kërkesave të BE-së, nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime; etj. Nëse Plani nuk adoptohet kjo situatë jo vetëm që do të vijojë të mbetet problematike, por do të përkeqësohet më tej për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara në të gjithë sektorët përfshirë edhe planifikimin hapësinor / urban.

5.7 ZHURMA

Skenari 'mos bëj asgjë' nuk përfshin asnjë ndërhyrje infrastrukturore, me përjashtim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese. Nëse aktivitetet e parashikuara në Plan nuk zbatohen apo përfshihen në programet e detajuara të masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma, niveli i zhurmës do të rritet, veçanërisht më shumë për shkak të zhvillimeve te pakontrolluara infrastrukturore. Prandaj, objektivi i arritjes së standardit të BE-së mbi zhurmën (LAeq / ditën në 55dB (A) dhe LAeq / natën në 45 dB (A)) nuk do të realizohet. Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara ne Plan do të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri, dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture. Nëse masat e politikave të Planit nuk zbatohen, ekspozimi i banorëve ndaj zhurmës do të rritet. Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e BE-së, menaxherët e burimeve individuale të zhurmës duhet të rehabilitojnë zonat me ndotje akustike të tepërt. Megjithatë, përmirësimet e efektshme të mjedisit mund të kryhen vetëm nëpërmjet masave të kombinuara, logjistike dhe organizative.

5.8 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE

Pavarësisht nga disa investime të fundit në rrjetin e rrugëve lokale dhe rajonale, cilësia e infrastrukturës së transportit në Shqipëri mbetet e ulët dhe ka dallime të konsiderueshme rajonale në aspektin e qasjes ndaj tregjeve dhe shërbimeve themelore. Cilësia e ofrimit të shërbimeve në zonat rurale është ende e ulët dhe pjesa më pak e pasur e popullatës ka qasje të kufizuar në shërbimet sociale, veçanërisht shëndetësi dhe arsim. Kufizimet e transportit publik dhe kostot e larta ndikojnë në lëvizshmërinë e njerëzve dhe qasjen ndaj mundësive (dmth të punësimit) jashtë fshatrave. Menaxhimi i vazhduar i aseteve, mirëmbajtja rutinë e rrugëve, dhe qasja më e besueshme në transportin publik mund të zvogëlojë shpenzimet dhe të sjellë përfitime të rëndësishme njësoj si për familjet, fermerët dhe firmat. Edhe pse shkalla e aksidenteve fatale është në rënie (kjo shkallë është pothuajse përgjysmuar gjatë dekadës së fundit), siguria rrugore në Shqipëri është një problem i madh social dhe i shëndetit publik. Qeveria është fokusuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të sigurisë rrugore, në vend që t'i japë vëmendje auditimeve të sigurisë dhe përmirësimit të pikave të errëta, inkorporimit të standardeve të sigurisë në projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut. Në qoftë se Plani nuk do të adaptohet dhe masat nuk do të zbatohen,

aksesueshmëria do të mbetet një shqetësim i rëndësishëm, dhe çështjet e sigurisë do të vazhdojnë të jenë një problem serioz. Si pasojë nuk priten efekte pozitive në mënyrën dhe kushtet e jetesës në qendrat e banuara.

5.9 TRASHËGIMIA KULTURORE

Në qoftë se Plani nuk adaptohet dhe nuk zbatohen aktivitetet infrastrukturore, integriteti dhe karakteristikat e zonave dhe njësive të trashëgimisë kulturore, sidomos të peizazheve kulturore, peisazheve historike, zonave të trashëgimisë urbane dhe zonave të tyre të ndikimit, dhe vendeve arkeologjike, do të ruhen në një masë më të madhe. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të kenë një efekt negativ në trashëgiminë kulturore.

5.10 PEIZAZHI

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, dhe aktivitetet infrastrukturore nuk zbatohen, integriteti dhe tiparet e peizazheve të jashtëzakonshëm dhe zonave te peizazhit me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar, do të ruhen. Imazhi i peisazheve me cilësi të larta i zonave të ruajtura mirë dhe me elementë të rëndësishëm kulturor, do të ruhet. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në degradimin e peizazhit.

5.11 SEGMENTI I KORRIDORIT EKOLOGJIK URBAN (KEU), LIN - POGRADEC - TUSHEMISHT

Plani i Përgjithshëm Urban mund të parashikojë korridore ekologjike urbane, nga niveli lokal apo ndër rajonal deri në ato ndërshtetëror. Konkretisht, rajoni i Pogradecit mund të ketë një korridor ekologjik kulturor urban (KEKU) në rang lokal, siç mund të jetë ai lindje perëndim Lin-Pogradec-Tushemisht, i cili mund të vazhdojë duke marrë kuptimin e një KEKU regjional në drejtim të Tomorrit. Nga ana tjetër, ky segment mund të jetë pjesë e një KEKU ndërshtetëror, si vazhdimësi e korridoreve kulturore historike Vlorë-Himarë, Berat-Skrapar, Pogradec-Korçë, Ohër-Manastir-Selanik deri në Varna-Burgas të Bullgarisë. Infrastuktura e këtij korridori jep lehtësira, sikundër ka dhënë në histori për shkëmbime tregtare, etnokulturore, sportive, etj. Secili segment i këtij KEKU ka elementet e vet biometrik, ku bashkon dhe lidh zona brenda një bashkie, ndërbashkie deri në ndërshtetëror. Për korridorin lokal, sigurisht do të aplikohen elementet funksional të lejueshëm. Ky segment si pjesë përbërëse e korridorit ekologjik urban, duke qenë se ka një potencial të madh për shfrytëzimin rekreativ është supozuar si një zonë përdorimi rekreative dhe peisazhike, për faktin e shtrirjes në mes të dy zonave kodrinore me pyll masiv, me prani të pasqyrave të mëdha ujore të Liqenit te Ohrit, pasojat e së cilës ndihen, duke i dhënë një

veçori tepër specifike dhe vlera shumë të mëdha turistike, ekologjike, etj. Nën këto kushte, e kemi quajtur korridor ekologjik urban që presupozon të ketë këto parametra urbane:

ADN-ja e zonës	ruajtje e kodit gjenetik të saj që parapërcakton drejtimin kryesor të zhvillimit urban të kësaj zone, e cila në rastin tonë do të jetë zonë peisazhike dhe ekologjike;
Marrëdh.me qytetin	ky segment i KEU në marredhënie me qytetin e madh (Pogradecin) përbën atë që ndryshe quhet zone e jashtme, zonë thekër, zonë periferike e tipit qytet kopësht deri në konceptet zonë turistike;
Plan. i territorit	do të jetë ekologjik, turistik, bujqësor dhe banim që do të thotë ruajtje dhe rivitalizim i tokave bujqësore, ruajtje dhe rivitalizim i zonave oaze ekologjike dhe kthim në kopshte të tokës në përdorim ose të hapësirës personale që ka në zotërim;
Strukura urbane	me orientim ekologjik, historik, bujqësor, duke i dhënë akses banorëve drejt natyrës;
Zonat hapësinore	funksionet territoriale shumë më të larta se ato personale, ku ruhet toka bujqësore, ku arkitektët dhe urbanistët mund të projektojnë në formën e artit figurativ të natyrës, duke synuar ta paraqesin natyrën, jo siç është në të vërtetë por siç duhet të jetë në idealet e tyre.
Zona e banimit	do të jenë e tipit rezidencial, ku do të përmbushet tre qëllimet bazë të veprës urbane në harmoni me tipologjinë e mjedisin rrethues, si: 1. Rehatia që i referohet qëllimit funksional të projektimit, pra që edhe të pëlqehet nga njerëzit. Si e tillë vepra projektohet e lehtësuar, mbizotëron ndërtimi me dru, e kombinuar me rasa shkëmbi, me çati, me dritare të mëdha për përfitim energjie dhe ndricim natyror, me ngjyrë ku mbizotëron e çelta; 2. Qëndrueshmëria që i referohet fortësisë së bazamentit ose të shkëmbit rrënjësor që në rastin tonë është shkëmb kompakt, i përshtashëm për truallmbajtës; 3. Admirimi që do të thotë se vepra urbane me estetikën e saj në përputhje me kodin gjenetik të mjedisit do të ketë dhe pranueshmërinë nga publiku.
Zona e ndërtimit	zonë fshati me dendësi të ulët
Koif. i zënies urbane	0.1 - 0,15
Koif. i bazamentit	0.1 - 0,2
Intesiteti i ndërtimit	0.2 - 0.3
Numëri i kateve	2 plus papafingo (vilat), jo më tepër se 8m
Nr i apartamenteve	1-2, mundësisht shtëpi të destinuara për një familje
Pozicioni i banorit	dominon mbi vizitorin
Kufijt territorial	të dallueshme dhe të vendosura mirë, por jo me shkallë kujdesi të tepruar, duke bërë kështu hapësirën personale të shquar mirë;
Rreziku gjeo-natyror	Në këtë segment të KEU ndodhen sheshe me rrezik në lidhje me kushtet gjeologo-inxhinierike, për shkak të pjerrësisë së formacioneve shkëmbore, sikundër ky segment nuk ka sheshe me rrezik në lidhje me sizmologjinë,

	përmbajtjen e radonit dhe erozionin. Nuk ka as sheshe që të pësojnë zhytje, e as përmbytje.
Privacia personale	raporti i privacisë personale është më i lartë dhe më i fortë ndaj privacisë së grupit dhe/ose komunitetit, por me mekanizma kontrolli të privacisë;
Paketa e sjelljeve	ndër elementët e paketës së sjelljeve (bibliotekë, librari, stadium, teater, kinema, muze, pyll, qendra fetare, qendër tregetare, etj.) për këtë segment të KEU mund të projektohet një teatër veror pranë liqenit të Ohrit, një qendër fetare, një a dy zona të mbrojtura monument si dampa e Gurit të Kuq;
Gardhet rrethues	gardh me brezë bimësh të kombinuar me pemë me lartësi më të lartë se ndërtesa. Nga ana tjetër ndërtohen hapësira (zona) të mbrojtura, ku njerëzit aty ku janë nxiten të kryejnë mbikqyrjen informale dhe njerëzit të përkrahin kohezionin social, duke u ndjerë pronar.
Ngjyra	veprat rezidenciale mund të projektohen me ngjyrë portokalli, si ngjyrë e ngrohtë, pozitive dhe nxitëse në mënyrë që të kryejë më së miri qëllimin pse banorët vijnë e jetojnë aty, duke ndihmuar trupin që të karikohet me gjallëri elektrike dhe të rregullojë akumulimin e ushqimit, gjendrat tiroide, etj.
Ndricimi	ndriçimi pothuajse natyral, me shumë dritare për faktin që do të shërbejnë si një lidhje pamore me mjedisin dhe si burim në tejçimin e dritës së diellit;
Estetika	Vepra urbane në këtë segment të KEU presupozon të ketë karaktere të estetikës të tipit formal që përfshin përmasa si forma, propocionin, kompleksitetin, risinë dhe ndriçimin, që përkthehet se banesat rezidenciale duhet të jenë të thjeshta, të ulta, të ndriçuara, jo e paharmonizuar me mjedisin.
Zhurmat	ato mendohet të jenë të rendeve më të ulta se 50 decibël për ditën dhe 25-30 decibël për natën;
Qendra tregtare	mungesë totale të tyre, pa prani të hapësirave sociopetale, ku njerëzit ofrohen, me mundësi shumë të ulta të shërbimeve kafene, oborre, lulishte, restorante, por me qendra të vogla tregtimi brenda hapësirave rezidenciale.
Elementët urban	Restaurim-Rehabilitim Kalanë e Pogradecit dhe qendrën e banesave palafite pranë Linit me mjedise të përshtatshme shlodhëse, Parkim Automjetesh, Pikë Mbërritje, Biletari, Stacion, Biletari trenit ekologjik afër bregut, Stacion Teleferik në afërsi të Kalasë – Ngjitje përgjatë kodrës së kalasë), Sistem pastrimi të ujit, Parkim biçikletash, Shëtitore dhe një shesh i përbashkët për këmbësorë, pa automjete, ku njerëzit mund të mblidhen, të ulen, të sodisin dhe të shëtisin, duke nxitur te ta shkallën e kohezionit dhe të reaksionit pozitiv për mbrojtjen e territorit, ku në kësi rastesh krijohet "sensi i komunitetit ose "dashuria për vendin" ose "lidhja sociale me territorin" ku jeton;
Energjia	Sigurimi i energjisë kryesisht me alternativë miqësore me mjedisin që do të thotë prodhim energjie të gjelbër nga sisteme mundësisht hidrik, ose erë, ose gjeotermike ose diellore ose biomasë, por nën moton shtëpi me energji

	pozitive. Pra, mund të marrësh nga rrjeti kombëtar, por duhet të japësh pak më tepër nga sigurimi alternativ personal.
Termoizolimi	nxitjen e psikologjisë së kursimit me anë të masave termoizoluese;
Ndotja elek.manj.	asnjë shtëpi rezidenciale apo njësi shërbimi nën linjat 220kV a më tepër duke respektruar distancat 50-100m nga aksi i linjës.
Zgjidhjet mjedisore	krijimi i një parku me vlerë lokale dhe të një tjetri me vlerë kombëtarë si zona ku rezidentët dhe më gjerë gjejnë shërim të shqetësimeve urbane. Përpos këtyre, krijimi i parqeve sportive me vlerë tradicionale, ku mund të luhen lojra si mundje, përthyerje duarsh, etj., ose aventureske ku mund të zhvillohen vizita në shpella, ngjitje në mal, vozitje në Liqen, qitje me piatel, etj. të mos mungojnë shkallët e emergjencës; zjarrfikësit të kenë rrugët e tyre të hyrjes; linjat telefonike, interneti e antenat jo vetëm të jenë të përbashkëta, por të sistemohen nëntokë;
Sigurimi i ujit	sigurimi i ujit të jetë i përbashkët nga rrjeti i ujësjellësit, por edhe nga mundësia personale duke shfrytëzuar ujëra nëntokësorë, si për të pirë, dhe për të vaditur dhe ose për përdorim pishinash;
Men. mbetjeve	ndarja e tyre në burim me pesë llojë koshash plastik dhe nxjerrja e tyre me orar e me ditë të caktuar për tu tërhequr nga Nj. Administrative;
Men. i Ujrave të zeza	për njësitë rezidenciale dhe shërbimi pranë qendrës së fshatit apo rrugës kryesore ato do të menaxhohen duke i mbledhur në kolektor magjistral. Për ato në distancë e të vetmuara do të menaxhohen duke i trajtuar me gropa septike ekologjike me 2-3 dhomëza.
Sistemi rrugor	Mendohet që ky KEU të ketë disa korsi si: korsia e këmbësorit, korsia e biçikletës, korsia e trafikut urban dhe/ose korsia e trenit elektrik, korsi veçmas për lëvizje me karro dhe/ose me kuaj, korsi nacionale.
Roli ekologjik	të ndërtojë kanalet nëntokësorë në të gjitha llojet e rrugëve (primare, sekondare dhe terciare), duke lehtësuar kështu shpërhapjen dhe të zvogëlojë rrezikun e zhdukjes se specieve, si dhe izolimit e gjallesave të vogla. të ruajë të paprekur bregun e Liqenit, duke ruajtur gjallesat ujore. Kurora e pishave të buta, të cilat ndodhen në pjesën veriperëndimore, shumë shpejt do të gërshetohet me kurorat e gështenjave, duke u ndërthurur me to, për përmirësimin e gjendjes fito-patologjike të drurëve, por edhe të vlerave të peisazhit. Në brendësi parku, ka nevojë për një ri-strukturim gjithmonë në funksion të tij si park, por edhe si plotësues të zonës. Lokalet e rinj, së bashku me mjediset e gjelbër rreth tij do të përbëjnë një aktitekturë moderne, funksionale, zbukuruese dhe me efekt tek të gjithë ata që e vizitojnë. Lulishtet e ndërtuara me të gjitha llojet gjethembajtëse e zbukuruese, të shoqëruara me rrugicat e vogla të shtruara me guriçka do të jenë pjesa më funksionale dhe më e domosdoshme për komunitetin.

SEKSIONI 6

BAZA PËR PERGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR

6.1 PERCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE

Bazuar në analizën e detyrimeve të specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë, situatës ekzistuese të mjedisit dhe të ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan, Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore si më poshtë:

Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricikluesshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmet, ujërat bregliqenore dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kane një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve e incineratoreve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proçeseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e riperdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashegimise kulturore.

Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Shpjegimi i percaktimit te objektivave mjedisore jepet ne seksionet ne vijim.

6.1.1 Detyrimet e specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqiperisë

Për të përcaktuar objektivat e rëndësishme specifike, janë përdorur detyrimet e specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë. Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentat përkatëse të planeve, programeve apo politikave mjedisore është paraqitur në Tabelën e mëposhtme:

Tab. – 35 *Konventat e ratifikuara dhe Direkitivat respektive të BE-së dhe të shtetit Shqiptar*

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me SM	Lidhja me OM
Strategjia tematike per Mbrojtjen e Tokes – COM (2006)231. Referenca ne Shqiperi gjendet ne Ligjin nr. 10431 date 9.6.2011 **"Per Mbrojtjen e Mjedisit" (neni 18)**	Duhen marre ne konsiderate pozitat mbi te cilat eshte bazuar hartimi i Direktives qe percakton kuadrin per mbrojtjen e tokes dhe amendon Direktiven 2004/35/EC. Strategjia merr ne konsiderate nje sere funksionesh, diversitetin dhe kompleksitetin e tokes si dhe nje sere procesesh degradimi te cilave ajo (toka) u nenshtrohet. Objektivi strategjik është mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës, bazuar në parimet e mëposhtme udhëzuese: • parandalimi i degradimit të mëtejshëm dhe ruajtja e funksioneve të tokës, kur toka perdoret dhe kur funksionet	Toka	OM 1

	e tokes shfrytezohen, si dhe kur toka sherben si mjedis prites per efektet e aktivitetit te njeritu apo fenomeneve mjedisore; • Rikthimi i tokës së degraduar në një nivel funksionaliteti konsistent të paktën me përdorimin aktual apo të synuar, duke pasur parasysh kostot e restaurimit të tokës.		
Direktiva 2008/98/EC per mbetjet. **Direktiva 2006/12/EC per mbetjet Transpozuar ne legjislacionin shqiptar si VKM nr. 175, date 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025"**	Qellimi thelbesor i te gjitha rregulloreve mbi mbetjet eshte mbrojtja e shendetit te njerezve dhe e mjedisit nga efektet e demshme qe shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, perpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuader mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimi t të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja eshte nje burim i lendes se pare (dhe jo dicka qe duhet shperbere sa me lire qe te jete e mundur), keshtu qe duhet te merren masa per te riperdorur mbetjet sa me shume te jete e mundur. Persa i perket riciklimit, paraqet nje objektive mjedisore qe eshte '55% e mases totale te mbetjeve te riperdoret apo riciklohet, deri ne 2020'.	Toka Mbetjet	OM 2 OM 8

Direktiva 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën. **Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hirdokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Shqiperia i ka perafruar plotesisht keto direktiva permes:** **- Ligjit nr. 162/2014, date 12.04.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " dhe** **-VKM nr. 594, date 10.09.2014 " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit "**	**Direktiva 2008/50/EC përcakton masat që synojnë si vijon:** 1. Përkufizimin dhe përcaktimin e objektivave për cilësi të ajrit të ambientit hartuar në mënyrë të tillë që shmangin, parandalojnë apo reduktojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerëzve dhe në mjedisin në tërësi; 2. Përllogaritjen e cilësisë së ajrit të ambientit në Vendet Anëtare me bazë metoda dhe kritere të përbashkëta; 3. Sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të ambientit në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të monitorojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit; 4. Garantimin se informacioni i tillë mbi cilësinë e ajrit të ambientit do t'i bëhet i disponueshëm publikut; 5. Mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimin e saj në raste të tjera; 6. Nxitjen e rritjes së bashkëpunimit midis Vendeve Anëtare për reduktimin e ndotjes së ajrit. Objektivat e Direktives 2004/107/CE janë të: (a) të percaktoje një vlerë të synuar për përqendrimin e arsenikut , kadmiumit , nikelit dhe benzo (a) pirenit në ajrin e ambientit me qellim shmangien , parandalimin ose reduktimin e efekteve te dëmshme të arsenikut , kadmiumit , nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në shëndetin e njeriut dhe ne mjedis si një i tërë; (b) të sigurojnë, në lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike, që cilësia e ajrit të ambientit është ruajtur atje ku ajo është e mirë dhe është përmirësuar në raste të tjera; (c) të përcaktojë metodat e përbashkëta dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe per depozitimin e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike; (d) të sigurojë që informacioni i duhur mbi përqendrimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe mbi depozitimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike është marrë dhe të siguroje se ajo është vene në dispozicion të publikut.	Ajri	OM 3
Strategjia e BE per adaptimin ndaj	Objektiva e pergjithshme e Strategjise se BE per adaptimin eshte te kontribuoje ne nje Evrope me elastike ndaj klimes. Kjo	Faktoret klimatik	OM 4

ndryshimeve klimatike (COM (2013)	do te thote rritjen e punes pergatitore dhe te kapacitetit per t'ju pergjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike ne nivel lokal, rajonal dhe kombetar, duke zhvilluar nje perfrim logjik dhe duke permiresuar koordinimin. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, ne Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër te Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCC), që nga Janari 1995. Shqipëria ka përgatitur dy Komunikime Kombëtare në 2002 dhe 2009, si dhe ka finalizuar me sukses vete vlerësimin për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC. Ne vitin 2016 eshte parashikuar te perfundoje hartimi i Strategjise Kombëtare dhe Planit Kombëtar te Veprimit për Ndryshimet Klimatike, me koheshtrirje 2016-2030.	e	
Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emetimet e gazeve serë që t'i plotësojnë detyrimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazeve serë deri më 2020	Vendimi 406/2009/EC percakton kontributin minimal te vendeve anetare per te arritur detyrimin per zvogelimin e emetimit te gazeve 'sere' per periudhen nga 2013 deri ne 2020 per emetimet e gazeve 'sere' qe mbulohen nga ky vendim si dhe rregullat per arritjen e ketyre kontributeve dhe vleresimin e tyre. Angazhimi per reduktimin e emetimeve te gazeve 'sere' i referohet: – *emetimeve nga perdorimi i lendeve djegese ne shtepi dhe ne sektorin e sherbimeve;* – emetimeve nga perdorimi i lendeve djegese ne sektorin e transportit; – emetimeve nga perdorimi i lendeve djegese ne ndermarrjet e vogla dhe te mesme dhe ne sektorin e energjise; – emetimet qe çlirohen nga sektori i energjise; – emetimet nga proceset industriale; – perdorimi i tretesve dhe produkteve te tjere; – emetimet nga bujqesia; – emetimet nga administrimi i mbetjeve. – Shqiperia akoma nuk e ka transpozuar kete vendim; eshte parashikuar te behet ne vitin 2018. Pra bie brenda afateve kohore te realizimit te Planit, keshtu qe dipsozitat e ketij vendim	Faktoret klimatike	OM 4
Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në egjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të	Direktiva përcakton masat për arritjen e objektivit strategjik të statusit të mirë ekologjik për ujërat në vitin 2015.	Uji	OM 5

cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)			
Direktiva 2008/56/EC qe vendos kuadrin per veprimin e komunitetit ne fushen e politikes mjedisore te liqenit (Direktiva Kuader e Strategjise Liqenore).Shqiperia planifikon ta adoptoje plotesisht kete strategji gjate tremujorit te funsit te vitit 2016 permes nje VKM-je specifike “Per permbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjise Mjedisore Liqenore”.	Direktiva përcakton kuadrin brenda së cilit vendet anëtare duhet t ë marrin masat e nevojshme ‘per te arritur apo mbajtur nje gjendje te mire mjedisore ne mjedisin ujor deri ne vitin 2020. Ne perputhje me kete Direktive jane hartuar dhe zbatuar strategjite liqenore, me qellim qe te: -mbrojne mjedisin ujor, parandalojne degradimin e tij, apo, nese eshte e mundur, rivendosin ekosistemet liqenore ne zonat e prekuara nga efektet e demshme; -parandalojne dhe pakesojne nderhyrjet ne mjedisin ujor me qellim eliminimin gradual te ndotjes dhe keshtu garantojne se nuk ka pasoja te medha per biodiversitetin ujor, ekosistemet liqenore dhe shendetin e njeriut dhe se keto nuk jane te kercenuara.	Uji	OM 5
Direktiva 2008/105/EC per standartet e cilesise mjedisore ne fushen e politikave ujore (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Kjo Direktive percakton standartet e cilesise mjedisore per substancat prioritare dhe ndotesit e tjere, sic percaktohet ne Direktiven 2000/60/EC me objektive arritjen e nje gjendjeje te mire kimike te ujerave siperfaqesore dhe ne perputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktives 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit te substancave ne uje, duke ndare ujerat e zeza. VKM-ja qe transpozon Direktiven 2008/105/EC ne legjislacionin shqiptar percakton normativa te detajuara dhe gjithe perfshirese per vleresimin e gjendjes kimike te ujerave siperfaqesore.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Direktiva percakton masat per te: a) monitoruar dhe klasifikuar sipas cilesise ujin per larje; b) menaxhuar cilesine e ujit per larje; dhe c) informuar publikun mbi cilesine e ujit per larje. Qellimi (objektiva) i kesaj Direktive eshte ‘te ruaje, mbroje dhe permiresoje cilesine e mjedisit dhe te mbroje shendetin e njerezve, duke plotesuar Direktiven 2000/60/EC’.	Uji	OM 5
Direktiva e Keshillit 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar	Direktiva e Keshillit 98/83/EC regullon cilesine e ujit qe perdoret per konsum nga njerezit. Uji eshte i shendetshem dhe i paster nese ai nuk permban mikroorganizma, parazite	Uji	OM 5

për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	dhe cdo substance tjeter, te cilat ne sasi apo perqendrime te caktuara perbejne nje rrezik potencial per shendetin e njerezve. Objektiva e kesaj direktive eshte te mbroje shendetin e njerezve prej cdo efekti negativ apo ndotjeje te ujit qe perdoret per konsum nga njerezit, duke garantuar qe uji te jete i paster dhe i shendetshem.		
Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi percakton masa specifike per te parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e ujerave nentokesore ne perputhje me Direktiven 2000/60/EC. Keto masa kryesisht perfshijne: -kritere per vleresimin e statusit kimik të ujit nëntokësor, dhe -kritere per identifikimin dhe kthimin mbrapsht te tendencave te konsiderueshme dhe te qendrueshme te rritjes, dhe per percaktimin e pikenisjeve per tendencat e kunderta.	Uji	OM 5
Direktiva 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet (Direktiva e Permbytjeve). Shqiperia e ka perafruar pjeserisht kete direktive permes: - Ligji nr. 9860, date 21.01.2008 qe amendon Ligjin nr. 8518, date30.7.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin''- VKM nr. 835, date 3.12.2004 "PërPlanin Kombëtar te EmergjencaveCivile"- VKM nr. 267 date 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore''	Direktiva ka percaktuar negociatat nderkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga permbytjet, dhe perfshin angazhime te rendesishme per te rritur transparencen dhe integrimin e qytetareve. Objektiva e direktives se menaxhimit te rreziqeve nga permbytjet eshte te reduktoje rreziqet dhe pasojat negative te permbytjeve ne BE. Persa i perket Shqiperise, ne fund te 2015, dhe gjate tremujorit te pare te 2016, eshte parashikuar miratimi i dy VKM-ve: VKM "Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhepërditësimin e Kadastrës Kombëtare te Burimeve Ujore'' VKM "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujerat, planete menaxhimit te baseneve te lumenjve dhe planet e menaxhimit te rrezikut nga përmbytjet''	Uji	OM 5
Direktiva 2009/147/EC per mbrojtjen e zogjve te eger. Shqiperia e ka perafruar pjesersiht kete	Direktiva ofron një kornizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të egër që ndodhen në BE. Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të	Mjedisi natyror	OM 6

direktive, permes ligjeve: - Ligji nr. 9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar - Ligji nr. 10006, date 23.10.2008; "Per mbrojtjen e faunes se eger" - Ligji nr. 10253, date 11.3.2010 "Per Gjuetine"	zogjve të egër që ndodhen në shtetin e BE -së. Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe/ose ri-krijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullata të zogjve. Per te gjitha speciet e zogjve qe referohen ne Shtojcen i te Direktives si dhe per te gjitha speciet e rregullta migratore, qe kane nevoje per mbrojtje, vendet anetare duhet te krijojne Zonat e Vecanta te Mbrojtjes (ZVM), apo te quajtura zonat Natura 2000. Ne keto ZVM duhet garantuar qe popullatat e specieve gjenden ne nje situate te favorshme. SKZHI II percakton si objective strategjike "Ngritjen e rrjetit ekologjik "Natura 2000". Gjate periudhes 2015 – 2016 eshte parashikuar amendimi i ligjit "Per gjuetine", gje qe do te siguroje perafrimin e plote te kesaj Direktive ne legjislacionin shqiptar.		
Direktiva e Keshillit 92/43/EEC per ruajtjen e habitateve natyrore dhe te flores e faunes se eger. Shqiperia e ka perafruar pjeserisht kete direktive permes ligjeve:- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";Ligji "Për Zonat e Mbrojtura", nr.8906, datë 6.6.2002, të amenduar;Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; and- VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Permiratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes per KE	Direktiva e habitateve kerkon qe Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të mënjanuar në zonat e vecanta të ruajtjes shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe shqetësimin e specieve për të cilat janë përcaktuar zonat e Natura 2000, në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kësaj Direktive. Kjo dispozite aplikohet per ZVM-te e propozuara, sic percaktohet ne merputhje me procedurat dhe kriteret e direktives se habitateve. SKZHI II percakton si objektiva strategjike: -Nje rritje e synuar me 17% e siperfaqes se Zonave te Mbrojtura ne gjithe territorin, permes zgjerimir dhe menaxhimit te integruar te zonave te mbrojtura; - Garantimi i statusit te mbrojtur per 5% te specieve dhe habitateve te kercenuara. Ne tremujorin e trete te vitit 2016 eshte parashikuar aprovimi i projektligjit "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" i ndryshuar", gje qe do te siguroje perafrimin e plote te kesaj Direktive ne legjislacionin shqiptar	Mjedisi natyror	OM 6
Konventa e Bernes (Bern, 1979) me Ligjin nr. 8294, date 2.3.1998)	Per ruajtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisit naturor evropian.	Mjedisi natyror	OM 6
Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar ne 29.3.1996)	Shtetet pale kane rene dakort qe te: •percaktojne ligatinat e territorit te tij te pershtatshme per tu perfshire ne listen e ligatinave me rendesi nderkombetare; - formulojne dhe zbatojne plane per promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave te	Mjedisi natyror	OM 6

	perfshira ne Liste, si dhe per perdorimin sa me racional te ligatinave ne territorin e tyre • promovojne ruajtjen e ligatinave dhe shpendeve ujore duke krijuar rezervate natyrore ne ligatina, te perfshira ose jo ne Liste, dhe siguron ruajtjen e tyre ne menyren me te pershtatshme; •marrin ne konsiderate pergjegjesine e tij nderkombetare per ruajtjen, menaxhimin dhe perdorimin racional te grupeve shtegtare te shpendeve ujore, si kur percakton nje hyrje ne Liste ashtu dhe kur ushtron te drejtat e tij per ndryshim ne kete Liste ne lidhje me ligatinat ne territorin e tij; •konsultojne njera tjetren rreth zbatimit te detyrimeve te dala nga kjo Konvente vecanerisht ne rastet kur nje ligatine shtrihet ne territorin e me shume se te nje shteti pale ose kur nje sistem ujor ndahet mes disa Shteteve Pale.		
Direktiva 2002/49/EC për vlerësimin &administrimin e zhurmës në mjedis. Shqiperia e ka perafruar pjeserisht kete Direktive permes Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis".	Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë. Ne tremujorin e fundit te vitit of 2017 eshte parashikuar miratimi i dy VKM-me: - "Për kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikim, pezullimin dhe heqjen e certificates së ekspertit të zhurmës në mjedis" -Për përbërjen dhe organizimin e Komitetit Teknik të Zhurmave (KTZH)"Kjo gje do te siguroje perafrimin e plote te kesaj Direktive ne legjislacionin shqiptar.	Zhurmat	OM 9
Direktiva 2008/96/EC mbi sigurine e infrastruktures rrugore (e perafruar plotesisht nepermjet Udhëzimit Nr. 9, datë 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore"	Objektiva e kesaj Direktive eshte 'garantimi i infrastruktures se sigurt rrugore per te gjithe perdoruesit e rruges'.	Popullsia & asetet materiale	OM 10
Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike–Konventa e Maltës(MEKVAD)	Konventa i referohet konceptit gjithëpërfshirës të ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike. Ajo përcakton lidhjen mes ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe planifikimit hapësinor. Konventa kërkon që çdo palë firmosëse të:	Trashëgimia kulturore	OM 11

(Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	-kërkojë të pajtojë dhe ndërthurë kërkesat përkatëse të arkeologjisë me planet hapësinore duke siguruar që arkeologët marrin pjesë në hartimin e politikave të planifikimit hapësinor dhe në faza të ndryshme të zbatimit të këtyre politikave; -sigurojë që arkeologët, planifikuesit urbanë dhe ata hapësinorë konsultohen sistematikisht me njëri-tjetrin me qëllim lejimin e modifikimit të atyre planeve hapësinore që kanë të ngjarë të dëmtojnë trashëgiminë arkeologjike -sigurojë kohë dhe burime të mjaftueshme për një studim të duhur shkencor që duhet të bëhet në zonën përkatëse dhe që të publikohen rezultatet e atij studimi -sigurojë që vlerësimi për ndikimin në mjedis dhe vendimet rezultuese përfshijnë konsideratën e plotë mbi zonat arkeologjike dhe shtrirjet e tyre -garantojë konservimin *in situ,* kur është e mundur, të elementëve të trashëgimisë arkeologjike që janë gjetur gjatë kryerjes së aktiviteteve hapësinore; -sigurojë që zonat arkeologjike janë të arritshme nga publiku, dhe se rrugët hyrëse për pranimin e një numri të madh vizitorësh, nuk dëmtojnë veçoritë arkeologjike dhe shkencore të këtyre zonave dhe mjedisit përreth.		
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Europës – Konventa e Granadës (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	Konventa përforcon konceptin gjithëpërfshirës në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike(monumente, njësi arkitektonike, zona apo struktura memoriale). Konventa kërkon që çdo palë pjesëmarrëse të: -zbatojë mbikëqyrje dhe procedurat e autorizimeve të duhura në përputhje me kërkesat e paracaktuara per mbrojtje ligjore të strukturave në fjalë; - parandalojë dëmtimin, rrënimin ose shkatërrimin e strukturave të mbrojtura. Politika e ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë arkitektonike i detyron të gjitha palët firmosëse që të: -përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë arkitektonike si objektiv të rëndësishëm në planifikimin hapësinor dhe atë urban; - nxitin programet për restaurimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë arkitektonike;	Trashëgimia kulturore	OM 11
Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, drafti i 2-të,	**Strategjia** e dyte **Kombetare per Zhvillim dhe Integrim** (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqiperise per zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik per periudhen 2015-2020, si	Toka Ajri	OM 1 OM 2 OM 3

2015 - 2020	dhe aspiraten per integrimin evropian. SKZHI-II shpjegon se si do te arrihet ky vizion permes politikave dhe strategjive te qeverise, duke synuar ne: Shnderrimin e Shiqperise ne nje vend te denje per t'u anetaresuar ne Bashkimin Evropian, Arritjen e standarteve qe i sherbejne qytetareve, rritjes se mireqenies se tyre dhe garantimit te mbrojtjes se te drejtave te tyre, dhe Hartimit te politikave qe nxitin konkurrueshmerine dhe prosperitetin ekonomik ne Shqiperi si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe me gjere. SKZHI-II eshte nje komponent kyc i **Sistemit te Planifikimit te Integruar** (SPI) ne Shqiperi. SPI perbehet nga nje komplet parimesh operacionale, te cilat garantojne se planifikimi dhe zbatimi i politikave te qeverise behen ne nje menyre koherente, efektive dhe te integruar. Kuadri kohor 2015-2020 i SKZHI-II eshte harmonizuar me periudhen vijuese 2014-2020 te planifikimit financiar te BE-se, me Strategjine e Lisbones deri ne 2020, dhe me tre ciklet vijues Kuadrit Afatmesem Buxhetor. Pervec ketyre proceseve, SKZHI-II eshte harmonizuar edhe me procese dhe dokumente te tjere kyc te zhvillimit dhe reformimit strategjik, si me poshte: Dokumenti Tregues Strategjik per Shqiperine (2014-2020), referuar gjithashtu edhe si ***Dokumenti Strategjik i Komisionit Evropian per Vendin;*** Programi Kombetar i Reformave Ekonomike (PKRE) 2015-2017, perfshire Strategjine e Zhvillimit te Bizneseve dhe Investimeve 2014-2020; Strategjia e Administrimit te Financave Publike 2014-2020; Strategjia e Administrimit te Financave Publike 2014-2020; Strategjia e Evropes Jug-Lindore 2020 (SEE2020) Punesimi dhe Prosperiteti nePerspektiven Evropiane; Plani Kombetar per Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020; Raportet e progresit te BE dhe Bankes Boterore (sic eshte Kuadri i Financimit te Vendit 2015-2020); dhe kombetar dhe integrimin ne BE. Integrimi ne BE eshte qellimi madhor. Mireqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit perbejne **themelet** mbi te cilat do te arrihet vizioni i SKZHI-II.	Faktoret klimatike Uji Mjedisi natyror Mbetjet Zhurma Popullsia &asetet materiale Trashegimia kulturore Peisazhi	OM 4 OM 5 OM 6 OM 7 OM 8 OM 9 OM 10 OM 11 OM 12

6.1.2 Identifikimi i ndikimeve mjedisore

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan janë përvijuar në Tabelën më poshtë:

Tab. – 36 *Ndikimet mjedisore qe mund te shkaktohen nga aktivitetet e parashkuara ne Plan*

Sektori i mjedisit	**Percaktimi i ndikimeve qe mund te vleresohen ne raportin e VSM-se**	**Vleresimi PO/JO**
Toka	• fragmentimi i zonave me aktivitet te dendur bujqesor apo zona pyjore • përdorimi i burimeve te energjise se rinovueshme dhe karburanteve 'bio' • administrimi i mbetjeve të gjeneruar nga aktivitetet e ndërhyrjeve infrastrukturore	PO
Ajri	• emetimi i ndotësve në ajër, të cilët kanë ndikime të dëmshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti • emetimi i ndotesve per te cilet jane percaktuar kufijte e siperm ne nivel kombetar • ndikimi ne shendet (sistemi respirator) ne rastet e nje pranie te larte te ndotesve ne ajer	PO
Faktoret klimatike	• ndjeshmeria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme te motit • emetimet e gazrave 'sere' qe shkaktohen nga djegia e karburanteve	PO
Uji	• siguria nga permbytjet • ndikimet e substancave te rrezikshme ne cilesine e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore, ne rast te derdhjeve aksidentale te tyre • ndikimet tek ujesjellesat dhe cilesia e ujit te pijshem • ndikimet mbi ujerat qe perdoren per larje (plazh)	PO
Mjedisi natyror (biodiversiteti, habitatet, zonat e mbrojtura)	• fragmentimi i habitateve • ndikim ne linjat e migrimit te kafsheve • ndikim ne integritetin dhe funksionalitetin e zonave te mbrojtura dhe te zonave te Natura 2000 • ndikime mbi tipologjine dhe cilesite e vecorive te cmuara natyrore	PO
Mbetjet	• ndikimet nga zona te ndotura te njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale te rrezikshme) qe akoma nuk jane sistemuar • ndikimet nga vend depozitime te hapura (te ligjshme dhe te paligjshme) • kapacitet i pamjaftueshem i landfilleve ekzistues / mungesa e tyre • mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kerkesave ligjore • ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi (kuadri ligjor është plotësuar që prej vitit 2011, por nuk zbatohet në praktikë)	PO

Zhurma	• ndotja akustike qe shkaktohet gjate ndertimit dhe shfrytezimit te infrastruktures perkatese dhe ndikimi tek shendeti i njerezve	PO
Popullsia dhe asetet materiale	• ndikime mbi asetet materiale per shkak te nevojes per hapesire • aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve te ndryshme • ndikimet qe lidhen me sigurine rrugore	PO
Trashegimia kulturore	• ndikime ne elementet e trashegimise kulturore	PO
Peisazhi	• ndryshimi i peisazhit dhe i vecorive pamore te hapesires	PO

6.2 METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

6.2.1 Metodika e vlerësimit

Vlerësimi i paraqitur në Seksionin 9 është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", ku jepet edhe përvijimi dhe përmbajtja e raportit të VSM-së. Ndikimet e rëndësishme të Planit në mjedis dhe objektivat mjedisore janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkallëve të mëposhtme:

A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv
B – ndikim i parëndësishëm
C – ndikimi bëhet i parëndësishëm, për shkak të zbatimit të masave zbutëse
D – ndikim i rëndësishëm
E – ndikim shkatërrues
X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur

Vlerësimi i ndikimeve të Planit sipas shkallës A, B dhe C do të thotë që ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të pranueshme. Ndikimet e parëndësishme janë vlerësuar me B, ndërsa ndikimet që bëhen të pranueshme vetëm pas zbatimit të masave zbutëse përkatëse, janë vlerësuar me C. Shkallët D dhe E nënkuptojnë se ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të papranueshme. Më poshtë janë përshkruar indikatorët dhe kriteret e vlerësimit si dhe shkallët përkatëse të vlerësimit për secilën objektivë mjedisore.

6.2.2 Përshkrimi i kritereve dhe metodologjisë së vlerësimit për objektivat mjedisore

6.2.2.1 Toka

Në tabelën 30 janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.***

Tab. – 37 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM1*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
Ndryshimi i struktures aktuale te perdorimit te tokes dhe pyjeve	**A – *s'ka ndikim/ndikim pozitiv:*** Aktivitetet e parashikuara nuk prekin zonat pyjore apo token

(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne toka bujqesore dhe zona pyjore do te coje ne humbjen dhe/ose ndryshimin e perhershem te kategorise se perdorimit te tyre (nga toke bujqesore apo zone pyjore ne truall ndertimi apo ndonje kategori tjeter) • ndryshimi i struktures se perdorimit te tokes bujqesore me potencial te mire prodhues *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne toka bujqesore me potencial te mire prodhues do te coje ne humbjen e perhershme te tokes bujqesore me cilesi te larte)* • probabiliteti i zbatimit te aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zona pyjore me status te vecante *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zona pyjore me status te vecante mbrojtjeje / konservimi mund te preke ne menyre te konsiderueshme ato cilesi per te cilat zona eshte vene nen kete status)* • probabiliteti i zbatimit te aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore do te coje ne humbjen e perhershme te ketyre zonave)*	bujqesore, sipas ndarjes aktuale te perdorimit te tokes. ***B – ndikim i parendesishem:*** Nese zbatohen dispozitat ligjore, ndikimi mbi perdorimin e qendrueshem te tokes bujqesore dhe pyjeve do te jete i parendesishem, pavaresisht faktit se aktivitetet do te zbatohen ne toka bujqesore me potencial te mire prodhues, apo ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore. **C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese**: Probabiliteti i ndryshimit te struktures aktuale te perdorimit te tokes bujqesore dhe pyjeve eshte i larte. Infrastruktura do te shtrihet ne toka bujqesore me potencial te mire prodhues, apo ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore. Duhen parashikuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **D – ndikim i rendesishem**: Probabiliteti i ndryshimit te struktures aktuale te perdorimit te tokes bujqesore dhe pyjeve eshte shume i larte. Ndikimi mbi perdorimin e qendrueshem te tokes bujqesore dhe te pyjeve do te jete i konsiderueshem. Infrastruktura do te shtrihet ne toka bujqesore me potencial te mire prodhues, apo ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues**: Probabiliteti i ndryshimit te struktures aktuale te perdorimit te tokes bujqesore me potencial te mire prodhues, apo te zonave pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore eshte kaq i madh sa qe ndikimi ne bujqesi dhe pyje do te kete pasoja shkaterruese. **X – vleresimi i ndikimit** nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.***

Tab. – 38 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM2*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
Niveli i riciklimit te mbetjeve qe gjenerohen gjate ndertimit / rehabilitimit te infrastruktures fizike *(aktivitetet qe lidhen me ndertimin / rehabilitimin e infrastruktures fizike duhet te garantojne se te pakten 55% e mbetjeve qe gjenerohen duhet te riciklohen, dhe materiali qe germohet duhet, sa me shume te jete e mundur te riciklohet duke u perdorur ne mbushjet gjate ndertimeve)*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv**: Aktivitetet e parashikuara nuk do te shkaktojne mbetje nga punimet e ndertimit apo germimet. **B – ndikim i parendesishem**: Zbatimi i aktiviteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, ato do te perpunohen totalisht, nderkohe qe 55% e tyre do te riperdoren si mbetje ndertimore e ricklueshme. **C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese**: Zbatimi i aktiviteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, per shkak te vecorive cilesore te mbetjeve, ato nuk mund te perpunohen dhe nuk mund te garantohet se 55% e tyre do te riperdoren, ne rast se nuk zbatohen masat zbutese. **D – ndikim i rendesishem**: Zbatimi i aktiviteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, per shkak te vecorive cilesore te mbetjeve, te pakten 55% e tyre nuk mund te perpunohen dhe riperdoren. Nuk mund te merren masa zbutese per te rritur sasine e mbetjeve te ricikluara. **E – ndikim shkaterrues:** Zbatimi i aktiviteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi, per te cilat duhet te organizohet procesi i largimit. **X – vleresimi i ndikimit** nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

Theksojmë se Plani i Përgjithshëm Urban në perputhje me direktivat e Planin e Përgjithshëm Kombëtar, si dhe në përputhje me direktivat e legjislacionit Europian ka menduar se në asnjë rast, sikundër ka ndodhur deri më sot, tokave bujqësore të bonitetit të klategorisë së parë, dytë, tretë dhe të katërt, t'iu mbivendosen vepra urbane. Ndërkohë që tokat me bonitet të kategorisë së pestë, të mund të diskutohet prekja apo zenia e tyre, dhe ato të kategorisë 6 dhe7, normal qe mund te preken nga veprat urbane.

6.2.2.2 Ajri

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.***

Tab. – 39 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM3*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
Sasia vjetore e emetimeve te ndotesve ne ajer, dmth e oksideve te squfurit, oksideve te azotit, lendes organike volatile pa permbajtje metani, amoniakut dhe pjesezave (permiresime te matshme te cilesise se ajrit duke arritur nivelet e synuara te ndotesve e ajrit ne lidhje me shenetin e njerezve, sipas vlerave respektive: per NOx - 40 µ/m³, per PM10 - 40 µ/m³, per PM2,5 - 25 g/m3 dhe 20 g/m3 dhe SO2 - 125 µ/m³. Numri vjetor i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes se ajrit me pjeseza, i matur ne pikat e monitorimit, te cilat jane te ekspozuara ndaj emetimeve te ndotesve (duhet te reduktohet me 40% numri i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes se ajrit me pjeseza; sa me pak dite me ndotje te larte te ajrit, aq me i ulet eshte ndikimi tek shendeti i njerezve dhe kostoja per shoqerine, per shkak te numrit relativisht te larte te njerezve te ekspozuar, shendeti i te cileve preket nga ky faktor)	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet e parashikuara nuk do te shkaktojne emetime te ndotesve ne ajer (perfshire edhe pjesezat), per te cilat jane percaktuar kufijte maksimale te emetimit ne nivel kombetar. Zbatimi i aktiviteteve do te reduktoje emetimet e ndotesve. **B – ndikim i parendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do te shkaktoje emetime te ndotesve ne ajer (perfshire edhe pjesezat), per te cilat jane percaktuar kufijte maksimale te emetimit ne nivel kombetar, por jo deri ne ate mase sa te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Zbatimi i aktiviteteve do te shkaktoje emetime te ndotesve ne ajer (perfshire edhe pjesezat), per te cilat jane percaktuar kufijte maksimale te emetimit ne nivel kombetar deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Per te reduktuar emetimet duhet te parashikohen dhe zbatohen masa zbutese ne menyre qe niveli maksimal i emetimeve te zbrese ne kufijte e parashikuar ne SKZHI-II. **D – ndikim i rendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do te shkaktoje emetime te ndotesve ne ajer (perfshire edhe pjesezat), per te cilat jane percaktuar kufijte maksimale te emetimit ne nivel kombetar deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar nivelin e emetimeve nen kufijte e percaktuar dhe per te mbajtur ndikimin nen nivelin e percaktuar te ndotjes se ajrit me pjeseza. **E – ndikim shkaterrues:** Zbatimi i aktiviteteve do te shkaktoje emetime te ndotesve ne ajer (perfshire edhe

	pjesezat), per te cilat jane percaktuar kufijte maksimale te emetimit ne nivel kombetar deri ne ate mase sa kufijte e percaktuar ne SKZHI-II do te tejkalohen ne menyre te konsiderueshme dhe ndotja e ajrit me pjeseza do te jete ne nivel te tille qe do te kete nje efekt te konsiderueshem dhe te demshem mbi shendetin e njerezve. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave

6.2.2.3 Faktorët Klimatikë

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 4: adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.***

Tab. – 40 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM4*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• adaptimi i infrastruktures perkatese ndaj ndryshimeve klimatike *(aktivitetet qe lidhen me ndertimin / rehabilitimin e infrastruktures perkatese duhet te perfshijne aktivitete qe zvogelojne apo parandalojne pasojat e ndryshimeve klimatike, vecanerisht te permbytjeve, debores dhe ngricave)* • sasia vjetore e emetimeve te gazeve 'sere' *(sasia maksimale e emetimeve te gazeve 'sere' nuk duhet te tejkaloje sasine e synuar vjetore prej 18,000 Gg CO2 ekuivalent ne 2020* *Ndikimet kumulative te te gjithe aktiviteteve te Planit nuk duhet te shkaktojne nje sasi vjetore nga te gjitha burimet e emetimeve te gazeve 'sere' qe te tejkaloje vlerat e synuara qe jepen ne SKZHI-II lidhur me Reduktimin e Emetimeve te Gazeve 'Sere' ne 2020.)*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevoje te garantohet; aktivitetet e parashikuara nuk do te shkaktojne rritje te emetimeve te gazeve 'sere'. Zbatimi i aktiviteteve do te reduktoje emetimet e gazeve 'sere'. **B – ndikim i parendesishem:** Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevoje te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten, por por jo deri ne ate mase sa te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevoje te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Per te reduktuar emetimet duhet te parashikohen dhe zbatohen masa zbutese, te cilat do te garantojne qe niveli i emetimeve nuk do

	te kaloje kufijte e parashikuar ne SKZHI-II. **D – ndikim i rendesishem**: Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevoje te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar nivelin e emetimeve nen kufijte e percaktuar. **E – ndikim shkaterrues:** Aktivitetet e parashikuara nuk garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo zbatimi i aktiviteteve do te rrite emetimet e gazeve 'sere' deri ne ate mase sa kufijte e percaktuar ne SKZHI-II do te tejkalohen ne menyre te konsiderueshme. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.4 Uji

Në tabelën më poshtë janëe përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregliqenore dhe burimet e ujit të pijshëm.***

Tab. – 41 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM5*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• mundesi nderhyrjeje ne zonat me burime ujore te mbrojtura *(zbatimi i aktiviteteve jashte zonave me burime ujore do te thote me pak mundesi per ndotjen e ujit nentokesor qe perdoret si burim furnizimi me uje)* • mundesi nderhyrjeje ne zonat me burime ujore per larje *(zbatimi i aktiviteteve ne zonat me burime ujore per larje do te thote me shume mundesi per ndotjen e ujerave qe perdoren per larje)* • mundesi nderhyrjeje ne zonat me rrezik permbytjeje *(zbatimi i aktiviteteve ne zonat me rrezik permbytjeje*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet nuk do te ushtrojne trysni shtese mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem, apo ndikimi do te jete pozitiv. **B – ndikim i parendesishem:** Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem do te jete i parendesishem, pavaresisht faktit se aktivitetet mund te zbatohen ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbytjeje.

redukton zonat mbrojtese dhe rrit mundesine per deme nga permbytjet) • mundesi nderhyrjeje ne zonat ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise *(zbatimi i aktiviteteve ne zonat ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise do te thote me shume mundesi per ndotjen e ujerave nentokesore)*	**C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem mund te jete e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbytjeje, eshte i larte. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **D – ndikim i rendesishem:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem do te jete e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbytjeje, eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem do te jete jashtezakonisht e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbytjeje, eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur**: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.5 Mjedisi Natyror

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes-së biodiversitetit.***

Tab. – 42 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM6*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• mundesia e nderhyrjes ne zonat qendrore te habitateve te mishngrenesve te medhenj *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat e rendesishme ekologjike te habitateve te mishngrenesve te medhenj do te sjelle nje trysni me te madhe mbi keta lloje dhe do te nderprese linjat e migrimit; ka mundesi potenciale per ndikim tek biodiversiteti ne nivel rajonal dhe nderkufitar)* • mundesia e nderhyrjes ne zonat me pyje te dendura *(planifikimi i infrastruktures se re ne zona me pyje te dendura do te sjelle ndikime negative mbi kafshet e egra dhe do te nderprese linjat e migrimit; ka mundesi potenciale per ndikim tek biodiversiteti ne nivel lokal dhe rajonal)*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Nuk do te kete ndikim ne kohezionin e popullatave dhe ne mbrojtjen e biodiversitetit, apo ndikimi do te jete pozitiv. **B – ndikim i parendesishem:** Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi ne kohezionin e popullatave dhe ne mbrojtjen e biodiversitetit do te jete i parendesishem. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund te garantohet kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimet e rendesishme. **D – ndikim i rendesishem:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund te garantohet kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi kohezionin e popullatave dhe mbrojtjen e biodiversitetit eshte shkaterrues. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.***

Tab. – 43 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM7*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• mundesia e nderhyrjes ne zonat e Natura 2000 dhe/ose zonat e mbrojtura	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Nuk do te kete ndikim ne zonat natyrore me status mbrojtjeje, apo ndikimi do te jete pozitiv.

(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat e mbrojtura do te sjelle ndikime negative ne funksionimin dhe kohezionin e ketyre zonave, si dhe tek speciet dhe llojet e vecanta te habitateve) • mundesia e nderhyrjes ne zonat me vlera te vecanta natyrore *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat me vlera te vecanta natyrore do te sjelle ndikime negative ne llojin dhe cilesine e ketyre vlerave te vecanta natyrore)*	**B – ndikim i parendesishem**: Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi ne zonat natyrore me status mbrojtjeje do te jete i parendesishem, megjithe faktin se ka mundesi te nderhyrjes se aktiviteteve ne zonat natyrore me status mbrojtjeje dhe ne zonat me vlera te vecanta natyrore. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, zonat natyrore me status mbrojtjeje nuk mund te mbrohen. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimet e rendesishme. **D – ndikim i rendesishem:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, zonat natyrore me status mbrojtjeje nuk mund te mbrohen. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues:** Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi zonat natyrore me status mbrojtjeje eshte shkaterrues. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur**: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.6 Mbetjet

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.***

Tab. – 44 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM8*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• sasia e mbetjeve qe gjenerohen dhe depozitohen ne landfill *(zhvillimet e reja do te rritin sasine e mbetjeve qe gjenerohen, perfshir mbetjet e ngurta, te lengeta dhe te rrezikshme, dhe ky fakt ben qe te priten ndikime*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet e pritshme nuk do te rritin sasine e mbetjeve te gjeneruara. Zbatimi i aktiviteteve do te permiresoje procesin e grumbullimit/trajtimit te mbetjeve. **B – ndikim i parendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do

negative ne cilesine e tokes, te ujerave nentokesore, te ajrit dhe ne shendetin e njerezve) • sasia e mbetjeve qe riciklohen *(SKZHI II deklaron se deri ne 2020 sasia embetjeve urbane te ricikluara do te jete 55%)* • ndertimi i landfilleve te reja *(kjo gje do te ndikoje pozitivisht ne procesin e trajtimit dhe riciklimit te mbetjeve; megjithate gjate ndertimit dhe shfrytezimit te tyre priten disa ndikime, te cilat do te jene te parendesishme nese aplikohet strategjia e duhur e zbutjes)*	te rrite sasine e mbetjeve te gjeneruara, por jo deri ne ate mase sa te influencoje procesin e grumbullimit/trajtimit te mbetjeve dhe te preke mjedisin natyror dhe njerezor. **C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite sasine e mbetjeve te gjeneruara, gje qe do te shkaktoje ndotje te tokes, ujit, ajrit dhe rreziqe per shendetin e njerezve. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin, te cilat garantojne se procesi i grumbullimit/trajtimit te mbetjeve i pergjigjet sasise se rritur te mbetjeve dhe se niveli i ndotjes ulet deri ne kufijte e vlerave te pranuara/percaktuara. **D – ndikim i rendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite sasine e mbetjeve te gjeneruara, gje qe do te shkaktoje ndotje te tokes, ujit, ajrit dhe rreziqe per shendetin e njerezve. Nuk ka mundesi te merren masa zbutese per ta mbajtur ndikimin nen kufijte e vlerave te pranuara/percaktuara. **E – ndikim shkaterrues:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite sasine e mbetjeve te gjeneruara, dhe ndotja e tokes, ujit, ajrit dhe rreziqet per shendetin e njerezve jane ne nje mase te tille qe kane efekt te konsiderueshem dhe te demeshem per shendetin e njerezve. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur**: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.7 Zhurma

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.***

Tab. – 45 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM9*

Indikatori / kriteri i vleresimit	Shkalla e vleresimit
• ekspozimi ndaj zhurmes se shkaktuar prej	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet e pritshme

nderhyrjeve ne infrastrukture *(sa me pak shqetesime qe te kete mjedisi nga zhurma, aq me i ulet eshte ndikimi ne cilesine e mjedisit, shendetin e njerezve dhe kostot e shoqerise, per shkak te numrit te njerezve te ekspozuar, shendeti i te cileve preket direkt)*	nuk do te rritin ekspozimin ndaj zhurmes. Perkundrazi keto aktivitete do ta ulin kete ekspozim. **B – ndikim i parendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite pak ekspozimin ndaj zhurmes, por nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi do te jete i parendesishem. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Zbatimi i aktiviteteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes. Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do te jete i rendesishem. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese shtese per te reduktuar ndikimin. **D – ndikim i rendesishem:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes. Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do te jete i rendesishem. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese shtese per te reduktuar ndikimin. Nuk ka mundesi te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E –ndikim shkaterrues:** Zbatimi i aktiviteteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes deri ne nje mase te tille qe kjo gje do te kete nje efekt te konsiderueshem dhe te demshem per shendetin e njerezve e me tej. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.8 Popullsia dhe Asetet Materiale

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.***

Tab. – 46 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM10*

Indikatori / kriteri i vleresimit	Shkalla e vleresimit
• lidhja mes vendbanimeve dhe qendrave rajonale	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet nuk do te ndikojne ne arritjen e objektives, ose zbatimi i tyre do

(nje lidhje me e shpejte dhe me e mire permireson kohezionin social: lidhja me e shpejte me qendrat e qyteteve perben nje baze me te mire per zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve ekonomike, te cilat nga ana e tyre sjellin ndikime pozitive ne te ardhurat individuale dhe komunitare, ne menyren e jeteses dhe ne vleren e aseteve materiale – pasurite e paluajtshme) • perfshirja e aktiviteteve per te permiresuar sigurine e trafikut *(me shume aktivitete te kesaj natyre sjellin permiresim te sigurise rrugore dhe me pak aksidente)* • perfshirja e aktiviteteve per te rritur efektivitetin e transportit publik *(perdorimi sa me i madh i transportit publik sjell nje levizshmeri me efektive dhe te qendrueshme; nje transport publik me efektiv sjell uljen e ngarkese se trafikut ne rruge dhe ruan vleren e aseteve materiale sic eshte toka dhe pasurite e paluajtshme; gjithashtu nje transport publik me efektiv redukton sforcon financiare per familjet, pasi redukton nevojen per te patur apo perdorur makina personale)* • perfshirja e aktiviteteve per te rritur mundesite per nje menyre te shendetshme te jeteses *(aktivitetet qe lidhen me levizshmerine e qendrueshme, kerkojne nje organizim te mire te infrastruktures clodhese/agetuese (per shembull korsite e bicikletave, monopatet e ecjes me kembe, perfshire edhe mberritjen deri aty); clodhja/argetimi ndikon pozitivisht ne gjendjen mendore dhe fizike te njerezve dhe ne kete menyre redukton kostot e shoqerise, pasi shfrytezohet nje menyre e shendetshme e jeteses)*	te permiresoje lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, do te permiresoje sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme. **B – ndikim i parëndesishëm**: Zbatimi i aktiviteteve do te garantoje lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, por krahasuar me gjendjen aktuale keto lidhje do te jene disi me te dobeta. **C – ndikimi bëhet i parëndësishem** për shkak të zbatimit të masave zbutese: Zbatimi i aktiviteteve do t'i beje me te dobeta lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **D – ndikim i rëndësishëm:** Zbatimi i aktiviteteve do t'i beje konsiderueshem me te dobeta lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. Nuk ka mundesi te merren masa zbutese. **E – ndikim shkatërrues:** Zbatimi i aktiviteteve do t'i shkateroje plotesisht lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.9 Trashëgimia Kulturore

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.***

Tab. – 47 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM11*

Indikatori / kriteri i vleresimit	Shkalla e vleresimit
• probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e trashegimise kulturore mund te rrezikojne seriozisht integritetin e trashegimise dhe te modifikoje vecorite e saj cilesore. Vecanerisht te rrezikuar jane peisazhet kulturore dhe peisazhet historike te zonave te trashegimise arkitektonike dhe arkeologjike)* • probabilitet i shkaterrimit te mbetjeve arkeologjike *(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e trashegimise kulturore nenkupton cenimin e tokes dhe si pasoje mbart nje probabilitet te larte per shkaterrimin e mbetjeve arkeologjike)*	**A– s'ka ndikim/ndikim pozitiv:** Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen njësite e regjistruara të trashëgimise kulturore. Perderisa hapesira nuk do të cënohet, edhe mbetjet arkeologjike nuk do të dëmtohen. **B – ndikim i parendesishem:** Ka mundesi potenciale qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore. Perderisa aktivitetet shtrihen prane apo pergjate infrastruktures ekzistuese, probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore dhe qe mbetjet arkeologjike te demtohen, eshte i ulet. Duke zbatuar dispozitat perkatese ligjore, ndikimi mbi vecorite cilesore te njesive te regjistruara te trashegimise kulturore do te jete i parendesishem. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore, dhe per pasoje te zvogelojne permasat e tyre, eshte i larte. Megjithe zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteve mbi trashegimine kulturore do te jete i rendesishem. Per shkak se aktiviteti shtrihet ne zone te gjere, probabiliteti i demtimit te mbetjeve arkeologjike eshte i larte. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **D – ndikim i rendesishem**: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore, dhe per pasoje te zvogelojne permasat e tyre, eshte shume i larte. Megjithe zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteve mbi trashegimine kulturore do te jete i konsiderueshem. Per shkak se aktiviteti shtrihet ne zone te gjere, probabiliteti i demtimit te mbetjeve arkeologjike eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues:** Ndikimi i aktiviteteve mbi vecorite cilesore te njesive te regjistruara te

	trashegimise kulturore, do te jete shkaterrues. Edhe ndikimi mbi mbetjet arkeologjike do te jete shkaterrues. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

6.2.2.10 Peisazhi

Në tabelën më poshte janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për ***OM 12: Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.***

Tab. – 48 *Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM12*

Indikatori / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
• probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar *(zbatimi i aktivitetetеve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e peisazhit mund te rrezikojne seriozisht integritetin e peisazheve te vecanta dhe zonave peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, dhe te shkaterroje vecorite e tyre cilesore)* • probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara, te cilat mbartin edhe simbolika te vecanta *(zbatimi i aktivitetetеve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e peisazhit mund te ndryshoje ne menyre te konsiderueshme imazhin ekzistues te peisazhit. Ndikimi eshte vecanerisht i dukshem ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara)*	**A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv**: Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar. Do te ruhet imazhi i peisazhit me cilesi te larte, pasi aktivitetet do te integrohen ne zona me nje shkalle te larte te degradimit te peisazhit. **B – ndikim i parendesishem:** Ka mundesi potenciale qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, apo ne zona peisazhistike imazhi i te cilave eshte ne prishje e siper. Ndikimi mbi imazhin eksitues te peisazhit do te jete i parendesishem, pasi shumica e aktiviteteve do te integrohen ne zona me nje shkalle te larte te degradimit te peisazhit. **C – ndikimi behet i parendesishem** per shkak te zbatimit te masave zbutese: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, eshte i larte. Ndikimi mbi vecorite cilesore te ketyre zonave eshte i madh. Aktivitetet do te shtrihen ne zona te konservuara peisazhistike natyrore apo kulturore, keshtu qe ndikimi ne peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre, do te jete i rendesishem. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.

	D – ndikim i rendesishem: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar eshte i madh, keshtu qe edhe ndikimi eshte i konsiderueshem. Aktivitetet do te shtrihen ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara, keshtu qe ndikimi ne peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre, do te jete i rendesishem. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin. **E – ndikim shkaterrues:** Ndikimi i aktiviteteve mbi vecorite cilesore te peisazheve te vecanta dhe zonave peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar do te jete shkaterrues. Peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre dhe qe permbajne elemente te jashtezakonshem natyrore dhe kulturore, do te shkaterrohen. **X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur:** Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.

SEKSIONI 7

VLERËSIMI i PËRPUTHSHMERISË SË OBJEKTIVAVE

7.1 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMERISË

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin 91/2013 "Për Vleresimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktiven 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vleresuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij. Për të percaktuar rëndesinë e objektivave mjedisore, duhet të vleresohet përputhshmeria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e percaktuara mjedisore. Vleresimi i perputhshmerise krijon konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave; të gjitha këto duhen vene në dukje veçanërisht në pjesen e vlerësimit të projekteve pecifike të Planit. Përputhshmeria e politikave të Planit është vlerësuar, duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bërë duke përdorur përafrimin standart në formë matrice. Për të kryer vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur grafiku i vlerësimit që jepet në tabelen me poshtë.

Tab. - 49 *Grafiku i vleresimit te nivelit te perputhshmerise mes objektivave*

Niveli i perputhshmerise	Vleresimi numerik
Objektivat perputhen plotesisht	3
Objektivat perputhen pjeserisht	2
Lidhja mes objektivave eshte e zbehte	1
Nuk ka lidhje mes objektivave	0
Objektivat nuk perputhen	-1

7.2 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE DHE POLITIKAVE TË PLANIT ME OBJEKTIVAT MJEDISORE

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë së politikave të Planit me objektivat mjedisore janë paraqitur në Tabelën më poshtë. Tabela tregon se, në parim, të gjitha politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.

Tab. – 50 *Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore*

Objektiva Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12	Mesatarja
Objektivat dhe politikat e Planit	Toka – Perdorimi i qendrueshem i tokes	Toka – Shfrytezimi i burimeve natyrore	Ajri – Emetimet e ndotesve	Faktoret Klimatike – Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Uji – Kufizimi i efekteve negative	Mjedisi Natyror – Kohezioni i popullatave dhe biodiversiteti	Mjedisi NAtyror – Zonat e Mbrojtura	Mbetjet – Kompletimi i landfilleve	Zhurmat – Reduktimi i zhurmavene deri ne nivlete e OBSH-se	Popullsia dhe asetet materiale – kohezioni social, siguria e trafikut	Trashegimia kukturore – Ruajtja	Peisazhi – Ruajtaj	Vleresimi numerik
Objektiva Strategjike 1 (OS 1): Infrastruktura urbane dhe mjedisi urban													
Politika 1: Program per dixhitalizmin/modernizimin e planifikimit	3	2	2	1	3	2	2	3	3	3	3	3	2.80
Politika 2: Integrimi i zonave informale	3	2	2	1	2	0	0	3	3	3	0	2	1.75
Politika 3: Rikualifikimit te tesktures urbane	3	2	3	1	2	1	0	3	3	3	0	3	2.00
Politika 4: Rigjenerimi i strukturës urbane dhe rurale duke ruajtur kodin gjenetik të ve muze, krijimit të hapësirave publike dhe zhvillimit/ rizhvillimit të strukturës urbane, vendbanimeve historike, lagje	2	1	2	1	3	3	3	3	3	3	3	3	2.40
Politika 5: Zhvillimi i infrastrukturës rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokale brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NjA me qendrën e qytetit dhe qëndrat e NjA me fshatrat e tjerë.	3	2	2	1	3	0	0	3	3	3	3	3	2.16
Politika 6: Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe sistemit të kanalizimeve të ujit të pijshëm dhe të ujrave të zeza dhe ndriçimit.	3	2	1	1	2	2	1	3	2	2	1	3	1.91
Politika 7: Menaxhimi efektiv i sistemeve të transportit brenda bashkisë, atij ndërqytetas, dhe ndërkombëtar ujor	**3**	1	1	0	2	1	0	0	1	3	0	0	1
Objektiva Strategjike 2 (OS 2): Përmirësimi i Cilësisë së Jetesës													
Politika 1: Incentivimi i banesave ekologjike	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	0	3	2.50
Politika 2: Përmirësimi i shërbimeve publike dhe administrative të Bashkisë	3	0	1	1	2	0	0	3	2	3	0	1	1.33
Politika 3: Përmirësimi i efiçiencës energjitike në banesa dhe biznese	0	0	1	3	3	0	0	3	0	3	0	0	1.08
Politika 4: Zhvillimi dhe mbështetja për Energjitë Alternative	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	0	3	2.50
Politika 5: Rritja e cilësisë së jetës përmes ndërhyrjeve në arsim, shëndetësi.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00

Politika 6: Ulja e papunësisë nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 7: Krijimi i programeve të strehimit dhe mbrojtjes sociale për shtresat në nevojë.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 8: Rivlerësimi i traditës dhe kultures lokale për rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e turizmit.	3	0	3	0	1	0	0	2	2	3	0	1	1.25
Objektiva Strategjike 3 (OS 3): Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë.													
Politika 1: Program specifik per bashkepunimin nderkufitar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 2: Program specifik per nxitjen e punesimit	3	3	3	3	3	3	0	3	1	3	0	3	2.33
Politika 3: Program specifik per administrimin e aseteve vendore	3	0	2	2	2	1	0	0	1	3	0	0	1.16
Politika 4: Program specifik per zhvillimin e biznesit, finacave të qëndrueshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 5: Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të Bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës	3	3	3	0	1	0	0	1	0	3	0	0	1.41
Politika 6: Hartimi i programeve për zhvillimin e industries minerare në zonat me potencial më të madh.	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.08
Objektiva Strategjike 4 (OS 4): Zhvillimi i Turizmit													
Politika 1: Zhvillimi i Turizmit Kulturor	3	1	1	0	1	0	0	2	1	3	3	3	1.50
Politika 2: Zhvillimi i Turizmit të Natyrës, malor dhe liqenor	3	0	3	0	1	0	0	2	2	3	0	1	1.25
Politika 3: Krijimi i Itinerarëve drejt monumenteve të kulturës dhe natyrës	3	0	0	0	0	0	3	1	0	3	3	3	1.33
Politika 4: Përfshirja në rrjetin e intererareve turistike kombetare dhe nderkombetare.	3	0	0	0	1	0	0	3	1	3	0	1	1.00
Politika 5: Ndërthurje midis turizmit modern dhe atij tradicional	3	1	1	0	1	0	0	2	1	3	3	3	1.50
Politika 6: Aktivizimi i turizmit në zonat e mbrojtura natyrore.	3	2	2	0	1	0	2	2	1	3	3	3	1.80

Objektiva Strategjike 5 (OS 5): Përmirësimi i Infrastrukturës së Transportit													
Politika 1: Përmirësimi i Transportit Publik	3	0	3	3	1	0	0	2	3	3	0	0	1.50
Politika 2: Transporti Multimodal dhe hekurudhor	3	3	3	3	2	3	1	2	2	3	0	0	2.08
Politika 3: Transporti Alternativ dhe i Shëndetshëm	3	0	3	3	0	1	1	0	3	3	0	1	1.50
Politika 4: Menaxhimi efektiv i sistemeve të transportit brenda bashkisë, atij ndërqytetas, dhe ndërkombëtar ujor.	3	0	3	3	1	0	0	2	3	3	0	0	1.50
Politika 5: Zhvillimi i infrastruktures rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve locale brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NjA me qëndrën e qytetit dhe qëndrat e NjA	3	0	3	3	1	0	0	2	3	3	0	0	1.50
Objektiva Strategjike 6 (OS 6): Mbrojtja e mjedisit natyror													
Politika 1: Krijimi i Parqeve Rajonale	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
Politika 2: Ruajtja e Burimeve Ujore në Rajon	3	3	2	1	3	3	3	3	3	3	3	3	2.74

Politika 3 : Programi i Menaxhimit te Pyjeve	3	3	3	1	1	1	1	1	1	3	1	3	1.85
Politika 4: Ruajtja e biodiversitetit	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Politika 5: Konservimi i peisazhit të mbrojtur të Ohrit nëpërmjet ruajtjes së habitatit dhe biodiversiteti parqeve natyrore dhe gjeomumenteve.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
Politika 6: Zbutja e efekteve mjedisore nga veprimtaritë natyrore, aktiviteti ekonomik,industria e ndërtimit dhe minierave	2	2	0	1	1	2	1	1	1	2	1	1	1.25
Politika 7: Programi i Menaxhimit te Mjedisit	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
Objektiva Strategjike 7 (OS 7): Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të institucionit të bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumenteve financiare për daljen nga situata e borxhit.													
Politika 1: Kontrolli dhe menaxhimi me i mirë i detyrimeve të të gjithë institucioneve në varësi të Bashkisë.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 2: Bashkëpunim me nivelin Qendror për evidentimin e këtij problem dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për situaten financiare të bashkisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00
Politika 3 : Ulja e nivelit të borxhit nëpërmjet negociatave me palët e treta dhe duke përdoruasetet dhe pronat e bashkisë si mënyrë për të shlyer detyrimet e papaguara.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00

Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

1) Politikat që lidhen me Infrastukturën urbane dhe mjedisin urban dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilesisë së Mjedisit Natyror kanë klasifikimin më të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore.
2) Politikat që lidhen me Sigurimin e zhvillimit ekonomik, me Zhvillimin e Turizmit dhe Përmirësimin e Infrastrukturës së Transportit kanë klasifikimin më të ulët në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre politikave është në përputhshmëri të plotë me të paktën një, dhe në shumicën e rasteve me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.
3) Dy politika të Planit, specifikisht: Vendosja e standarteve të projektimit urban, dhe Krijimi i Parqeve Rajonale, janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore, duke marrë rezultatin maksimal të mundshëm.
4) Secila prej politikave të planit (përveç dy politikave që klasifikohen me përputhshmëri të plotë) nuk kanë lidhje me të paktën një objektivë mjedisore dhe në shumicën e rasteve me dy objektiva.
5) Dy objektiva të Planit që lidhen me Infrastukturën Urbane dhe Rajonalizimin janë pothuajse në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore.
6) Tre objektiva të Planit që lidhen me sektorin për sigurimin e qëndrueshmërisë financiarë të institucionit të Bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumentave financiare për daljen nga borxhi nuk përputhet me asnjë nga objektivat mjedisore.
7) Një nga ovjektivat e planit që lidhet me sektorin për "Sigurimi i zhvillimit ekonomik" nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industriesë, saktësisht "Hartimi i programeve për zhvillimin e industrisë minerare në zonat me potencial më të madh", përputhet pjesërisht vetëm me një nga objektivat mjedisore.
8) Një nga ovjektivat e planit që lidhet me sektorin për "Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë, saktësisht Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të Bashkisë Pogradec, nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës, përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore, duke kërkuar kështu zbatimin e masave mbrojtëse.

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Konkretisht:

Objektiva mjedisore 1 që lidhen me menaxhimin e tokës, dhe objektiva 10 që lidhen me popullsinë, janë në përputhshmeri të plotë me pjesën më të madhe të politikave të planit.

Duhet theksuar se të dyja këto objektiva janë ose në përputhshmëri të plotë, ose nuk lidhen me politikat e planit.

Objektiva 11 që lidhet me ruajtjen e trashëgimise kulturore ë shtë objektiva që nuk lidhet me pjesën më të madhe të politikave të Planit.

Të gjitha objektivat e tjera mjedisore paraqesin një diversitet të madh lidhur me nivelin e përputhshmërisë së tyre me politikat përkatëse të Planit.

***Si konkluzion**, mund të thuhet se në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat dhe politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.*

SEKSIONI 8
VLERËSIMI i PROJEKTEVE

8.1 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTEVE

Plani i përgjithshëm vendor i Pogradecit përcakton projekte specifike/konkrete për çdo politike, të cilat janë gjykuar si më të përshtatshmet për zbatimin e politikës përkatëse. Projektet janë listuar për çdo politikë, sipas përcaktimeve në Plan.

Në Tabelat më poshtë janë identifikuar projektet prioritare dhe ndikime direkte në mjedis që këto projekte mund të shkaktojnë, në lidhje me objektivat mjedisore të përcaktuara. Shkurtimisht, këto projekte përfshijnë rigjenerimin e qendrave urbane dhe rurale, projekte që lidhen me përmirësimin e shërbimeve publike dhe private, urbanizimin, stilin e jetesës, hapësira argëtimi/çlodhjeje, turizmin, bujqësinë, mjedisin etj.

Ky seksion përfshin vlerësimin e projekteve prioritare në lidhje me përputhshmërinë e tyre me objektivat mjedisore dhe impakti i tyre në mjedis. Vlerësimi i projekteve specifike është bërë mbi bazën e përcaktimit të klasifikimit mesatar të përputhshmerisë së secilit projekt me të 12 objektivat mjedisore. Përveç projekteve prioritare në tabelat e mëposhtme kemi vlerësuar të gjithë projektet e PPV të bashkisë së Pogradecit

Projektet e listuara më poshtë do të përputhen plotësisht apo pjesërisht me objektivat mjedisore, gjatë zbatimit dhe funksionimit të aktiviteteve përkatëse, dhe, për të gjitha aktivitetet duhet të garantohet zbatimi i masave zbutëse për të reduktuar ndikimin në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës.

Në çfarëdolloj varianti, Plani i Përgjithshëm Urban do të udhehiqet nga filozofia e ndërtimit, duke respektuar traditën, d.m.th që ndërtimet në zona suburbane nuk duhet të kalojnë atë të peisazhit të përgjithshëm të ndërtimeve deri më sot, ku mbizotëron ndërtimi dy katësh, i cili mund të harmonizohet deri në një siluetë 2 +1 kate.

Në përcaktimin e qendrave të çdo zone administrative mund të ketë ose një institucion fetar në varesi të besimit që egziston ose një ndërtesë të tipit 'target', por jo më e lart se 4-5 kate që mund të jetë vepër banimi, siluetë arkitekturore ose objekt kulti, etj. Shkurt dhe prerazi, nuk mund të ketë ndërtim më tepër se dy tre kate në zona nën urbane.

8.2 KRAHASIMI I PROJEKTEVE PRIORITARE PËR BASHKINË E POGRADECIT

Tab. – 51 *FISHA 1*

TITULLI i PROJEKTIT	**Hartimi i një Plani Menaxhimi për zonat e konflikitit të transportit në Qytet si dhe për ndërtimin e zonave të Parkimit**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i infrastrukturës urbane dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit

	të turizimit, bujqësisë dhe Industrisë Minerare ***Programi:*** Zhvillimi i Infrastrukturës rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokale brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NJA me qendrën e qytetit dhe qendrat e NJA me fshatrat e tjerë.
Përshkrimi i projektit	**Projekti do të zgjidhë :** -Riorganizimin e Trafikut urban ne Bashkinë Pogradec -Zgjidhjen për problemin e parkimit sidomos në sezonin turistik.
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi riorganizimi i trafikut do të ndihmonte shumë në përmirësimet e cilësisë së ajrit, përmirësimin e cilësisë së jetesës etj, të cilat janë disa nga objektivat tona dhe ky projekt përputhet me objektivat tona mjedisore.

Tab. – 52 *FISHA 2*

TITULLI i PROJEKTIT	**Projekti i sistemit të ujërave të larta të Qytetit Pogradec**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Infrastrukturës urbane dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizimit, bujqësisë dhe Industrisë Minerare ***Programi:*** Zbutja e efekteve mjedisore nga veprimtaritë natyrore, aktiviteti ekonomik, industria e ndërtimit dhe minierave.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Eleminon ndotjen e qytetit dhe të liqenit -Zgjidh problemin e menaxhimit te ujërave që vijnë në qytete, dhe dëmtimet prej tyre -Përmirëson cilësinë e jetës së banorëve
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, megjithëse duhen marrë masa zbutëse në zbatim të tij. Ky projekt ka përpuethshmëri të lartë me objektivat mjedisore, pasi ka efekt të menjëhershëm në uljen e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në Bashkinë Pogradec, përmirëson cilësinë e jetesës etj.

Tab. - 53 *FISHA 3*

TITULLI i PROJEKTIT	**Rikonstruksioni i rrjetit të ujit të pijshëm si dhe ndërtimi i rrjetit të ujrave te zeza dhe Impianti i trajtimit Udenisht (Memelisht, Lin, Udënisht)**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Infrastrukturës urbane dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizimit, bujqësisë dhe Industrisë Minerare ***Programi:*** Përmirësimi i menaxhimit të mbejteve dhe sistemimit të kanalizimieve te ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza dhe ndriçimit.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Eleminon ndotjen dhe kontaminimin e tokës dhe ujërave që derdhen në liqenin e Ohrit -Përmirëson cilësinë e jetës së banorëve -Krijon kushtet për zhvillimin e rajonit (ekonomik, turizëm)

Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve etj. Ky projekt ka përpuethshmëri të lartë me objektivat mjedisore, pasi ka efekt të menjëhershëm në uljen e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë, eleminon ndotjen dhe kontaminimin e tokës dhe të ujrave që derdhen në liqenin e Ohrit, në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm, përmirëson cilësinë e jetesës etj.

Tab. - 54 *FISHA 4*

TITULLI i PROJEKTIT	**Rikonstruksioni i rrjetit të ujit të pijshëm si dhe ndërtimi i rrjetit të ujrave të zeza dhe impianti i trajtimit në NJA Çërravë**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Infrastrukturës urbane dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizimit, bujqësisë dhe Industrisë Minerare ***Programi:*** Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe sistemimit të kanalizimeve të ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza dhe ndriçimit
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Eleminon ndotjen dhe kontaminimin e tokës dhe ujërave që derdhen në liqenin e Ohrit -Përmirësimin e cilesisë së jetës së banorëve -Krijon kushtet për zhvillimin e rajonit (ekonomik, turizëm)
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim,pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve etj. Ky projekt ka përpuethshmëri të lartë me objektivat mjedisore, pasi ka efekt të menjëhershëm në uljen e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë, eleminon ndotjen dhe kontaminimin e tokës dhe të ujrave që derdhen në liqenin e Ohrit, në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm, përmirëson cilësinë e jetesës etj.

Tab. – 55 *FISHA 5*

TITULLI i PROJEKTIT	**Ndërtimi i një çerdheje e kopshti të ri, të integruar e me standarte të menaxhimit të energjisë me burime alternative energjie.**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ***Programi:*** Rivlerësimi i traditës dhe kulturës lokale dhe rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimit të turizmit
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Do rrisë kapacitetin aktual për këtë funksion -Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve -Do të shërbejë si projekt pilot për të parë menaxhimin eficient të energjisë në ndërtesa
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në kursimin e energjisë elektrike, në cilësinë e jetës së banorëve dhe edukimin e brezave të rinj me një frymë të re

pozitive etj. Ky projekt ka përpuethshmëri të lartë me objektivat mjedisore, pasi ka efekt të menjëhershëm në kursimin e energjisë elektrike, uljen e ndotjes në mjedis etj.

Tab. - 56 *FISHA 6*

TITULLI i PROJEKTIT	**Hartimi i Strategjisë Lokale për Zhvillimin e Turizmit Multidimensional**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ***Programi:*** Rivlerësimi i traditës dhe kulturës lokale, rritja e cilësisë së jetesës dhe zhvillimi i turizmit
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Orientimin e këtij sektori bazë për zhvillimin e ekonomisë të Bashkisë Pogradec -Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve -Qartësimin për mundësinë e buxhetimit për të zhvilluar degët e ndryshme të turizmit
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, siç është rritja e cilësisë së jetesës dhe zhvillimi i turizmit. Përpuethshmëria e këtij projekti me objektivat mjedisore është e lartë.

Tab. - 57 *FISHA 7*

TITULLI i PROJEKTIT	**Strategjia lokale per zhvillimin e Bujqësisë**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ***Programi:*** Rivlerësimi i traditës dhe kulturës lokale, rritja e cilësisë së jetesës dhe zhvillimi i turizmit
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Orientimin e këtij sektori bazë për zhvillimin e ekonomisë të Bashkisë Pogradec -Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve që e kanë burim jetese këtë fushë -Qartësimin për mundësinë e buxhetimit sipas prioriteteve -Mundësinë e krijimit dhe forcimit të hallkave ë zinxhirit ushqimor -Markimi i produkteve lokale -Marketim e shpërndarje në tregje të huaja
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, siç është rritja e cilësisë së jetesës. Përpuethshmëria e këtij projekti me objektivat mjedisore janë të pranueshme.

Tab. - 58 *FISHA 8*

TITULLI i PROJEKTIT	**Plan i Detajuar për Zhvillimin Urban, Ekonomik, Turistik të zonës Breg-liqenore Lin- Tushemisht**

Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Mbrojtja e Mjedisit natyror duke respektuar kuadrin ligjor të peisazheve të mbrojtura si dhe duke siguruar qasje te zhvillimit të qëndrueshëm të territorit. ***Programi:*** Konservimi i Peisazhit të mbrojtur të Ohrit nëpërmjet ruajtjes së habitatit dhe biodiversitetit parqeve natyrore dhe gjeomonumenteve.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Ruajtjen e peisazhit natyror -Ruajtjen e mjedisit -Zhvillim të kontrolluar Brenda standarteve të Unesco -Përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve -Zhvillim të turizmit
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, siç është rritja e cilësisë së jetesës, zhvillimi i turizmit dhe ruajtja e mjedisit. Përpuethshmëria e këtij projekti me objektivat mjedisore janë të larta duke u përputhur plotësisht me disa nga ojektivat siç është ruajtja e peisazhit natyror, zhvillimi i turizmit, përmirësimi i cilësisë së jetesës etj.

Tab. - 59 *FISHA 9*

TITULLI i PROJEKTIT	**Projekti për restaurimin e zonës historike të Qytetit, infrastrukturës publike dhe banesave (përfshirë rehabilitimin e Banesës të Lasgush Poradecit dhe rikonstruksionin e shtëpisë së Mitrush Kutelit)**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizmit, bujqësisë dhe industrisë minerale ***Programi:*** Rigjenerimi i strukturës urbane dhe rurale duke ruajtur kodin gjenetik të vendbanimeve historike, lagjeve muze, krijimit të hapësirave publike dhe zhvillimit/rizhvillimit të strukturës urbane
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Ruajtjen e vlerave historike dhe kultuore të qytetit -Nxitjen e turizimit kulturor
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Përpuethshmëria e këtij projekti me objektivat mjedisore është i pranueshëm.

Tab. - 60 *FISHA 10*

TITULLI i PROJEKTIT	**Sistemim Asfaltim Rruga e Qafë Pllocës dhe Unazës Ekzistuese**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Infrastrukturës urbane dhe Permirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizmit, bujqësisë dhe Industrisë Minerare ***Programi:*** Zhvillimi i Infrastrukturës rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokale Brenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NJA me qendrën e qytetit dhe qendrat e NJA me fshatrat e tjerë.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Zgjidh lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë, duke e spostuar jashtë qytetit

	-Eleminon zhurmën dhe ndotjet nga trafiku i automjeteve në zonat urbane -Lehtëson trafikun në pjesët e tjera të qytetit
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi riorganizimi i lëvizjes së mjeteve të tonazhit të rëndë dhe spostimin e tyre jashtë qytetit, gjithashtu asfaltimi i këtyre segmenteve rrugore, do të ndihmonte shumë në përmirësimet e cilësisë së ajrit, përmirësimin e cilësisë së jetesës etj, të cilat janë disa nga objektivat tona dhe ky projekt përputhet me objektivat tona mjedisore.

Tab. - 61 *FISHA 11*

TITULLI i PROJEKTIT	**Projekt për Rehabilitimin e pastrimin e kanaleve vaditëse (Mujazë, Çezmë e Vogël, Krickovë)**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i Zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit bujqësisë dhe industrisë **Programi:** Hartimi i Programeve për Zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NJA të Bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Përmirësimin e cilësisë të jetës së banorëve që e kanë burim jetese këtë fushë -Përmirësimin e produktivitetit lokal të produkteve -Zhvillimin ekonomik te fermerëve
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve dhe cilësinë e tokës. Ky projekt ka përpuethshmëri të mirë me objektivat mjedisore.

Tab. - 62 *FISHA 12*

TITULLI i PROJEKTIT	**Rehabilitim i Tregut Blegtoral në NJA, Cerrave**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ***Programi:*** Hartimi i Programeve për Zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NJA të Bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Përmirësimin e cilësisë të jetës së banorëve -Përmirësimin e kushteve të tregtimit të produkteve -Mundësi më të mira tregtimi -Zhvillimin ekonomik te fermerëve
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve. Ky projekt përputhet mjaftueshëm me objektivat mjedisore.

Tab. - 63 *FISHA 13*

TITULLI i PROJEKTIT	**Ndërtimi i pikave të grumbullimit në Trebinjë/Velcan/Dardhas/Cërravë**
Objektivi Strategjik	***Objektivi Strategjik:*** Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë ***Programi:*** Hartimi i Programeve për Zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Njësitë administrative të Bashkisë Pogradec, nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës.
Përshkrimi i projektit	Projekti do të zgjidhë : -Përmirësimin e cilësisë të jetës së banorëve -Përmirësimin e kushteve të tregtimit të produkteve -Mundësi më të mira tregtimi -Zhvillimin ekonomik të fermerëve
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Me miratim brenda strukturave të Bashkisë
Partnerët apo donatorë të huaj	Bashkia, FZHR, apo donatorë të tjerë të huaj

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve. Ky projekt përputhet mjaftueshëm me objektivat mjedisore.

Tab. - 64 *Përpuethshmëria me Objektivat Mjediore dhe Impakti në Mjedis për projektet e PPV të bashkisë Pogradec.*

Objektiv Strategjik	Programe	Projekte	Përpuethshmëria me OM	Impakti Në mjedis
Mbrojtja e mjedisit natyror duke respektuar kuadrin ligjor të peisazheve të mbrojtura si dhe duke siguruar qasje të zhvillimit të qëndrushëm të territorit.	Konservimi i peisazhit të mbrojtur të Ohrit nëpërmjet ruajtjes së habitatit dhe biodiversitetit, parqeve natyrore dhe gjeomumente ve.	Zbatimi i Planit të Menaxhimit të peisazhit te mbrojtur te Pogradecit të vitit 2013.	**+ + +**	**A**
		Hartimi i rregullores për mbrojtjen e elementeve dhe standarteve të statusit të Liqenit të Ohrit të mbrojtur nga UNESCO.	**+ + +**	**A**
	Sigurimi i qasjeve të zhvillimit të qëndrueshëm për zhvillim e territorit,lidhur me mënyrat alternative të sigurimit të energjisë, mënyrat e transportit dhe sigurimin e hapësirave të gjelbra.	Hartimi i projekteve pilot për ndërtesat rezidenciale dhe të shërbimeve me kosto zero të energjisë.	**+ + +**	**A**
		Hartimi i projekteve pilot për ndërtimin e shkollave/kopshteve të cilat përdorin energjinë e rinovueshme (diellore, të erës, biomasa).	**+ + +**	**A**
		Hartimi i projekteve për rigjenerimin e pemës së Gështenjës dhe Arrës në kodrat e Pogradecit dhe Nj.A të tjera. Fushata sensibilizuese për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve	**+ +**	**A**
	Zbutja e efekteve mjedisore nga veprimtaritë natyrore, aktiviteti ekonomik, ndërtimit dhe minierave.	Plan masash për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore.	**+ + +**	**C**
		Studimi i vlerësimit të plotë për strukturat ekzistuese të industrisë minerare dhe hartimi i projekteve rehabilituese të tyre.	**+**	**C**
		Hartimi i projekteve për pyllëzimin e zonave me erozion të lartë siç është zona e Lumit të Vërdovës dhe përrenj të tjerë.	**+ + +**	**B**
		Sistemimi i urjave të larta Liqen – Vërdovë – "Varret e Grekut"	**+ + +**	**C**
		Sistemimi i ujrave të larta Liqen –Rëmënjë – Guri i Kamjes	**+ + +**	**C**
		Sitemimi i urjave të larta Liqen - Kabash	**+ ++**	**C**
Sigurimi i infrastrukturës urbane dhe përmirësimi i mjedisit urban për zhvillimin e sektorit të turizmit, bujqësisë dhe industrisë minerale.	Zhvillimi i infrastrukturë s rrugore për lidhje më të mirë të rrugëve lokalebrenda qytetit të Pogradecit, lidhjen e NjA me qëndrën e qytetit dhe qëndrat e NjA	Hartimi për projektin e ByPass-it të qytetit të Pogradecit sipas standarteve (rehabilitimi i unazës ekzistuese).	**+**	**C**
		Hartimi i projektit për unazën e re të qytetit	**+**	**C**

		Kala – Kurora e Pogradecit – Vërdovë.		
		Hartimi i projektit për përcaktimin dhe ndërtimin e zonave të parkimit në bashkinë ePogradecit.	+	C
		Hartimi i një plani për menaxhimin e trafikut në qytet dhe parashikimi i rregullave për pika e konfliktit	-	C
		Hartimi i Projektit për rehabilitimin e rrugës Vërdovë – Pogradec.	+	C
		Projekti për rikonstruksionin e rrugës automobilistike Slabinjë – Bishnicë.	+	C
		Sistem, asfaltim rrugë të brendshme, fshati Dardhas	+	C
		Sistem, asfaltim rrugë të brendshme, fshati Stropckë	+	C
		Sistemim rrugësh Blloku "Stadiumi"	+	C
		Sistemim rrugësh Blloku "GORICË"	+	C
		Sistemim rrugësh Blloku "Përroi i Çaprazit"	+	C
		Sistemim rrugësh blloku i banesave përballë 1 Majit"	+	C
		Sistemim i shetitores "10 Dëshmorët e Pojskës" (segmenti 1 Maji-fundi i rezidencësqeveritare)	+	C
		Sistemim rrugësh blloku Lagje nr. 1 (ish Ferma)	+	C
		Sistemim asfaltim rruge: Dalje Çërravë-rruga Pogradec-miniera Alarup	+	C
		Sistemim-asfaltim rruga hyrje ÇërravëPogradec Alarup	+	C
		Sistemim asfaltim rruge: Hyrje Çërravë – Dalje Çërravë	+	C
		Sistemim asfaltim rrugësh Lagja "Demokracia" Çërravë	+	C
		Sistemim-rrethim i shkollës 9-vjeçare,	+	C

		Dardhas		
		Sistemim-asfaltim rruga Prenisht-Osnat	+	C
		Sistemim Asfaltim Rruga Velçan- Buzaishtë	+	C
		Sistemim Asfaltim Rruga Golik – Slatinë	+	C
		Lidhje e rrugës Qukës – Qafë Pllocë (Sistemim rrugë të brëndshme Kalivaç – Potkozhan – Trebinjë – Pleshisht).	+	C
		Sistemim rruge Çezmë-Shën Marenë, komuna Trebinjë	+	C
		Sistemim-Asfaltim Rruge Lumi Çezmë-Shën Marenë	+	C
		Sistemim rruge lumi Çezmë-fshati Çezmë, komuna Trebinjë	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge të brendshme Dunicë-Kalivaç-Potkozhan-TrebinjëPleshisht	+	C
		Sistemim rruge Lumi Çezmë-Shën Marenëkomuna Trebinjë	+	C
		Sistemim Asfaltim Dardhas – Osnat – Niçë.	+	C
		Sistemim Asfaltim rrugë të brëndshme Buçimas.	+	C
		Sistemim Asfaltim Rruga Rodokal – Katjel.	+	C
		Sistemim Asfaltim Rruga Golik – Slatinë – Miniera Debrovë	+	C
		Sistemim Asfaltim Tushemisht – Cërravë (unaza).	+	C
		Sistemim Asfaltim Rodokal poshtë – Golik	+	C
		Sistemim-çakullim i rrugës Proptisht Somotinë-Laktesh-Lagja "Biba" Velçan	+	C
		Sistemim-asfaltim i rrugës Lumi SlabinjëLosnik (Velçan)	+	C
		Sistemim-asfaltim i rrugës Somotinë-Laktesh- Velçan-Losnik-Ura Slabinjë	+	C

		(segmenti VelçanBuzahisht)		
		Sistemim-asfaltim i rrugës Somotinë-LakteshVelçan-Losnik-Ura Slabinjë (segmenti Somotinë-Ura Laktesh)	+	C
		Sistemim-asfaltim i rrugës Somotinë-LakteshVelçan-Losnik-Ura Slabinjë (segmenti Ura Laktesh-Buzahisht)	+	C
		Sistemim-asfaltim i rrugës Somotinë-LakteshVelçan-Losnik-Ura Slabinjë	+	C
		Sistemim-asfaltim i rrugës Somotinë-Laktesh-Velçan-Losnik-Ura Slabinjë (segmenti Slabinjë-Qafë e Losnikut)	+	C
		Sistemim-çakullim i rrugës Somotinë-LakteshVelçan (lagja Biba)	+	C
		Rikonstruksion i rrugës Lagjja "Sheshe" - Laktesh, Velçan	+	C
		Rikonstruksion i rrugës "Kroi i Madh" Velçan	+	C
		Rikonstruksion i rrugës Lagjja "Lufo" - Bishnicë	+	C
		Rikonstruksion i rrugës Lagjja "Dervishaj" Losnik, Velçan	+	C
		Rikonstruksion i rrugës Shkolla e Vjetër, Velçan	+	C
		Rikonstruksion i rrugës nga rruga kryesore në shtëpinë e Nazmi Hykës, Buzahisht	+	C
		Sistemim rrugësh, fshati Laktesh	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge, qendër Proptisht	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge Golik Slabinjë	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge të brendshme Verri	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge, Qafë e ZhellaritRodokal	+	C
		Sistemim-asfaltim-ndriçim rruge të	+	C

		brendshme fshati Rodokal sipër -Rodokal poshtë - Letovë		
		Sistemim rruge Lagje e Sipërme Rodokal sipër	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge, Lumi labinjëLosnik	+	C
		Sistemim-asfaltim rruge, hyrje Slabinjëdalje Slabinjë	+	C
		Sistemim Asfaltim lidhja Selcë - Homçan	+	C
	Menaxhimi efektiv i sistemeve të Transportit Brenda bashkisë, atij ndërqytetas, dhe ndërkombëtar ujor	Hartimi i studimit të fizibilitetit për sigurimin e infrastrukturës për mjetet ujore të transportit brenda vijës liqenore (Lin – Tushemisht) të bashkisë Pogradec dhe jashtë kufijve (Ohër – Strugë).	+ +	B
		Hartimi i projektit për rehabilimin dhe vënien në funksionim të Molit të qytetit.	+	C
		Hartimi i projektit për pajisjen e bashkisë me transport publik urban me theks të veçantë linja: Lin – Pogradec – Tushemisht.	-	C
		Hartimi i projektit për klasifikimin dhe standartizimin e rrjetit rrugor qytetas.	-	C
		Hartimi i planit të fizibilitetit për ndërtimin e terminalit qëndror të pasagjerëve.	-	C
		Promovimi i itenerareve natyrore turistike (Tushemisht - Mali i Thatë, Vërdovë – Rëmënjë – Gështenjas – Guri i Kamjes – Ura e Egnatias Niçë, Hecet e Bishnicës – Jollë – Shpellë – Liqenet e Lukovës – Liqeni i Madh - Valamare) .	++	A
	Përmirësimi i menaxhimit tëmbetjeve dhe sistemit të kanalizimeve të ujit të pijshëm dhe të ujrave të zeza dhe ndriçimit.	Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve.	+ + +	A
		Hartimi i Studimit për përcaktimin e zonës së transferimit të mbetjeve dhe lidhja e saj me landfillin e Maliqit.	+ + +	B
		Hartimi i projekteve pilot për skemat e riciklimit të mbetjeve.	+ + +	B

		Hartimi i projekteve për pajisjen e NjA me sistem të kanalizimeve të ujrave të zeza dhesistem të ujit të pijshëm.	+ + +	C
		Rikonstruksioni i rrjetit të ujrave të zeza dhe impianti trajtimit UDENISHT (Mëmëlisht, Lin, Udënisht).	+ + +	C
		Kanalizim i ujrave të zeza - Nizhavec	+ + +	C
		Ndërtim dhe sistemim i ujrave të zeza - Leshnicë	+ + +	C
		KUZ fshati Dardhas	+ + +	C
		Sistemim i ujrave të zeza, fshati Proptisht	+ + +	C
		KUZ fshati Stropskë Lagje poshtë faza II	+ + +	C
		Rikonstruksion i rrjetit të ujrave të zeza Stropckë, Leshnicë, Cërravë.	+ + +	C
		Hartimi i projektit të ndriçimit urban për qytetin e Pogradecit.	-	B
		Hartmi i projektit për sistemin e elektrifikimit Hoshteçë, Selcë dhe Cezmë).	-	B
		Hartimi i projektit për sistemin e ujësjellësit Bishnicë – Velçan.	+ + +	C
		Hartimi i projektit për sistemin e ujësjellësit Dunicë – Potkozhan – Pleshisht –Trebinjë.	+ + +	C
		Linjë e jashtme ujësjellësi – Pretushë	+ + +	C
		Linja e jashtme e ujësjellësit Dunicë-Trebinjë	+ + +	C
		Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të lagjes "Kolneku-Novaku", Rodokal poshtë	+ + +	C
		Linjë e jashtme dhe e brendshme Rodokal poshtë lagjja Pura-Mertkola	+ + +	C
		Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të lagjes "Nofulla", Rodokal poshtë	+ + +	C
		Ujësjellësi Laktesh, komuna Velçan	+ + +	C
		Rikonstruksion i ujësjellësit Bishnicë	+ + +	C
		Lagje e jashtme, Ujësjellësi Bishnicë-Velçan	+ + +	C

		Hartimi i projektit për sistemimin e ujësjellësit Mëmëlisht (Guri i Bardhë).	+ + +	C
	Rigjenerimi i strukturës urbane dhe rurale duke ruajtur kodin gjenetik të vendbanimeve historike, lagjeve muze, krijimit të hapësirave publike dhe zhvillimit/ rizhvillimit të strukturës urbane.	Hartimi i projektit për rehabilitimin e Objektit të Oktapodit dhe hapësirës publike përreth përfshirë edhe Turizmin e vjetër.	+	B
		Hartimi i projekteve për krijimin e zonës muzeale të qytetit, kthimin në muze të shtëpive të shkrimtarëve të qytetit të Pogradecit.	+	A
		Hartimi i projektit pilot të zonës bregliqenoretë Buçimasit dhe Linit.	+ + +	C
		Krijimi i qendrave të agroturizmit në zonën e Trebinjës, Potkozhanit, Slabinjës, Kalivaçit duke promovuar vlerat arkitektonike dhe kulturore lokale.	+	B
		Hartimi i projektit për krijimin e muzeut të peshkatarëve në NjA Hudënisht.	+	B
		Hartimi i projektit të rehabilitimit të zonës së Gurit të Kuq për kthimin e saj në një zone turistike atraktive në shërbim të turizmit liqenor.	+	C
		Hartimi i projektit të dizajnit për rehabilitimin e hapësirës rreth Kalasë së Vjetër të Pogradecit dhe propozimi i ballkonit (belvedere) të qytetit.	+	B
		Rikonstruksion i fasadave në rrugët "Kajo Karafili" dhe "Gani Butka"	+	C
		Rikonstruksion i fasadave në rrugët "Kajo Karafili" dhe "Gani Butka"	-	C
		Sistemim i bllokut të pallateve rruga "Rinia" dhe rruga "Gent"	-	C
		Hartimi i një projekt – ideje për ndërtimin e një teleferiku që do të lidhë NjA Tushemisht me Malin e Thatë.C	+	C
Përmirësimi i cilësisë së jetespërmes përmirësimit të infrastrukturaveshëndetsore –	Rritja e cilësisë së jetës përmes Ndërhyrjeve në arsim dhe shëndetsi.	Hartimi i projekteve për sigurimin e çerdheve në Pogradec dhe NjA të tjera.	-	C
		Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare Potkozhan.	-	C
		Rikonstruksioni i shkollës fillore në Kriçkovë.	-	C

arsimore, uljes snivelit të varfërispromovimit të punësimit të qëndrueshëm dvlerësimit të traditës lokale.		Ndërtim kopshti fshati Velçan, komuna Velçan	-	**C**
		Ndërtimi i fushës së futbollit (kalçeto) komuna Velçan	-	**C**
		Rikonstruksion + shtesë, shkolla 9-vjeçare Laktesh	-	**C**
		Sistemim-rrethim i shkollës 9-vjeçarDardhas	-	**C**
		Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Osnat	-	**C**
		Rikonstruksioni i shkollës së vjetër në Velçan	-	**C**
		Rikonstruksion i shkollës, fshati Nizhavec	-	**C**
		Rikonstruksion i kopshtit, fshati Leshnicë	-	**C**
		Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, fshati Pretushë	-	**C**
		Rikonstruksion i shkollës së mesme, Blacë	-	**C**
		Rikonstruksion i shkollës "Kozma Basho" dhe ndërtim i palestrës së re	-	**C**
		Rikonstruksion i bazës së praktikës profesionale (shkolla prof. Çërravë)	-	**C**
		Rikonstruksion Spitali, Trebinjë	-	**C**
	Ulja e papunësisë nëpërmjet punësimit të qëndrueshëm.	Hartimi i projekteve për shtimin e shkollaveprofesionale për aftësimin e fuqisë punëtorenë sektorin e bujqësisë, turizmit dhe industrisë minerare.	-	**C**
		Shkolla e re profesionale në qytetin e Pogradecit	-	**C**
	Rivlerësimi i traditës dhe kulturës lokale për rritjen e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e turizmit.	Hartimi i programeve kulturore dhe krijimi i kalendareve kulturore me fokus të veçantë zonën e Mokrës.	**+ + +**	**A**
		Hartimi i projekteve për çeljen e qëndrave kulturore, muze dhe mjedise të tjera kulturore pranë qendrave të njësive administrative.	**+ +**	**A**
	Krijimi i programeve të strehimit dhe mbrojtjessociale për shtresat në nevojë.	Hartimi i programeve të strehimit për shtresat në nevojë duke shtrytëzuar apartamentet private stok të gjendura në territorin e bashkisë	-	**X**

		Hartimi i programeve të integrimit të komunitetit Rom.	-	X
Sigurimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë dhe mbështetja në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe industrisë.	Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës	Ndërtimi i pikave të grumbullimit në Trebinjë/Velçan/ Dardhas/ Cërravë.	-	C
		Rehabilitimi i tregut aktual blegtoral në NjA Çërravë.	+	C
		Ndërtimi i tregut të ri blegtoral në Proptisht	-	C
		Sistemim i kanalit ujitës - Çërravë	+ +	C
		Hartimi i projekteve për rehabilitimin dhe pastrimin e kanalave vaditëse (Mujazë, Cezmë e Vogël – Kriçkovë)	+ +	C
		Hartimi i projektit për rehabilitimin e kanaleve vaditës Bishnicë – Frangovishtë – Velçan – Laktesh – Proptisht.	+ +	C
		Hartimi i projektit për rehabilitimin e rezervuarit Selcë – Kriçkovë	+ + +	C
		Hartimi i projektit për rehabilitimin e kanalit vaditës Guri i Nikës – Cërravë.	+ +	C
		Rikonstruksion i kanalit ujitës Rezervuari Mujaze-Hondisht-Çezmë-Dunicë-TrebinjëPleshisht-Malinë	++	C
		Rikonstruksion i kanalit ujitës RezervuMujaze-Hondisht-Çezmë	++	C
		Depo uji 50 m3 fshati Pevelan	+ +	C
		Depo uji 100 m3 fshati Trebinjë	+ +	C
		Depo uji 50 m3 lagjja "Qosolle", fshati Trebinjë	+ +	C
		Rikonstruksion i kanalit ujitës Rodokal	+ +	C
		Rikonstruksion i kanalit ujitës BishnicëSlabinjë	+ +	C
		Rikonstruksion i kanalit ujitës Rezervuari Selcë Poshtë-Kriçkovë	+ +	C
		Rikonstruksion i varrezave ilire, Selcë e Poshtme	+ +	C
		Përmirësimi i sistemit të vaditjes mekanike meujrat e liqenit për NjA Buçimas.	+ +	C

	Hartimi i programeve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në NjA të bashkisë Pogradec nëpërmjet diversifikimit të profileve të tyre dhe sigurimit të infrastrukturës	Hartimi i projekteve për evidentimin dhe vlerësimin e potencialeve për zhvillimin e industrisë minerare.	+	C
		Sistem, asfaltim rruge DALJE ÇERRAVE - MINIERA ALARUP	+	C
Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të institucionit të bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumenteve financiare për daljen nga situata e borxhit.	Kontrolli dhe menaxhimi me i mirë i detyrimeve të të gjithë Institucioneve në varësi të Bashkisë.	Të hartohet një studim analitik për të kontrolluar shpenzimet operative dhe menaxhimine tyre.	-	X
	Bashkëpunm me nivelin Qendror për evidentimin ekëtij problemidhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për situaten financiare të bashkisë	Marrja e borxhit financiar nga sistemit banker duke marre garanci nga Ministria e Financaveme interes zero.	-	X
		Marrja e një huaje publike nga niveli qëndpër shlyerjen e detyrimeve.	-	X
		Kalimi i projekteve dhe investimeve të ndodhura në portofolin e Fondin e Rajoneve.	-	X
	Ulja e nivelit të borxhit nëpërmjet Negociatave me palët e treta dhe duke përdorur asetet dhe pronat e bashkisë si mënyrë për të shlyer detyrimet e papaguara.	Marrja e nismës për inventarizmin dhe rivlerësimin e pronave të bashkisë pranë zyrës vendore të pronave.	-	X

Përpuethshmëria me objektivat mjedisore

Projekti përputhet plotësisht me objektivat mjedisore **shumë mirë**	**+++**
Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore është e kushtëzuar **mjaftueshëm**	**++**
Projekti përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore **mirë**	**+**
Projekti nuk përputhet me objektivat mjedisore	-
Projekti nuk përputhet fare me objektivat mjedisore	- -

Impakti në mjedis

Impakti pozitiv	**A**
Impakti i parëndësishëm	**B**
Impakti është i parëndësishëm pasi zbatohen masat zbutëse	**C**
Nuk ka impakt në mjedis	**X**

Në marrëdhënie me objektivat mjedisore, të gjitha projektet janë vlerësuar sipas impaktit që këto projekte japin në mjedis dhe sipas përpuethshmërisë me objektivat mjedisore në këtë projekt. Si konkluzion mund të themi se niveli i përpuethshmërisë në përgjithësi është i lartë, megjithatë ka projekte ku niveli i përpuethshmërisë është i kushtëzuar, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutëse për projektet e parashikuara për arritjen e këtyre objektivave. Përsa i përket projekteve që kanë lidhje me Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit të bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumenteve financiare për daljen nga situata e borxhit, këto projekte nuk kanë përpuethshmëri me asnjë prej 12 objektivave mjedisore.

Në përgjithësi, konkludohet se *duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.*

SEKSIONI 9
VLERËSIMI i NDIKIMEVE MJEDISORE

9.1 VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMET E PASOJAVE TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT

Seksioni 7.1 përfshin vlerësimin e përpuethshmerisë të Planit me zonat e veçanta mjedisore dhe objektivat e rëndësishme mjedisore. Udhëzimet, masat zbutëse dhe masat specifike paraqiten në Seksionin 10.

9.1.1 Toka

Objektivi Mjedisor 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj

- Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj ndërkohë që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ato sektorë ose nën sektorë ku përqëndrimi më i madh i aktiviteteve do të ketë të bejë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative;

- Përmes okupimit të tokës, ndërtimet në infrastrukturë prodhojnë ndikime të gjera të pakthyeshme, që reflektohen pas zhvillimit si një ndryshim në perdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindërtuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër (te riparueshme) që mund të ndoshin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet dhe okupimet e tokave ose dëmtimin e produkteve për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj;

- Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukturë, përdorimi i tokës bujqësore ekzistuese pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë të tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore. Nëse masat e infrastrukturës shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqësore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqësore do të përkeqësohen edhe më tej;

- Pozicionimi i vendosjes së strukturave infrastrukturore të reja në hapësira të hapura dhe me natyrë për të konservuar biodiversitetin do të sjellin ndërhyrje direkte tek aktivitetet e vazhdueshme të zonave pyjore të cilat duhet të kryejnë funksionet vegjetative bimore me anë të drurëve si aktivitet primar (dëmtime të pakthyeshme).

Objektivi Mjedisor 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të ricklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

- Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi (rindërtime ose të reja) të infrastrukturës janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve, dhe gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operacionale, si edhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve është i përhershëm dhe në mjaft raste i pakthyeshëm në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakësohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve;

- Duke konsideruar mënyrën sesi gjenerohen dhe llojin e strukturës, sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastrukturë prej çdo sektori ekonomik duhet të konsiderohen si sasira të mëdha, sidomos prej veprave të nivelit kombëtar ose rajonal, ndërkohë që sasitë e mbetjeve nga zhvillimet në nivel lokal priten të jenë më të lokalizuara dhe më të pakta krahasuar me dy nivelet e para, Shqipëria ka kryer transpozimin e Direktivës 2008/98/EC mbi mbetjet, me anë të VKM no. 175, datë 19.1.2011, siç referohet edhe në "Strategjinë Kombëtare Ndërsektorialë për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025" dhe në "Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025". Në këtë aspekt, SKZHI II prezanton si objektiv mjedisor "55 per qind e masës totale të mbetjeve të ripërdoret ose riciklohet deri në 2020";

- Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimet e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjisë reflektohet veçanerisht në faktet e mëposhtme:
    - Sasira të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushëse janë mjaft të nevojshme;
    - Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të mobilizohen në mënyrë të vazhdueshme në rast se ato përdoren në mënyren e duhur;
    - Komponentë të rin j të ndërtimit shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

Në vijim të zbatimit të masave specifike që paraqiten në Plan, administrimi ekonomik i burimeve natyrore duhet të mbështetet nga masa të tjera të përgjithshme shtesë që promovojnë pakësimin e ndotjes së mjedisit duke përdorur materiale të ricklueshme në ndërtimin dhe rindërtimin e

infrastrukturës së parashikuar për çdo sektor. Prandaj, masa të tilla duhet të përgatiten dhe të përfshihen që në fazat e hershme të programeve të zhvillimit në çdo sektor dhe për çdo masë specifike me vete.

9.1.2 Ajri

Objektivi Mjedisor 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristikë gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktivitetesh nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por në lidhje direkt me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit.

Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afat-shkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme.

Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Zbatimi i masave specifike që synojne arritjen e qëllimeve të Planit pritet të kenë një impakt pozitiv për shkak të pakësimit të shkarkimeve të ndotësve, së pari për shkak të masave të parashikuara lidhur me sistemet multimodale të transportit, siç janë transporti me kargo dhe pjesërisht në transportin e pasagjerëve me mjetet rrugore dhe hekurudhore. Masa të tjera nga sektorët që emetojnë shkarkime të ndotësve në ajër priten gjithashtu të kontribuojnë me efekte pozitive për shkak të pakësimit të ndotësve të shkarkuar, në veçanti të atyre që synojnë pakësimin e bllokimeve/ngjeshjes dhe përdorimin më të madh të sistemit publik të transportit si edhe kontrollit të shkarkimeve në ajer nga industritë dhe promovimit të mëtejshëm të energjive të gjelbërta përmes investimeve të pritshme në hidrocentrale dhe gazit natyror.

Megjithatë, ekziston edhe rreziku që përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor do të prodhojë të ashtu-quajturin 'kërkesë e detyruar' për shkak të pakësimit të ngjeshjes, i cili nga ana tjetër mund të rrisë sasinë e shkarkimeve të ndotësve, veçanërisht në zona ku nuk kishte ndotje para se të zbatoheshin masat e Planit.

Gjithsesi, impaktet negative me përmirësimin e rrjetit rrugor mund të pakësohen dhe biles të parandalohen përmes marrjes njëkohësisht të masave të përgjithshme për promovimin e përdorimit të rrjetit publik të transportit të pasagjerëve dhe biçikletave.

Sfidat kryesore dhe prioritete që pasqyrohen edhe në Plan janë:

1) kompletimi i adoptimit dhe zbatimit të standarteve Europiane mbi cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër;
2) konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standarteve Europiane;
3) adoptimi e zbatimi i planeve të veprimit mbi cilësinë e ajrit si në nivel qendror dhe atë lokal.

Duke konsideruar që sektori i transportit prodhon sasira të konsiderueshme shkarkimesh të ndotësve të ajrit brenda sasisë së lejuar tavan të shkarkimeve në ajër të përcaktuara/synuara për Shqipërinë, mund të ishte më e përshtatshme të supozohej për vlera më të ulta të përcaktuara/synuara për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri në mënyrë që të pakësohen shkarkimet e ndotësve nga transporti.

Objektivi strategjik është "Arritja e përmirësimeve të matshme në 2020 për cilësinë e ajrit përmes":

- Objektivit prej 40% pakësim në nivelin e ndotësve në zonat urbane; dhe
- Arritja e niveleve objektiv të ndotësve të ajrit duke u bazuar në shëndetin human, sipas vlerave respektive: për NOx - 40 µ / m³, për PM10 - 40 µ / m³, për PM2,5-25 g / m3 dhe SO2-125 µ / m³.

Shpërndarja reciproke e ngarkesës për të arritur tavanet e shkarkimeve kombëtare vjetore për çdo sektor (energji, industri, tregti dhe shërbime, transport, bujqësi dhe menaxhim i mbetjeve) do të përcaktohet më në detaje përmes amendimeve prej Programit Operacional të përputhshmërisë me tavanet e shkarkimeve kombëtare. Gjithsesi, kërkesat për pakësimin e shkarkimeve nga transporti nuk priten të jenë më të ulta sesa pakësimi mesatar i përcaktuar për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri. Për këtë arsye, tavanet e shkarkimit për NOx dhe PM2.5 që janë ndotësit kryesorë prej transportit rrugor janë përcaktuar në bazë të pakësimit tregues në shkarkimet ndotëse.

Indikatori	**Njësitë e matura / Vendmatjet**	**Burimi**	**Vlera e fundit e vlefshme**		**Synimi në 2017**	**Synimi në 2020**
			Viti	**Vlerat**	**Vlerat**	**Vlera**
Cilësia e ajrit (mesatarja vjetore e përqendrimit të 3 ndotësve të ajrit	mg/m^3 te PM10; SO2; NO2 në Pogradec	Ministria e Mjedisit	2014	35.2 17.5 14.35	30 16 14	15-25 % pakësim i vlerës

Tab. - 65 *Indikatorët kryesore kumulative dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Pogradec*

Rinovimi i mjeteve motorike kontribuon së tepërmi në pakësimin e shkarkuesve ndotës, si edhe zhvillimi i standarteve sipas tipave të aprovuar për mjetet siguron që shumica e shkarkimeve të ndotësve të synuara për transportin të arrihen. Masat për promovimin e transportit publik të pasagjerëve dhe transportin hekurudhor kargo kontribuojnë gjithashtu në pakësimin e shkarkimit të ndotësve.

Plani nuk mund të adresojë specifikisht promovimin e rinovimit të mjeteve, por me anë të të gjithë masave/veprimeve, veçanërisht atyre që promovojnë transportin publik të pasagjerëve dhe transferimin e transportit kargo nga rruga në hekurudhë, ka ndikim pozitiv në mjedis dhe kontribuon qenësisht në arritjen e synimeve për shkarkimet kombëtare.

Përsa i takon shkarkimeve të grimcave pezull në ajer, ato do të pësojnë rritje të përkohshme në zonat ku do të zbatohen masat e rindërtimit të infrastrukturës sipas sektorëve (impakte të kthyeshme). Në përputhje me rregullat që rregullojnë masat për pakësimin e shkarkimeve të grimcave nga sheshet e ndërtimit, zbatimi i punimeve në ndërtim garanton që rritjet e përkohshme lokale të ndotësve të mjedisit në ajër të jenë ende të pranueshme për mjedisin dhe njerëzit. Ekspozimi në ajër të ndotur ka impakt kryesor negativ mbi shëndetin human. Është përllogaritur se 2 milion njerëz vdesin vazhdimisht çdo vit për shkak të ajrit të ndotur. Problemet më të shumta në sigurimin e cilësisë së ajrit të përshtatshëm të mjedisit lidhet me arritjen e tavanit të përcaktuar për grimcat.

Transporti është burimi kryesor ndotës i ajrit të mjedisit përmes grimcave pezull në ajër. Grimcat mund të japin një sërë impaktesh negative mbi shëndetin: ato shkaktojnë dhe rëndojnë astmat, krijojnë aterosklerosa, përkeqësojnë përvijimin e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare, shkaktojnë kancer. Raporti i mortalitetit në zonat ku ndotja me grimca pezulli është i lartë është 15 – 20 për qind më i lartë në krahasim me zonat me ajër relativisht të pastër.

Pritet që zbatimi i masave të Planit të ulin në mënyrë permanente shkarkimet e grimcave nga transporti rrugor, së pari për shkak të eleminimit të bllokimeve të trafikut, menaxhimit më të mirë të shtresave sipërfaqësore të rrugëve dhe përdorimit të më shumë mjeteve rrugore me efiçencë energjie. Siç u përmend më sipër, sfidat kryesore dhe prioritetet prezantohen ne NSDI II dhe ato janë përmbledhur në tabelën më poshtë në raport me pakësimin e ditëve kur PM10 tejkalon standartet.

Indikatori	Njësite e matura / Vendmatjet	Burimi	Vlera e fundit e vlefshme		Synimi në 2017	Synimi në 2020
			Viti	Vlerat	Vlerat	Vlerat
Numri i diteve në një vit kur PM10 tejkalon standartin e 50 µg/m³ ndaj ditëve të monitoruara	Numri i ditëve që tejkalojnë në % në Pogradec	AKM, Ministria e Mjedisit	2014	Pogradec 65%	Pogradec 45%	Pogradec 50%

Tab. - 66 *Indikatori PM10 dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Shqipëri*

Në mënyrë që të arrihen objektivat e eliminimit të mos-përputhshmërisë së cilësisë së ajrit me standartet e përcaktuara për cilësinë e ajrit, që ndodh shpesh në disa zona të kufizuara, zakonisht në bashkitë me densitet të lartë, është e domosdoshme që Qeveria dhe Institucionet respektive të përgatisin dhe përshtasin Planet e Cilësisë së Ajrit në ato zona që tejkalojnë ndotjen e ajrit në mjedis. Programe të detajuara të veprimit për të reduktuar ndotjen nga grimcat PM10 do të vijojne përgatitjen e këtyre planeve. Këto programe dhe veprime që vijnë nga Plani do të duhet të jenë në bashkëpunim të plotë me njëri tjetrin.

1. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimeve me institucione përgjegjëse për:
   - Zvogëlimin e numrit të makinave nëpërmjet përmirësimit të transportit publik ;
   - Menaxhimi i rrjetit rrugor dhe trafikut ;
   - Promovimi i teknologjive të pastra të automjeteve;

- Promovimi i përdorimit të biçikletave ;
- Kontrolli dhe përmirësimi i cilësisë së karburanteve;
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe larja e rrugëve.

2. Forcimin e kapaciteteve teknike për monitorimin e të gjitha llojeve të shkarkimeve në ajër në vendin tonë.
3. Ngritjen e kapaciteteve për modelim të shpërndarjes së ndotjes, hartimin e studimeve dhe analizave për gjendjen e ajrit.

9.1.3 Faktorët Klimatikë

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Nje sërë aktivitetesh ndërtimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyshëm) mbi shkarkimet e gazeve serë (GHG), që përbëjnë shkakun kryesor të ndryshimeve klimatike. Për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë GHG në ajër gjatë përdorimit përfaqësojnë në këto momente burimin më të rëndësishëm të energjisë në sektorin e transportit e bëjnë sot këtë sektor të parin si burim shkarkimesh të gazeve serë në Shqipëri, pasi sektori i energjisë këtu është hidro. Impakti në ndryshimet klimatike është gjithashtu pasojë në kushtet e motit dhe klimës që po rriten çdo vit. Një tjetër pasojë pasojë e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmbytje, erozione, stuhi me breshër, valë të nxehta, temperatura të ulëta me ngrica, etj.
Vendimi 406/2009/EC përcakton minimumin e kontributit të Shteteve Anëtare të EU për të kapur angazhimin e reduktimit të shkarkimeve të gazeve serë të Komunitetit për periudhën nga 2013 në 2020 për te gazet serë që mbulohen nga ky vendim dhe rregullat për të bërë këto kontribute si dhe për vlerësimin e tyre më pas. Shqipëria ende nuk ka bërë transpozimin e këtij vendimi; që planifikohet të ndodhë në 2018. Kjo periudhë është brenda kohës së zbatimit të Planit; prandaj parashikimet e këtij vendimi në lidhje me faktorët klimatikë duhet të adresohen në avancë. Për më tepër, SKZHI II vendos synimin për shkarkimet e gazeve serë në 2020 si vijon:

- Një synim 8% reduktim të GHG siç krahasohet me skenarin bazë; dhe
- Një synim 40% reduktim në sasinë e HCFC-s (hidroklorofluorokarbon).

Në nivelin strategjik të zhvillimit të sektorëve, masat në lidhje me fushën e adaptimit të ndryshimeve klimatike mund të trajtohen si të përgjithshme. Përpara projektimit dhe zbatimit të çdo veprimi individual do të jetë e nevojshme të krijohen udhëzues specifikë, metodologji dhe procedura për grumbullimin e informacionit rreth ngjarjeve ekstreme të motit dhe për të planifikuar dhe zbatuar detyrat respektive.

Shkarkimet e gazeve serë nga sektorë të tillë si transporti rrugor, bujqësia, energjia, etj. përfaqësojnë një rrezik të konsiderueshëm për masat zbutëse të ndryshimeve klimatike. Në vijim veç shkarkimeve të përkohshme të gazeve serë gjatë fazës së ndërtimit të veprave infrastrukturore të parashikuara në Plan, shkarkimet e gazeve serë priten të rriten edhe pse do të merren masa për të eleminuar mjaft pengesa. Zbatimi i masave specifike duhet të garantojnë përdorim më të madh të transportit publik, metodave të

reja bujqësore të kultivimit dhe vaditjes, energjisë të rinovueshme, etj. Promovimi i këtyre masave dhe përdorimi i mjeteve të reja të energjisë eficiente do të kontribuojë në parandalimin e shkarkimeve nga sektorët kontribues në GHG në fazën afat-mesme dhe ndoshta një rënie pas 2020.

Rritja e shkarkimeve të gazeve serë nga transporti ajror priten për shkak të punimeve të ndërtimit, ndërkohë që rritjet potenciale në shkarkimet e gazeve serë për shkak të rritjes së volumeve të transportit ajror nuk përfaqësojnë një ndarje të rëndësishme në strukturën totale të shkarkimeve në Shqipëri. I ngjashëm me transportin ajror është edhe ai detar për sa i takon kontributit ndarës në prodhimin e gazeve serë.

Transporti ngelet sektori kyç në arritjen e objektivave kombëtare mbi masat për ndryshimet klimatike i vijuar nga sektori bujqësor dhe përdorimi i tokës.

9.1.4 Uji

Objektivi Mjedisor 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregliqenore dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet më të mëdha për arritjen e këtij objektivi mjedisor pritet nga zhvillimet e sektorëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore. (ujësjelles/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetesia, etj). Impaktet mbi ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë, ujërat e njelmët, ujërat liqenorë dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristikë të periudhës së ndërtimeve ose rindërtimeve të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave edhe më tepër. Kjo në varësi respektive të sektorëve përkatës në lidhje me nevojën për përdorimine ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotjeje të mëdha ndotëse që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe ndërkufitar përtej kufijve. Impaktet ndërtimore të infrastruktures ngelen në përgjithësi afat- shkurtër dhe të rikthyeshme (rasti psh i cilësisë së ujrave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht më pak të përhapura, port e parikthyeshme permanente (rasti psh i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mësiperme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujrave sipërfaqësorë, që janë elementet biologjikë, hidromorfologjik, mbështetës, kimik dhe fiziko-kimik dhe në statusim kimik të ujrave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë së tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore. Veprimet e sektorëve që ndikojnë në ujërat dhe objektivat mjedisore mbi ujrat, përmblidhen si më poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zonë të caktuar duke sjellë edhe situatë eko-morfologjike mbi rrjedhen e ujit;
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore);

- Derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, impakt potencial mbi ujrat balneare);
- Rrezik i lartë ekzistent nga përmbytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore më këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmbyten ose masa rregulluese në rrjedhën e ujrave; ndryshime në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, përfshirë pakësimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distancë);
- Ndryshimet në regjimin ujor të ujrave nëntokësorë për shkak të ujrave të ndërhyrjeve të veprave infrastrukturore (psh tunelet);
- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në zonat akuifere me ndjeshmëri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impakt negativ mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, ndërkufitar);
- Pozicionimi në zonat e ujrave të mbrojtur të burimeve ujore (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe ndërkufitar).

Shqipëria ka aprovuar Ligjin No. 111/2012 "Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore" dhe "Strategjinë Kombëtare Sektoriale për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2014-2040", "Në Strategjinë Ndërsektorialë për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025" dhe "Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025". Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitete në ujë dhe tokat anash ujrave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojnë thelbësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakësojnë zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.

9.1.5. Natyra

Objektivi Mjedisor 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit

Ndikimet që kanë të bëjnë me fragmentimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristikë gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe më tej. Ato vërehen më tepër në mjedisin lokal, ndërsa në rastin e projekteve me shtrirje të gjerë impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjate kufijve (psh në migrimin e karnivoreve të mëdhenj, rrugët e migrimit të shpendëve, vijat ujore të kalimit ndërkufitar etj). Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshme (psh ndotje nga zhurmat e sheshit të ndërtimit, kafshët largohen prej makinerive të ndërtimit, etj.). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në perdiorimin e tokës (psh. ndërprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmës nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis – linja elektrike, etj.). Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe përfaqësuesve individuale të llojeve të bimëve dhe kafshëve (impakt direkt, i përhershëm);

- Impakt direkt, permanent mbi funksionimin e disa habitateve për shkak të fragmentimit të habitatit;
- Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjerë ne një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës më të ngushtë ose të gjerë (impakt permanent);
- Kalimet e reja shpesh fragmentojnë habitatet e kafshëve të egra dhe ndërpresin rrugët migratore dhe rrugicat e fluturimit ose pengojnë migrimin e disa grupeve të kafshëve (veçanërisht të gjitarëve dhe amfibëve, nëse një rrugë kryqëzohet me një korridor migrimi ose fluturimi, konflikte me shpendët dhe lakuriqët e natës jane gjithashtu të mundshme), të cilat mund të pengojnë në mënyrë permanente migrimin e kafshëve individuale midis popullatave individuale dhe të shkaktojnë një rënie të biodiversitetit në disa zona (impakt direkt, kumulativ, i largët);
- Shumica e problemeve të migrimit ndodhin në fazat e ndërtimit të infrastrukturave të mëdha ku nuk ka përkujdesje për rindërtimin e kalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të habitateve (psh ndërtimi i urave të gjelbërta). Kjo duhet të merret parasysh kur projektohet dhe ndërtohet (impakt direkt, në distancë);
- Në zonat ku nuk merren masa mbrojtëse ekziston mundësia e konflikteve mes infrastrukturës së ngritur dhe gjitarëve gjatë lëvizjeve ditore dhe amfibëve që levizin gjatë sezonit të migrimit (impakt direkt, në distancë); dëmtime të rregullta dhe të shpeshta mund të shkaktojnë gjithashtu rënie të përmasave të popullatave (impakt direkt, kumulativ, në distancë);
- Zhurma ka impakt negativ veçanërisht për shpendët dhe gjitarët dhe nuk është i pranishëm vetëm në distancën më të afërt të aktivitetit, por përhapet mjaft më gjerë (impakt në distancë);
- Rrezatimi në drejtim të qiellit prej ndriçimit të strukturave të ndryshme të infrastrukturave mund të krijojë shqetësim direkt në ciklin jetësor, veçanërisht për kafshët që janë aktive natën dhe ato që jane aktive në mbrëmje;
- Pozicionimi i aktiviteteve në ujë ose në tokat në krahë të vijave ujore (që lejohet për marrëveshje me rëndësi kombëtare dhe që nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të përmasave të mëdha), mund të krijojnë impakte negative permanente dhe direkte për habitatet ujore dhe ato përgjatë vijave, veçanërisht kur infrastruktura shtrihet përgjatë rrjedhave ujore.

SKZHI II prezanton sfidat kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë: (1) nevoja për të krijuar rrjetin ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian; (2) ristrukturimin dhe forcimin organizativ të strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura; dhe (3) nevoja për të garantuar zbatim më efektiv të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe planet e veprimit për llojet dhe habitatet.

Gjate fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve dhe në këtë mënyrë të arrihet objektivi i SKZHI II "Përmirësimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës".

Objektivi Mjedisor 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

- Zhvillimet infrastrukturore në mjediset natyrale përfaqësojnë një humbje permanente të habitateve dhe ndikojnë në mënyrë negative permanente në përhapjen natyrale të tipeve të habitateve dhe ato të habitateve të llojeve të bimëve dhe kafshëve, në cilësinë e tyre dhe në integrimin e habitateve të popullatave. Nëse zhvillimi vendoset në zona me status natyror të mbrojtur, impaktet mund të jenë veçanërisht të zgjeruara dhe shkatërruese, pasi ato mund të degradojnë në mënyrë permanente nivelin e konservimit të mjedisit natyror dhe objektivat e mbrojtjes për zonat e mbrojtura, siç janë ato për pikat e Natura 2000.

- Zonat me Rëndësi Ekologjike (IEAs) dhe veçoritë e vlerave natyrore. Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet nëse strukturat e infrastrukturës pozicionohen në zonat e mbrojtura ku mund të ndodhin humbje permanente të sipërfaqeve të kualifikuara, tipet kyç të habitateve, habitatet e llojeve, impakte mbi integritetin, funksionalitetin dhe kohezionin e zonave. Këtu janë të mundshme edhe impaktet permanente dhe direkte mbi cilësinë e veçorive të vlerave dhe të tipeve të tyre për shkak të të cilave është bërë deklarimi i veçorisë. Duke qenë se një pjesë e mirë e territorit të Shqipërisë është deklaruar zonë me një statur natyror të mbrojtur, ka mjaft mundësi që ndërtimet e reja të kalojnë pranë ose hyjnë në territoret e këtyre zonave.

- Impaktet në zonat me status natyror të mbrojtur janë të mundshme gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës dhe në vijim. Ato jane më të dukshme në mjedisin lokal, ndërkohë që për aktivitete të zgjeruara, ato mund të ndjehen në nivel rajonal dhe përtej kufirit (psh, impakti mbi kohezionin dhe integritetin e rrjetit të Natura 2000). Gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshëm (psh ndotje nga zhurma në kantierin e ndërtimit, turbullimi i vijave ujore). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (psh, rritje e ndotjes nga zhurmat prej transportit, pengesat në mjedis, shkatërrimi i habitateve të një lloji të kualifikuar, etj.

9.1.6 Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve dhe njëkohesisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

- Prania e zonave të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar (ndotja e tokës nga aktivitete Industriale përpara vitit 1990). Nga 36, janë rehabilituar vetëm 5 pika të rrezikshme mjedisore ;
- Prania e vend-depozitimeve të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme) të hedhjes së mbetjeve.
- Kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues/mungesa e tyre (SKMM pozicionin politikën 1 landfill për rajon);
- Menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele te ulta, sisteme grumbullimi miks ka vetëm në qytete;
- 70% e ish komunave nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbetjeve;

- Mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, mungesa e landfilleve për mbetjet e rrezikshme. Nuk ka landfille të veçanta, trajtim i veçuar bëhet vetëm nga sektori privat;
- Ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi, e cila megjithëse është kërkesë ligjore që prej vitit 2011, nuk realizohet në praktikë;
- Kuadri ligjor i përgjigjet kërkesave të BE-së, por nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime.

Problemet / shqetësimet kryesore që lidhen me këtë sektor janë listuar më poshtë:

- Zhvillimi i zonave të caktuara mund të cënojë integritetin e shtresave të ujrave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Mund të shkaktojnë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonave në fjalë. Pikat e vjetra e të nxehta përbëjnë rrezik, jo vetëm për shëndetin e njeriut, por krijojnë ambient për investime të reja para pastrimit të duhur;
- Planet sektoriale mund të parashikojnë ndërhyrje teknike, rinovime urbane, pra të krijojnë kushte për një rritje ekonomike të qëndrueshme. Planet nuk mund të garantojnë zhvillime në këto pika/sheshe. Kriteret e forta mjedisore-shëndetsore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi urban;
- Djegie të mbetjeve në fushë, përhapja e ndotësve nëpërmjet ajrit konsiderohet si një rrezik serioz për shëndetin, gjë që krijon rreziqe potenciale për shëndetin e banorëve lokalë. Rrjedhjet e mbetjeve nga fusha ndotin ujërat sipërfaqësorë të lumenjve që kalojnë pranë. Pamje e shëmtuar vizive e territorit që ndikon në imazhin e tij të përgjithshëm dhe tërheqës për aktivitetet, vizitorët dhe banorët;
- Mbetjet e këtyre zonave depozitohen në lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujrat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.
- Nuk ka zbatim të direktivës së BE për landfillet. Ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të bashkisë së Pogradecit;
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane sipas legjislacionit në fuqi është i decentralizuar, që do të thotë se kryhet në nivel njësie administrative. Aktualisht në Bashkinë e Pogradecit, mund të vërehet një dallim i theksuar në sistemin e menaxhimit të mbetjeve nga qyteti te fshatrat. Në qytet, grumbullimi i mbetjeve bëhet nëpër kontejnerë grumbullues të cilët pastrohen rregullisht;
- Problemi kryesor në Pogradec është mungesa e kompanive të kualifikuara për grumbullimin edhe riciklimin e mbeturinave prej kartoni e plastike, dhe transportimi i tyre drejt pikave të riciklimit në qytete të tjera është i pamundur për shkak të kostos të lartë. Mbetjet trajtohen nga subjekte private, të cilat nga pikat e grumbullimit i transportojnë në venddepozitimin e përcaktuar;
- Venddepozitimi ku trajtohen mbetjet ndodhet në vendin e quajtur Përroi i Shtogut, në territorin e Njësisë administrative Buçimas, në distancë 13km nga qyteti i Pogradecit. Ky venddepozitim ka shërbyer dhe shërben si i tillë deri në ndërtimin dhe vënien në përdorim të

landfillit rajonal të Maliq-it. Në këtë venddepozitim të përbashkët depozitohen mbeturinat shtëpiake e inerte të qytetit Pogradec, Njësisë Administrative Buçimas dhe Njësisë Administrative Hudënisht. Këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim, dhe megjithëse janë të përqëndruara, sjellin ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale;

- Venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushteve teknike të përcaktuara nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike, dhe rrjedhja e ujërave nga venddepozita krijon ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore.

Mënyrat e trajtimit deri më sot

Si kudo edhe në Bashkinë e Pogradecit, më përpara mbetjet urbane, me përbërje të tilla si: mbetje organike, mbetje inerte, mbetje letre, mbetje plastike, mbetje qelqi, hekurishte, madje edhe ato sanitare, hidheshin ku të mundnin, duke ndotur ambjentin për faktin se të gjitha mbetjet e lehta si plasmaset dhe grimcat e tjera largohen nga era, të tjerat dekompozohen, por sidomos djegiet në natyrë duke sjellë ndotje të theksuara kudo në ambjentin rrethues, si në ajër, në ujëra dhe në toka, duke dëmtuar kështu si florën, faunën dhe gjithë botën e kafshëve si dhe njerëzit. Është llogaritur që në Qytetin e Pogradecit grumbullohen rreth 35-40 ton mbetje urbane, menaxhimi i të cilave bëhet problem veçnarisht në sezonin e verës. Këto mbetje trajtohen nga subjekte private, të cilat nga pikat e grumbullimit i transportojnë në venddepozitën e re, të përcaktuar, që ndodhet në lindje të fshatit Alarup, rreth 13 km larg, në vendin e quajtur Përroi i Shtogut. Për këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim të tyre, të cilat përsëri edhe pse janë të përqëndruara, sjellin aksese në ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale, nga djegja e tyre në natyrë etj, rrisqet negative të të cilave i kemi përshkruar më lart. Vet venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushtet teknike të përcaktuara, si nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike etj. Rrjedhja e ujërave nga venddepozita krijon ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore.

Duke marrë parasysh mundësinë financiare, do të hartohen zgjidhje efektive për të reduktuar rreziqet e shkaktuara nga lëngu kullues i vend depozitimit:

- Përmirësimi i rrjedhjes së ujërave sipërfaqësore ;
- Përmirësimi i normës së avullim-djersitjes me anë të masave për mbjelljen e bimëve ;
- Izolimi i sipërm me shtresë argjilore dhe/ose HDPE.

Është i nevojshëm një vlerësim i ndikimeve ose rreziqeve mjedisore që shkaktohen nga fusha e mbetjeve (sa i përket ujit, tokës, ajrit dhe në veçanti furnizimit me ujë të Pogradecit).

Në varësi të përmasave të fushës së mbetjeve, sasisë së mbetjeve të depozituara, ndjeshmërisë së mjedisit dhe distancës nga vendet e banuara lind domosdoshmëri që shtyrja e mbetjeve dhe mbulimi me dhe gjatë vitit 2017 duhet bërë për të mbyllur përfundimisht këtë pikë depozitimi me anë të një sistemimi të thjeshtë me izolim sipërfaqësor.

Ky vlerësim duhet të bëhet pak kohë para zbatimit të masave të rehabilitimit dhe para fillimit të punës në vend depozitimin e ri sanitar.

Alternativa e vetme për këtë lloj të fushave të mbetjeve duhet të jetë mbulimi me dhe i mbeturinave gjatë rehabilitimit dhe shkëputjes prej saj përfundimisht.

Për pastrimin e pikave të nxehta mjedisore të vogla brenda dhe pranë qendrave të banuara, bashkitë duhet të organizojnë fushata pastrimi me përfshirjen e banorëve, para zbatimit të masave të rehabilitimit.

Nëse transportimi i mbetjeve nuk është i mundshëm, këto fusha të vogla mbetjesh do të rehabilitohen në vend. Masat e mundshme do të jenë gërmimi, shtyrja e mbetjeve së bashku, mbulimi me dhé të ngjeshur të papërshkueshëm dhe vendosja e një shtrese toke me bimësi.

Duke marrë në konsideratë masat e ngjashme të rehabilitimit në Shqipëri gjatë viteve të fundit, kostot për transportimin përllogariten rreth 2 Euro/m³/km. Në disa raste rehabilitimi në vend mund të kushtojë më pak, megjithatë ndikimet mjedisore nuk mund të ndreqen plotësisht.

Nevoja dhe investime të shtuara për landfille, nga menaxhimi jo i diferencuar i mbetjeve.

- Nuk kursehen hapësira dhe ka impakte negative në mjedis mungesa e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve (kontenierë), nxitja e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit;

- Nga Zonat rurale që nuk mbulohen me shërbim një sasi e konsiderueshme mbetjesh qarkullojnë në rrjetin hidrik duke krijuar një potencial ndotës, duke ndikuar kështu veçanërisht në degradimin e zonave të mbrojtura liqenore, (siç është dhe liqeni i Ohrit në bashkinë e Pogradecit), dhe ulur kështu aftësine e tyre ripërtëritëse;

- Ndikim tjetër negativ është edhe degradimi i peisazhit dhe mjedisit. Shumica e ish komunave (sot njësi administrative), rreth 70% e tyre, nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Ndërtesat e shumta informale nuk kanë mbledhje të rregullt të mbetjeve të ngurta;

- Plani parashikon ngritjen e infrastrukturës së duhur për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe bashkitë duhet ta konsiderojnë këtë një prioritet me nisjen e planeve të përgjithshme vendore. Strategjitë në Infrastrukturë dhe përpunim të Mbetjeve duhet të ndërmerren nga ministritë e linjës dhe NjQV- të;

- Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme (MRR) dhe atyre klinike në zona të pacaktuara. Shkarkimi i MRR në ujë, ajër ose tokë shkakton rreziqe për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, sjell ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore pastrimi i të cilave kërkon kosto të mëdha. Hedhja e MRR në kanale dëmton sistemin e kanalizimeve dhe ve në rrezik funksionimin e impianteve te trajtimit te bimëve. MRR në skrap metali ose materiale të tjera të ricikluara shkakton rreziqe mjedisore dhe të shëndetit ne industrinë e riciklimit;

- Aktivitetet e riciklimit kufizohen te sektori informal dhe sektori privat zhvillon mbledhjen e pjesëve të riciklueshme të mbetjeve, jo nëpërmjet sistemit;

- Plani parashikon ricklimin përkrah rritjes së kapacitetit të landfilleve. Gjithashtu rekomandohen masa dhe programe për riciklimin e mbetjeve të cilat do të kishin një impakt në zgjatjen e përdorimit të landfilleve duke siguruar edhe përfitim ekonomik;

- Strategjia e menaxhimit të mbetjeve duhet të përfshij dhe mundesitë e incentivimit të riciklimit nga konsumatorët, si dhe krjimin e zonave të dekompozimit të mbetjeve organike në çdo zonë rurale për krijuar lëndë të parë për industrinë bujqësore për një ekonomi ciklike;

- Probleme të tjera që shfaqen në këtë sektor janë: mosrealizimi i objektivave të synuara në dokumentat strategjike dhe afatet përkatëse, dhe gjetja e zgjidhjeve të përkohshme qendrore, rajonale, vendore që ndikojnë negativisht mjedisin. Në këtë kuadër, Plani duhet të përcaktojë qartë standartin e detyrueshëm sektorial të shërbimit që imponon më tej rregullime financiare në funksion të mbrojtjes së burimeve dhe zhvillimit të turizmit.

9.1.7 NDOTJA PREJ ZHURMËS

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Në zona individuale pritet një nivel më i lartë ndotjeje mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej gjatë fazës së operimit. Për këtë, masat zbutëse do të duhet të realizohen gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht mbikqyrja e shkarkimeve të përshkruara prej makinerive të ndërtimit, vendosja e një kohe të limituar për ndërtimin dhe nëse nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar zhurmën të përhapet në mjedis.

Impaktet gjatë fazës operacionale do të jenë afat-gjatë. Si rregull, projektet me shtrirje të gjerë ose si korridore (rrugë, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj) nënkuptohet kanë impakt më të madh mbi mjedis dhe në mënyrë direkte përgjatë korridoreve, por në të njëjtën kohë mund të zbuten me ridrejtimin e aktiviteteve ato bëjnë të mundur të pakësojnë impaktet lokale sidomos aty ku densiteti i popullsisë është i lartë.

Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtme mund të aplikohen gjatë fazës së operimit të strukturave të reja në infrastrukturë:

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis;
- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rris ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej ky aktiviteti i burimit te ri;
- Masat e mbrojtjes nga zhurma duhet të garantojnë parandalimin dhe pakësimin e zhurmës që vjen nga përdorimi ose operimi i një burimi në mjedis.

Nga aspekti i mbrojtjes prej zhurmave, këto masa mbrojtëse të referuara në legjislacion duhet të përdoren për të pakësuar ndotjen nga zhurmat në të gjitha aktivitetet e pritshme për të ulur dhe mbajtur

më poshtë se niveli ligjor i përcaktuar. Zbatimi i masave të mëtejshme shtesë për mbrojtjen nga zhurmat do të jetë i nevojshëm në zonat e qendrave të mëdha urbane dhe korridoret e lidhjeve të infrastrukturës.

Politikat sektoriale për masat e veprimit do të bëjnë të mundur gjithashtu indirekt lehtësimin e situatës ekzistuese që do të rezultojë në pakësimin e ndotjes nga zhurmat në zonat kryesore urbanistike të transportit, në rrjetin e autostradave dhe në qendrat kryesore urbane (Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë). Rritje e ndotjes nga zhurmat pritet në afërsi të aeroporteve (Rinas, Kukës dhe aeroporti i jugut), veçanërisht nëse rritet trafiku ajror.

Veprimet më të rëndësishme në Plan, nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit nga zhurmat janë ato aktivitete që garantojnë pakësimin e shkarkimit të zhurmës, siç janë modernizimi i mjeteve dhe i vetë infrastrukturës dhe teknologjisë si dhe masat për pakësimin e impaktit të zhurmës në mjedis. Veprime që influencojnë indirekt në riorientimin e rrjedhës së trafikut në korridoret e transportit të distancave të gjata dhe në mjedisin urban (transporti publik) janë gjithashtu të rëndësishme.

Në pozicionimin e veprimeve mbi infrastrukturën sipas sektorëve të zhvillimit në hapësirë, zgjidhjet e përgjithshme dhe teknike do të duhet të sigurohen të tilla që garantojnë se ndotja nga zhurmat nuk e tejkalon kufirin e lejuar. Gjithë masat zbutëse që kërkohen burojnë nga legjislacioni dhe synimet janë të vendosura në SKZHI-II.

9.1.8 Popullatat Dhe Asetet Materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Në vijim të impakteve mbi shëndetin human, arritjet e këtyre objektivave influencojnë gjithashtu konsiderueshëm situatën ekonomike të njerëzve dhe asetet materiale qv ata kanë në dispozicion. Gjithashtu, ato kanë sinergji të rëndësishme pasi synojnë të kufizojnë rritjen e mbipopullimit, kërkojnë përdorim në rritje të zgjidhjeve mbi ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, hapësirës dhe energjisë, si edhe të efekteve të dëmshme mbi asetet materiale për shkak të ekspozimit të tyre në mjedise të ndotura. Impaktet do të jenë pozitive, permanente dhe rajonale.

Sipas SKZHI-II, objektivat kryesore mbi popullsinë dhe asetet materiale janë :

1) Mundësi më të mëdha dhe cilësi më të mirë të arsimimit;
2) Një sistem kujdesi shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm;
3) Zgjerimi i mundësive për punësim;
4) Forcimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale;
5) Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse;
6) Garantimi i barazisë gjinore;
7) Fokus më i madh tek artet dhe kultura;
8) Forcimi i rolit të sporteve.

Për sa i takon problemeve kryesore që lidhen me çështjet e mirëqënies, sigurisë dhe shëndetit, në mënyrë të përmbledhur ato kanë të bëjnë me aksesimin e trafikut dhe transportit në zonat urbane dhe

rurale, lidhur ngushtë me lëvizshmërinë drejt tregjeve dhe ruajtjen e lidhjeve në komunitet. Ndërkohë komunitetet lokale e kanë sfidën më të madhe me ruajtjen e situatës social-ekonomike (përfshirë bujqësinë, hortikulturën, akuakulturën, pyjet, shërbimet utilitare, edukimin etj). Zhvillimet e parashikuara në Plan detyrimisht që do të shkaktojnë më shumë trafik, më shumë emetime, më shumë zhurmë dhe më shumë trysni mbi burimet natyrore. Për të patur një zhvillim të qëndrueshëm Plani parashikon, ndër të tjera edhe zhvillimin e sistemeve të trajtimit të mbetjeve dhe të ujërave të zeza. Në këtë këndvështrim problemet që shkaktohen nga menaxhimi i dobët i këtyre sistemeve ka gjasa të zvogëlohen.Ndër rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Rritjen e nivelit të zhurmave dhe uljen e cilësisë së ajrit, që shkaktohen nga shtimi i trafikut, rritja e aktiviteteve urbane dhe shtimi i zhurmave nga aktivitetet e shërbimeve në komunitet;
- Uljen e cilësisë së ajrit që shkaktohet nga trafiku i rënduar;
- Cilësia e ulët e ujit të pijshëm e shkaktuar nga pakësimi i burimeve ujore për shkak të keqmenaxhimit të tyre si dhe për shkak të rritjes së ndotjes dhe eutrofikimit ;
- Rritja e sasisë së mbetjeve në vendet e paautorizuara që vjen si pasojë e keqmenaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe mungesës së ndërgjegjësimit ;
- Zhvillimet e reja në qendrat urbane dhe industriale do të sjellin rritjen e numrit të banorëve dhe të përdoruesve të rrugëve, duke sjellë kështu një rrezik real për sigurinë e njerëzve.

Fokusimi në zhvillimet infrastrukturore që i përgjigjen realizimit të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, kryesisht për t'i sherbyer rritjes së pritshme të numrit të vizitorëve në zonat përkatëse, mbart me vete rrezikun që komunitetet dhe vendbanimet ekzistuese mund të neglizohen nga pikëpamja e shërbimeve komunitare. Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqënies së njerëzve, ekziston rreziku që rritja ekonomike të ketë një shpërndarje të çekuilibruar.

Ndër rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Mungesa e transportit dhe lëvizshmërisë së shkaktuar nga humbja e lidhjeve me tokën bujqësore, plazhet dhe shërbimet sociale, si dhe nga një transport publik i pamjaftueshëm ;
- Prishja e cilësisë së jetës që vjen si pasojë e zhvillimeve të reja të cilat dëmtojnë mënyrën tradicionale të jetesës dhe sjellin rritje të kostove bazë të jetesës.

Ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet mjedisore nuk rezulton automatikisht me ndryshimin e sjelljeve të tyre. Duke dhënë informacione, rritur ndërgjegjësimin, dialogimin me të gjitha palët e interesuara dhe me përfshirjen e publikut në proceset vendimarrëse për politikat e propozuara do të kontribuojë së tepërmi në ndryshimin e modeleve të sjelljes përsa i takon zgjidhjeve të qëndrueshme, gjë që është theksuar së tepërmi edhe në udhëzimet strategjike të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimit.

Plani ofron zgjidhje që kanë të bëjnë me mobilitete të qëndrueshme alternative si është rasti i trafikut të biçikletave që klasifikohet midis mënyrave më të përshtatshme të transportit në terma mjedisor dhe të shëndetit. Në nivel kombëtar ky përafrim me anë të sistemit të rrugëve për biçikletat mund të lehtësojë transferimet në distancat e zakonshme të lëvizjeve nëpër qytete dhe zonat fushore dhe bregliqenore në distancë të shkurtër dhe për rekreacion në distancë të gjatë. Krijimi i rrugëve të biçikletave dhe rrugicave të marshimeve me anë të aksesimit të përshtatshëm në qendrat e rekreacionit do të kishte një impakt

pozitiv në shëndetin human (impakt lokal). Sa i takon përhapjes gjeografike të zonave të banuara në Shqipëri, veprimet e paraqitura në Plan do të sjellin zonat e largëta më afër (në kohë dhe hapësirë) me qendrat kryesore dhe veçanërisht me tregjet dhe shërbimet. Ky është impakt pozitiv, rajonal dhe permanent.

9.1.9 TRASHËGIMIA KULTURORE

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë impakte direkte në njësi dhe zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej të operimit si rezultat i efekteve të mëposhtme:

- Degradimi i veçorive të peisazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshëm);
- Dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt direkt, i pakthyeshëm);
- Shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit (impakt direkt, lokal, i pakthyeshëm);
- Vibrime që mund të shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshëm);
- Çlirime gazrash ndotës që bëjnë pjesë në kontribuimin e shirave acid dhe që shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë (impakt indirekt, kumulativ, në distancë).

Duke qenë se Shqipëria ka një diversitet të madh të trashëgimisë kulturore, në terma kompozimi dhe përhapjeje në të gjithë vendin, gjë që ka të ngjarë që ndërtimet e reja të infrastrukturës do të përzihen në këto zona, veçanërisht me peisazhin kulturor, peisazhin historik, trashëgiminë arkitekturore dhe zonat e tyre të influencës si edhe pikat arkeologjike. Pozicionimi i infrastrukturës sipas sektorëve do të ndryshojë në mënyrë permanente përdorimin e hapësirës në këto zona. Për këtë, duhet të zbatohen masa të përshtatshme për të ruajtur veçoritë e zonës së trashëgimisë kulturore. Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (psh gërmimet). Kërkime paraprake arkeologjike në plan të gjerë do të duhet të kryhen, rezultatet e tyre do të duhet të merren në konsideratë kur të pozicionohen strukturat e infrastrukturës dhe masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike do të duhet të zbatohen.

Në vijim të impakteve direkte të vazhdueshme, zbatimi i veprimeve të Planit mund të ndikojë gjithashtu në trashëgiminë kulturore në mënyrë indirekte, dmth duke përkeqësuar veçoritë e peisazhit në mjedisin përreth njësisë së trashëgimisë kulturore, vibracionet mund të shkaktojnë dëmtime në strukturat e trashëgimisë kulturore, dhe shkarkimet e gazeve që janë përbërës të shirave acide mund të shkaktojnë dëme në strukturat e monumenteve. Për më tepër në efektet indirekte, impakti i gazeve mund të jetë kumulativ dhe të ndikojë në distanca të mëdha.

9.1.10 Peisazhi

Objektivi Mjedisor 12: Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i nje imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Përcaktimi i ndikimit në cilësinë e peizazhit kryesisht buron nga veçoritë e dukshme të hapësirës dhe të peizazhit karakteristik të elementëve të pranishëm në hapësirë. Peisazhi është më i shkelur nga lidhjet e transportit që shtrihen në hapësirë të hapur, ku ndikimet e transportit janë më të dukshme për shkak të një niveli më të lartë të ruajtjes së tij (i përhershëm, ndikim i pakthyeshëm). Ndikimi është veçanërisht i madh në rast të ndërtimit të një korridori të infrastrukturës në zonat me pamje të jashtëzakonshme apo të zonave të peizazhit me karakteristika të dallueshme, dhe peisazhet me elemente të ruajtura natyrore dhe elemente jashtëzakonisht të balancuara kulturore të cilat kanë domethënie të madhe simbolike.

Ndikimet në karakteristikat e peizazhit të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të largëta. Objektet e infrastrukturës në hapësirë bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë e përvojës së saj. Prandaj, marrëveshja e tyre duhet të jetë në përputhje me llojet ekzistuese të peizazheve. Duke marrë parasysh karakteristikat natyrore dhe topografinë e zonës të aktivitetit do të zvogëlojë fragmentimin e peisazhit.

9.1.11 Konkluzuion Mbi Vlerësimin

Paraqet vlerësimin e impakteve mbi zbatimin e Planit bazuar në realizimin e objektivave mjedisore, të paraqitura për secilin veprim. Impaktet mbi objektivat mjedisore mund të ndodhin gjatë zbatimit të secilit prej veprimeve individuale (niveli A, B dhe C). Në përgjithësi, u vu re që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarr gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 10.

Gjate zbatimit të veprimeve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, uje, etj). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilesinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen

edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

9.2 IMPAKTET KUMULATIVE

Impaktet mjedisore kumulative përcaktohen në këte Raport si një kombinim i impakteve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit.

Në zbatimin e veprimeve të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vlerësohen impaktet mbi tokën, ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- tokën, zona tokë bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integrimit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen;
- asetet minerale, shkalla e riciklimit të gjenerimit të mbetjeve ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit që kombinohen;
- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- faktoret klimatikë, shkarkimet e gazeve serë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të Planit janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore të përcaktuar për sektorët e Shqipërisë për 2030 në lidhje me:

- menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit;
- shkarkimet tavanë të ndotësve ;
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serë.

Kur vlerësohen impaktet mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peisazhin, impaktet kumulative zakonisht nuk mund të shprehen si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur synimet e Planit. Kur vlerësohen impaktet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në impaktet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distancë) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë, përkohësisht dhe permanent) të impaktit. Kur vlerësohen impaktet mbi shëndetin human, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si një kombinim i impakteve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqënien e njerëzve dhe zakonisht referohen për:

- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të zhurmës;
- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat që lehtësojnë veprimtari shlodhëse dhe rekreative në një mjedis të shëndetshëm për distanca të shkurtra, veçanërisht gjatë shkëmbimeve ditore (impaktet u vlerësuan midis popullatës).

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve në Plan shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e Planit janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi

popullsinë dhe asetet materiale, nëse impaktet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

9.3 IMPAKTET NDËRKUFITARE

Ligji 91/2013 "Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor" kërkojnë përcaktimin dhe konsultimin mbi efektet ndërkufitare për planet dhe programet e hartuara.

Impaktet ndërkufitare mbi objektivat mjedisore për veprimet mbi prioritet dhe synimet nuk paraqesin asnjë efekt negativ apo pozitiv.

SEKSIONI 10
UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE

Ky paragraf përcakton udhëzimet dhe masat mbrojtëse për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisorë në fushat e vecanta. Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse, ndikimet negative të përshkruara në Seksionin 6.1 do të parandalohen dhe do të sigurohet arritja e objektivave mjedisore. Për më tepër, ky seksion ofron disa masa specifike zbutëse të zbatueshme për projektet specifike të përshkruara në Plan. Është e rëndësishme të theksohet se lista e dhënë më poshtë e masave specifike për zbutjen nuk është shteruese. Masa më të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjesë e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të Planit.

10.1 TOKA

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisorë 1 dhe 2

Duke zënë një territor të caktuar, ndërtimi i infrastrukturës së parashikuar do të shkaktojë ndikime të gjera të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në strukturën e përdorimin e tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastrukturës së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj. Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohet në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet t'i jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në tokë me potencial më të varfër të prodhimit, dhe tokë jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së pare të drurit. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja. Infrastruktura e parashikuar duhet të planifikohet në atë mënyrë që mos të rritë probabilitetin e rrëshqitjeve të tokës në zonën përreth aktiviteteve. Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotësohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re, dhe më e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuara të ndërtimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektorët e tjerë. Kur përdoren materiale ndërtimi për infrastrukturën e re, të cilat nuk janë me origjinë primare natyrore, duhet të merret parasysh fakti se:

- kërkohen sasi më të mëdha të materialeve të ndërtimit, kryesisht si mbushje;
- mobilizohen në mënyrë të përhershme disa substanca të rrezikshme nga materialet e mbetjeve;
- materialet e reja të ndërtimit mund të kenë cilësi më të mira funksionale se materialet me origjinë natyrale.

Masa Zbutëse Specifike

1.Punimet në dhera të ndotura

a. Gjatë punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Këto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur tokë artificiale me gjeomembranë, argjile dhe shtresë plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe pemë. Kjo tokë artificiale duhet të mbulojë edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të lëvizen.
b. Të gjithë materialet ndotës (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe groposen në vende të caktuara ku duhet të jenë të izoluara nga ujërat nëntokësore.

2.Ndotja e tokës

c. Toka që shtrihet nën rrugë mund të jetë në rrezik gjatë ndërtimit, pasi mund të ndotet nga derdhjet e hidrokarbureve dhe ato kimike. Pastaj toka mund të shërbejë si një burim ndotjeje kur përshkohet nga ujërat nëntokësore.

3. Metoda e thyerjes e shkëmbit

d. Në zonat ku kërkohen prerje të mëdha, do të ndeshen shkëmbinjtë, të cilët mund të kërkojnë zhvendosje. Metoda e zhvendosjes mund të variojë nga gërmimi me një ekskavator, deri tek shpërthimi, i cili do të sjellë zhurmë të konsiderueshme dhe dridhje që lidhen me të.

4. Ripërdorimi i materialit të gërmuar

e. Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në bazë të një skeme do të maksimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinerike.
f. Megjithatë, pashmangshmërisht do të ketë një sasi të konsiderueshme materiali, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinierike brenda skemës. Megjithatë, ky material mund të jetë i përshtatshëm për aktivitete të tjera, siç është krijimi i peisazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore. Ripërdorimi i këtij materiali do të maksimizohet brenda skemës, dhe çdo material i tepërt do të transportohet jashtë.
g. Materiali i gërmuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe do të depozitohet në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e gërryerjes. Koha midis gërmimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagësht duhet të jetë sa më e vogël. Gjatë periudhave të zgjatura me lageshtirë, kontraktori duhet të ndërpresë gërmimin dhe vendosjen e materialit për të parandaluar degradimin për shkak të lagështirës.

5. Erozioni

h. Përcaktimin e vijes bregliqenore qe nënkupton përcaktimin nga ana ligjore të asaj që quhet vija zero e liqenit mbi bazën e së cilës do të realizoheshin më mirë vlerësimet e erozionit, dinamikës së lëvizjes së bregut dhe të sedimenteve
i. Duhet ndërmarrë mbrojtja e argjinaturës nga erozioni, me qëllim që të sigurohet stabilizimi i argjinaturës, përfshirë edhe përzgjedhjen e material më pak të erodueshëm, përdorimin e gabioneve dhe gurëve të thyer, si dhe një ngjeshje të mirë, veçanërisht përreth urave dhe tombinove.

j. Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kërkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimëve.
k. Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rrugës janë ngritur dhe krijojnë shpate të zhveshura, të cilat kërkojnë stabilizim, përpara fillimit të sezonit të shirave.

10.2 AJRI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3

Në planifikimin e politikave dhe aktiviteteve të Planit në zonat e ndotjes së tepruar të ajrit, duhet të merren parasysh objektivat e SKZHI II dhe standartet e lejuara te emetimeve, te percaktuara nga BE, OBSH dhe legjislacioni perkates shqiptar. Duhet të përgatitet një program i detajuar i masave për zvogëlimin e ndotjes me grimca PM10 dhe PM2.5 për zonat problematike. Programi do të duhet të vërehet gjatë planifikimit të politikave dhe projekteve specifike të Planit për zonat problematike, në një shkallë më të gjerë. Prioritet në procedurën e përzgjedhjes duhet t'i jepet varianteve të cilat ofrojnë përmirësimin më të madh të cilësisë së ajrit të ambientit. Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të reja në infrastrukturë, duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit të ambientit në zonat e ndikimit të aktiviteteve përkatëse:

Cilësia e ajrit - komuniteti

- Monitorim te rasteve te sëmundjeve dhe shkaktareve;
- Përcaktimi i zonave urbane të reja me cilësi të lartë ajri për popullsinë;
- Dizenjim me kushtet dhe kriteret e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mirëmbajtje dhe zëvendësim i materialeve rezistente ndaj ndryshimit te temperaturave dhe lageshtise;
- Përdorim i mjeteve të transportit publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të eduktimit maksimal;
- Përcaktimi i zonave industriale me teknologji të lartë dhe me emetime të gazeve në sasi të ulët.

Cilësia e ajrit - ekosistemet

- Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve që shkaktojnë shiun acid;
- Komunikim ndërkufitar institucional për të shmangur incidentet mjedisore të qarkullimit të ajrit si dhe përcaktimi i masave konkrete të veprimit në raste të incidenteve ndërkufitare;
- Përcaktimi i kritereve të tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës dhe qëllimit të përdorimit të saj që në fazat e projektimit;
- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
- Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore;
- Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij.

Masa Zbutëse Specifike

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (të gjitha bashkitë të kenë dy- tre stacione monitorimi sipas specifikës së zonave industriale dhe të banimit);
- Koordinimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilesinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike.

Gjate fazës së ndërtimit, masat më të zakonshme specifike të rekomanduara në punimet infrastrukturore rrugës konsistojnë në:

- Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit: ujitja e anëve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave, gjë që bëhet përditë);
- Kufizimi i shpejtësisë së impianteve të lëvizshme në rrugë.

Ulja e ndikimit nga ndërtimi përfshin gjithashtu:

- vendodhjen potenciale të zonave që kërkohen instalimin e kantierit, magazinim si dhe zonat e stabilizimit të tokës;
- rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve.

Përsa i përket fazës së shfrytëzimit të infrastrukturës propozohen masat specifike të mëposhtme:

- kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit me pezulli në qendrat kryesore urbane;
- mirëmbajtje e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive.

10.3 Faktorët klimatikë

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 4

10.3.1 Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimaterike

Zbatimi i masave për të arritur objektivat e Planit duhet të marrë parasysh të ashtuquajturat objektiva indikative për të reduktuar emetimet e gazit, të cilat janë të përcaktuara deri në vitin 2020 në SKZHI II për reduktimin e emetimeve të gazit serrë. Në këtë kudër duhet mbajtur në vëmendje si më poshtë:

- përcaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve të trajtimit të sëmundjeve që vijnë si pasojë e ngjarjeve të motit;
- përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit ;
- Përcaktimi i kritereve dhe politikave për futjen e teknologjive bashkëkohore në bujqësi ; si dhe
- praktikave më të mira të bujqësisë organike zbatimi i një politike parkimi kufizuese në zonat urbane;

- integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe përgjegjësitë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse/përshtatëse ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

10.4 PËRSHTATJA NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Projektet specifike të Planit duhet të hartohen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë një përdorim efektiv të burimeve, që do të thotë se ndjeshmëria e infrastrukturës së parashikuar ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive antropogjenike duhet të vërehet siç duhet. Kjo do të thotë se kur planifikohet infrastruktura, duhet të merren në konsideratë masa nga vlerësimet e rreziqeve, të cilat do te rrisnin elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrën e duhur, veçanërisht në lidhje me reshjet, përmbytjet, temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit, thatësirat, rritjet e nivelit të detit dhe stuhitë. Në këtë kuadër, është e nevojshme të:

- përgatitet një analizë e ndjeshmërisë së infrastrukturës së parashkuar ndaj ndryshimeve klimatike ;
- zbatohen masat dhe orientimet e bazuara në rezultatet e analizave të cilat përmirësojnë në mënyrën e duhur elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike.

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si më poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jenë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, debores, apo edhe ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri apo zgjerimi të strukturave ekzistuese, duhet të kryhet një analizë ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit , dhe në bazë të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre fenomeneve;
- zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë einfrastrukturës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të bëhet një detyrë qëndrore e menaxhimit të çdo lloj infrastrukture. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në reduktimin e dëmit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukturës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë;
- duhet të përcaktohen qartë udhëzimet për metodologjinë, procedurat dhe realizimin e mbledhjes së informacionit mbi kushtet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës së parashikuar ndaj kushtet ekstreme të motit.

Masa Zbutëse Specifike

Masa Zbutëse Specifike

- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
- Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore;

- Dizenjimi dhe përcaktimi i kritereve të ndërtimit të infrastrukturave nëntokësore me materiale dhe struktura rezistente ndaj kushteve të motit dhe në veçanti ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë;
- Ndalimi i ndërhyrjeve ilegale në infrastrukturat nëntokësore ;
- Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve ekologjike të mjediseve natyrore;
- Monitorimi i dinamikës së vijës bregore dhe nivelit të liqenit;
- Monitorimi i nivelit të liqenit dhe cilësisë së ujërave në zonat ligatinore dhe ujërat nëntokësore;
- Monitorimi i vijës bregliqenore dhe sasisë së sedimenteve që vijnë nga lumenjtë;
- Monitorimi i lëvizjes së tokës dhe tjetërsimit të saj;
- Monitorimi i marrjes së zhavorreve nga shtretërit e lumenjve ;
- Përcaktimi i zonave të lejuara për ndërtim HEC-esh dhe digash për bujqësinë ;
- Monitorimi i gjendjes së monumenteve dhe veprave të trashëgimisë kulturore;
- Monitorimi i lëvizjes së popullsisë në zonat urbane dhe rurale ;
- Zbatimi i kodeve të reja të ndërtimit për ndërtesat sociale dhe kulturore duke përdorur materiale ; termoizoluese dhe rezistente ndaj kushteve të motit ;
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore ; dhe
- Përcaktimi i zonave buferike për rastet e ndikimeve nga rritja e nivelit të liqenit

10.5 UJI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 5

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtrojë infrastruktura e parashikuar në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmanget integrimi hapësinor i infrastrukturës së re në zonat e mbrojtura ujore.

- Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së re, është e nevojshme që të shmanget integrimi i objekteve në zonat në rrezik nga përmbytjet dhe erozioni si pasojë e tyre. Në rast të ndërhyrjeve në këto zona, duhet të provohet se niveli ekzistues i rrezikut nga përmbytjet në zonën përreth nuk do të rritet. Udhëzimi i lartpërmendur duhet të merret parasysh në mënyrë që të reduktojë presionin e infrastrukturës së re në zonat në rrezik nga përmbytjet, dhe për të siguruar se niveli i rrezikut nga përmbytjet në zona të veçanta nuk do të rritet.

- Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shumë të lartë dhe të lartë të akuifereve, është e nevojshme që të studjohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme). Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të reduktojë probabilitetin e ndotjes nëntokësore, duke siguruar ndikime të kufizuara të presionit të infrastrukturës së re në ujërat nëntokësore.

- Sa më shumë që të jetë e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të ndërhyjë në tokën pranë liqenit. Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenet mbrojtëse ujore, dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimit të kësaj mase, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë llogaritjen e kostove më të saktë dhe të balancuar. Duhet të priten më pak aktivitetete zonat bregliqenore. Kjo do të parandalonte ndikime të rëndësishme negative në gjendjen ekologjike të rrjedhave ujore.

Në mënyrë që të zvogëlohen ndjeshëm ndikimet negative në cilësinë e ujit të liqenit te Ohrit, duhet të merren masat e mëposhtme:

- të blihen pajisjet e duhura për t'u marrë me derdhjet e substancave të rrezikshme në liqen;
- të ndërtohet infrastruktura e duhur për të pritur dhe asgjesuar mbetjet nga anijet ;
- të sigurohet qarkullimi i rrjedhave ujore dhe kështu të parandalohet eutrofikimi përmes planifikimit të duhur.

Masa zbutëse specifike

- Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akuifer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i dëmit ndaj ujërave nëntokësore. Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe një mënyrë për ta kaluar këtë zonë (si psh ndërtimin e një ure) për të garantuar mbrojtjen e ujit nëntokësor.
- Duhen planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e larjes, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës, si dhe në rastet e ndodhive të jashtëzakonshme (psh derdhjet e substancave të rrezikshme).

Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pas se 50 m nga Lumi Devoll si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lumë, apo kanalet kulluese;
- Hedhja e betonit duhet të bëhet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;
- Kur derdhjet nga kantieri duhet të shkarkohen në një lumë, norma e derdhjeve duhet të kontrollohet, në mënyrë që ajo te mos shkaktojë përmbytje lokale në rrjedhen e ujit, apo erozioni;

- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Marrja e mostrave të ujërave nëntokësore duhet të bëjë gjithashtu matjen e pH, turbullirës dhe përcjellshmërisë elektrike. Të gjitha veprimet e kërkuara dhe nëse nevojiten analizat duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.

10.6 MJEDISI NATYROR

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisorë 6 dhe 7

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi mjedisore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rrugët e migrimit të kafshëve të egra (variante të cilat kalojnë më shumë nëpër tunele dhe variante të cilat ndërpresin më pak rrugët e migrimit);
- Duhet të sigurohen pasazhe të përshtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Para se të planifikohet çdo ndërtimi i ri, duhet të kryhet një studim apo të përmblidhen rezultatet e studimeve ekzistuese, të cilat do të lehtësonin integrimin në mënyrë të përshtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formën, madhësinë, dhe sistemimin e objektit dhe rrethinave të tij). Planet duhet gjithashtu të parashikojnë pasazhe për kafshët e vogla (amfibët, gjitarët e vegjël, zvarranikëve) në bazë të studimeve ekzistuese ose, nëse është e nevojshme, hulumtimeve shtesë.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmanget ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë ruajtjen e llojeve dhe karakteristikave të vlefshme natyrore. Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmanget ndërhyrja e projekteve në zonat e mbrojtura. Nëse aktivitetet në zona të tilla nuk mund të shmangen, dhe nëse kjo është e lejuar në bazë të aktit për mbrojtjen e një zone të caktuar, duhet të merren parasysh udhëzimet, bazat dhe kushtet për ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë në regjim mbrojtjeje, të miratuar me aktet për mbrojtjen. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

Tab. – 67 *Masat për mbrojtjen e Biodiversitetit*

Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike

1	Zbërthim i kuadrit ligjor, në menaxhimin e Biodivesitetit. Përgjithësime, por dhe veçori të relievit dhe biodiversitetit në NjAV	Përmirësime afat-shkurtra të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës; zbatimi i Ligjit të Biodiversitetit duke përfshirë trajnimin e e specilaistëve të NjAV
2	Njohje dhe menaxhim shkencor i zonave të Mbrojtura	Morava (NjAV e Drenovës), Menaxhimi i GJEOMONUMNTEVE të mbrojtura (Voskopojë dhe Vithkuq)
3	Zhvillimi i Planeve të të zgjerimit të zonave të Mbrojtura në Voskopojë dhe Vithkuq.	Është menduar që të gjitha vendet të cilat janë përcaktuar para fundit të vitit 2012 do të kenë plane të menaxhimit të plotë deri në fund të 2015.
4	Rritja e Menaxhimit të Specieve të Mbrojtura, në malin e Moravës dhe ujëmbledhjen e Çemericës.	Ndërmarrja e fushatës për të zvogëluar numrin e armëve të zjarrit pa leje
5	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve.	Sigurimi i objektivave për menaxhimin e zonës së mbrojtur janë përfshirë si kritere kyç në udhëzuesin shëndetësor të MM.
6	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit në krijim të një GIS për Biodiversitetin.	Bashkëpunim i Administrtaës së Bashkisë dhe NjAV për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, ndërhyrja e projekteve në zonat e Natura 2000 duhet të shmanget. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e lidhjes dhe integrimit të zonave të Natura 2000. Periudha për zbatimin e projekteve duhet të rregullohet sipas cikleve jetësore të kafshëve dhe bimëve, dmth:

- duke ju përshtatur kafshëve pa apo me aktivitete me një shtrirje në një masë të vogël, që përkon me periudhën kur kafshët kanë nevojë për qetësi, ose nuk mund të lëvizin larg, sidomos gjatë periudhës së riprodhimit, shumimit, rritjes, dhe dimërimit;
- duke ju përshtatur bimëve duke lehtësuar prodhimin e farës, mbjelljen natyrore dhe format e tjera të riprodhimit.

Respektimi i masës do të zvogëlojë shqetësimet për ciklet e jetës së kafshëve dhe bimëve dhe do të rrisë probabilitetin për të arritur apo ruajtur një gjendje të favorshme të popullsisë. Mundësitë e arritjes së objektivit për ruajtjen e biodiversitetit do të jenë më të larta.

Në përputhje me objektivin SKZHI II "nje rritje e synuar te 17% e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura të territorit nëpërmjet përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura" sipërfaqja e zonave të mbrojtura pritet të rritet. Prandaj, ndërhyrja hapësinore e infrastrukturës së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmanget për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore të ruajtjes së natyrës.

Sa më shumë që të jetë e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të ndërhyjë në tokë bregliqenore. Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, për të zvogëluar basenet mbrojtëse ujore, dhe për të prodhuar ndikime kumulative mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimeve, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk

mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistem. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë llogaritjen e kostove më të saktë dhe në mënyrë të balancuar siç duhet. Në zonat bregliqenore pritet të zhvillohet më pak ndërhyrje, për të parandaluar kështu ndikime të rëndësishme negative në biodiversitetin e këtyre zonave.

Masa Zbutëse Specifike

Projektet specifike duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë më adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasojë e ndërtimit të infrastrukturës se re. Duhet të zbatohet masa zbutëse specifike: Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve. Përmbajtja e kësaj mase duhet të jetë si më poshtë:

- Të ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Për këtë qëllim, fillimisht, duhet të kryhet një studim apo të përmblidhen të dhënat nga monitorimet ekzistuese rreth vdekshmërisë së kafshëve të egra në rrugë. Pastaj, bazuar në gjetjet e studimit, do të krijohen lehtësira për migrimin e kafshëve të egra. Në kuadër të kësaj mase, do të përgatitet një listë prioritare e zonave 'të zeza' ku kafshët rrezikohen më shumë dhe në këto zona do të zbatohen masat zbutëse përkatëse (sisemim të vendkalimeve, gardhe anësore etj.). Gjithashtu kjo gjë ndikon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë së trafikut.

- Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit, duke ndërtuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithe sistemimet e tjera për të parandaluar lëvizjen e kafshëve të egra (sidomos mishngrënësve, drerëve, lakuriqve të natës dhe amfibëve). Për nevoja të planifikimit, do të përgatitet në fazën e parë një studim (ose nëse është e mundur do të përmblidhen rezultatet e studimeve tashmë të kryera), i cili do të përfshijë të dhëna për speciet, migrimi i cilave do të preket nga aktiviteti, si dhe udhëzime për projektuesin që do të planifikojë objektin apo ndërhyrjen (vendndodhja, forma, madhësia, gjelbërimi i objektit dhe rrethinave, etj).

Këto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rrugët e migrimit) të specieve dhe arrijnë e objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

10.7 MBETJET

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Zhvillimet e parashikuara padyshim që mbartin pasojën e gjenerimit të shtuar të sasisë së mbetjeve, të cilat mund të cënojnë integritetin e shtresave të ujrave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Nga ana tjetër mund të shkaktohen sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës së ndotur. Pikat e vjetra e të nxehta përbëjnë rrezik jo vetem për shëndetin e njeriut, por krijojnë ambient për investime të reja para pastrimit të duhur. Gjenerimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe ne integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Rehabilitimi /Inkapsulimi i pikave të nxehta mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Propozohet të studiohen të gjitha territoret e objekteve industriale që kanë përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin dhe të prioritizohen mbi bazën e shkallës së rrezikut, duke zbatuar të gjitha direktivat e BE-së që lidhen me kontaminimin e rrezikshëm të tokës;
- Plani të përcaktojë dhe të ndajë zonat e ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve;
- Inventarizmi dhe diagnostifikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe duhet bërë dhe raportimi. Rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë ;
- Duhet riparë norma 1 landfill/rajon sipas stratetgjisë kombëtare, kur pritet rikompozim i rajoneve në kuadrin e reformës së re territoriale. Rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë ;
- Hartimi i projekteve të standardizuara dhe mbështetja teknike duhet t'u ofrohen zonave të mbetjeve dhe autoriteteve lokale për të garantuar cilësinë e përshtashme të planeve dhe që rezultatet e tyre të jenë të krahasueshme. Në kuadrin e reformës territoriale bashkitë duhet të zgjerojnë shërbimin në këto zona ;
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat ;
- Të shihet mundësia e ngritjes së një landfilli industrial qëndror për depozitimin e mbetjeve të ngurta industriale mbas trajtimit të tyre me metodat e përcaktuara nga Konventa e Bazelit, duke shmangur depozitimin e tyre në landfillet urbane ;
- Planet duhet të saktësojnë orientimin drejt trajtimit të tyre sipas hiearkisë që është më praktikja dhe më e arritshmja në nivelet e ulta, të ndërlidhura me masa që varen shumë nga aktorët kryesorë në qeverisjen qendrore, politikat e saj dhe përgjegjësitë e prodhuesve. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, duke vendosur standarde lokale për të cilat kanë rënë dakord të tre nivelet ;
- Duhen planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit, kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis ;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturat e nevojshme ;
- Mobilizimi i një instrumenti financues nga niveli kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim që të plotësohen funksionet e tij në fushën e menaxhimit të mbetjeve ;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve ;
- Përcaktimi i zonave ndërkufitare liqenore për menaxhimin e incidenteve të ndotjes industriale.

10.8 ZHURMAT

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Kur të planifikohen politikat për zhvillimin e infrastrukturës së parashikuar, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja akustike në mjedis në përputhje me objektivat e përcaktuara në SKZHI II, është e nevojshme të sigurohen masa që kontribuojnë në:

- reduktimin e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative;
- mbrojtjen e mjedisit.

Ndotja akustike në Shqipëri është veçanërisht e lartë në qendrat urbane dhe në zonat e qendrave më të rëndësishme me zhvillime infrastrukturore. Prandaj është e domosdoshme që të merren masa për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Zbatimi i masave është i nevojshëm në zonat me ndotje të tepruar akustike në situatën aktuale, ndërsa duhet gjithashtu të merren masa zbutëse në të gjitha zonat ku Plani parashikon infrastrukturë të re. Gjatë përgatitjes së akteve hapësinore për projektet e infrastrukturës, duhet të respektohen udhëzimet e mëposhtme për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma:

- duhet të sigurohen për aq sa të jetë e mundur, masa për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim (masa në rrjetin apo strukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e përkohshëm ose të përhershëm të lëvizjeve tranzite, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësinë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj) ;
- në zonat ku tejkalohen tavanet e ndotjes, duhet të merren masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis (nëpërmjet barrierave të zhurmës dhe argjinaturave, galerive të mbuluara, etj) dhe për të siguruar kushte të mira jetese në ndërtesa (mbrojtja pasive);
- duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuar dhe / ose në zona të cilat janë të përcaktuara në bazë të legjislacionit për mbrojtjen nga zhurma si veçanërisht të ndjeshme ndaj zhurmës (ndërtesat e banimit, objektet e kujdesit shëndetësor, zonat turistike);
- duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta në natyrë (zonat e mbrojtura në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës).

Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma në duhet të përqëndrohet kryesisht në: (a) masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim; (b) masat për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis; dhe (c) nëse është e nevojshme, masa për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në ndërtesat e mbiekspozuara.

Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë më të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikës në përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut dhe orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHI II në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrijë objektivin e 56 dB / ditë dhe 45 dB / natë.

Masat për të parandaluar përhapjen e zhurmës në mjedis (barrierat e zhurmës / argjinaturat dhe mbrojtja pasive) janë përdorur kryesisht për të mbrojtur mjedisin nga zhurmat e shkaktuara prej sektorit të

transportit. Masat janë të përshtatshme kryesisht për mbrojtjen e zonave me dendësi të madhe të popullsisë përgjatë rrjetit rrugor, ndërkohë që zbatimi i këtyre masave përgjatë rrugëve ekzistuese që kalojnë përmes vendbanimeve me një strukturë urbane të formuar dhe të dallueshme tashmë, është i arsyeshëm vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Masat për të siguruar kushte të duhura jetësore (përmirësimi me hapësira mbrojtëse i izolimit nga zhurma i dritareve në ndërtesat e ekspozuara së tepërmi) janë të përshtatshme në zonat ku masat e tjera nuk janë teknikisht të zbatueshme apo ekonomikisht të qëndrueshme.

Masa Zbutëse Specifike

Rritje e ndikimeve të ndotjes akustike pritet gjithashtu gjatë zbatimit të aktiviteteve të infrastrukturës. Ndikimet e fazës së ndërtimit do të jenë afatshkurtër dhe të kthyeshme. Në veçanti, për të reduktuar ndikimet gjatë zbatimit të aktiviteteve, duhet të merren masat e mëposhtme zbutëse:

- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës nga makinerive të ndërtimit, në përputhje me rregullat mbi emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- Do të ndiqen mënyrat më të mira të praktikueshme, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e duhur të impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara nga operacionet në terren, dhe në të gjitha rastet, në përputhje me rregullat shqiptare;
- Sheshet e ndërtimit dhe rrugët e transportit duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që ndotja akustike nga makineritë e transportit, funksionimi i pajisjeve në katier dhe ndërtimet e objekteve, të mos tejkalojë vlerat kufi në ndërtesat më të afërta;
- Çdo impiant, i tillë si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jetë i rrethuar nga një barierë akustike apo reflektor portativ;
- Implementimi i masave të përkohshme për të mbrojtur nga zhurma zonat e popullsuara pranë kantiereve të ndërtimit dhe rrugëve të transportit ku janë tejkaluar vlerat kufi;
- Respektimi i afateve kohore për ndërtimin afër zonave të popullsuara;
- Publiku i gjerë dhe banorët e zonës do të informohen paraprakisht kur të kryhen vepra që emetojnë zhurma të konsiderueshme;
- Në kantierin e punimeve nuk do të përdoret asnjë makineri apo pajisje që shkakton shqetësim te publiku për shkak të zhurmës;

10.9 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

- Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat mulitmodale të transportit) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Për të shmangur një përkeqësim të mjedisit ku jetohet në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet në vëmendje kur të bëhet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuadër të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

- Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen më aktive të komunitetit në kuadër të sistemimeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.
- Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë aksesin, dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.

10.10 TRASHËGIMIA KULTURORE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë te njësitë dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njësive të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore. Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike;
- Në kuadër të ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimi). Do të duhet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike;
- Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e punëve përgatitore (projektit) për një detyrë të veçantë. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës. Zona më pas do të studiohet dhe mundësisht do të rrethohet; duke mos lejuar asnjë zhvillim të mëtejshëm në atë zonë derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara;
- Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jetë i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasojë e neglizhencës ndaj arkeologjisë;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja;
- E gjithë puna e ndërtimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivite të lidhura me ndërtimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet kombëtare përkatëse.

10.11 PEISAZHI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peisazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar dhe një imazh të cilësisë së lartë të peisazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të vecantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së lartë të peisazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

10.11.1 Strategjia e Peizazhit

Në rastet kur projekti specifik i mbivendoset ndonjë peizazhi ekzistues bujqësor apo rural, duhet të ndiqet një qasje ku synohet mbrojtja e vlerave rurale dhe rezidenciale dhe pasurimi i peisazhit përgjatë anëve të rrugës. Objektivat e punimeve peisazhistike:

- Të zhvillohet një peizazh, karakteristikat e të cilit lidhen me modelin, shkallën dhe diversitetin e karakteristikave të peizazhit ekzistues ;
- Të minimizohen ndërhyrjet vizuale dhe të zvogëlohet natyra negative e çdo pengese vizuale;
- Për të mbrojtur, të rikthehen apo të zmadhohen elementet e peizazhit ekzistues, të prekur drejtpërdrejt nga propozimi;
- Të ndihmohet në krijimin e kushteve të këndshme e të sigurta të drejtimit të mjeteve.

10.11.2 Masat e përgjitshme zbutëse ndaj peizazhit

Gjatë zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsideratë duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jetë e mundur. Në këtë kuadër, alternativa përfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tillë që të minimizojë ku të jetë e mundur ndikimin në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet. Megjithatë, disa ndikime janë të pashmangshme, dhe masat e propozuara synojnë të zbutin natyrën negative të këtyre ndikimeve. Në rastet kur shtrirja vertikale propozon argjinatura të larta që krijojnë ndikime të rëndësishme në mjedis, këto përforcime të larta nuk duket të jenë optimizuar. Ato duhet të jenë ku është e mundur, të reduktuara deri në nivelin e tokës apo 1m lartësi.

Masa të tjera të përgjithshme përfshijnë:

- Në skarpata, për të parandaluar rënien e shkëmbinjve, duhet të jenë më preferueshme bordurat e gjera se platformat e ndërmjetme. Skajet e skarpatave duhet të rrumbullakosen. Shpatet e parregullta duhet të jenë më të preferueshme se sipërfaqet gjeometrike;

- Zbatimin e standardeve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantiereve dhe rivegjetacionin, për të siguruar ruajtjen e komoditeve të nevojshme të peizazhit;
- Për mbushje, shpatet duhet ti nënshtrohen mbjelljes hidraulike me një përzierje farë që përfshin si farat e barit, ashtu edhe të shkurreve mesdhetare. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambjenteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projektit, sidomos në kryqëzime;
- Për zonat potenciale në një nivel (pas optimizimin të lartësisë së projektit) bimësia e propozuar do të përmirësojë ndikimet negative të automjeteve, si dhe hapësirën vizuale të projektit të propozuar;
- Përgjatë gjatësisë së projektit përkatës do të trajtohen sipas rastit: venddepozitimet për mbeturinat, zonat e përkohshme të ndërtimit, zonat e peizazhit brenda kryqëzimeve, zonat e vogla të fushave të copëzuara, fermat apo pronat e tjera të siguruara për ndërtimin e projektit. Te pikat e mbetjeve do të psh: mbillet në mënyrë hidraulike. Zonat e përkohshme të ndërtimit do të jenë të rrethuara dhe të integruara vizualisht duke përdorur mbjelljen e bimëve sipas kërkesës.

10.11.3 Faza e ndërtimit

- Kontratat do të jetë e përshtatur për të siguruar praktika të mira të punës në mënyrë që të zvogëlojë çfarëdo ndikimi negativ që rrjedh nga ndërtimi në nivelin më të ulët të mundshëm dhe për të siguruar që makineritë veprojnë brenda zonës përkatëse të ndërtimit të projektit. Në të gjitha rastet, rregulloret kombëtare do të mbështeten kur të jetë e mundur me udhëzime nga praktikat ndërkombëtare;
- Zonat e përkohshme të ndërtimit do të pozicionohen në një mënyrë të tillë që të shmangin ndikimet e mëtejshme në pronat ekzistuese të banimit, pemët, gardhet, kanalet e kullimit etj. Këto zona, përpara ose në fund të kontratës së ndërtimit, do të rikthehen plotësisht në gjendjen e mëparshme ;
- Lidhur shfrytëzimin e materialeve inerte, nxjerrja e e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve është e kontrolluar në përputhje me ligjin 8093/96, Neni 20;
- Sa i përket zonave të magazinimit, kontraktori do të kërkohet të përgatisë dhe zbatojë një plan të magazinimit të përkohshëm në konsultim me punëdhënësin dhe Agjensinë përkatëse Rajonale të Mjedisit. Ky plan do të hartohet para fillimit të punimeve të dheut. Në këtë plan, kontraktori duhet të përcaktojë qartë sasinë e materialit që do të hidhet apo ruhet përkohësisht, para se të fillojnë punimet përfundimtare. Plani gjithashtu do të specifikojë llojin e materialit dhe burimin e tij p.sh. gërmim hendeqesh, dhe sipërfaqësor etj;
- Me përfundimin e çdo projekti përkatës, shpatet anësore, duke përfshirë gërmimet dhe argjinaturat, bankinat dhe sipërfaqet e tjera të buta do të përgatiten për t'u mbuluar me dhè, dhe do te mbillen apo vishen me bimësi mbrojtëse.

Masa Zbutëse Specifike

- Në zonat kodrinore / malore, hapësira që kërkon okupimin e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmanget prerja e panevojshme e pemëve;

- Në zonat përgjatë brigjeve liqenore / lumore, sipërfaqja e tokës së okupuar do të mbahet në minimum, me qëllim shmangien e prerjes së panevojshme të pemëve në këto zona;
- Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahet dhè, dhe ato do te mbillen me bimë që mund të adoptohen në kushtet lokale;
- Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.

SEKSIONI 11
MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Sistemi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Planit, është një mjet i thjeshtë për t'u perdorur për një monitorim efektiv. Monitorimi i ndikimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit, dhe në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktivën 2001/42/EC, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme. Në këtë kuadër, është hartuar edhe sistemi i monitorimit të ndikimeve kryesore në mjedis, të cilat pritet që të shkaktohen nga zbatimi i Planit. Këto ndikime janë identifikuar gjatë vlerësimit të ndikimeve mjedisore të planit përkatës. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversiteti, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji, peisazhi, trashëgimia kulturore, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatori mjedisor të propozuar.

Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime:

(a) të dhënat e para që merren nga matja e parametrave të mjedisit; dhe
(b) vlerësimi i indikatorëve mjedisorë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes matjeve mund të realizohet duke përfshirë Autoritetet Rajonale (Qarqet), por edhe Institucionet Shtetërore (përmes Ministrisë së Mjedisit), Pushtetin Lokal, institucione kërkimore shkencore dhe ato profesionale, si dhe ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës – kanalizime etj.). Matja e indikatorëve mjedisorë është një proces kompleks; ai është një proces që kryhet rregullisht dhe për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë këndvështrim ne duhet që të bazohemi në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga strukturat e tjera, duke theksuar, nga njëra anë, monitorimin e zbatimit të standarteve të nevojshme të matjeve nga strukturat e tjera, dhe kryesisht nga operatorët përkatës (përmes përfshirjes së tyre në procesin e nxjerrjes së lejeve përkatëse mjedisore), dhe nga ana tjetër, duke u përqendruar tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Autoritetet Rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kontekts, autoritetet përkatëse duhet të planifikojnë dhe të veprojnë si një qendër mbledhjeje, analizim dhe shpërndarje të informacionit. Më konkretisht, roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

- Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme;

- Mbledhjen e të dhënave bazë që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.);
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë, etj);
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera;
- Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit në një zonë të caktuar;
- Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohë te caktuara;
- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këto raporte synojnë që:

(a) të plotesojnë kërkesat e legjislacionit;

(b) të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit (vendim-marrësit);

(c) të informojnë publikun që preket nga Plani.

Për çdo sektor mjedisor janë dhënë indikatorët përkatës, strukturat përgjegjëse për monitorimin, parametrat mjedisore dhe frekuenca e monitorimit. Siç u përmend edhe më sipër, theksohet që monitorimi i ndikimeve të Planit në mjedis do të realizohet, aty ku është e mundur, duke përdorur të dhëna që dalin nga:

- Sistemi ekzistues i monitorimit të parametrave mjedisore nga Ministria e Mjedisit (MM) apo institucione te tjera. Disa parametra që maten dhe japin të dhëna janë:
- Cilësia e ajrit (niveli i ndotjes);
- Cilësia e ujit (ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat e plazheve në liqen);
- Studime të veçanta dhe të pavarura për identifikimin e ndikimeve mjedisore në kuadër të programeve apo projekteve të tjera;
- Raportet e përgatitura nga kontraktorë/konsulentë të ndryshëm, me të dhëna të drejtpërdrejta ose të referuara nga VNM-të individuale të projekteve specifike infrastrukturore të financuara nga buxheti i shtetit apo donatorët e huaj.

Tab. – 68 *Monitorimi i ndikimeve ne mjedis prej zbatimit të planit*

Nr	Aspekti Mjedisor	INDIKATORI MJEDISOR	AUTORITETI MONITORUE	PARAMETRAT MJEDISORE	FREKUENCA E MONITORIMIT	KOMENTE
1	Biodiversiteti – fauna - flora	• Sa habitate të rëndësishme janë në gjendje të Kënaqshme? • Numri dhe /ose sipërfaqja	Strukturat e Menaxhimit te Zonave te Mbrojtura	• Habitatet • Numri dhe /ose sipërfaqja • me zona të mbrojtura • Numri i specieve	Sipas Planit të Menaxhimit Çdo vit	

		• me zona të mbrojtura • Përmasat e biodiversitetit, • krahasuar me BE (Numri i specieve endemike dhe të rralla • Sipërfaqja e mbuluar me pyje	Drejtorite pergjegjese ne qarqe	endemike dhe të rralla • Sipërfaqja e mbuluar me pyje • Numri dhe sipërfaqja e mbuluar me zona natyrore		
2	Popullsia – shendeti i njerezve	• Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme • Aksidentet në punë • Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Drejtorite pergjegjese ne qarqe	• Vitet e jetëgjatësisë së • Shëndetshme • Aksidentet në punë • Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Çdo vit	
3	Toka	• Përqindja e tokës së • degraduar • Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille • Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali • % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio të degradueshme, alumin)	Drejtorite pergjegjese ne qarqe Strukturat e Menaxhimit te Lendfilleve	• Përqindja e tokës së degraduar • Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille • Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali • % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio të degradueshme, alumin)	Çdo vit	
4	Uji	• Cilësia e ujërave sipërfaqësorë • Cilësia e ujërave nëntokësorë • Përdorimi i ujit nga sektori • Përqindja e riciklimit të ujit • Përqindja e	Drejtorite pergjegjese ne qarqe Strukturat e menaxhimit te ITUN[6]-ve	• Total N, total P, BOD-et, • COD, SS, TDS, pH, përcjellshmëria, etj. • pH, përcjellshmëri, fortësia, kloridet, sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet,	Kampionim dhe matje sipas miratimit të kushteve mjedisore për çdo ITUN. Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së	Sipas Ligjit nr. 34/2013 qe amendon Ligjin nr 9115, datë 24.7.2003 Ligji nr. 9915, date

		popullsisë së lidhur me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotur	Ministria e Mjedisit	detergjentet, ngarkesa toksike e mikrobiologjike, etj. • Parametrat mikrobiologjikë	Ujërave Sipërfaqësorë	12.05.2008
5	Ajri	Ditët kur tejkalohen normat e cilësisë së ajrit	Ministria e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet serë, Pb, CO	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit te Cilesise se Ajrit te Ndotur
6	Faktoret klimatike	• Shkarkimet e Gazeve Serë shkarkimet sipas burimit (%) • Zhvillimi i kërkesës për energji • Alokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit • Përqindja e BER (%)	Ministria e Mjedisit Ministria e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet serë, Pb, CO Përqindja e Energjisë nga BER (%) Numri i automjeteve të udhëtarëve	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit te Cilesise se Ajrit te Ndotur
7	• Asetet e prekshme – • Trashegimia kulturore(perfshire trashegimine arkitektonike arkeologjike) • Peisazhi	• Numri i godinave të ruajtura që restaurohen • Numri i vizitorëve • Gjelbërim urban për frymë	Drejtorite pergjegjese ne qarqe	• Numri i godinave të ruajtura që restaurohen • Numri i vizitorëve • Gjelbërim urban për frymë	Çdo vit	

Monitorimi i ndikimeve mjedisore për çdo projekt specifik të Planit do të bëhet në përputhje me programin e monitorimit dhe mund të përmbajë informacion në formë tabelë, sipas formatit të paraqitur më poshtë.

Projektet specifike te Planit	Indikatorët mjedisore	Parashikimi i ndikimeve kumulative (nëse ka)	Ndikimi total i Planit
Projekti 001			
Projekti 002			
Projekti 003			

Projekti …			

SEKSIONI 12

PËRFUNDIME DHE MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH

12.1 PËRFUNDIME

1. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.
2. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.
3. Në thelb të vizionimit të territorit të bashkisë Pogradec qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit. Pogradeci, Qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror - bujqësi.
4. Qëllimi që synon të përmbushë ky Plan është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore, të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private, të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit, të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin, dhe të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.
5. Vizioni është formuluar me disa fasha: Të kthehemi në një nga rajonet ekonomike më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, Një ekonomi lider, e cila konkuron në nivel ndërkombëtar, Të përmirësojë cilësinë e jetesës për të gjithë, Përmirësimi e lëvizshmërisë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, Specializim, densifikim dhe mbështetje e bizneseve të vogla dhe të mesme, dhe
6. Suksesi duhet të sigurohet me mënyra që promovojnë efiçiencën energjitike, mbrojnë cilësinë e ajrit, minimizojnë dhe menaxhojnë mbetjet, si dhe mbrojnë e përmirësojnë mjedisin natyror dhe atë të ndërtuar.
7. Ojektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues (PPRr) së Bashkisë Pogradec për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij.
8. Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të PPRr, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre.
9. VSM analizon disa skenarë. Skenari "0", pra "i të mos bërit asgjë" në këtë Bashki do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm.
10. Megjithëse ka një proces të qartë në zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët qëndron

në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore. Ndër to do të veçonim ligjet: “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”; “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”; “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve; “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; “Për trajtimin e ujrave të ndotur”; “Për substancat dhe preparatet kimike”; “Për administrimin e zhurmave në mjedis”; “Për zonat e mbrojtura”; “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe “Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”.

11. Faktorët kryesor që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë sektori i transportit dhe djegia për ngrohje që mbeten burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban.
12. Zhurmat e matura në DB në disa zona dhe fshatra të qytetit të Pogradecit, Rruga nacionale në Buçimas, e cila ka dhe ndotjen më të madhe akustike si pasojë e transportit të makinave. Për zvogëlimin e impaktit të zhurmës në komunitetin urban të Pogradecit duhet të kenë përparësi të madhe.
13. Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
14. Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat liqenore mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.
15. Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100; Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit; Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;
16. Në ndërtimin gjeologjik të rajonit Pogradec, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë, ato që ndikojnë më tepër në truall mbajtjen për shërbime civile janë depozitimet e kuaternarit
17. Zonat e mësipërme tektonike kontaktojnë midis tyre, me kontakte tektonike mbihipëse e mbulesore, lëvizjet neotektonike aktuale sot, kanë diferencuar relievin e sotëm. Prania e lëvizjeve neotektonike vihet re në ekzistencën e formimit të tarracave lumore të lumenjve, që takohen në këtë territor, në fund të grykave depërtuese të lumenjve.
18. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë resurse ujore nënëtokësore shumë të mëdha dhe kryesorët për furnizimin me ujë të territorit të bashkisë.
19. Burimi i ushqimit të ujërave nëntokësore janë kryesisht reshjet atmosferike dhe Liqenet e Prespës. Ujërat nëntokësore që grumbullohen në këtë strukturë drenojnë në drejtim të veri-perëndimit nëpërmjet burimeve të Tushemisht-Volorekë dhe Shën Naum në Maqedoni, por një pjesë e këtyre ujërave drenojnë brenda në liqenin e Ohrit.
20. Furnizimi kryesor me ujë i liqenit bëhet nëpërmjet rrugëve nëntokësore nga liqeni i Prespës, i vendosur 157m me lart, që dalin pranë bregut Shën Naum-Drilon, me prurje të përgjithshme 15m^3/sek. Rreth 26% e ujrave vijnë në liqen nga lumenjtë e përrenjtë që derdhen në të.
21. Lëndët ushqyese (fosfori dhe azoti) të pranishëm në ujrat e përrenjve, sidomos mbas ndotjes me lëndët ushqyese të fabrikës së rritjes së peshkut pranë Volorekut dhe në ujrat e përdorura

shtëpiake (ende jashtë skemës së mbledhjes për trajtim) favorizojnë rritjen e algave dhe të bimëve ujore, gjë që përshpejton eutrofizimin e liqenit.

22. Presionet mbi akuiferët e rajonit Pogradec janë përqëndruar në: Kërkesën më të madhe për burimet ujore (bujqësia dhe turizmi) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i burimeve të ujërave nëtokësore është më i ulët; Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar të një numri të madh shpimesh privatë për furnizim me ujë pijshëm dhe industri; Shfrytëzimi pa kriter i shumë shpimeve të vjetër e të rinj të kryer në akuiferë me presion; Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.
23. Uji i pijshëm mund të shfaqë së shpejti problem sanitar sepse kemi ruajtje të dobët të brezave të mbrojtjes sanitare të vendburimeve ujore, për shkak të ngritjes mbi to të ndërtesave apo mbjelljes së tokës fare pranë burimit, duke përdorur edhe shumë kimikate;
24. Liqeni e zona për rreth janë të rrezikuara seriozisht nga mbetjet industriale historike, derdhja e ujrave të zeza të disa shtëpive të pakontrolluara deri në nivel të një ish Komune dhe lëndëve kimikate në të, erozioni i tokës, pesticidet e përdorura dhe prurjet e ngurta, etj.
25. Territori i Bashkisë Pogradec shtrihet në një hapësirë me kontraste të mëdha përsa i përket morfologjisë së relievit. Ai fillon që nga male të larta, në lindje, në jug e deri në bregun e liqenit të Ohrit, dhe luginën e lumit Shkumbin. Brenda këtij territori gjenden zona fushore të sheshta, ose gati të sheshta, pllaja, shpate kodrash të buta deri mesatare, shpate malore të pjerrëta deri të thikëta, shpate të luginave lumore të formave të ndryshme, deri në kanione, si dhe liqeni i Ohrit.
26. Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit shërben si bio - korridor për gjitarët e mëdhenj midis zones qendrore Rajcë-Shebenik-Jabllanicë dhe Guri i Nikës-Holtë-Lukovë, në Shqipëri.
27. Liqeni është një nga rezervatet biologjike më të pasura dhe më të çmuara të Europës. Ai shkëlqen si një sistem unikal, pasi karakterizohet nga një biodiversitet me shumë specie endemike të florës dhe faunës. Në liqen, rriten rreth 17 lloje peshqish nga të cilët 10 janë endemicë ndërsa 7 të tjerët me vlera komerciale.
28. Liqeni i Pogradecit ka një bimësi të pasur prej 125 bimësh ujore. Brezi i pyjeve, tipet e grumbujve pyjore, shkurret mesdhetare që shtrihen në territorin e bashkisë dhe shtrirjes së tyre sipas zonave fitoklimatike, përfaqësojnë formacionet bazë të bashkëshoqërimeve bimore që rriten në kushtet aktuale të stacionit prodhues dhe mjedisit.
29. Pas popullatave të rëndësishme të llojeve më të përhapura për Shqipërinë, liqeni i Pogradecit është i rëndësishëm gjithashtu edhe/ose për llojet e rralla e te kërcënuara, të tilla si karabullaku i vogël (Phalacorcorax pygmaeus me një popullsi afër 100 specie dhe Pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus).
30. Bashkia e Pogradecit është pjesë e rrjetit të zonave natyrore të mbrojtura dhe një pjesë e mirë e saj është pjesë e Kat.-V të Zonave të Mbrojtura, atë të “Peisazhit të Mbrojtur”. Kjo zonë është shpallur zonë e mbrojtur me vendim Nr.80, datë 18.2.1999, ku të gjitha aktivitetet njerëzore që zhvillohen në veçanti në këtë zonë duhet të parashikojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e gjithë ekosistemit.

31. Gjeomonumentet në Bashkinë e Pogradecit janë të rëndësisë ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Për nga origjina e tyre, dominojnë gjeomonumentet me origjinë: stratigrafike, mineralogjike-ekonomike, gjeomorfologjike (erozionale-lumore, karstike, atmosferike), tektono-strukturore, paleontologjike-paleoambientale, hidrogjeolo-gjike-termominerale etj.
32. Pavarësisht planeve të menaxhimit dhe direktivave për mbrojtjen e peisazhit të mbrojtur të Liqenit të Pogradecit, kjo zonë rrezikohet seriozisht nga mbetjet industriale, derdhjet e ujrave të zeza dhe aktivitete të tjera njerëzore.
33. Zonat qendrore të propozuara janë sipërfaqe me përparësi, të cilat lejojnë zhvillimin e proceseve ekologjike të pacënuara dhe iu ofrojnë strehë llojeve të rrezikuara, të rralla dhe endemike.
34. Pritshmëritë, si pasojë e vendosjes së zonës qëndrore, janë që llojet indikatore të tregojnë një përmasë të qëndrueshme apo në rritje të popullatave.
35. Duke qenë se rajoni në fjalë sidomos zonat suburbane, kryesisht ndërtimet dhe banesat vendosen në zona të ngritura mund të sigurohet trajtimi i ujrave të përdorura me anë të lagunazhit natyror.
36. Në rastin e banesave që bien jashtë skemës gravitative të përgjithshme të fshatit rekomandohen ndërtime të gropave septike ekologjike, të cilat parashikohen me dhomëza të përbëra dhe të ndërtuara me mure hermetikisht të izoluara, ku uji i ingarkuar me nitirite dhe fosfate mund të transformohet në ujë të pranueshëm për tu derdhur në ujërat sipërfaqësorë, por rast pas rasti ka një skemë specifike enkas për të.
37. Nga përllogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezulton se në këtë zonë mund të formohen jo më tepër se 200 ton mbetje urbane në ditë ose rreth 6’000 ton në muaj.
38. Këto mbetje grumbullohen pa ndonjë trajtim të tyre, të cilat përsëri edhe pse janë të përqendruara, sjellin aksese në ndotjen e mjedisit, (ajrit, ujërave dhe tokave), sidomos nga mungesa e seleksionimit sipas tipeve të mbetjeve urbane dhe industriale, nga djegia e tyre në natyrë etj, rrisqet negative të të cilave i kemi përshkruar më lart. Vet venddepozitimi, është jashtë kritereve dhe kushtet teknike të përcaktuara, si nga pikëpamja gjeologo-inxhinierike etj.
39. Rrjedhja e ujërave nga venddepozitat aktuale krijojnë ndotje për ujërat sipërfaqësore dhe për tokat bujqësore.
40. Mbetjet urbane grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë; Nuk kryhet asnjë lloj përpunimi; Vendosen në depozitime të shkrifta, toka buke; Hidhen pranë sistemeve ujore (lumenj, perrenj); Digjen jo rallë në gjendje të lirë; Jashtë kushteve të kontrollit mjedisor; Përzihen me mbetje spitalore, farmaceutike, dhe industriale apo të rrezikshme, si edhe ato elektronike.
41. Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjve, afër atyre urbane, (shpesh të përziera me to), ku edhe sot këto mbetje inerte (ndoshta edhe të reja), gjenden anës së rrugëve dhe në shpatet e përrenjëve dhe lumenjëve.
42. Lidhur me konsumimin e energjisë, sektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40.43%, sektori i banesave 26.06%, industria 16.32%, sektori i shërbimeve 8.51% dhe bujqësia e të tjerat 8.68 %. Konsumi i energjisë

elektrike nga konsumatorët në vitin 2014 është rritur 10,1 përqind krahasuar me një vit më pare.

43. Prodhimi nga hidrocentralet publike përfaqëson 72,1 përqind të prodhimit neto vendas, ndërsa prodhimi i energjisë nga prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë përbën 27,9 përqind.
44. Potenciali teorik për shfrytëzimin e energjisë diellore në rajonin e Pogradecit shkon deri në 1200 kWh/m2.
45. Deri në tremujorin e parë të vitit 2012, nga ERE dhe nga METE, janë licensuar disa kompani të ndryshme për të ndërtuar parqe eolike, që shfrytëzojnë energjinë e erës, me një fuqi të instaluar në shkallë vendi prej rreth 1600MW, një pjesë e së cilës është në shkallë regjionale Korçë-Pogradec.
46. Në Masivin Malor të Pogradecit, llogaritet që dendësia e fluksit të nxehtësisë të luhatet nga 40 mW/m2 deri në 61. 8 mW/m2.
47. Në dekadën e fundit, qeveria shqiptare ka inkurajuar ndërtimin e HEC-eve. Deri në vitin 2015, janë nënshkruar 173 kontrata koncesionare për ndërtimin e 540 hidrocentraleve të vegjël, 104 prej të cilëve janë në veprim dhe 75 janë në ndërtim e sipër.
48. Këto H ec-e janë zhvilluar në pjesët malore të vendit, ku mund të shfrytëzohet energjia potenciale e ujit, por lënia prej pothuaj 2% në lumenjt ekzistues, dhe marrja prej 98% e ujit në tub, e kthen më tepër në problem këtë aktivitet, sesa në zhvillim.
49. Në bazë të hartës sizmotektonike të Shqipërisë, (Sh. Aliaj, 1988) rajoni në fjalë bën pjesë në zonën sizmogjene Shkodër-Mat-Librazhd-Korcë me aktivitet sizmik deri në 8 ballë ose me magnitudë 5.5 deri në 6.0.
50. Linjat tektonike aktive, krijojnë zona të paqëndrueshme në hapësira të gjera, paqëndrueshmëri e cila vjen si rezultat i jonjëtrajtshmërisë së lëvizjës së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedime të diferencuara të trojeve. Edhe pse këto levizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcenuese në rastet e ndodhjes së tërmeteve.
51. Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdesshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve, etj.
52. Rrëshqitjet janë një fenomen i përhapur në territorin e Bashkisë. Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, janë hedhur rreth 88 rrëshqitje të njojtura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera.
53. Erozioni sipërfaqësor prek zona të mëdha të fshatrave të rrëzës së malit të Thatë dhe në luginën e lumit Shkumbin. Në këtë territor kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike molasike e flishore argjilore. Ekspozimi ndaj faktorëve ekzogjenë të alterimit, si rezultat i mungesës së pyjeve natyrale, bën që sipërfaqe shumë të gjera të denudohen me shpejtësi të frikshme.
54. Sipërfaqet e djegura, gjatë periudhës 1990-2014, janë të madhësive të ndryshme, me nivelin më të lartë në vitin 2007, me 30,856 ha. Përveç pyjeve prodhues, zjarret kanë djegur edhe zona

të mbrojtura, në sipërfaqe të konsiderueshme, duke u humbur vlerat dhe rëndësinë që kanë patur. Për sa u përket shkaqeve, në shumicën e rasteve ata nuk kanë qënë natyrorë.

55. Në kushtet e mungesës së mbulesës bimore, erozioni në këtë rajon sikundër në shumë zona të tilla të ngjashme të vendit, varion nga 20.1-34.2ton/ha/vit. Ndërkohë që në sipërfaqet e pjerrëta, përrenjtë transportojnë 70-100ton/ha/vit. Në tokat e larta, me pjerrësi më të madhe se 30% dhe në vartësi të mbulesës bimore, shkalla e humbjes së tokës nga erozioni është në kufij më të lartë.
56. Në tokë të zhveshur, intensiteti i erozionit dhe niveli i humbjes së tokës është i lartë, më shumë se 100ton/ha/vit, kështu shtimi i prerjeve rrit intensitetin e erozionit. Zonat më të prekura janë në afërsi të zonave malore ku kemi shpyllëzime dhe prerje drurësh., etj.
57. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse përkatese, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
58. Problemet ambientale të lidhura me rehabilitimin e zonave jo-operacionale të ish-sheshit minerar përfshijnë sa më poshtë: Sistemimi me banesë i atyre që kanë zaptuar ish ndërtesat e minierës; Nxjerrja jashtë përdorimit dhe rilëvizja e uzinës së abandonuar brenda ndërtesave; Realizimi i vlerës së ndonjë aseti; Shkatërrimi i banesave dhe strukturave të abandonuara dhe hedhja e materialit të padobishëm; Rehabilitimi i shërbimeve dhe përdorimeve ekzistuese; Rilëvizja dhe hedhja e të gjithë materialit ndotës për të qenë në standartet e kërkuara për përdorimin industrial; Stabilizimi i grumbujve (dampave) ekzistues të mbeturinave; Ri-profilizimi i sheshit duke përdorur materialet ekzistuese të mbetura; Instalimi i sistemit drejtues të ujrave sipërfaqësorë; Rinovimi i sheshit për të qenë në standartet industriale (në bashkëpunim me autoritetet e Pogradecit); Monitorimi i ujrave nëntokësorë dhe stabiliteti i shpatit (rrëshqitjes) – si pjesë e monitorimit ambiental të sheshit në vazhdim.
59. Bashkia Pogradec është e pasur në gjeoresurset natyrore. Në bashkinë Pogradec kanë përhapje të mëdha mineralet metalore, kryesisht: Krom 25 vendburime dhe objekte; V.b . Hekur-Nikeli 6; Qymyre 10; Argjila 12; Gëlqerorë 16 dhe gurë dekorativë 11 objekte. Këto pasuri kanë ndikuar dhe ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së kësaj zone.
60. Plani i Përgjithshëm Urban mund të parashikojë korridore ekologjike urbane, nga niveli lokal apo ndër rajonal deri në ato ndërshtetëror.
61. Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndesishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore.
62. Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:
63. Mund të thuhet se në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat dhe politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.
64. Mund të themi se niveli i përpuethshmërisë në përgjithësi është i lartë, megjithatë ka projekte ku niveli i përpuethshmërisë është i kushtëzuar, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutëse për projektet e parashikuara për arritjen e këtyre objektivave.

65. Përsa i përket projekteve që kanë lidhje me Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit të bashkisë nëpërmjet gjetjes së instrumenteve financiare për daljen nga situata e borxhit, këto projekte nuk kanë përpuethshmëri me asnjë prej 12 objektivave mjedisore.
66. Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.
67. Ndikimet mbi objektivat mjedisore mund të ndodhin gjatë zbatimit të secilit prej veprimeve individuale (niveli A, B dhe C).
68. Në përgjithësi, u vu re që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarr gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 10.
69. Gjate zbatimit të veprimeve, priten të ndodhin Ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale.
70. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë Ndikime mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave.
71. Për më tej, në pjesën pozitive të Ndikimeve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.
72. Përgjithësisht, shumica e Ndikimeve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, uje, etj).
73. Ndikimet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto Ndikime do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.
74. Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe Ndikimet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.
75. Ndikimet mjedisore kumulative përcaktohen në këte Raport si një kombinim i Ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit.
76. Në zbatimin e veprimeve të Planit, Ndikimet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vlerësohen ndikimet mbi tokën, ajrin dhe faktorët klimatikë, ndikimet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e Ndikimeve të të gjitha masave
77. Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale.

78. Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma në duhet të përqëndrohet kryesisht në: (a) masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim; (b) masat për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis; dhe (c) nëse është e nevojshme, masa për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në ndërtesat e mbiekspozuara.
79. Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë më të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikësnë përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut dhe orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHI II në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrijë objektivin e 56 dB / ditë dhe 45 dB / natë.
80. Masat për të parandaluar përhapjen e zhurmës në mjedis (barrierat e zhurmës / argjinaturat dhe mbrojtja pasive) janë përdorur kryesisht për të mbrojtur mjedisin nga zhurmat e shkaktuara prej sektorit të transportit.
81. Masat janë të përshtatshme kryesisht për mbrojtjen e zonave me dendësi të madhe të popullsisë përgjatë rrjetit rrugor, ndërkohë që zbatimi i këtyre masave përgjatë rrugëve ekzistuese që kalojnë përmes vendbanimeve me një strukturë urbane të formuar dhe të dallueshme tashmë, është i arsyeshëm vetëm në raste të jashtëzakonshme.
82. Masat për të siguruar kushte të duhura jetësore (përmirësimi me hapësira mbrojtëse i izolimit nga zhurma i dritareve në ndërtesat e ekspozuara së tepërmi) janë të përshtatshme në zonat ku masat e tjera nuk janë teknikisht të zbatueshme apo ekonomikisht të qëndrueshme.
83. Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat mulitmodale të transportit) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve.
84. Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara.
85. Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë te njësitë dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njësive të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore.
86. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversiteti, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji, peisazhi, trashëgimia kulturore, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatori mjedisor të propozuar.
87. Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime: të dhënat e para që merren nga matja e parametrave të mjedisit, dhe vlerësimi i indikatorëve mjedisorë.
88. Monitorimi i ndikimeve mjedisore për çdo projekt specifik të Planit do të bëhet në përputhje me programin e monitorimit dhe mund të përmbajë informacion në formë tabelë, sipas formatit të paraqitur më poshtë.

12.2 MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH

1. Në lidhje me ujin e pijshëm duhet të bëjmë të mundur

- mbrojtjen e burimeve karstike, si akuiferi me i rëndesishëm i Bashkisë së Pogradecit;
- mbrojtjen e burimeve kryesore që lidhen me mbrojtjen e Liqeneve Prespa, të cilët kanë lidhje të mirë hidraulike dhe kontribuojnë në masen 30-50% të burimeve karstike dhe shpejtësia e lëvizjes së ujit është shumë e madhe. (Ndotësi mund të vijë në burimet e Tushemishtit, Volorekës, Gështënjasit për 7-8 orë);
- përcaktimin e zonave sanitare të burimeve të akuiferit çarje-karst, si akuiferi kryesor i Bashkisë, si dhe më i prekshmi ndaj ndotjeve të ndryshme;
- sistemimin e hedhurinave drejt pikes së transferimit;
- ndalimin e nxjerrjes së gurëve nëpërmjet karrierave të gurit në akuiferin karstik, apo ndalimi i shfrytëzimit të mëtejshëm;
- shtimin e kapaciteteve ujore, ku kryesori të jetë akuiferi, me porozitet çarje-karst, i cili ka edhe rezervat kryesore dhe më të mëdha në Bashkinë Pogradec, si burimet; Lini, Gështenjas-Volorekë, Peshkëpi, etj;
- Monitorimin e vazhdueshëm të akuiferëve, por në mënyrë të veçantë në akuiferin karstik për treguesit cilësorë e hidrokimikë të tyre;
- Shpërnguljen e fabrikës së rritjes së peshkut në ujërat dalëse pranë Drilonit.

Masa urgjente

1. Përmirësimi i pyjeve të lisit, rehabilitimit të tyre në një kohë sa më të shkurtër për rritjen e prodhimtarisë së tyre.
2. Kryerja e prerjeve silvikulturale në trungishtet e pyjeve tea hut, nxjerrja prej tyre të materialit drusor si dru zjarri dhe shkurtimin e kohës për futjen në shfrytëzim të tyre.
3. Pyllëzimi i kanaleve, brigjet e lumenjve, krijimi i brezave mbrojtës në fushë dhe futjen e llojeve me rritje të shpejtë.
4. Pyllëzimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga erozioni dhe tokave të refuzuara kryesisht afër qendrave të banuara për të krijuar një mjedis të pëlqyeshëm nga faktori njeri.
5. Të kryhen investime për përmirësimin e kullotave dhe rritjen e kapacitetit kullor të tyre.
6. Të shkohet drej dhënies në përdorim të fondit pyjor personave fizikë me banim në fshat në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyre për material drusor.

2. Ruajtja e tokës së bukës

Plani i Përgjithshëm Urban në perputhje me direktivat e Planin e Përgjithshëm Kombëtar, si dhe në përputhje me direktivat e legjislacionit Europian ka menduar se në asnjë rast, sikundër ka ndodhur deri më sot, tokave urbane t'ju mbivendosen vepra urbane. Ndërkohë që tokat me bonitet të kategorisë së pestë, të mund të diskutohet prekja apo zënia e tyre dhe ato të kategorisë 6 dhe 7, normal që mund të preken nga veprat urbane.

Për të ardhmen në shërbim të përmirësimit të gjendjes rekomandojmë:

1. Rigjenerimin dhe ripërtritjen e bimësisë ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes nga kullota dhe ripyllëzimeve.
2. Disiplinimi i rrjedhjeve ujore në përroska dhe përrenj

Frenimi i rrëshqitjeve dhe mbrojtja e tokave nga gërryerja, rekomandohet një sërë masash komplekse kundër me kryesoret dhe emergjente janë:

1. Ndërhyrja në grumbujt pyjorë me kurordëndësi nën 04, ku numri i drurëve është i rrallë dhe bimësia barishtore është e dëndur me punime ndimëse për te siguruar ripërtëritjen e tyre.
2. Ndërhyrja në parcelat e eroduara me shkallë mbulimi të vogël deri në mesatare me punime biollogjike si Pyllëzime me farë e fidana, si dhe pyllëzime të kombinuara.
3. Ndërtimi i veprave si prita të bëhen në pellgjet ujëmbledhës në pjesën e sipërme të baseneve (përroskave).
4. Ndërtimin e veprave të ndryshme hidroteknike të karakterit inxhinerik, me mure të thatë, me gabona në vendet që rrëshqasin, si dhe me llaç çimento.
5. Kryerja e punimeve përmirësuese agroteknike në kullota si: Kontrolli dhe shkulja e barneve të këqija në këto sipërfaqe; Plehrimi i tyre me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre; Rimbjellja e llojeve të vlefshme në sipërfaqet që janë dëmtuar; Krijimi i plantacioneve me shkurre me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në pikat kritike dhe duke kontrolluar erozionin; Nxitja e popullsisë lokale drej zhvillimit të turizmit rural, duke patur parasysh vlerat që afron zona; Kryerja e studimeve të reja lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave agro-pyjore për zonën.

3. Një filozofi që e shoqëron përjetësisht Planin e Përgjithshëm Urban duhet të jetë:

1. Ajo e mosprekjes së zonës pranë bregore liqenore, që d.t.th. asnjë vepër apo objekt në anën ose në zonën midis rrugës dhe bregut të liqenit, ku rruga do të jetë si një 'filldispanjë' që ndan zonën prourbane me atë proliqenore.
2. Në zonën e mbrojtur të Kat.-V, nuk duhet të ketë zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën qendrore.
3. zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën e përdorimit të qendrueshëm, në zonën e përdorimit tradicional dhe në zonën e rekreacionit, në rastet kur ato zenë vend në pamjen estetike të Liqenit, ose kur bien me pamje nga liqeni ose kur bien brenda zonës ujëmbledhëse, ose kur bien në zona gjeologjike karstike, pavarsisht se ato lejohen mbasi pajisen me Leje Mjedisore.
4. Aktivitetet industrriale do të lejohen mbasi të pajisen me Leje mjedisi, vetëm në rastet kur ato zënë vend jashtë zonës së mbrojtur të kësaj kategorie (peisazh i mbrojtur), në rastet kur ndodhen jashtë kufijve të zonës buferike për gjeomonumentet e natyrës dhe të kulturës, dhe në rastet kur ndodhen prapa kodrave brenda zonës së mbrojtur, por jo në zona karstike.
5. Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati për të ruajtur traditen dhe uniformalitetin.

Këto duhet të jenë koncepte të panegociueshme.

4. Tipologjia e ndërtimit

1. Plani i Përgjithshëm Urban do të udhëhiqet nga filozofia e ndërtimit, duke respektuar traditen, d.m.th që ndërtimet në zona suburbane nuk duhet të kalojnë atë të peisazhit të përgjithshëm të ndërtimeve deri më sot, ku mbizotëron ndërtimi dy katësh, i cili mund të harmonizohet deri në një siluetë 2 +1 kate.
2. Ndoshta në përcaktimin e qendrave të çdo zone administrative mund të ketë ose një institucion fetar në varesi të besimit që egziston ose një ndërtesë të tipit 'target', por jo më e lart se 4-5 kate që mund të jetë vepër banimi, siluetë arkitekturore ose objekt kulti, etj.
3. Ndërtimi pranë liqenit duhet të jetë në formë shkallarësh, ku vija e parë një kateshe me njesi sherbimi, vija e dytë me tre kate, vija e tretë 5 katëshe.
4. Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati, për të ruajtur traditen dhe uniformitetin.
5. Një filozofi tjetër që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet), apo në zonen suburbane (fshat), të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit çati, pse jo, pjese te kesaj çatie të jenë të përshtatura me paisje si panele diellore për përfitim energjie. Mbulimi me çati na siguron, jo vetem termoizolim apo kursim energjie, por edhe moskthim të energjisë diellore për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd jo estetik.
6. Çdo njësi administrative duhet të ketë një njesi tipike turistike.

Projekti Pilot Pogradec - Tushemisht

1. Vetë Plani i Përgjithshëm Urban propozon projekte të tipitit Pilot, në rastin e Pogradecit përgjate rrugës Pogradec-Tushemisht në të djathtë të saj mendohet të ndërtohet një kuartall apo lagje e përbërë nga një bashkësi pallatesh 4-5 katësh të distancuar nga njeri-tjetri dhe të distancuar nga liqeni, të cilat kërkojnë një diskutim më të madh.
2. Ne duhet të propozonim që segmenti ekologjik Lin-Pogradec-Tushemisht të ishin edhe të lidhur, edhe të bashkuar, por dhe të ndarë, në mënyrë të tillë që secila zonë të ndiente frymemarjen e vet, brënda një bashkësie të madhe. Në këtë kuadër dhe në hapësirën midis Pogradecit me Tushemishtin mund të ketë vend për ndërtime, por jo që ta lidhi 'mot a mot' apo fizikisht Pogradecin me Tushemishtin. Kjo do të thotë ndryshe nga plani pilot i propozuar të kemi një lagje midis Pogradecit dhe Drilonit, me hapësira të tipit me nderprerje.
3. Gjithashtu, silueta të jetë e tipit shkallarë, ku rrjeshti i parë pranë rrugës të jetë njesi shërbimi një katëshe, rrjeshti i dytë tre katësh dhe rrjeshti i tretë pesë katësh, shoqeruar me distanca dhe hapësira distancë publike.

Korridore Ekologjike Kulturore Urbane (regjionale dhe lokale)

1. Plani i Përgjithshëm Urban mund të parashikojë Korridore Ekologjike Kulturore Urbane, nga niveli lokal apo ndër rajonal deri në ato ndër shteteror.
2. Konkretisht, rajoni i Pogradecit mund të jetë pjesë e një KEKU ndërshteteror, si vazhdimesi e korridoreve kulturore historike Vlorë-Himare, Berat-Skrapar, Pogradec-Korçë, Ohër-Manastir deri në Varna-Burgas të Bullgarisë. Infrastuktura e të cilit jep lehtësira sikundër ka dhënë në histori për shkëmbime tregtare, etnokulturore, sportive, etj. Secili segment i këtij KEKU ka

elementet e vet biometrik, ku bashkon dhe lidh zona brenda një bashkie ndërbashkie deri në ndërshtetror.

3. KEKU lokal mund te jete LIN-Pogradec-Tushemisht. Për korridorin lokal, sigurisht do te aplikohen elementet funksional te lejueshëm.
4. Ndertim jo më tepër se dy tre kate në zona nën urbane.

5. Sugjerime për trajtimin e mbetjeve

Në kushtet e reja ku do të ndodhet Bashkia Pogradec lidhur me mbetjet urbane shihet i nevojshëm një plan i ri menaxhimi për mbeturinat, ku të spikasin masat, rrugët dhe mekanizmat për:

4. Mënyrën e ndarjes së mbetjeve qysh në burim, për të cilën do të propozonim atë të ndarjes me dy kazanë prej 1,7m3, plastik, hermetikisht të mbyllur që mund të futesh, jo të tërheqësh prapa, ku njeri do të jetë për mbetjet e thata (plastikë, karton, letra, qelq, metalike) e tjetri për mbetjet e njoma (kuzhine, organike).
5. Gjetjen dhe ngritjen e një sheshi i quajtur pikë transferimi, i cili do të shërbejë për ri ndarjen e mbetjeve, duke krijuar lëndë të parë e të ndryshme deri në] masën 80% për kompanitë e riciklimit, si dhe duke zvogëluar sasinë e tyre deri në 20% për drejt landfillit të Maliqit.
6. Mbetja e tepruar dhe e pa biodegradueshme, që rezulton nga para trajtimet e mësipërme, ku riciklimi, të drejtohet për në Landfillin Ekologjik Rajonal të Maliqit.

6. Sugjerime lidhur me masat antisizmike për mosdëmtimin e objekteve do të konsistojnë:

1. Objektet duhen ndërtuar solid, me disa breza e të lidhur mirë;
2. Të përdoren si taban shtresa të rekomanduara nga studime enkas gjeoteknike;
3. Të mënjanohen ujërat sipërfaqësorë;
4. Të përdoren material ndërtimi me cilësi të kontrolluar;

Sugjerimet lidhur me rreziqet gjeonatyrore do të konsistojnë në kujdesin:

1. ndaj fundosjes në rastet e zonave që prodhojnë ujëra nëntokësorë ose ato që ndodhen mbi sipërfaqe të shfrytëzuara minerare, të cilat lidhen me këto mundësi, duke bërë që të mund të preken nga këto ndikime negative.
2. Për shkëmbinjë që çlirojnë radonin si ata magmatikë e metamorfikë si shiste, gnejse, etj., ku sSa më të mbyllura të jenë ndërtimet aq më shumë përqëndrohet edhe radoni. Përqendrime më të mëdha janë në dimër se sa në verë për shkak të avullimeve. Përqëndrimet e larta mbi normën e lejuar shkaktojnë kancer në mushkëri. Bazuar në interpretimet e bëra mendojmë se ndotja nga radoni është e shumë e përfillshme, për shkak se treguesit e sipërmendur rezultojnë të jenë pjesëmarrës në formacionin tonë në sipërfaqe e në thellësi, ose në zonat përreth saj.
3. Investitorët duhet të marrin masa, duke bërë zbutjen e saj me anë të izolimit të themeleve, ventilimit të përshtatshëm për raste zyrash apo ndërtimesh, etj.

7. Lidhur me masat ndaj erozionit dhe sitemimit të kullotave e pyjeve për të ardhmen në shërbim të përmirësimit të gjendjes rekomandojmë:

1. Rigjenerimin dhe ripërtritjen e bimësisë ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes nga kullota dhe ripyllëzimeve.
2. Disiplinimi i rrjedhjeve ujore në përroska dhe përrenj

Frenimi i rrëshqitjeve dhe mbrojtja e tokave nga gërryerja, rekomandohet një sërë masash komplekse ku ndër me kryesoret dhe emergjente janë:

1. Ndërhyrja në grumbujt pyjorë me kurordëndësi nën 04, ku numuri i drurëve është i rrallë dhe bimësia barishtore është e dëndur me punime ndimëse për te siguruar ripërtëritjen e tyre.
2. Ndërhyrja në parcelat e eroduara me shkallë mbulimi të vogël deri në mesatare me punime biollogjike si Pyllëzime me farë e fidana, si dhe pyllëzime të kombinuara.
3. Ndërtimi i veprave si prita të bëhen në pellgjet ujëmbledhes në pjesën e sipermë të baseneve (përroskave).
4. Ndërtimin e veprave të ndryshme hidroteknike te karakterit inxhinerik, me mure te thatë, me gabona në vëndet që rrëshqasin, si dhe me llac cimento.
5. Kryerja e punimeve përmiresuese agroteknike në kullota si Kontrolli dhe shkulja e barneve të këqia në këto sipërfaqe; Plehrimi i tyre me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre ; Rimbjellja e llojeve te vlefëshme në sipërfaqet që janë dëmtuar; Krijimi i plantacioneve me shkurre me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në pikat kritike dhe duke kontrolluar erozionin ; Nxitja e popullsisë lokale drej zhvillimit të turizmit rural, duke patur parasysh vlerat qe afron zona ; Kryerja e studimeve të reja lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave agro-pyjore per zonën.

8. Lidhur me sitemimin e dampave minerare

1. Sistemimi i karrierave me taraca dhe mbushja e hapësirave të tyre me sterile të stoqeve përkatëse si dhe mbyllja e grykave të puseve të kërkim-shfrytëzimit, si dhe të galerive;
2. Duhet të krijohet koncepti i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, sepse deri më sot pothuajse ato konsiderohen si mbetje të thjeshta urbane.
3. Kompanitë dhe subjektet private do të kenë njohuritë e nevojshme, për të ndërmarrë hapat e mëtejshme për investime në fushën e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të pasurive minerale për bashkinë e Pogradecit.

Masa Zbutëse Specifike

1. Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi
2. Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore
3. Dizenjimi dhe përcaktimi i kritereve të ndërtimit të infrastrukturave nëntokësore me materiale dhe struktura rezistente ndaj kushteve të motit dhe në veçanti ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë
4. Ndalimi i ndërhyrjeve ilegale në infrastrukturat nëntokësore
5. Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve ekologjike të mjediseve natyrore
6. Monitorimi i dinamikës së vijës bregore dhe nivelit të liqenit
7. Monitorimi i nivelit të liqenit dhe cilësisë së ujërave në zonat ligatinore dhe ujërat nëntokësore
8. Monitorimi i vijës bregliqenore dhe sasisë së sedimenteve që vijnë nga lumenjtë

9. Monitorimi i lëvizjes së tokës dhe tjetërsimit të saj
10. Monitorimi i marrjes së zhavorreve nga shtretërit e lumenjve
11. Përcaktimi i zonave të lejuara për ndërtim HEC-esh dhe digash për bujqësinë
12. Monitorimi i gjendjes së monumenteve dhe veprave të trashëgimisë kulturore
13. Monitorimi i lëvizjes së popullsisë në zonat urbane dhe rurale
14. Zbatimi i kodeve të reja të ndërtimit për ndërtesat sociale dhe kulturore duke përdorur materiale termoizoluese dhe rezistente ndaj kushteve të motit
15. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore, dhe
16. Përcaktimi i zonave buferike për rastet e ndikimeve nga rritja e nivelit të liqenit.

Masa zbutëse specifike

1. Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akuifer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i dëmit ndaj ujërave nëntokësore.

2. Duhen planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e larjes, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës,

3. Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pas se 50 m nga Lumi Devoll si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lumë, apo kanalet kulluese;
- Hedhja e betonit duhet të bëhet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;

- Kur derdhjet nga kantieri duhet të shkarkohen në një lumë, norma e derdhjeve duhet të kontrollohet, në mënyrë që ajo te mos shkaktojë përmbytje lokale në rrjedhen e ujit, apo erozioni;

- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

9. Filozofia e shfrytëzimit të energjisë

1. Një filozofi që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet) apo në zonën suburbane (fshat) të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit çati, pse jo pjesë të kësaj çatie të përshtatura me pajisje si panele diellore për përfitim energjie.
2. Gazsjellsi Tap përben një fat urban dhe social që nëse do lihet të përfitohet ai ofron vlera të medha në sigurimin e energjisë elektrike dhe në punësimin e njerëzve. Duke qënë se zona e

Korçës, ka një klimë kontinentale dhe përdor për ngrohje, energjinë nga biomasa, ky gazsjellës mund të bëjë të mundur furnizimin me lëndë të parë për gaz të një Teci që punon dhe funksionon me anë të kësaj lënde, e cila është dhe në vazhdim të traditës së mëparëshme. Një Tec prej 100 MW mund të sigurojë për rajonin juglindor Korçë Pogradec Ersekë një përfitim energjie dhe një kursim të lëndës drusore në pyll. Nga ana tjetër TAP-i mund të sigurojë dhe një linjë bashkëshoqeruese të rrugëve ndër rajonale.

3. Mbulimi me çati na siguron jo vetëm termoizolim apo kursim energjie, sepse në rastet me mbulim prej solete, kemi kthim të energjisë diellore, për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd jo estetik.
4. Një koncept tjetër i Planit të Përgjithshëm Urban që duhet të shoqërojë vendimmarrjet Bashkiake është arritja apo sigurimi i ndërtesave me Energji 0, të paktën e atyre që ndërtohen rishtaz, kjo d.t.th që të gjitha ndërtesat e planifikuara për ndërtim, do ti nënshtrohen një procesi analitik të shfrytëzimit të energjive alternative. Në kësi rastesh, rrjeti do të punojë me dy kahje, edhe të marrë nga rrjeti kombëtar, por edhe një zgjidhje lokale dhe specifike (mulli ere, panele diellorë, biomas) t'i transmetojë energji rrjetit kombëtar. Këto quhen ndertesa të tipit me energji 0 dhe në rastin, kur jep më shumë seç merr quhen ndërtesa me energji pozitive në përputhje të plotë me legjislacionin Europian.
5. Të shikohet mundësia që lëndet drusore të kenë lehtësira për import, si psh. heqja e TVSH-se, në menyre që të ruhet lënda drusore e zonës përdorur për energji

Propozime

5. Duke qenë se vendimmarrja shqiptare është treguar dorëlëshuar në dhënien e Hec-eve të shumtë mbi lumenjt shqiptarë (mbi 500 të tillë), ku bëjnë pjesë edhe lumenjt e Bashkisë Pogradec, sugjerojmë që në sistemet lumore duhet të zbatohen praktika të sistemit propocional, ku 33.3% e sasisë ujore të konsiderohet e paprekshme si prurje ekologjike, 33.3% të tjera si të paprekshme për produktet bujqësore dhe 33.3% t'iu përkasi prurjeve energjitike, dhe në varësi të kushteve klimaterike, raportet bujqësi dhe energji mund të shkëmbejnë sasira të caktuara për muaj të caktuar.
6. Të abrogohet neni 39, i Ligjit 111, viti 2012, "Për menaxhimin e burimeve ujore", pika 'd', ku thuhet: Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355) – dhe të bëhet: ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 300 ditë në vit (Q300).
7. HEC-et në kategorinë e katërt dhe të pestë të zonave të mbrojtura mund të lejohen me Leje Mjedisi, por me kushtin që të ruhet Q (sasia) e 6 muajve ose afërsisht 50% dhe 40-50% mund të jetë prurje energjitike.

8. Nga pikëpamja hidrologjike, Shqipëria ka vështirësi për të përmbushur kërkesat e brendshme për energji, për shkak të luhatjes së reshjeve që janë thelbësore për funksionimin e hidrocentraleve. Ndërkohë, përdorimi i ujit nga hidrocentralet e vogla bie ndesh me kërkesën e

bujqësisë për ujitje. Ky konflikt vërrehet kryesisht në stinën e thatë të verës kur kërkesat për ujë janë të larta dhe prurjet të pakta.

10. Si të gatitet një analizë e ndjeshmërisë së infrastrukturës së parashkuar ndaj ndryshimeve klimatike.

1. Në mënyrë që të zvogëlohen ndjeshëm ndikimet negative në cilësinë e ujit të liqenit te Ohrit, duhet të merren masat e mëposhtme: të blihen pajisjet e duhura për t'u marrë me derdhjet e substancave të rrezikshme në liqen; të ndërtohet infrastruktura e duhur për të pritur dhe asgjesuar mbetjet nga anijet. të sigurohet qarkullimi i rrjedhave ujore dhe kështu të parandalohet eutrofikimi përmes planifikimit të duhur.
2. Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve. Përmbajtja e kësaj mase duhet të jetë si më poshtë: Të ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit. *Këto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rrugët e migrimit) të specieve dhe arrijnë e objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.*
3. Rehabilitimi /Inkapsulimi i pikave të nxehta mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë.
4. Propozohet të studiohen të gjitha territoret e objekteve industriale që kanë përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin dhe të prioritizohen mbi bazën e shkallës së rrezikut, duke zbatuar të gjitha direktivat e BE-së që lidhen me kontaminimin e rrezikshëm të tokës.
5. Plani të përcaktojë dhe të ndajë zonat e ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve.
6. Inventarizmi dhe diagnostifikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe duhet bërë dhe raportimi.
7. Të shihet mundësia e ngritjes së një landfilli industrial qëndror për depozitimin e mbetjeve të ngurta industriale mbas trajtimit të tyre me metodat e përcaktuara nga Konventa e Bazelit, duke shmangur depozitimin e tyre në landfillet urbane
8. Planet duhet të saktësojnë orientimin drejt trajtimit të tyre sipas hiearkisë që është më praktikja dhe më e arritshmja në nivelet e ulta, të ndërlidhura me masa që varen shumë nga actorët kryesorë në qeverisjen qendrore , politikat e saj dhe përgjegjësite e prodhuesve. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, duke vendosur standarde lokale për të cilat kanë rënë dakord të tre nivelet.
9. Duhen planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit, kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.
10. Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturat e nevojshme.
11. Mobilizimi i një instrumenti financues nga niveli kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim që të plotësohen funksionet e tij në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

12. Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve.
13. Përcaktimi i zonave nderkufitare liqenore për menaxhimin e incidenteve të ndotjes industriale.

Masa Zbutëse Specifike

Në veçanti, për të reduktuar ndikimet gjatë zbatimit të aktiviteteve, duhet të merren masat e mëposhtme zbutëse:

1. Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës nga makinerive të ndërtimit, në përputhje me rregullat mbi emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
2. Do të ndiqen mënyrat më të mira të praktikueshme, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e duhur të impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara nga operacionet në terren, dhe në të gjitha rastet, në përputhje me rregullat shqiptare;
3. Sheshet e ndërtimit dhe rrugët e transportit duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që ndotja akustike nga makineritë e transportit, funksionimi i pajisjeve në katier dhe ndërtimet e objekteve, të mos tejkalojë vlerat kufi në ndërtesat më të afërta;
4. Cdo impiant, i tillë si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jetë i rrethuar nga një barierë akustike apo reflektor portativ;
5. Implementimi i masave të përkohshme për të mbrojtur nga zhurma zonat e populluara pranë kantiereve të ndërtimit dhe rrugëve të transportit ku janë tejkaluar vlerat kufi.
6. Respektimi i afateve kohore për ndërtimin afër zonave të populluara;
7. Publiku i gjerë dhe banorët e zonës do të informohen paraprakisht kur të kryhen vepra që emetojnë zhurma të konsiderueshme;
8. Në kantierin e punimeve nuk do të përdoret asnjë makineri apo pajisje që shkakton shqetësim te publiku për shkak të zhurmës;

Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

1. Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike.
2. Në kuadër të ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimi). Do të duhet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.
3. Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e punëve përgatitore (projektit) për një detyrë të veçantë. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës.

4. Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jetë i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasojë e neglizhencës ndaj arkeologjisë.
5. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

11. Si të sigurojmë dhe të ruajmë peizazhet me karakteristika të dallueshme në nivel :

1. Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
2. Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të vecantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
3. Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së lartë të peisazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;
4. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

Masa të tjera të përgjithshme përfshijnë:

1. Në skarpata, për të parandaluar rënien e shkëmbinjve, duhet të jenë më preferueshme bordurat e gjera se platformat e ndërmjetme. Skajet e skarpatave duhet të rrumbullakosen. Shpatet e parregullta duhet të jenë më të preferueshme se sipërfaqet gjeometrike.
2. Zbatimin e standardeve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantiereve dhe rivegjetacionin, për të siguruar ruajtjen e komoditeve të nevojshme të peizazhit.
3. Për mbushje, shpatet duhet ti nënshtrohen mbjelljes hidraulike me një përzierje farë që përfshin si farat e barit, ashtu edhe të shkurreve mesdhetare. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambjenteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projektit, sidomos në kryqëzime.
4. Për zonat potenciale në një nivel (pas optimizimin të lartësisë së projektit) bimësia e propozuar do të përmirësojë ndikimet negative të automjeteve, si dhe hapësirën vizuale të projektit të propozuar.
5. Përgjatë gjatësisë së projektit përkatës do të trajtohen sipas rastit: venddepozitimet për mbeturinat, zonat e përkohshme të ndërtimit, zonat e peizazhit brenda kryqëzimeve, zonat e vogla të fushave të copëzuara, fermat apo pronat e tjera të siguruara për ndërtimin e projektit. Te pikat e mbetjeve do të psh: mbillet në mënyrë hidraulike. Zonat e përkohshme të ndërtimit do të jenë të rrethuara dhe të integruara vizualisht duke përdorur mbjelljen e bimëve sipas kërkesës.

Masa Zbutëse Specifike

1. Në zonat kodrinore / malore, hapësira që kërkon okupimin e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmanget prerja e panevojshme e pemëve.
2. Në zonat përgjate brigjeve liqenore / lumore, sipërfaqja e tokës së okupuar do të mbahet në minimum, me qëllim shmangien e prerjes së panevojshme të pemëve në këto zona.
3. Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahet dhè, dhe ato do te mbillen me bimë që mund të adoptohen në kushtet lokale.
4. Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.

12. Roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

1. Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme.
2. Mbledhjen e të dhënave bazë që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.).
3. Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar I Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë, etj).
4. Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera.
5. Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit në një zonë të caktuar.
6. Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohë te caktuara.
7. Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çfarë synojnë Raportet

1. të plotesojnë kërkesat e legjislacionit;
2. të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit t;
3. Planit (vendim-marrësit);
4. të informojnë publikun që preket nga Plani.

Të ndryshme

1. Ngritja e tregjeve në zona të caktuara.
2. Plani i Përgjithshëm Urban mund të parashikojë disa qëndra që mund të shërbejnë si tregje në kuadër me të gjerë se sa fshati apo Njësia Administrative, duke i lënë vendin njëra tjetrës sipas ditëve të javës.
3. Përmbytja më e madhe ndodh në Maliq, për të cilën duhet të ulet shtrati i lumit Devoll ose duhet thithur uji me pompa prej fushës se Maliqit.
4. Të ndalohet hyrja e ujit të Devollit në liqenin e Prespes së Vogël. Për shkak se në Prespën e vogël kemi mbathje të fundit të liqenit duke e kthyer zonën liqenore nga uji në stere duhet me patjetër që të ndalet devijimi dhe prurja ujore prej lumit Devoll, i cili mbush dhe mbath me sediment zonën e Prespës.

5. Studimi i kryer ka evidentuar zonat me rrezikshmëri të lartë (zona e ngjyrosur në hartë me ngjyrë të kuqe), zonat me rrezikshmëri mesatare (e ngjyrosur me ngjyrë të verdhë) dhe zonat me pak rrezik apo të parrezikuara, me ngjyrë jeshile.

SHTOJCAT

SHTOJCA 01: PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA DHE TAKIMI PUBLIK

Identifikimi i palëve të interesuara

Grupet e interesit të përfshira në hartimin e Dokumentit të Strategjisë së territorit të Bashkisë Pogradec janë të shumta dhe varjojnë nga grupet e punës brenda Institucionit të bashkisë dhe njësive administrative, Agjensia Kombëtare e Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban, bashkia kufitare Prrenjas dhe organizata vendore pranë bashkisë Pogradec si Nehemia Gateway. Nga ana tjetër Dokumenti i Strategjisë ka synuar të dëgjojë zërin e qytetarëve dhe sektorit privat. Të gjjitha ndërmjetësimet janë arritur nëpërmjet realizimit të dëgjesave publike dhe konsultave më të ngushta me grupet e interesit dhe ekspertët e institucionit të bashkisë.

Konsultimi me palët e interesuara dhe dëgjesa publike

Përpara kryerjes së dëgjesës publike zyrtare në bashkinë e Pogradecit, grupi i punës ka përdorur disa mënyra alternative të evidentimit të karakteristikave të zonës, nevojat për infrastrukturë apo nevoja të tjera për përmirësimin e cilësisë së jetës. Një prej mënyrave është kryerja e vizitave në qëndrat kryesore të njësive administrative dhe kryerja e intervistave me grupe interesi të kryesuara nga kryetarët e njësive administrative, punonjës të tjerë të administratës dhe banorë të fshatrateve. Prej këtyre gjetjeve janë realizuar profilet e çdo njësie administrative të cilat janë shtjelluar në kapitullin e parë të gjetjeve të analizave. Prej intervistave të kryera dhe hulumtimeve të mëtejshme nga grupi i punës janë gjeneruar të dhëna mbi gjenezën e formimit të vendbanimeve, aspektin ekonomik dhe social, mbulimi me shërbime dhe nevojat primare për ofrimin e shërbimeve nga ana e bashkisë. Profilet e njësive administrative kanë qënë një ndihmë tepër e madhe edhe për identifikimin e projekteve prioritare të bashkisë. Një mënyrë tjetër për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për të vlerësuar nevojat dhe dëshirat e tyre është hedhja e anketës " Vlerësimi dhe prioritetet e qytetarëve". Objektivat e kësaj ankete kanë për qëllim matjen e vlerësimit të qytetarëve për aspekte të ndryshme të jetesës s\në këto zona, matjen e vlerësimit për shërbimet publike të ofruara si dhe vlerësimi i prirotiteve që qytetarët kanë për të përmirësuar cilësinë e jetesës. Anketimi është kryer në periudhën Mars – Prill 2016 dhe numri total i të anketuarve është 600 persona (18 vjeç +). Metoda e pyetësorëve ishte ballë-për-ballë dhe zgjat 20 minuta.

Gjetjet kryesore

Zonat rurale të Bashkisë së Pogradecit kanë vlerësim qartazi më negativ se ata që banojnë në qytetin e Pogradecit për zonën e tyre si një vend për të punuar, jetuar apo rritur fëmijet. Ndërkohe që Pogradeci si qytet, vlerësohet pozitivisht nga banorët e tij si "një vend per t[u vizituar" (1.9 pikë në shkallën e lerësimit), kjo gjë nuk mund të thuhet për zonat rurale të cilat vleresohen me 3.1 pikë nga banorët e tyre.

Po kështu këta banorë të zonave rurale e vlerësojne negativisht dimensionin e zonës së tyre si një "vend për të rritur femijet" 3.1 pikë kundrejt një vlerësimi më pozitiv që kanë banorët e qytetit të Pogradecit.



Fig. – 102 Vlerësimi për qytetin dhe fshatin

Ekonomia, vlerësohet më negativisht nga banorët e Bashkisë së Pogradecit si nga ata që banojnë në zonat rurale (3,6 pikë në shkallën nga 1 deri në 5 ku 1=Shkëlqyeshëm dhe 5= Shumë keq), ashtu edhe nga ata që banojnë në qytetin e Pogradecit (3.1 pikë). Në zonat rurale vlerësime negativ ka marrë Arsimi & Kultura (që nënkupton, infrastrukturën shkollore, çerdhe/kopshte, arsimin profesional si dhe mundesitë për aktivitete kulturore) dhe Mjedisi Urban që nëkupton cilësinë e ndërtimeve të reja, hapësirat publike, dhe mundësitë për të zhvilluar pronën private. Argëtim & Shendet gjithashtu meriton vëmëndje pasi ka marrë 3 pikë në shkallen nga 1 deri në 5. Ndërkohe që Mjedisi Natyror vlerësohet qartazi pozitiv në zonat rurale (natyra në përgjithësi, cilësia e ajrit, pastërtia) dhe po ashtu pozitivisht edhe në qytetin e Pogradecit. Po kështu edhe Siguria dhe deri diku edhe Jetesa Komunitare. Sipas qytetarëve bashkia duhet të ketë këto përparësi në lidhje me zonën e tyre: Nxitja e punësimit është përparësia kryesore që vleresojnë qytetarët, banorë të qytetit të Pogradecit. (91.5%). Rrugët brenda qytetit" janë gjithashtu një përparësi e madhe e vlerësuar nga rreth 78% e banorëve të qytetit si e tillë. Nxitja e Punësimit është një Përparësi e madhe edhe për banorët e zonave rurale të bashkisë së Pogradecit. Po keshtu ngajshëm me qytetin e Pogradecit, edhe banorët e zonave rurale vlerësojne si përparësi të lartë edhe rregullimin e rrugëve brenda fshatrave (dhe atyre lidhëse). Një prioritet i veçantë për zonat rurale të Bashkisë së Pogradecit është "Furnizimi me ujë të pijshëm". Planet e Investimeve kapitale duhet të marrin parasysh këtë prioritet madhor të këtyre zonave të përmendur nga rreth 71% e të anketuarve. Po kështu duke marrë parasysh natyrën e njësive administrative, del si prioritet edhe Përmirësimi i sistemeve vaditëse dhe kulluese. Prioritete të tjera të rëndësishme për këto zona janë Grumbullimi i mbeturinave, Ndriçimi rrugor, dhe Pastrimi i fshatrave. Burimet financiare të bashkisë për të trajtuar të gjitha prioritetet e qytetarëve janë të kufizuara. Pikërisht për këtë arsye të anketuarve ju është bërë një pyetje nëse do të ishin dakord që bashkia të merrte Hua Financiare për të përmiresuar shërbimet publike. Banorët e zonave rurale janë dakord masivisht për marrjen e huasë (77%) dhe po kështu, ndonëse në masë më të vogël, janë edhe banorët e qytetit të Pogradecit (56%).

Fig. – 103 *Përparësitë që duhet të ketë bashkia për zonën urbane*





Fig. – 104 *Përparësia që duhet të ketë bashkia sipas qytetarëve në zonën rurale*

Megjithatë qytetarët nuk shprehen aq entuziastë kur pyeten nëse do të ishin dakord edhe po qe se huaja do të sillte rritje të tarifave dhe taksave vendore.



Fig. - 105 *Dakortësia në lidhje me huanë*

Qytetarët janë shprehur edhe se cili sektor i ekonomisë është më premtues për zhvillimin e ekonomisë në bashki. Turizmi qartazi është sektori qeë dominon në perceptimin e qytetarëve të Pogradecit si sektori që mund të sherbejë si motor për rritjen ekonomike(86% e të anketuarve e vleresojnë si "premtues"). Është interesante megjithatë të vihet re që sektori i dytë i vlerësuar si premtues për qytetin e Pogradecit është ai i Ndërtimit (36%). Gjithsesi, te gjithe sektorete e tjere vlresohen pergjithesisht shume me ulet se Turizmi. Ndryshon situata kur analizohen rezultatet e të anketuarve në zonat rurale. Blegtoria del si sektori më premtues sipas tyre (66%) e ndjekur nga Bujqësia me 65%. Duke pasur parasysh edhe relievin e këtyre zonave është i natyrshëm ky perceptim dhe vlerësim. Agropërpunimi gjithashtu shihet si sektor premtues nga banorët e këtyre zonave (55%). Vetëm në vend të katërt gjendet Turizmi si sektor (45%).

Fig. 106 *Sektori parësor sipas qytetarëve në zona urbane*





Fig. – 107 *Sektori parësor sipas qytetarëve në zona rurale*

Të gjitha mendimet e qytetarëve janë marë parasysh gjatë hartimit të vizionit të territorit të bashkisë duke përcaktuar sektorin e turizmit si një sektor parësor për zhvillimin e ekonomisë së bashkisë dhe si

sektor të dytë blegorinë dhe bujqësinë. Nevojat për shërbime publike janë marrë parasysh në përcaktimin e projekteve prioritare, projekte të cilat paraqiten edhe në planin e veprimit. Përveç takimeve konsultative midis grupit të punës dhe ekspertëve pranë bashkisë Pogradec është kryer edhe një dëgjesë publike e cila përfshiu në të edhe grupe të tjera interesi si ndërtues, intelektualë të qytetit, biznesmenë dhe artistë.

DËGJESË PUBLIKE NË BASHKINË E POGRADECIT 10.09.2020

Në vijim të punës për hartimin e Strategjisë të zhvillimit për territorin e Bashkisë Pogradec, ditën e enjte në datë 26.05.2016, në ambjentet e Bashkisë Pogradec u organizua dëgjesa publike dhe u kërkua mendimi dhe sugjerimi i qytetarëve për aspekte të ndryshme të këtij plani. Në këtë takim ishin pjesëmarrës specialistë dhe zyrtarë të Bashkisë Pogradec dhe njësive administrative, ekspertë të grupit të konsulencës të konsorciumit Bolles+Wilson dhe IDRA, qytetarë të Pogradecit, intelektualë, profesionistë e artistë. Në fjalën hapëse, kryetari i Bashkisë Pogradec, Z. Ilir Xhakolli theksoi se aktivizimi i qytetarëve në këtë proces është thelbësor, dhe se mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre duhet të merren parasysh në Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Prezantimi i draft strategjisë, u strukturua në 4 faza: Analizimi i territorit, Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet), vizioni i propozuar për territorin e Bashkisë Pogradec, lista e projekteve prioritare dhe dy projekte pilot. Faza analitike

Foto – 26 *Dëgjesa publike, bashkia Pogradec*

konsistoi në një trajtim të detajuar të elementëve të territorit të Bashkisë Pogradec (pas ndarjes të re administrative territoriale) me njësitë administrative përbërëse të saj, duke trajtuar elementë si pozicioni strategjik i Bashkisë në rajon, relievi i saj, hidrografia, pasuritë minerale, elementët që kanë ndikuar në formimin e territorit, pozicionimi i monumenteve të kulturës dhe zonave të mbrojtura, hotspotet mjedisore dhe ndotësit e ajrit. Analiza e përdorimit të tokës në Bashkinë e Pogradecit dhe sistemet territoriale. Më tej u vijua me një analizë të infrastrukturës rrugore ekzistuese, sistemit arsimor, demografisë, turizmit dhe papunësisë. Pjesa e analizës u mbyll me evidentimin e një prej problemeve më të mëdha të Bashkisë: situatën e saj kritike financiare, dhe disa rekomandime për mënyrën e daljes prej saj. Si pjesë e rëndësishmë e fazës të analizës, u prezantuan rezultatet e nxjerra të anketës të bërë nga IDRA për "Vlerësimin dhe prioritetet e qytetarëve", ku qytetarët (600 persona mbi moshën 18 vjeç, 300 prej të cilëve në zona urbane dhe 300 në zona rurale) u anketuan lidhur me vlerësimin e apekteve të ndryshme të jetesës, shërbimeve publike, dhe prioritetet lidhur me jetën e tyre. Prezantimi i pjesës të analizës u mbyll me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, në të cilin Pogradeci përmendet si një

qendër e specializuar për turizmin liqenor, natyror dhe bujqësinë. Nëpërmjet Analizës SWOT u radhitën në mënyrë të përmbledhur disa nga Fuqitë, Dobësitë, dhe Mundësitë. Gjithashtu u prezantuan edhe objektivat strategjike për 15 vjeçarin e ardhshëm, për të cilat janë dhënë edhe rekomandime dhe projekte prioritare. Pas mbylljes të prezantimit, vijoi diskutimi mes grupit të ekspertëve, personelit të Bashkisë dhe qytetarëve të pranishëm. Tematikat ishin të shumëllojshme. Qytetarët u interesuan në ishin marrë parasysh dokumentet e mëparshëm të planifikimit, dhe nëse kishtë ndryshuar funksioni i përdorimit të zonave të caktuara. Këtij shqetësimi ekspertët e pranishëm iu përgjigjën duke saktësuar që të gjitha dokumentet e planifikimit të cilat janë vënë në dispozicion nga Bashkia janë shqyrtuar, dhe janë marrë parasysh. Megjithatë, mund të ketë rishikime ose përmirësime nëse është e nevojshme (shiko 2. Dokumentet e Planifikimit). Një sugjerim tjetër, i cili u mbështet edhe nga Z. Xhakolli, ishte që grupi të ishte më prezent në Pogradec, për të thithur më të mirën e arshivës njerëzore të këtij qyteti: profesionistëve, arkitektëve, ish punonjësve të bashkisë, intelektualëve etj. Megjithë kohën mjaft të kufizuar, gjatë periudhës së hartimit të planit, grupi i punës parashikon të bëjë vizita më të shpeshta në Bashkinë e Pogradecit, në mënyrë që produkti final i PPV të jetë sa më i pasur me informacion. Për Turizmin, i cili ka një rëndësi thelbësore pati disa sugjerime. U propozua itinerari Qafë Thanë – Çervenakë (shteg turistik panoramik –me pamje nga liqeni i Ohrit), i cili u shtua në itineraret turistike të propozuara (shiko harta e vizionit mbi turizmin). Po ashtu, duke e menduar bashkinë e Pogradecit të përshtatshme për zhvillimin e një turizmi 4 stinor, u sugjerua që TURIZMI të klasifikohet si dimension më vete, dhe të ketë një trajtim specifik për zona të caktuara (Zona e Çërravës dhe Malit të Thatë, zona e Mokrës dhe zona bregliqenore të ketë trajtim të diferencuar). U sugjerua që te merret në konsideratë zona e rezidencave qeveritare (të cilat janë të amortizuara), e cila duke qënë ende e paprekur përbën një potencial për zhvillimin e turizmit. Megjithatë kjo pikë mund të rishikohet dhe të meret parasysh gjatë hartimit të Planit. Lidhur me mjedisin, doli në pah nevoja e kontrollimit të prerjes të pyjeve, dhe nevoja imediate për ripyllëzim për të shmangur rrëshkitjet e dheut; ri-mbjellja e kurorës të liqenit me pemë gështenje (të dëmtuara nga prerjet pa kriter të viteve të fundit), dhe mbyllja e menjëhershme e guroreve që operojnë në qytet, duke dëmtuar mjedisin natyror. Rivreshtëzimi i zonës të kalasë së Pogradecit është gjithashtu një pikë me interes për banorët e Pogradecit. Lidhur me infrastrukturën, u kërkua krijimi i një agjensie transporti për udhëtarët, dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese. Problem mjaft shqetësues janë edhe përmbytjet sa herë ka rreshje në qytet, për shkak të mungesës të sistemimit të ujrave të larta, dhe u kërkua të prioritizohet ky shqetësim (komenti u mor parasyh gjatë planit të veprimeve). U kërkua gjithashtu një vëmendje më e madhe ndaj strukturave të shëndetësisë, pasi shumë banorë, për shkak të mungesës të kushteve të përshtatshme në amjentet e ambulancave apo spitaleve të zonës, detyrohen të shkojnë në qytete të tjera (Korçë), apo edhe ne shtetin fqinjë (Maqedoni) për t'u kuruar.

DËGJESË PUBLIKE PER RAPORTIN FINAL TE VLERESIMIT STRATEGJIK MJEDISOR 26.10.2020

Ne takimin mbi Degjesen per Raportin Perfundimtar te Vleresimit Strategjik Mjedisor, moren pjese 31 qytetare te Pogradec, perfaqesues nga grupe te ndryshme te komunitetit. Degjesa nisi fillimisht me prezantimin e ekspertit te mjedisit, autor kryesor i VSM-se z. Sazan Guri. Ne vijim te prezantimit u be nje diskutim mbi gjetjet nga ky raport dhe mendime apo propozime te ndryshme qe mund te kishin qytetaret pjesemarres.

Nje problem qe u ngrit nga nje qytetar ishte mbi mungesen dhe cmimi ilarte druve te zjarrit. Nga pjesemarresit u kerkua te dihej se cfare ka marre paraysh dhe rekomanduar VSM-ja ne lidhje me perdormin e druve te zjarrit duke marre parasysh mungesen e pyjeve si edhe moratoriumin aktual te prerjes se tyre.
Nga Prof. Guri u vu theksi qe VSM ka rekomanduar nje sere veprimesh qe te mund te permiresohet situata ne kete drejtim.

- Rekomandimi per nje TEC potencial 100 MWatt ne Korce i cili duke perdorur gazin e sjelle nga TAP te mund te sherbente per ngrohje edhe per qytetin e Korces por edhe per ate te Pogradecit
- Termoizolimi – praktika e termoizolimit qe duhet nxitur dhe kerkuar nga Bashkia me qellim uljen e kostove per ngrohje.
- Perdorimi i lendeve te tjera alternative per ngrohje si pelleti apo bersite e ullinjve.
- Perdormi I metodave alternative te ngrohjes is ajo me tuba te futur ne thellesi toke qe lejojn e ngroje e ujit ne temrperatura te prnaueshme per ngrohje ne dimes.

Rekomandim i dale nga pjesemarresit ne degjese ishte qe te shihet mundesia e heqjes se TVSH per drute e zjarrit me qellim qe te lejohet/mundesohet importi I tyre duke mos shkaterruar ato pak pyje qe kane mbetur ne zone. Mundesi e tille do te ishte Bullgaria ku cmimi i druve eshte relativisht I ulet por kostoja rritet shume nga aplikimi I TVSH ne dogana.

Foto – 27 *Prezantimi i Raportit final te Vleresimit Strategjik Mjedisor, gjate Degjeses me Publikun*

Nje diskutim tjeter ishte çeshtja e **projektit te UNESCOs mbi futjen ne fondin e trashegimise boterore te anës shqiptare të liqenit te Ohrit**. Qeveria Shqiptare po ben gati dosjen per marrejen e statusit te trashegimise boterore per pjesen shqiptare te Liqenit te Pogradecit. Me kete rast duhet qe PPV dhe dokumenti I VSM-se te marrin parasysh rekomandimet e UNESCO-s ne lidhje me parametrat qe duhen plotesuar ne kete drejtim. U konfirmua qe hartuesit e planit dhe Bashkia kane pasur disa takime me

ekipin e UNESCO dhe kane diskiutuar mbi ceshtjet kryesore te planit. Rekomandimet e UNESCO-s jane marre parasysh gjate hartimit te PPV-se.

***Foto – 27**, Disa nga pjesemarresit, gjate Degjeses me Publikun*

Teme tjeter qe u diskutua ishte mbi **pejzazhin e mbrojtur** – Pjesemarresit kerkuan konfirmim nese PPV ka marre parasysh kufizirin e zones "Peizazh i mbrojtur" pergjate vijes liqenore te Pogradecit. Kjo gje u konfirmua nga prezantuesit si dhe u paraqiten rekomandimet e parashturara ne kete drejtim nder te cilat:

- Moslejimi i veprimtarise minerare ne zonen e peizazhit te mbrojtur ose mundesia qe minierat te shfrytezohen me "traverbak" qe daljen e ka jashte zones se mbrojtur
- Cdo zhvillim ndertimor I parashikuar ne zone duhet te marre paraprakisht aprovimin e institucioneve perkatese qe monitorojne parametrat e dosjes per pranim ne trashegimine botereore te pjeses shqiptare te liqenit te Ohrit.

Ne lidhje me **zonen arkeologjike e palafiteve**. Nga perfaqesuesit e Drejtorise rajonale te Mbrojtjese Monumenteve Kulturore u ngrit çeshtja e zonave arkeologjike te palafiteve dhe e kufinjve qe ato duhet te kene te pasqyruar ne zone. Nga prezantuesit e VSM-së u theksua se çeshtja e zonave arkeologjike eshte e zgjidhur nga rregullroja e PPV-se e cila kerkon respektimin e gjiethe rregullave qe kane te bejne me zonat arrkeolgjike duke e vene keshtu si detyrim edhe ne rastet kur kufiri I zonave arkeolgjike mund te ndryshojne ne te ardhmen.
Mbi **rrëshqitjet**, nga pjesemarresit u kerkua te dihej se cfare rekomandet VSM ne lidhje me situaten e rreqitjeve qe ndodhin ne zonen e Pogradecit sidomos ne zonen prane qytetit. Nga prezantuesit e Konsorciumit u shpjegua se nje nga masat kryesore te rekoamdnuar eshte ri-pyllezimi duke filluar qe nga zonat e larta ne vazhdimesi deri afersi e qytetit te Pogradecit duke krijuar nje brez mbrojtes.

SHTOJCA 02: Dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar

Në tabelën e mëposhtme paraqet një përmbledhje e dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar

Tab. – 69 *Lista e dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar*

Nr.	Akti miratues	Titulli i Strategjisë	Objekti/ qëllimi i strategjisë
1	VKM nr. 405, datë 27.6.2012	Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020	Trajton zgjidhjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara; përfundimi i regjistrimit fillestar të të gjitha pasurive; digjitalizimi i sistemeve.
2	VKM Nr.797, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut	Të mbrojë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe vetë konsumatorët për ushqimet, produkte joushqimore dhe farmaceutikën/medikamente.
3	VKM Nr.773, datë.14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal	Të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin.
4	VKM Nr.1561, datë 3.10.2008	Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013	Trajton reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje
5	Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004	Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë	Trajton tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.
6	VKM Nr. 658 , date 17.10.2005	Strategjia e shërbimeve shoqërore	Trajton situatën e nevojave shoqërore, nxit mirëqenien shoqërore dhe synon/lehtëson integrimin e familjeve që jetojnë në kushte varfërie, të grupeve vulnerabël dhe personave me nevoja të veçanta.
7	VKM Nr.643, datë 14.09.2011	Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	Trajton hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e BE-së
8	VKM Nr.342, datë 12.3.2008	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013	Dokument i vetëm strategjik (axhenda) për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm, të harmonizuar me axhendën e integrimit në BE dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.
9	VKM Nr.847, datë 29.11.2007	Strategjia ndërsektoriale e mjedisit	Trajtim modern dhe i integruar i sektorit mjedisor dhe i sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj.
10	VKM Nr. 751, datë 7.11.2007	Strategjia sektoriale e punësimit	Vendos bazat për përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, dhe zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit.
11	VKM Nr.924, datë 14.11.2007	Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit	Orienton dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit
12	VKM Nr.774, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural	Shërben si një bazë kombëtare, për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënrajoneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin e banorëve në zonat rurale.
13	VKM Nr.519, datë	Strategjia ndërsektoriale e	Trajton përsosjen e sistemit të drejtësisë në

	20.7.2011	drejtësisë	RSH, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare paralelisht me forcimin dhe rritjen e kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe nxitjen e përshpejtimin e integrimit europian.
14	VKM Nr.80, datë 28.01.2008	Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale	Trajton orientimin e politikave horizontale për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social.
15	VKM Nr.844, datë 11.06.2008	Strategjia sektoriale e turizmit 2007 - 2013	Merret me strukturimin dhe zhvillimin e turizmit dhe produkteve të tij si prioritete afatshkurtra dhe afatmesme.
16	VKM Nr.59, datë 21.01.2009	Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit	Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.
17	VKM Nr.760, datë 01.09.2010	Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Garantimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, në funksion të konsolidimit të një sistemi social ekonomik konkurrues me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë, në përputhje me të gjitha kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit të Shqipërisë në BE.
18	VKM Nr.863, datë 29.07.2009	Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009– 2015	Përqendrimin e burimeve financiare në grupe kryesore kërkuesish të aftë, për të arritur një nivel ndërkombëtar njohjeje dhe ekselence.
19		Strategjia Kombëtare e Energjisë	Zhvillimi i një sektori energjetik efektiv që garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike në përgjithësi dhe energji elektrike ne veçanti, dhe nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.
20	VKM Nr.175, datë 19.1.2011	Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet	Zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore
21	VKM Nr.479, datë 29.6.2011	Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025	Përcakton politikat dhe programet e veprimit të menaxhimit të burimeve minerare ekzistuese, si dhe zhvillimin e tyre në perspektivë në përputhje me zhvillimet e reja të ekonomisë shqiptare, prioritetet e zhvillimit të kësaj industrie, me objektivat afatgjatë, objektivat afatmesëm dhe imediatë, vlerësimin e potencialit minerar sipas grup-mineraleve, bazë për vendimmarrjen, planifikimin territorial, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe infrastrukturës, luftës kundër varfërisë, sidomos në zonat rurale, punësimin në vijimësi, përmirësimin e bilancit valutor të vendit, transparencës dhe luftën ndaj korrupsionit, ka si vizion të saj një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke marrë parasysh impaktet ekonomike, mjedisore dhe sociale, bazuar mbi parimet e ndarjes së të ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve konkurruese për tërheqjen e investitorëve dhe balancuese midis së drejtës së licencës

			minerare dhe taksimit të industrive përgjatë zinxhirit të vlerës.
22	VKM Nr. 395, datë 21.6.2006	Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmin kulturor dhe mjedisor	Perceptimin e Shqipërisë si destinacion i pasur kulturor dhe natyror (imazhi) dhe vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore shqiptare, kuptimi i vlerave nga industria turistike dhe komuniteti i gjerë
23	Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005	Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë	Vlerëson mjedisin e brendshëm dhe te jashtëm te sigurisë, përparimet e bëra në transformimin ristrukturimin.
24	VKM Nr.1214, datë 3.9.2008	Strategjia sektoriale e transportit	Zhvillimin e transportit rrugor në Shqipëri

Dokumente strategjikë

VKM nr. 405, datë 27.6.2012	"Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020"
VKM Nr.797, datë 14.11.2007	"Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut"
VKM Nr.773, datë.14.11.2007	"Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal"
VKM Nr.1561, datë 3.10.2008	"Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013"
Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004	"Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë"
VKM Nr. 658 , date 17.10.2005	"Strategjia e shërbimeve shoqërore"
VKM Nr.643, datë 14.09.2011	"Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve"
VKM Nr.342, datë 12.3.2008	"Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013".
VKM Nr.847, datë 29.11.2007	"Strategjia ndërsektoriale e mjedisit".
VKM Nr. 751, datë 7.11.2007	"Strategjia sektoriale e punësimit".
VKM Nr.924, datë 14.11.2007	"Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit".
VKM Nr.774, datë 14.11.2007	"Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural"
VKM Nr.519, datë 20.7.2011	"Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë"
VKM Nr.80, datë 28.01.2008	"Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale"
VKM Nr.844, datë 11.06.2008	"Strategjia sektoriale e turizmit 2007 – 2013"
VKM Nr.59, datë 21.01.2009	"Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit"
VKM Nr.760, datë 01.09.2010	"Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale"
VKM Nr.863, datë 29.07.2009	"Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009–2015"
VKM Nr.175, datë 19.1.2011	"Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet"
VKM Nr.479, datë 29.6.2011	"Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025"
VKM Nr. 395, datë 21.6.2006	"Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmin kulturor dhe mjedisor"
Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005	"Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë"
VKM Nr.1214, datë 3.9.2008	"Strategjia sektoriale e transportit"

SHTOJCA 03: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PROCESIT TË PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË SEKTORIN E MJEDISIT

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit Shqiptar ne fushën e mjedisit me atë të BE-sëe, rrjedh nga Neni 108 i MSA-se, ne te cilin citohet si me poshtë vijon:

1. Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisor.

2. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për fushën e mjedisit.

Prioritetet

Për sa i përket mjedisit, në fushën e ***legjislacionit horizontal***, disa nga prioritetet kryesore kane te bëjnë me:

a. përafrimin e plote te Ligjit "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe Ligjit "Për lejet mjedisore" me Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
b. forcimin e zbatimit te legjislacionit mjedisor,
c. garantimin siç duhet te informimit dhe pjesëmarrjes se publikut në vendimmarrje, bazuar ne detyrimet e Konventës së Aarhusit

Miratimi i projektligjit për ***cilësinë e ajrit*** dhe aktet nënligjore për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe kriteret për disa ndotës të caktuar, si dhe përafrimi i plote i legjislacionit te BE-se, janë disa nga prioritetet kryesore ne këtë fushe. Gjithashtu, me qellim përmirësimin e cilësisë se ajrit, si prioritete te Ministrisë se Mjedisit janë edhe:

a. hartimi i planit kombëtar dhe planeve lokale te veprimit për përmirësimin e cilësisë se ajrit te mjedisit;
b. forcimi i sistemit kombëtar te monitorimit te ajrit urban dhe shkarkimeve ne ajër sipas standardeve evropiane, si dhe;
c. forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave te cilësisë se ajrit ne strategjitë sektoriale te tyre.

Megjithëse, janë miratuar aktet nënligjore për ***menaxhimin e mbetjeve***, si dhe janë përgatitur planet e menaxhimit për Tiranën, Lezhën dhe Shkodrën, përmirësimi i menaxhimit te integruar mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore te punës se Ministrisë se Mjedisit. Ndarja e mbetjeve ne burim, rritja e nivelit te riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plote i hedhjes se mbetjeve ne vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plote i djegies se mbetjeve, ndërtimi i landfilleve sipas standardeve te BE-së, sigurimi i faciliteteve për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve te reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit te mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore ne këtë fushë.

Në fushën e ***cilësisë së ujit***, Ministria e Mjedisit ka si prioritet te punës
se saj:

a) përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit te akteve nënligjore ne zbatim te Ligjit Nr. 111/2012;
b) vlerësimin e shkallës së dëmtimit të baseneve të lumenjve si rezultat i aktiviteteve të subjekteve që shfrytëzojnë inertet lumore dhe ndërmarrja e masave ndëshkuese;
c) krijimi i regjistrit kombëtar te burimeve ujore
d) përmirësimi i menaxhimit te burimeve ujore ne nivel baseni dhe kombëtar nëpërmjet hartimit te strategjisë kombëtare te menaxhimit te integruar te burimeve ujore, hartimit te 2 planeve te menaxhimit te baseneve te lumenjve (Drin-Bune dhe Seman) dhe krijimit te kadastrës elektronike kombëtare te burimeve ujore.

Në fushën e ***mbrojtjes së natyrës***, do te punohet për te garantuar:

a. mbrojtjen e zonave te mbrojtura;
b. zbatimin e rregullave te miratuara në vitin 2011 për ngritjen e zonave të mbrojtjes së veçantë në kuadrin e Natura 2000;
c. marrjen e masave për ndalimin e veprimtarive të paligjshme si gjuetia, prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe;
d. forcimin e kapaciteteve administrative të inspektoratit për goditjen e këtyre fenomeneve.

Për sa i përket ***politikave për zhurmën në mjedis***, një nga prioritetet kryesore ne këtë fushe është forcimi i zbatimit te vendimeve të Task Forcës se ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregliqenore.

Për sa i përket ***ndryshimeve klimatike***, përafrimi i plote me legjislacionin e BE-se, hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, ngritja e sistemit kombëtar të inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe të gazeve me efekt serrë, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të ndryshimeve klimatike në strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet në këtë fushë.

---

[i] Studimi i Fizibilitetit të Lidhjes Hekurudhore Shqipëri Maqedoni

[ii] Ky seksion do të trajtohet në mënyrë më të detajuar në analizën e thelluar të PPV-së

[iii] Burimi: Konsultime me stafin e bashkisë Pogradec

[iv] Agjensia Kombëtare e Mjedisit, 2015